

ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Manual praktik

© OSCE Presence in Albania

Autorë: Marsida Xhaferllari
Dr. Fiona Papajorgji
Përparim Kalo
Drejtuese e Projektit: Luljeta Krasniqi

ISBN 9789928395405

Hartimi i Manualit për Ankimin Kushtetues Individual (Manuali), si dhe publikimi i tij, është mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të Projektit "Forcimi i shtetit të së drejtës dhe promovimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet mbështetjes për Gjykatën Kushtetuese", financuar nga Misioni i SHBA-së në OSBE, Misioni i Përhershëm i Italisë në OSBE dhe Ambasada e Greqisë në Shqipëri. Përmbajtja e Manualit nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.



ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Manual praktik

Gusht, 2024

PËRMBAJTJA E LËNDËS

HYRJE	7
Shkurtime	10
PJESA E PARË - ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL DHE OBJEKTI I TIJ	11
Kreu I - Kuptimi i ankimit kushtetues individual.....	11
Kreu II - Vështrim historik mbi ankimin kushtetues individual.....	15
Seksioni 1 - Para hyrjes në fuqi të Kushtetutës të vitit 1998.....	15
Seksioni 2 - Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës të vitit 1998	18
Seksioni 3 - Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016	20
Kreu III - Objekti i ankimit kushtetues individual.....	21
Seksioni 1 - Vendimet gjyqësore.....	24
Seksioni 2 - Aktet normative.....	26
Seksioni 3 - Raste të veçanta.....	30
PJESA E DYTË - PARAQITJA DHE SHQYRTIMI PARAPRAK I KËRKESËS	33
Kreu I - Paraqitja e kërkesës	33
Seksioni 1 - Elementët formalë të kërkesës	36
Seksioni 2 - Dokumentet shoqëruese	38
Seksioni 3 - Subjektet e interesuara	38
Seksioni 4 - Shpenzimet gjyqësore	40
Kreu II - Kriteret për të ushtruar ankimin kushtetues individual	42
Seksioni 1 - Juridiksioni kushtetues.....	42
Seksioni 2 - Legjitimimi i kërkuesit	45
2.1. Legjitimimi racione personae.....	45
2.2. Shterimi i mjeteve juridike efektive	61
2.2.1 Shterimi formal dhe substancial i pretendimeve.....	62
2.2.2. Mungesa e mjeteve efektive në dispozicion	63
2.2.3. Natyra përfundimtare e aktit që kundërshtohet.....	66
2.2.4. Shterimi i mjeteve për gjykimin brenda afatit të arsyeshëm	73
2.2.5. Shterimi i mjeteve në gjykimin me objekt ligjin ose aktin normativ	75
2.3. Afati për paraqitjen e ankimit	78
2.4. Legjitimimi racione materiae	84
2.4.1 Natyra kushtetuese e pretendimeve	85
2.4.2 Bazueshmëria prima facie e pretendimeve.....	91
2.5.3 Res judicata	92
2.5.4 Rivendosja e së drejtës së shkelur të individit.....	93
Kreu III - Shqyrtimi paraprak i kërkesës.....	96
Seksioni 1 - Rastet e moskalimit të çështjes në seancë plenare.....	97
Seksioni 2 - Vendimmarrja e Kolegjit	98
Seksioni 3 - Vendimmarrja e Mbledhjes së Gjyqtarëve	99

PJESA E TRETË - GJYKIMI KUSHTETUES	102
Kreu I - Shqyrtimi në seancë plenare.....	102
Seksioni 1 - Kuptimi i gjykimit kushtetues	102
Seksioni 2 - Parimet e gjykimit kushtetues	103
Seksioni 3 - Veprimet paraprake të gjykimit kushtetues	105
Seksioni 4 - Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues	107
Seksioni 5 - Zhvillimi i seancës plenare	108
5.1 Solemniteti	111
5.2 Amicus Curiae	111
5.3 Ekspertët dhe dëshmitarët	112
Seksioni 6 - Pezullimi i akteve ligjore.....	113
Seksioni 7 - Procesverbali.....	114
Seksioni 8 - Riçelja e seancës plenare.....	114
Kreu II - Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese	115
PJESA E KATËRT - LLOJET E VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE	118
Kreu I - Vendimet e Gjykatës Kushtetuese	118
Seksioni 1 - Kuadri normativ	118
Seksioni 2 - Klasifikimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese	118
Kreu II - Llojet e vendimeve	120
Seksioni 1 - Vendimet që nuk shqyrtojnë themelin e çështjes	120
Seksioni 2 - Vendimet përfundimtare.....	121
2.1. Vendime të interpretimit të Kushtetutës.....	122
2.2. Vendimet e pranimit të kërkesës.....	123
2.3. Vendimet e rrëzimit të kërkesës.....	124
2.4. Vendimet në lidhje me boshllëkun ligjor	126
2.5. Vendime konstatimi dhe për dëmshpërblim	126
2.6. Vendimet e rrëzimit formal.....	128
Seksioni 3 - Hyrja në fuqi e vendimeve	129
Kreu III - Gabimet në vendimmarrje	130
Seksioni 1 - Plotësimi dhe ndreqja e gabimit në vendim	130
Seksioni 2 - Interpretimi i vendimeve	131
Seksioni 3 - Rihapja e procedurave	132
Kreu IV - Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese	135
Bibliografia.....	137
Aneks 1	145
Aneks 2	147
Aneks 3	151

HYRJE

Projekti *"Forcimi i shtetit të së drejtës dhe promovimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet mbështetjes për Gjykatën Kushtetuese"* është konceptuar të mbështesë më tej një drejtësi kushtetuese transparente, efikase dhe të aksesueshme në Shqipëri, si dhe të kontribuojë në forcimin e shtetit të së drejtës në vend në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e OSBE-së. Projekti zbatohet në periudhën 2022-2025 nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, me financim nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Qeveria Italiane dhe Qeveria Greke.

Manuali për *Ankimin Kushtetues Individual* është një ndër masat në zbatim të komponentit të Projektit, që ka të bëjë me përgatitjen e një pakete me materiale informuese për avokatët, akademikët, studentët e drejtësisë dhe praktikantëve të tjerë të drejtësisë në lidhje me ankimin kushtetues individual, si një mekanizëm i rimodeluar me reformën në drejtësi të vitit 2016. Manuali synon të zgjerojë njohuritë e studentëve si dhe të lehtësojë punën e cilitdo që merret me të drejtën kushtetuese. Ai përmban një sërë shpjegimesh dhe udhëzimesh praktike të punës së përditshme, në kushtet e reformës së thellë kushtetuese të vitit 2016 dhe zhvillimit të vullshëm të jurisprudencës kushtetuese. Megjithatë, shpjegimet dhe udhëzimet që përmban ky Manual nuk janë të detyrueshme, por ofrojnë informacion ndihmës lidhur me *Ankimin Kushtetues Individual*.

Ankimi kushtetues individual ka disa funksione të rëndësishme. *Së pari*, nëpërmjet tij të drejtat dhe liritë themelore të individit kanë mundësi të realizohen efektivisht, duke qenë se kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese prodhon efekte të menjëhershme dhe të drejtpërdrejta për kërkuesin në aspektin juridik. *Së dyti*, mund të thuhet se vendimet e dhëna nga drejtësia kushtetuese, me standardet, parimet dhe argumentat e dhëna për të drejtat dhe liritë themelore të individit, kanë rëndësi dhe ndikojnë jo vetëm tek subjektet private, por dhe sidomos te të gjitha institucionet publike, që janë të detyruar t'i marrin ato në konsideratë si gjatë proceseve gjyqësore, ashtu edhe gjatë procedurave administrative apo iter ligjvënës. *Së treti*, duke marrë parasysh se të drejtat dhe liritë themelore të individit përbëjnë bazat e shtetit të së drejtës, nuk do të kishte kuptim mungesa e një mekanizmi juridik konkret për mbrojtjen e tyre, i cili, mbron më gjerësisht Kushtetutën dhe vetë rendin juridik në tërësinë e tij.

Pas këtyre konsideratave të përgjithshme, duke folur në mënyrë më specifike për objektin kryesor të këtij Manuali, vlen të theksohet se përmbajtja e tij gërsheton traditën e Gjykatës Kushtetuese me ndryshimet normative të vitit 2016. Këto të fundit përfshijnë ndryshimet kushtetuese (ligji nr. 76, datë 22.07.2016 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"*) dhe ligjore të vitit 2016 (ligji nr. 99/2016 *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese"*), së bashku me aktet nënligjore të miratuara nga vetë Gjykata Kushtetuese (Rregullore për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese me vendimin nr. 9, datë 22.12.2021 dhe e ndryshuar me vendimin nr. 13, datë 31.10.2023). Gjithashtu, duhet vënë re se nga pikëpamja metodike, Manuali është pasuruar me referenca nga jurisprudenca 30 vjeçare e Gjykatës Kushtetuese, përfshi vendimet e Kolegjeve dhe të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Në disa raste, referencat ndonëse nuk lidhen drejtpërdrejt me procedurën e ankimit kushtetues individual, janë të vlefshme për

shkak se në vendimet respektive janë interpretuar norma kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme për çdo lloj kompetence të Gjykatës.

Gjithashtu nuk mund të mos theksohet se ky Manual ka për qëllim të japë, në *subiecta materia*, një vështrim të përgjithshëm të ecurisë dhe përparimit të jurisprudencës kushtetuese, duke nisur që nga vitet e para të funksionimit të saj, deri në vendimet e fundit. Për të kuptuar më mirë këtë evoluim, është menduar si e përshtatshme të përshkruhet edhe një kuadër i përgjithshëm i tipareve dalluese të ankimit kushtetues individual, siç janë individualizuar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe janë "huazuar" nga ajo e Gjykatës Kushtetuese.

Nga pikëpamja strukturore dhe për të lehtësuar përdorimin e tij, Manuali është i ndarë në katër pjesë. Secila prej tyre përbëhet nga disa krerë dhe seksione.

Pjesa e parë jep njohuri të përgjithshme për konceptin e ankimit kushtetues individual, shpjegon origjinën dhe vështrimin historik të ankimit kushtetues individual, duke u përqendruar mbi modelin e zgjedhur nga kushtetutbërësi në periudha të ndryshme. Në përpjekje për të përshkruar zhvillimin historik të ankimit kushtetues individual, janë analizuar edhe kriteret juridiko-formalë që ai duhet të përmbushte në secilën periudhë. Në kreun e tretë të pjesës së parë analiza përqendrohet në objektin e ankimit kushtetues individual, sipas parashikimeve aktuale.

Pjesa e dytë trajton paraqitjen e kërkesës, kriteret për të ushtruar ankimin kushtetues individual, shqyrtimin paraprak të tij dhe vendimmarrjen e Kolegjeve të Gjykatës ose Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Punimi në krerët e kësaj pjesë ndalet në konceptet e zhvilluara nga jurisprudenca e Gjykatës, e cila e ka konsideruar ankimin kushtetues individual, *ab origine*, si një formë garancie thelbësore në sistemin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe për rrjedhojë, si mekanizëm praktik për zbatimin e tyre. Për të lehtësuar kuptimin e standardeve dhe parimeve të jurisprudencës kushtetuese janë paraqitur edhe raste konkrete të trajtuara nga Gjykata Kushtetuese, kryesisht ato pas hyrjes në fuqi të reformës së vitit 2016.

Pjesa e tretë shpjegon procedurën e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual në seancë plenare, duke u ndalur tek parimet e gjykimit kushtetues, veprimet paraprake, procedurën e gjykimit, përfshi rastet e riçeljes së seancës plenare, deri në vendimmarrjen e Gjykatës. Po ashtu, në këtë pjesë paraqiten të drejtat dhe detyrimet e palëve, rastet e kërimit nga Gjykata të opinioneve këshillimore, si dhe rastet e pezullimit të akteve ligjore.

Pjesa e katërt dhe e fundit analizon vendimmarrjen e Gjykatës dhe llojet e vendimeve, saktësimin e vendimit, rihapjen e procedurave dhe efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër, në këtë pjesë të punimit nënvizohen edhe *revirement* të jurisprudencës kushtetuese, pra ato raste kur Gjykata ka ndryshuar qëndrimin e saj, të cilat shpesh janë bërë të domosdoshme nën ndikimin e vendimeve të GJEDNJ-së dhe zhvillimeve shoqërore të vendit, si dhe ato raste ku jurisprudenca nuk duket të ketë reflektuar ende sa duhet mbi pasojat që rrjedhin nga nevoja për të respektuar dispozitat e KEDNJ-së dhe ligjin e gjallë mbikombëtar.

Së fundmi, duke marrë në konsideratë nga njëra anë ndryshimet kushtetuese dhe nga ana tjetër divergjencat e opinioneve dhe kontrastet e nxehta që shënojnë debatin politik dhe doktrinar, nëpërmjet këtij Manuali janë formuluar disa reflektime mbi nevojën ose, në çdo rast, mundësinë për të arritur në disa standarde konstante dhe uniforme në jurisprudencën kushtetuese sa i takon ankimit kushtetues individual. Ato synojnë, mbi të gjitha, zbatimin sa më të mirë të tij dhe për rrjedhojë, fuqizimin më tej të mbrojtjes dhe garatimit të të drejtave dhe lirive të individit.

Pjesë e Manualit janë edhe 3 anekse. Në aneksin e parë paraqitet një fjalorth juridik, në të cilin shpjegohen termat juridikë latinë të përdorur në Manual. Në aneksin e dytë jepen një pjesë e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, të cilat kanë shënuar edhe vendimmarjen e Gjykatës Kushtetuese dhe janë referuar në Manual. Ndërsa në aneksin e tretë është paraqitur një model kërkesë e ankimit kushtetues individual.

Duhet theksuar se ankimi kushtetues individual përbën prej vitesh numrin më të madh të kërkesave që i drejtohen Gjykatës (rreth 85%), prandaj dhe shqyrtimi i tyre zë vëllimin më të lartë të kompetencës së saj. Ky fakt ka lejuar jo vetëm rrënjosjen progresive të një ndërgjegjësimi gjithmonë e në rritje për të drejtat kushtetuese në opinionin publik, por edhe rritjen e besueshmërisë dhe besimit kolektiv që i nevojitet vetë Gjykatës, për të përputhur realitetin shoqëror me parimet (dhe/ose rregullat) e së drejtës pozitive.

SHKURTIME

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

ILD – Inspektori i Lartë i Drejtësisë

KC – Kodi Civil

KF – Kodi i Familjes

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

KLJG – Këshilli i Lartë Gjyqësor

KLP – Këshilli i Lartë i Prokurorisë

KP – Kodi Penal

KPA – Kolegji i Posaçëm i Apelit

KPC – Kodi i Procedurës Civile

KPK – Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

KPP – Kodi i Procedurës Penale

Kushtetuta – Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, të ndryshuar.

Ligji Antimafia – Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Ligji i Gjykatave Administrative – Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Ligji i Pronave – Ligji nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar.

Ligji i Statusit të Magjistratëve – Ligji nr. 96/2016, datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji Organik i Gjykatës – Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar.

Rregullore e Gjykatës – Rregullore për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, miratuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese me vendimin nr. 9, datë 22.12.2021 dhe e ndryshuar me vendimin nr. 13, datë 31.10.2023.

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

PJESA E PARË

ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL DHE OBJEKTI I TIJ

Kreu I

Kuptimi i ankimit kushtetues individual

1. Dy janë format e aksesit të individit në kontrollin kushtetues: aksesit individual i tërthortë dhe ai i drejtpërdrejtë. I pari përfshin rastet kur kushtetutshmëria e një norme apo e një akti mund të kundërshtohet vetëm nëpërmjet organeve ose subjekteve publike. Këto organe janë të mandatuara posaçërisht për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (për ilustrim, në rastet e parashikuara nga Kushtetuta, bëhet fjalë për Avokatin e Popullit apo komisionerët për të drejta specifike të njeriut), për zgjidhjen e çështjeve konkrete (gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nëpërmjet rrugës së kontrollit incidental të normës ligjore të zbatueshme prej tyre në zgjidhjen e çështjes) ose subjekte që veprojnë për interes publik, në të cilin përfshihet edhe mbrojtja e sistemit normativ dhe e parimeve shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale, të shpalosura në Kushtetutë dhe që bazohen në respektimin e të drejtave të njeriut (për ilustrim një e pesta e deputetëve).¹ Aksesit i tërthortë është një mjet i rëndësishëm mbrojtës i të drejtave dhe lirive themelore në nivel kushtetues për shkak të mënyrës se si ai realizohet. Organet ose subjektet që paraqesin ankim kushtetues janë të mirëinformuara dhe zotërojnë aftësitë ligjore për të hartuar një kërkesë të formuluar saktë në formë dhe përmbajtje, duke eliminuar në këtë mënyrë kërkesat abuzive ose të përsëritura. Gjithsesi efektiviteti i këtij mjeti varet kryesisht nga aftësia e tyre për të identifikuar aktin normativ antikushtetues, por edhe nga vullneti i tyre për të paraqitur ankimin në Gjykatën Kushtetuese. Përvoja ka treguar se këto organe ose subjekte përgjithësisht aktivizohen kur çështja kushtetuese ka ndjeshmëri të lartë publike, për shkak të rëndësisë së të drejtave themelore që janë në lojë ose të numrit të lartë të individëve të prekur.
2. Aksesit individual i drejtpërdrejtë ushtrohet nëpërmjet *actio popularis* dhe ankimit kushtetues individual. *Actio popularis* nënkupton që çdo person ka të drejtë të aktivizohet kundër një akti normativ pas miratimit të tij, pa pasur nevojë të provojë se preket individualisht drejtpërdrejt nga dispozita. Siç ka pohuar Kelsen, *actio popularis* është garancia më e gjerë e një rishikimi gjithëpërfshirës kushtetues, pasi çdo individ mund të bëjë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese. Ankuesi në këtë rast nuk ka nevojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të tij themelore.²

¹ Shih vendimin nr. 1, datë 16.01.2017. Një prej subjekteve që vunë në lëvizje Gjykatën ishte edhe një e pesta e deputetëve për kontrollin e kushtetutshmërisë së Ligjit të Pronave.

² Shih Studim mbi aksesin individual në drejtësinë kushtetuese, miratuar nga Komisioni i Vencias në mbledhjen plenare të datave 17-18 dhjetor 2010, CDL-AD (2010) 039 rev.

3. Ndërsa ankimi kushtetues individual përbën një mekanizëm në dispozicion të çdo individi, person fizik ose juridik, me të cilin ai vë në lëvizje drejtpërdrejt gjykimin kushtetues për mbrojtjen përfundimtare të të drejtave dhe lirive themelore të tij, kur ai pretendon se i janë cenuar nga akte të pushtetit publik, përfshi vendimet gjyqësore. Në kuptimin procedural, ai është akti i kërkesës apo ankesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, ndërsa në kuptimin material është e drejta e individit që të dëgjohet mbi themelin e pretendimit për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore dhe që Gjykata Kushtetuese të vendosë mbi të.
4. Përsa i takon origjinës së ankimit individual në Europë, ideja sipas të cilës, individi mund t'i drejtohet një autoriteti gjyqësor, duke pretenduar shkeljen e të drejtave kushtetuese nga aktet ose sjelljet e autoriteteve administrative, juridiksionale, legjislative ishte parashikuar në Kushtetutat e Badenit dhe Bavarisë të vitit 1818, nga e cila u huazua në Kushtetutën e Weimarit të vitit 1919 dhe më pas, në Kushtetutën austriake të vitit 1920, për t'u zbatuar përfundimisht në *Grundgesetz* gjerman dhe në tekste të tjera që kanë parashikuar ankimin individual kushtetues të drejtpërdrejtë në mbrojtje të të drejtave kushtetuese (i quajtur *Verfassungsbeschwerde* në vendet gjermanishtfolëse).
5. Në Shqipëri, duhet vënë re se Kushtetuta (në tekstin aktual) kur parashikon kompetencat e Gjykatës Kushtetuese përdor disa terma: "kërkesë"³ dhe "ankesë"⁴, për çdo mjet juridik që vë në lëvizje gjykimin kushtetues, si dhe termin "ankesë e individit"⁵. Ligji Organik i Gjykatës dhe Rregullorja e Gjykatës i referohen me termin "ankim kushtetues individual" dhe "kërkesë". Jurisprudenca kushtetuese duke marrë parasysh terminologjinë e ndryshme në Kushtetutë, ligj dhe Rregullore, i referohet si me termin "ankim kushtetues individual", ashtu edhe me "kërkesë".
6. Ankimi kushtetues individual, pas reformës në drejtësi të vitit 2016⁶, parashikohet në mënyrë të shprehur në dy dispozita të Kushtetutës. Bëhet fjalë për nenin 131, pika 1, shkronja "f"⁷, kur përcaktohet kompetenca e Gjykatës Kushtetuese, si dhe nenin 134, pika 1, shkronja "i"⁸, në lidhje me subjektet që mund ta përdorin këtë mjet. Nga këto dy dispozita rezulton në mënyrë të qartë që drejtësia kushtetuese, në të cilën sot mund të ketë akses çdo individ, pavarësisht nëse është person fizik apo juridik, shfaqet si një instrument i një garancie të përgjithshme ndaj çdo cenimi që aktet e pushtetit publik mund t'u bëjnë të drejtave themelore. Me fjalë të thjeshta, ankimi kushtetues individual përmirëson jetën e qytetarëve, ndërsa Gjykatën Kushtetuese e shndërron në një gjykatë të të gjithë individëve. Ky ndikim i ankimit kushtetues individual mund të ilustron me dy shembujt e mëposhtëm.

³ Neni 134, pika 1 e Kushtetutës, kur parashikon subjektet që e vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese citon: "vihet në lëvizje me kërkesë"; ndërsa pika 2 e po të njëjtit nen parashikon se: "Subjektet e parashikuara nga nënparagrafët "d", "dh", "e", "ë", "f", "g", "gj", "h" dhe "i", të paragrafit 1, të këtij neni, mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre".

⁴ Neni 133, pika 1 e Kushtetutës parashikon se "Pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj".

⁵ Neni 131, pika 1, shkronja "f" e Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos: "gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve ...".

⁶ Ligji nr. 76, datë 22.07.2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

⁷ Neni 131, pika 1, shkronja "f" e Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos: "gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shtuar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë".

⁸ Neni 134, pika 1, shkronja "i" e Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: ... (i) individëve.

Shembull 1 – E drejta për t'u zgjedhur (vendimi nr. 31, datë 04.10.2021 i Gjykatës Kushtetuese)

Kërkuesi ishte kandidat i propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare. Ai paraqiti ankim kushtetues individual për kundërshtimin e pikës 1 të nenit 162 të Kodit Zgjedhor, që përcaktonte si prag zgjedhor kombëtar marrjen e 1% të votave të përgjithshme për të gjitha subjektet zgjedhore. Kërkuesi pretendoi se kjo normë ligjore i cenonte të drejtën për t'u zgjedhur dhe parimin e barazisë së votave e mundësive të barabarta, të sanksionuar në nenin 45 të Kushtetutës meqenëse ai kandidonte vetëm në një zonë zgjedhore dhe merrte vota vetëm aty, ndërkohë që partitë politike mbledhin vota nga të gjitha zonat zgjedhore të Republikës së Shqipërisë.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se *"kandidati i propozuar nga zgjedhësit, si kusht për të përfituar nga shpërndarja e mandateve, duhet të arrijë pragun kombëtar 1%, por faktikisht nuk ka mundësi reale të konkurrojë në shkallë kombëtare për ta arritur atë. Praktikisht është shumë e vështirë, madje thuajse e pamundur, që një kandidat i pavarur të fitojë mandat për të përfaqësuar mbështetësit e zonës së tij zgjedhore"*. Për këto arsye Gjykata shfuqizoi, si të papajtueshme me Kushtetutën, fjalinë e dytë të pikës 1 të nenit 162 të Kodit Zgjedhor, në pjesën që barazon kandidatët e propozuar nga zgjedhësit me kandidatët e propozuar nga partitë politike ose nga koalicion partish politike.

Shembull 2 – E drejta për arsim dhe e drejta për punë (vendimi nr. 1, datë 25.01.2024 i Gjykatës Kushtetuese)

Një grup studentësh të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë të Tiranës (UMT) iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual për kundërshtimin e disa dispozitave të ligjit nr. 60/2023, datë 21.07.2023 "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e Përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë", si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dispozitat e kundërshtuara lidheshin me nënshkrimin e një marrëveshjeje me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik. Sipas marrëveshjes, studenti: (i) në varësi nëse regjistrohet në ciklin e dytë të studimeve, apo është student i vitit të dytë deri në vit të katërt, apo student i vitit të pestë dhe të gjashtë, duhet të punojë në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për, respektivisht, jo më pak se 5 vite, 3 vite dhe 2 vite, në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë; (ii) pranon që diploma e tij të kalojë nga institucioni publik i arsimit të lartë në institucionin shëndetësor ku punësohet, deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit; dhe (iii) ka të drejtë ta tërheqë diplomën universitare pas përmbushjes së detyrimit të punësimit.

Gjykata e shqyrtoi çështjen në këndvështrimin e të drejtave kushtetuese për punë dhe arsim, të garantuara respektivisht nga nenet 49 dhe 57 të Kushtetutës. Ajo vlerësoi se afatet e ligjit nuk janë proporcionale për arritjen e qëllimit (garantimi i ofrimit të shërbimit shëndetësor) pasi ishin më të ashpra në raport me rrethanat që i kishin diktuar ato (plotësimin e vendeve vakante për mjekë). Për këtë arsye, Gjykata i shfuqizoi ato duke përcaktuar gjithashtu se nënshkrimi i marrëveshjes së parashikuar në ligjin nr. 60/2023 nuk mund të kryhet, derisa të vendosen afatet e reja nga ligjvënësi.

7. Rastet e paraqitura më lart, përveçse tregojnë se si individët garantojnë të drejtat e tyre kushtetuese, evidentojnë gjithashtu se ankimi kushtetues individual është një mjet për mbrojtjen edhe të drejtave substanciale dhe mund të përdoret edhe për kundërshtimin e ligjeve, duke kërkuar shfuqizimin e tyre. Ndërkohë, para vitit 2016, individi mund t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar vetëm shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të juridiksionit të zakonshëm, dhe ekskluzivisht për të garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.
8. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut jo gjithmonë respektohen nga institucionet publike, kështu që detyrimi që këto të fundit mbartin për t'i garantuar ato⁹, nuk përbën në vetvete një garanci. Për këtë arsye në Shqipëri, sikurse në vendet e tjera me demokraci të re, në përpjekje për të vendosur dhe konsoliduar shtetin e së drejtës, ka marrë rëndësi të veçantë parashikimi në rang kushtetues i instrumenteve materiale dhe procedurale të instancave të fundit, që kanë për qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore dhe që mund të aktivizohen kur mjetet e zakonshme nuk kanë pasur efektin e pritshëm.
9. Në fakt, ekziston një lidhje e ngushtë midis parimit të shtetit të së drejtës, demokracisë dhe të drejtave themelore. Është e vështirë të konceptohet demokracia dhe të drejtat themelore, të paktën në kontekstin e demokracive liberale evropiane, pa shtetin e së drejtës. Pa shtetin e së drejtës nuk ka barazi përpara ligjit, apo të drejta themelore efektive. Në të njëjtën kohë, pa demokraci apo të drejta themelore do të viheshin në pikëpyetje elementët kryesorë dhe objektivat e shtetit të së drejtës.¹⁰
10. Normalisht, kur të drejtat dhe liritë themelore shkelen, mbrojtja mund të kërkohet në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, sepse çdo gjykatë (e zakonshme ose e veçantë) duhet t'i zbatojë dhe t'i respektojë ato rreptësisht. Nëse, sidoqoftë, cenimi i pësuar nuk është riparuar, personit nuk i mbetet veçse, mjeti i jashtëzakonshëm (d.m.th. subsidiar), të paraqesë ankim individual në Gjykatën Kushtetuese. Prandaj, kjo e fundit jo vetëm që duhet të konstatojë shkeljen, duke identifikuar edhe organin përgjegjës, por gjithashtu të tregojë mënyrën më të mirë për ta korigjuar atë (shkeljen). Pas vendimit të saj, organet kompetente janë të detyruara të zbatojnë vendimin në përputhje me arsyetimin dhe parimet e përcaktuara nga vetë Gjykata Kushtetuese.
11. Nga kjo rrjedh se, nga njëra anë, ankimi individual konsiderohet tashmë një mjet efektiv dhe i pazëvendësueshëm i garancisë kushtetuese, dhe, nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese barazohet me një gjykatë të vërtetë të të drejtave të njeriut. Prandaj, nëse nisemi nga konsiderata e pakundërshtueshme, se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përbëjnë bazat e shtetit të së drejtës, për një realitet demokratik në zhvillim, si nga ana ekonomike ashtu edhe nga ajo civile, është me të vërtetë e rëndësishme ekzistenca e një mekanizmi efektiv përfundimtar për t'i mbrojtur ato në rast se mjetet e tjera dështojnë, duke bërë të mundur të mbrohet Kushtetuta *tout court*.
12. Së fundmi, duhet vënë re se ankimi kushtetues individual është mjeti përfundimtar në nivel të brendshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi më tej, nëse individi beson se edhe përdorimi i këtij mjeti nuk i ka ofruar mbrojtjen e dëshiruar, ai mund t'i drejtohet GJEDNJ-së.

9 Neni 15, pika 2 i Kushtetutës parashikon: "Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre".

10 M. P. Maduro, *Mutual trust, mutual recognition and the rule of law*, The XXX FIDE Congress in Sofia, 2023 Congress publications, Vol. 1, fq. 2.

Kreu II

Vështrim historik mbi ankimin kushtetues individual

13. Ankimi kushtetues individual ka regjistruar një evoluim i cili, për lehtësi të analizës, mund të ndahet në tre faza të veçanta. E para është ajo që i përket viteve 1991-1998, pra para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, faza e dytë u përrua në vitin 1998, me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së re¹¹ dhe përfundoi me hyrjen në fuqi të reformës kushtetuese të vitit 2016, ndërsa faza e tretë lidhet me periudhën post reformës në fjalë.

Seksioni 1

Para hyrjes në fuqi të Kushtetutës të vitit 1998

14. Pas ndryshimeve epokale me rënien e murit të Berlinit dhe zhvillimit të strukturave të reja politiko-ekonomike-sociale në të gjithë Evropën Lindore, Kushtetuta e vjetër shqiptare¹², e cila nuk mund të zbatohej më në regjimin e ri, u zëvendësua me ligjin kushtetues nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", i modifikuar më pas disa herë.
15. Gjykata Kushtetuese u krijua me një prej këtyre modifikimeve, konkretisht me ligjin kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Ky ligj në nenin 24, pika 9 parashikonte se: "Gjykata Kushtetuese ka këto kompetenca: ... Zgjidh përfundimisht ankesat e personave të paraqitur në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme". Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë kanë bërë betimin para Presidentit të Republikës në datë 19 Maj 1992¹³, ndërsa Gjykata ka filluar nga funksionet e saj më 1 Qershor 1992¹⁴. Vendimi i parë përfundimtar është marrë në datën 13.07.1992. Vitet e para Gjykata Kushtetuese funksionoi bazuar në normat kushtetuese dhe parimet e përgjithshme të së drejtës, pasi ligji nr. 8373, datë 15.07.1998 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili detajoi bazën normative për veprimtarinë e saj, u miratua pak përpara hyrjes në fuqi të Kushtetutës, pas pothuajse 6 vjetësh nga fillimi i funksionimit të Gjykatës.
16. Në ato vite, individi kishte mundësinë t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese të sapokrijuar për të kërkuar shfuqizimin e akteve të paligjshme që cenonin të drejtat e tyre themelore të sanksionuara me Kushtetutë. Ndërkohë klauzola "e procesit të rregullt ligjor" u parashikua nga ligji kushtetues nr. 7692, datë 31.03.1993 "Për një shtojcë në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese". Neni 38 i këtij ligji citonte: "Liria, prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor".¹⁵

11 Ajo u aprovua me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 nga Parlamenti, e konfirmuar me referendum të datës 22.11.1998 dhe e shpallur me dekret nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Shqipërisë. Ajo u konsiderua unanimisht si teksti i parë organik themelor demokratik i vendit të shqiponjave pas luftës së dytë botërore. Shih A. LOIODICE, N. SHEHU, *La Costituzione albanese*, in A. LOIODICE (a cura di) *Profili di Innovazione*, Caccuci, Bari, 1999, fq. 33 e vijues.

12 Pas çlirimit të vendit dhe vendosjes së pushtetit komunist, në vitin 1946 u shpall Republika Popullore e Shqipërisë si dhe hyri në fuqi kushtetuta e re. Në vitin 1976 u miratua një kushtetutë tjetër që stilizoi Shqipërinë si "Republikë Popullore Socialiste".

13 Gjyqtarët Manol Konomi, Franc Jakova, Natasha Sheshi dhe Ylvi Myrtja u dekretuan nga Presidenti i Republikës me dekretin nr. 182, datë 18.05.1992. Gjyqtarët Feti Gjilani, Hilmi Dakli, Rustem Gjata, Veli Budo dhe Thimjo Kondi u zgjedhën nga Kuvendi në të njëjtën periudhë. Kryetari i parë i Gjykatës ishte gjyqtari Rustem Gjata.

14 Shih vendimin nr. 4, datë 02.06.1995 të Gjykatës Kushtetuese për ripërtëritjen e anëtarëve të saj.

15 E njëjta klauzolë u përdor edhe në Kushtetutën e vitit 1998, duke nënvizuar, edhe nga këndvështrimi terminologjik dhe simbolik, respektimin e plotë dhe të pakushtëzuar të rendit të ri shqiptar me parimet e KEDNJ-së, në të cilën në nenin 6 parashikohet pikërisht "e drejta për një proces të rregullt".

17. Në lidhje me juridiksionin e saj, Gjykata bazuar në nenin 24, pika 9 të ligjit kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992, u shpreh se rezulton në mënyrë të qartë e pa ekuivoke se juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për këtë kategorinë e çështjeve konkrete – *ankesat e personave të paraqitur në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme* – nuk është juridiksion fillestar. Kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese mund të investohet për një shkelje të të drejtave kushtetuese, vetëm pasi shqyrtimi i saj të ketë përfunduar në të gjitha organet e tjera shtetërore të përcaktuara me ligj, si dhe në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të të gjitha shkallëve.¹⁶
18. Sidoqoftë, para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, kjo mundësi kontrolli kushtetues nuk është shfrytëzuar shumë, ndoshta edhe për shkak të mungesës së vetëdijes, apo familjaritetit, në lidhje me risitë e prezantuara nga rendi demokratik, veçanërisht në lidhje me rolin dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese¹⁷.

Seksioni 2

Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës të vitit 1998

19. Në këtë periudhë, ankimi kushtetues individual, parashikohej proceduralisht në nenin 131, shkronja "f" dhe nenin 134, shkronja "g" të Kushtetutës¹⁸ dhe materialisht bazohej në nenin 42 të saj, sipas të cilit "*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*". Caktimi i një kuptimi të saktë të së drejtës për proces të rregullt ligjor, ndërlikohej në funksion të faktit se Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës¹⁹, ndërsa e sanksiononin atë, nuk ofronin as edhe përkufizimin më të vogël. Ky boshllëk, sidoqoftë, u plotësua nga vetë Gjykata Kushtetuese, e cila jo vetëm që përdori një lexim/interpretim analogjik-sistematik të bazuar në parime të tjera themelore, por edhe huazoi disa koncepte të përpunuara nga jurisprudenca mbikombëtare (GJEDNJ-ja) dhe jurisprudenca kushtetuese e vendeve të tjera.
20. Nuk bëhet fjalë për një qasje origjinale të Gjykatës Kushtetuese, por për një qasje që i përket fenomenit të quajtur kozmopolitanizëm gjyqësor. Konkretisht, ditët e sotme, e drejta kushtetuese konsiderohet si një "konfigurim i hapur" i parimeve dhe i të drejtave themelore, përmbajtja e të cilit përcaktohet në mënyrë dinamike përmes ndërveprimit konstruktiv të sistemeve ligjore të vendeve të ndryshme. Me fjalë të tjera, organet publike bëjnë adoptim reciprok dhe balancues të vlerave kushtetuese, sidomos në fushën e të drejtave, por duke ruajtur në mënyrë konstante edhe kufijtë e sistemit ligjor respektiv. Gjykatat Kushtetuese gjenden në zemër të këtij procesi dialektik, i cili përfshin të gjithë shoqërinë në një nivel diskursiv si një përpjekje kolektive për garantimin e vlerave kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut.²⁰

16 Shih vendimin nr. 5, datë 15.04.1994 të Gjykatës Kushtetuese.

17 Sigurisht në fillimet e saj, siç deklaronte një nga hartuesit e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese krijoi përvojën e parë të drejtësisë kushtetuese dhe nuk mund të mos ishte një gardiane e ndrojtur e kushtetutës së përkohshme. Si për çdo gjykatë të tillë të krijuar rishtazi, rëndësia e saj nuk qëndronte aq në dhënien e një drejtësie të paqortueshme se sa në faktin që ajo ka qenë ekzistente dhe vepruese. K. Traja, *Drejtësia Kushtetuese*, Luarasi, Tiranë, 2000, fq. 246.

18 Neni 131, shkronja "f" e Kushtetutës parashikonte se: "*Gjykata Kushtetuese vendos për ... gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave*". Neni 134, shkronja "g" parashikonte se: "*Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje vetëm me kërkesë të: ... g) individëve*" dhe në pikën 2 të tij përcaktonte se subjektet e parashikuara nga shkronja "g" "*mund të bëjnë kërkesë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tyre*".

19 Me hyrjen në fuqi të këtij ligji u shfuqizua ligji nr. 8373, datë 15.07.1998 "*Për organizimin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*".

20 G. F. Ferrari, *Judicial Cosmopolitanism*, Brill Nijhoff, Leiden, Boston, 2019, fq. 3-4.

21. Gjithsesi ankimi kushtetues individual në atë periudhë u kufizua si mjet vetëm kundër rasteve të cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor²¹, dhe, prandaj, kishte si objekt vetëm vendimet gjyqësore, dhe, në raste shumë të veçanta, akte të tjera të pushtetit publik²². Ideja e pranuar nga Parlamenti për zvogëlimin e rasteve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese mbështetej mbi argumentin se çdo e drejtë themelore e njeriut e gjen vendin e saj më të natyrshëm të mbrojtjes në juridiksionin e zakonshëm, dhe për pasojë, ankimi kushtetues duhet të shërbejë ekskluzivisht për një kontroll të mëtejshëm dhe të jashtëzakonshëm të vetë pushtetit gjyqësor dhe të kufizuar në mosrespektimin e së drejtës së procesit të rregullt ligjor. Në fakt, ndryshimi i miratuar në momentin e fundit nga Parlamenti në tekstin e propozuar nga kushtetutbërësi ka krijuar jo pak perpleksitet²³.
22. E drejta për një proces të rregullt ligjor është – po ta mendosh mirë – vetëm një nga të drejtat themelore të individit, e cila posaçërisht ka të bëjë me rregullsinë e procesit administrativ dhe atij gjyqësor të zakonshëm, ndaj nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme për të siguruar mbrojtjen e të gjitha të drejtave të tjera themelore të njeriut, të tilla si dinjiteti, liria personale, prona private. Prandaj sa i takon ankimit individual, Gjykatës Kushtetuese, i është dashur të kufizohej në kontrollin e proceseve të zhvilluara nga gjyqësori i zakonshëm, në lidhje me rregullsinë e përdorimit të mjeteve procedurale, pasi nuk ishte në gjendje të merrte në shqyrtim çështje të tjera, edhe pse ishin po aq të rëndësishme nga pikëpamja e themelit. Kështu Gjykata nuk mund të kontrollonte kushtetutshmërinë e një ligji apo akti normativ mbi të cilin bazohej zgjidhja e çështjes në themel nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, kompetencë e cila në atë kohë, do të ushtrohej nga Gjykata Kushtetuese vetëm në rast të kërkesave në rrugë incidentale (nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm²⁴), ose të kontrollit të kushtetutshmërisë së akteve normative (nga subjektet e ndryshme nga individi, të parashikuara nga Kushtetuta²⁵).
23. Pavarësisht kësaj, Gjykata Kushtetuese, duke kërkuar të interpretojë rolin e saj në një mënyrë aktive dhe të ekuilibruar në lidhje me nevojat e sistemit, e konsideroi të drejtën për një proces të rregullt ligjor si një parim të pazëvendësueshëm të rendit juridik, duke lidhur në mënyrë të pazgjidhshme vetë ekzistencën e tij me nocionin e shtetit të së drejtës²⁶. Kështu, përmes një interpretimi logjik të gjerë të konceptit të procesit, ajo e ka zgjeruar sferën e të drejtave themelore të përfshira në të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke e kthyer me kalimin e kohës, si në një nga kompetencat më të rëndësishme të Gjykatës.²⁷ Kjo e fundit ka kërkuar, në kufijtë e mundshme, të zgjerojë rastet që hyjnë në sferën e mbrojtjes të kësaj të drejte, si dhe të ofrojë në këtë mënyrë mundësi të tjera të ankimit kushtetues individual.²⁸
24. Konkretisht në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese theksoi se "... përveç të drejtës për një proces të rregullt ligjor (nenit 42), disa nga të drejtat e tjera kushtetuese individuale që parashikohen

21 *Debatë Kushtetues - Diskutimet në Komisionin Parlamentar për Hartimin e Projekt-Kushtetutës së vitit 1998*, Vëllimi i Dytë, P.S.H., Tiranë, 2006, fq. 26 e vijues.

22 Xh. Zaganjori, A. Anastasi, E. (Methasani) Cani, *Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH*, Aldeprint, Tiranë, 2011, fq. 88 e vijues.

23 Teksti origjinal i propozuar në Parlament ripropozonte modelin deri në atë kohë ekzistent, edhe pse shumë pak të ushtruar, të ankimit kushtetues. K. Traja, *Drejtësia Kushtetuese*, vep. cit., fq. 263.

24 Neni 145 pika 2 i Kushtetutës.

25 Neni 134 i Kushtetutës.

26 Edhe në preambulën e KEDNJ-së, procesi i rregullt, në çështjet civile dhe penale, është një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës dhe pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese. C. Ovey, C.A. White, *The European Convention on Human Rights*, Fourth edition, Oxford University Press, New York, 2006, fq. 158.

27 S. Sadushi, *Kontrolli kushtetues*, Botimpex, Tiranë, 2004, fq. 182.

28 K. Traja, *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe procesi i rregullt ligjor sipas Kushtetutës shqiptare*, në *10 vjet Gjykatë Kushtetuese*, Buletin i Posaçëm, Botim i Gjykatës Kushtetuese, Klean, Tiranë, 2003, fq. 65.

në nenet 29²⁹, 31³⁰, 32³¹, 34³² të Kushtetutës shfaqen njëkohësisht edhe si aspekte të rëndësishme të një procesi të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese, konfirmon edhe një herë qëndrimin e saj, se pretendimet për shkeljen e parimeve themelore që përmbajnë këto të drejta themelore individuale, në kuptim të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës, janë objekt shqyrtimi në këtë gjykatë".³³

25. Dhe jo vetëm kaq. Gjykata Kushtetuese e ka shtrirë këtë të drejtë, nga proceset gjyqësore, gjithashtu në ato administrative dhe madje edhe në veprimtarinë e komisioneve parlamentare hetimore, nisur edhe nga fakti se termi i përdorur nga nenet 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f" e Kushtetutës është proces "ligjor", pra më i gjerë se ai "gjyqësor".
26. Kështu, në vitin 2002, gjatë shqyrtimit të ankimit të Prokurorit të Përgjithshëm, me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë dhe të dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin e tij nga detyra, Gjykata theksoi se *"ndërsa në Konventën (evropiane) parashikohet e drejta e individit për një gjykim të drejtë penal apo civil, në nenin 42 të Kushtetutës dhe në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ"*³⁴. Ky ka qenë një prej vendimeve që ka shënuar progres të rëndësishëm të institutit në fjalë, duke zgjeruar rastet e ankimit kushtetues individual.
27. Gjithashtu, në vitin 2008, Gjykata konsolidoi qëndrimin e saj, duke sqaruar që e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin jo vetëm vendimet gjyqësore, por edhe ato me karakter administrativ dhe/ose disiplinor. Ajo u shpreh se për kundërshtimin e *"vendimit të Kuvendit dhe të dekretit të Presidentit për shkarkimin nga detyra (të Prokurorit të Përgjithshëm), kërkuesi nuk mund të vërë në lëvizje ndonjë organ tjetër shtetëror për shqyrtimin e tyre veç Gjykatës Kushtetuese, sepse asnjë prej organeve të tjera shtetërore nuk ka në kompetencë shqyrtimin e këtyre kërkesave"*³⁵.
28. Gjykata, po ashtu, ia ka nënshtuar kontrollit të saj, gjithmonë në kuadër të ankimit individual, edhe aktet që ndikojnë në të drejtat e organeve të tjera kushtetuese, duke deklaruar se ato nuk i shpëtojnë detyrimit për të respektuar elementet e procesit të rregullt ligjor (kjo e fundit e interpretuar në një kuptim të gjerë).
29. Kështu, në vitin 2003 ajo shqyrtoi ankimin e një prokurori, i cili kishte kërkuar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm anulimin e dekretit të Presidentit të Republikës për transferimin e tij nga zyra e Prokurorisë së Përgjithshme në atë të prokurorisë së rrethit. Nevoja për t'iu drejtuar gjykimit kushtetues bazohej në faktin që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kishin vendosur pushimin e gjykimit duke arsyetuar se dekretet e Presidentit të Republikës, duke përfshirë edhe ato të largimit apo transferimit nga detyra të prokurorëve, nuk mund të kundërshtohen në gjykatë pasi ato janë të natyrës juridiko-kushtetuese dhe jo akte administrative. Sipas tyre, Kushtetuta nuk parashikonte për prokurorët ndonjë mjet juridik kundërshtimi përderisa, qëndrimi i tyre në detyrë bazohej në një vendimmarrje të karakterit diskrecional të Presidentit të Republikës. Gjykata Kushtetuese në atë rast theksoi se *"vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është*

29 Neni 29 i Kushtetutës parashikon mosdënimin pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*).

30 Neni 31 i Kushtetutës parashikon të drejtat gjatë procesit penal.

31 Neni 32 i Kushtetutës parashikon parimin e mosdënimimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

32 Neni 34 i Kushtetutës parashikon mosdënimin më shumë se një herë për të njëjtin vepër penale dhe të mos gjykimit sërish (*ne bis in idem*).

33 Shih vendimin nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

34 Shih vendimin nr. 76, datë 25.04.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

35 Shih vendimin nr. 21, datë 01.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

*rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, sepse i ka mohuar prokurorëve të drejtën e ankimit në gjykatë kundër dekreteve të Presidentit*³⁶.

30. *Kriteret paraprake, që Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës, përpara ndryshimeve të vitit 2016, parashikonin për të ushtruar ankim kushtetues individual, pra për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, lidheshin me: (i) subjektet që i drejtoheshin Gjykatës, pra individët; (ii) afatin për paraqitjen e kërkesës; (iii) shterimin e mjeteve juridike; dhe (iv) natyrën kushtetuese të pretendimeve.*
31. *Kushtetuta në nenet 131, pika 1, shkronja "f", 134, pika 1, shkronja "g", dhe 134, pika 2 i referohej individit si një prej subjekteve që mund t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese. Si i tillë, në jurisprudencën kushtetuese është konsideruar çdo titullar (mbartës) i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, pra çdo person fizik ose juridik.*
32. *Shterimi i mjeteve juridike lidhet me detyrimin që ka individi për të shfrytëzuar paraprakisht të gjitha mjetet dhe mundësitë procedurale të ofruara nga legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të tij. Mjetet juridike konsiderohen të ezauruara kur, sipas rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera juridike në dispozicion. Pra, vendimet gjyqësore mund të bëhen objekt i shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese, kur nuk ka mjete të tjera ligjore për mbrojtjen e të drejtave të individit. Ky ishte qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese, i shfaqur që në vendimet e para të saj, kur është marrë në shqyrtim çështja e legjitimitetit të kërkuarit³⁷, qëndrim i cili u konsolidua dhe nuk u ndryshua në vijim në jurisprudencën e saj³⁸.*
33. *Ligji Organik i Gjykatës në nenin 30, pika 2 të tij³⁹, parashikonte një afat dy vjeçar nga data e vendimit gjyqësor të formës së prerë për paraqitjen e kërkesave për (mos) respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Shumë dyshime janë ngritur në lidhje me kohëzgjatjen e këtij afati, veçanërisht në krahasim me situatën ekzistuese në vendet e tjera që parashikojnë ankimin kushtetues individual⁴⁰. Duke marrë parasysh, sidoqoftë, se ankimi individual përfaqësonte një risi absolute, e cila u prezantua me vendosjen e regjimit të ri demokratik, të paktën në periudhën e parë të funksionimit të Gjykatës, periudha dy-vjeçare e lartpërmendur u vlerësua e përshtatshme, e nevojshme dhe funksionale për një ndërgjegjësim më të madh të opinionit publik, profesionistëve, si dhe të çdo pale ndërgjyqëse, publike apo private, të cilët, kishin nevojë për më shumë kohë për të "metabolizuar" një mekanizëm plotësisht të ri, si dhe për të përcaktuar më mirë strategjitë e tyre procedurale.*
34. *Gjithsesi me kalimin e kohës, shkurtimi i këtij afati filloi të dukej më i përshtatshëm në respekt edhe të një parimi tjetër po aq të rëndësishëm, atij të sigurisë juridike, në mënyrë që të garantohej racionaliteti dhe koherenca në fushën e drejtësisë.*
35. *Sa i takon natyrës së pretendimeve, duhet të theksohet se kontrolli që ushtronte Gjykata nuk kishte të bënte me themelin e mosmarrëveshjes objekt të procesit gjyqësor, por vetëm me vlerësimin kushtetues të aspekteve formale/procedurale të procesit gjyqësor ose administrativ. Përndryshe,*

³⁶ Shih vendimin nr. 38, datë 23.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁷ Shih vendimet nr. 29, datë 23.03.1999 dhe nr. 30, datë 23.03.1999 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁸ Shih *ex plurimis* vendimet nr. 17, datë 18.07.2005; nr. 15, datë 18.04.2007; nr. 27, 20.06.2007; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 1, datë 19.01.2009; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 1, datë 25.01.2010; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁹ Neni 30, pika 2 parashikonte: "Kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes. Kur në bazë të ligjit individi mund t'i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në këtë rast, afati i paraqitjes së kërkesës është 2 vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror".

⁴⁰ Duke i analizuar në mënyrë krahasimore të dhënat, rezulton se bëhet fjalë për një periudhë që varion nga tre 3 deri në 12 muaj nga vendimi përfundimtar.

ajo do të kryente funksionet e një gjykate të shkallës së katërt të sistemit të zakonshëm gjyqësor, duke shqyrtuar vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ajo “ndërhyn vetëm në ato raste kur gjykatat e zakonshme shkelin të drejtën për një proces të rregullt ligjor. ... Gjykata nuk rivlerëson faktet dhe rrethanat, por kryen një vlerësim kushtetues, të ndryshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm”⁴¹. Ajo shtoi se, përveç vlerësimit të provave, edhe “interpretimi i ligjit është atribut i organeve që e zbatojnë atë” dhe për këtë arsye, jo i Gjykatës Kushtetuese.⁴²

36. Si përfundim, mund të thuhet se ankimi kushtetues individual, edhe pse i kufizuar vetëm për të drejtat procedurale, në periudhën 1998 - 2016, ka qenë një mjet shumë i dobishëm për mbrojtjen e individit nga proceset e padrejta administrative ose gjyqësore. Përkundër kësaj, jurisprudenca kushtetuese e asaj periudhe krijoi terrenin e duhur për zgjerimin e kompetencave të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ankimin kushtetues individual, i cili u bë i domosdoshëm edhe nga ndikimi i vendimeve të GJEDNJ-së⁴³, që jo pak herë ka konsideruar Gjykatën, si mjet jo efektiv për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit, përgjithësisht atyre me natyrë substanciale.

Seksioni 3

Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016

37. Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 zgjeruan më tej kompetencën e Gjykatës në lidhje me ankimin kushtetues individual. Qëllimi ishte të hiqeshin pengesat e vendosura për aksesin e individit në Gjykatë, të cilat, sikurse u evidentua më lart (*shih supra paragrafët 23-29*), u arritën vetëm pjesërisht të eliminohen nga vetë Gjykata⁴⁴. Ndër këto ndryshime vlen të përmendet paraprakisht shkurtimi i afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual nga 2 vjet në 4 muaj. Një ndryshim tjetër, me qëllim forcimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, kishte të bënte me pozicionin e Avokatit të Popullit, i cili për shkak të misionit të tij⁴⁵ ndryshoi nga subjekt i kushtëzuar në subjekt të pakushtëzuar. Pra, nëse para reformës së vitit 2016, ai mund të bënte kërkesë vetëm për çështje që lidheshin me interesat e tij dhe duhet ta provonte interesin në gjykimin kushtetues, tashmë Avokati i Popullit nuk e ka më një detyrim të tillë.
38. Edhe me këto ndryshime Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës (i cili gjithashtu është modifikuar)⁴⁶ përsëri nuk ofrojnë përkufizimin e ankimit kushtetues individual⁴⁷. Aktualisht ai parashikohet nga nenet 131, pika 1, shkonja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” të Kushtetutës, si dhe nga nenet 71, pika 1⁴⁸, 71/

41 Shih vendimet nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

42 Shih vendimet nr. 6, datë 10.02.2014 dhe nr. 19, datë 23.12.2004 të Gjykatës Kushtetuese.

43 Shih vendimet *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05, datë 27.05.2010; *Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 10508/02, datë 23.10.2007; *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, datë 18.12.2007.

44 Për sa i përket funksionimit të Gjykatës Kushtetuese, dokumenti analitik i sistemit të drejtësisë në Shqipëri, i hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, i emëruar nga Komisioni parlamentar i reformës në drejtësi, evidenton problematikat dhe nevojën e reformës së saj. Për më shumë të dhëna shih http://www.reformanedrejtesia.al/sites/default/files/dokumenti_shqip.pdf.

45 Neni 60, pika 1 i Kushtetutës parashikon se: “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”.

46 Ligji nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

47 Edhe neni 34 (*kërkesat individuale*) i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, por parashikon se: “Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktime të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose në protokollet e saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte”.

48 Neni 71, pika 1 i Ligjit Organik të Gjykatës citon: “Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kritereve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji”.

a⁴⁹ dhe 49, pika 3, shkronja "e"⁵⁰ të Ligjit Organik të Gjykatës. Pavarësisht mungesës së përkufizimit, në Kreun VII të Ligjit Organik të Gjykatës që parashikon "Procedurat e veçanta", për herë të parë është shtuar "Procedura për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual", që rregullohet nga nenet 71 dhe vijues të ligjit.

39. Sipas këtyre dispozitave çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të përcaktuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës, secili prej të cilëve do të analizohen në vijim.
40. Fillimisht vlen të theksohet se në vitet 2016-2019 nuk kishte jurisprudencë kushtetuese të konsoliduar në këtë drejtim, si për shkak të mungesës së përdorimit të këtij mjeti nga individët menjëherë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të reja (nëntor 2016), ashtu edhe për shkak të mungesës për një periudhë prej më shumë se dy vjetësh (maj 2018 – dhjetor 2020), të kuorumit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare nga Gjykata Kushtetuese. Gjyqtarët e kësaj të fundit, si çdo gjyqtar dhe prokuror tjetër, iu nënshtruan procesit të rivlerësimit kalimtar (të njohur si procesi *vetting*), i cili bëri që Gjykata të humbë kuorumin për të funksionuar⁵¹.
41. Sidoqoftë, pas plotësimit të kuorumit të nevojshëm ligjor për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare (dhjetor 2020), mund të thuhet se tashmë Gjykata ka mbajtur qëndrime të konsoliduara për disa aspekte të ankimit kushtetues individual. Bazuar në këtë jurisprudencë si dhe nga përcaktimet e dispozitave të lartpërmendura mund të nxirren disa konsiderata paraprake, të cilat përfaqësojnë elementë të rëndësishëm të ankimit kushtetues individual, siç do të analizohen në vijim.

Kreu III

Objekti i ankimit kushtetues individual

42. Neni 131, pika 1, shkronja "f" i Kushtetutës përcakton se individ i ankohet ndaj "çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon liritë dhe të drejtat themelore". Ligji Organik i Gjykatës, këtë koncept kushtetues e ka zbërthyer në nenin 71, cili në përmbajtjen e tij citon "çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë", që në "raste të veçanta mund të jetë ligj ose akt tjetër normativ"⁵².

49 Neni 71/a parashikon kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual.

50 Neni 49, pika 3 i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon: "Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe: ... e) individët, kur pretendojnë se u cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara në Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për këtë qëllim, si dhe kur akti që kundërshtojnë është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij".

51 Me ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i janë nënshtruar procesit të *vetting*-ut edhe gjyqtarët kushtetues. Për shkak të shkarkimit të disa gjyqtarëve, dorëheqjeve nga funksioni, por edhe mbarimit të mandatit, Gjykata Kushtetuese për një periudhë mbeti me vetëm një gjyqtar në detyrë, duke humbur kuorumin prej 6 gjyqtarësh të kërkuar nga neni 32, pika 1 i Ligjit Organik të Gjykatës për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare. Të njëjtën situatë kritike kaluan edhe institucionet e tjera gjyqësore, përfshirë Gjykatën e Lartë.

52 Neni 71 në pikën 1 të tij citon: "Çdo individ, [...], ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë" dhe në pikën 2 parashikon se "Objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, sipas nenit 49, pika 3, të këtij ligji", ndërsa sipas nenit neni 49 pika 3, individët kanë të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative, kur pretendojnë se u cenohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe reale të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara në Kushtetutë.

43. Siç konstatohet lehtësisht, tashmë ankimi kushtetues individual është i mundur të ushtrohet kundër çdo akti publik dhe nuk kufizohet më vetëm ndaj vendimeve të dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për të drejtën për një proces të rregullt ligjor (edhe pse të nënkuptuar dhe zbatuar në mënyrë të gjerë falë jurisprudencës kushtetuese, *shih supra paragrafët 23-29*).
44. *Objekti i ankimit* lidhet me të drejtën që Kushtetuta i ka dhënë individit për të paraqitur ankim në Gjykatë, ndërsa nga pikëpamja formale, objekti është kërkimi që i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, që ajo të marrë një vendim të caktuar, me efekt detyrues. Ai mund të formulohet me një ose më shumë kërkime, në varësi të numrit të akteve që individi kundërshton, si dhe të natyrës së të drejtave ose lirive themelore që janë shkelur. Si rregull, objekti paraqitet në hyrje të aktit të ankimit dhe formulohet si kërkim për shfuqizimin e vendimit gjyqësor, shfuqizimin e ligjit ose të aktit tjetër normativ. Megjithatë, nuk mungojnë edhe situata të veçanta, ku objekti formulohet si kërkim për konstatimin e shkeljes së të drejtës ose lirisë themelore. Pjesë e objektit të ankimit është edhe *baza juridike*, që përfshin referencat kushtetuese dhe ligjore, procedurale dhe materiale, që mbështesin ankimin kushtetues individual (*shih ankesin nr. 2*).
45. Duhet vënë re që baza juridike është e ndryshme nga *shkaku juridik* i ankimit. Ndryshimi i tyre është i rëndësishëm në planin praktik sepse mungesa ose pasaktësia e bazës juridike të paraqitur nga ankuesi, nuk e pengon shqyrtimin e ankimit bazuar në parimin *iura novit curia* (gjykata e di vetë ligjin), ndërsa mungesa ose pasaktësia e shkakut juridik passjell rrëzimin e ankimit sepse në këtë mënyrë, në thelb, pretendimi është i pabazuar. Shkaku juridik i ankimit ka të bëjë me gjendjen e faktit që i kundërvihet të drejtës ose lirisë themelore të individit. Thënë ndryshe, ai është rrethana faktike që tregon cenimin e një të drejte ose lirie themelore, rrethanë e cila mbështet nga pikëpamja kushtetuese kërkimin për shfuqizimin e aktit të pushtetit publik ose vendimit gjyqësor. Në ndryshim nga objekti, shkaku paraqitet në përmbajtje të ankimit.

Shembull

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor për të kërkuar detyrimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave t'i paguajë dëmin e shkaktuar si rrjedhojë e vonësës në pagimin e vlerës së kompensimit për pronën e shpronësuar gjatë regjimit komunist, vlerë e cila ishte njohur me vendim gjyqësor përfundimtar. Gjykatat civile të dy shkallëve të para kanë pranuar padinë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e këtyre vendimeve, duke rrëzuar padinë.

Kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese *ankim kushtetues individual*, me:

objekt shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë;

bazë juridike nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
nenet 27, 71 dhe 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës;

shkak juridik pretendon se i është cenuar e drejta e *për proces të rregullt ligjor* (gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj), e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Sipas tij, çështja e tij duhet të ishte shqyrtuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe jo nga Kolegji Administrativ. Ky i fundit nuk ka qenë kompetent nga pikëpamja lëndore, pasi kërkimi kryesor ka qenë kundërshtimi i vendimit të KKKP-së dhe pasojat e tij, i cili hyn në kompetencën e gjykatave civile dhe jo atyre administrative, ndaj dhe kërkimi i shpërblimit të dëmit, si rrjedhojë e vendimit të KKKP-së, është në kompetencë të juridiksionit gjyqësor civil.

46. Formulimi i saktë i objektit dhe shkakut të ankimit paraqet rëndësi të veçantë sepse përcakton lëndën që do të marrë në shqyrtim Gjykata. Në këtë kuptim, ato jo vetëm orientojnë dhe lehtësojnë gjykimin kushtetues, por mbi të gjitha vendosin kufijtë e shqyrtimit kushtetues të çështjes⁵³.
47. Gjykata në jurisprudencën e saj për përcaktimin e objektit të kërkesës i referohet jo vetëm objektit formal të paraqitur në ankim, por edhe përmbajtjes së argumenteve të ankimit, ndonjëherë edhe e riformulon atë.⁵⁴ Në këtë rast bëhet fjalë për një parim i përgjithshëm për të gjitha llojet e gjykimit (pra edhe ato që zhvillon gjykata e zakonshme⁵⁵), i cili ka të bëjë me zbatimin e së drejtës. Sipas këtij parimi, i cili në jurisprudencën kushtetuese cilësohet *iura novit curia*, gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me normat juridike në fuqi, duke bërë cilësimin e saktë juridik të fakteve të mosmarrëveshjes, pa u lidhur me përcaktimin e propozuar nga palët. Kjo do të thotë se Gjykata mund ta strukturojë dispozitivin e vendimit ndryshe nga objekti i propozuar prej ankuesit, por gjithmonë duke ruajtur thelbin e përmbajtjes së kërtimeve të tij.
48. Gjykimi kushtetues rregullohet nga e drejta kushtetuese, që është degë e së drejtës publike. Për këtë arsye, në ndryshim nga gjykimi i zakonshëm civil, ku vepron tërësisht parimi i disponibilitetit të padisë dhe lidhja ngushtësisht e disponimit të gjykatës me kërkimet e palëve, në gjykimin kushtetues, Gjykata Kushtetuese me nismën e saj mund të shprehet edhe përtej objektit të kërkesës. Kështu, kur ajo shqyrton kushtetutshmërinë e një akti dhe arrin në përfundimin se ai bazohet mbi një ligj ose akt normativ antikushtetues, gjykata vendos njëkohësisht edhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ⁵⁶. Ky është një rregull përjashtimor, i cili ka si element të domosdoshëm verifikimin e lidhjes që duhet të ekzistojë midis objektit të gjykimit kushtetues dhe një akti normativ⁵⁷, të ndryshëm nga ai i përcaktuar në objektin e ankimit. Verifikimi i lidhjes është i domosdoshëm, që do të thotë se shkelja e të drejtave dhe lirive themelore mund të riparohet ose parandalohet vetëm përmes disponimeve shtesë të Gjykatës.
49. Është e rëndësishme të evidentohet se shkakuri juridik për kundërshtimin e akteve të pushtetit publik ose vendimeve gjyqësore lidhet vetëm me cenimin e të drejtave dhe lirive themelore, që njihen, mbrohen dhe garantohen shprehimisht në tekstin kushtetues. Në këtë mënyrë, mbrojtja e të drejtave të tjera të parashikuara në nivel ligjor apo nënligjor nuk mund të realizohet nëpërmjet ankimit individual kushtetues. Gjykata Kushtetuese, duhet ritheksuar, nuk është gjykatë e shkallës së katërt, apo e një shkalle superiore në hierarki ndaj atyre të juridiksionit të zakonshëm, arsye për të cilën ajo nuk mund të marrë në konsideratë çdo shkelje të rregullave të rendit juridik, por vetëm të atyre kushtetuese.
50. Megjithatë ekziston një mundësi e tërthortë për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm përmes kontrollit kushtetues, të vënë në lëvizje me ankim individual. Bëhet fjalë për ato raste kur objekti i ankimit lidhet me shfuqizimin e vendimeve gjyqësore për shkak të cenimit të të drejtës për proces të rregullt ligjor. Kjo e fundit përbën të drejtë kushtetuese të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, e cila ka në përmbajtje të saj verifikimin kushtetues të procesit gjyqësor të zakonshëm, i cili në thelb është gjykim për mbrojtjen edhe të të drejtave dhe interesave të ligjshëm (pra jo vetëm atyre kushtetues).

53 Neni 48, pika 1 i Ligjit Organik të Gjykatës, i cili parashikon se: "*Kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të*".

54 Shih vendimet nr. 76, datë 05.07.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese; nr. 97, datë 19.07.2022; nr. 48, datë 20.04.2022; nr. 31, datë 18.03.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

55 Neni 16, paragrafi 1 i KPC-së; neni 17, pika 2 i Ligjit të Gjykatave Administrative, si dhe neni 375 i KPP-së.

56 Neni 71/b i Ligjit Organik të Gjykatës.

57 Neni 48, pika 2 i Ligjit Organik të Gjykatës.

51. Lind pyetja se cili është objekti material i ankimit kushtetues individual. Pavarësisht nga termat e ndryshëm të përdorur në normat juridike përkatëse “akt i pushtetit publik”, “vendim gjyqësor”, “akt”, “ligj” ose “akt tjetër normativ”⁵⁸, nuk duket se ka dyshim mbi faktin se individi mund të kundërshtojë në Gjykatën Kushtetuese çdo shprehje zyrtare të vullnetit të pushtetit ligjvënës, të pushtetit ekzekutiv (aktet administrative me karakter të përgjithshëm apo individual, të nxjerra në zbatim të ligjit), të pushtetit gjyqësor (vendimet gjyqësore përfundimtare), si dhe të Presidentit të Republikës, të organeve ndihmëse të qeverisë, të autoriteteve të pavarura administrative, të subjekteve ose organeve vendore, apo të ndonjë institucioni tjetër publik, me kusht që të ekzistojnë edhe kriteret e tjera për ushtrimin e ankimit kushtetues individual (të cilat do të argumentohen më poshtë). Nga kjo pikëpamje, duket që termi më gjithëpërfshirës është ai i aktit të pushtetit publik.
52. Duke ndjekur tipologjinë e objektit material të ankimeve individuale të paraqitura në Gjykatë, ato mund të kategorizohen në: (i) vendime gjyqësore; (ii) akte normative; (iii) raste të veçanta.

Seksioni 1

Vendimet gjyqësore

53. Vendimet gjyqësore janë objekt i ankimit individual kur ato kanë natyrë përfundimtare në kuptimin kushtetues, që është një koncept i ndryshëm nga vendimi përfundimtar në procedurat e juridiksionit gjyqësor të zakonshëm. Në kuptimin kushtetues, vendimi gjyqësor përfundimtar lidhet me natyrën përfundimtare të mbrojtjes kushtetuese, pra me faktin se ankimi kushtetues është mjete i fundit, pasi individi nuk ka më mjete juridike në dispozicion për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore. Po ashtu, ky koncept kushtetues lidhet edhe me parimin e subsidiaritetit që zbatohet në raportet midis juridiksionit gjyqësor dhe atij kushtetues, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut⁵⁹. Për rrjedhojë, ndryshe nga procedurat e juridiksionit gjyqësor, vendime gjyqësore përfundimtare në kuptimin kushtetues konsiderohen edhe ato që nuk zgjidhin themelin e mosmarrëveshjes gjyqësore, siç është rasti i vendimit gjyqësor për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor⁶⁰, vendimi i mospranimit të padisë për shkak të paraqitjes jashtë afatit⁶¹ ose vendimi për sqarimin dhe interpretimin e vendimit gjyqësor përfundimtar⁶² (për më shumë detaje, shih *infra* paragrafët 228 e vijues për natyrën përfundimtare të vendimit).
54. Vlen të risillet në vëmendje se vendimet gjyqësore më parë ishin objekt i gjykimit kushtetues vetëm nëse pretendohet cenimi i së drejtës për proces të rregullt ligjor, ndërsa sot individi mund të pretendojë edhe cenimin e të drejtave të tjera, të cilat nuk janë garantuar në mënyrë të përshtatshme nga juridiksioni i zakonshëm. Me fjalë të tjera, Gjykata Kushtetuese tashmë ka kompençë të shqyrtojë jo vetëm shkeljet për të drejtat procedurale (të drejtën për proces të rregullt ligjor), por edhe edhe për të drejtat materiale. Përsa u takon këtyre të fundit, rastet më të shpeshta të evidentuara deri më tani në jurisprudencën e Gjykatës lidhen me të drejtën e pronës⁶³ ose lirinë personale⁶⁴, të cilat duket se reflektojnë edhe zhvillimet shoqërore të vendit.

58 Neni 131 i Kushtetutës, nenet 49, pika 3, shkronja “e”, 71 dhe 71/b të Ligjit Organik të Gjykatës.

59 Sipas parimit të subsidiaritetit, të drejtat e njeriut duhet të mbrohen në radhë të parë dhe domosdoshmërisht nga gjykatat e zakonshme.

60 Shih vendimet nr. 33, datë 23.04.2024; nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

61 Shih vendimin nr. 22, datë 25.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

62 Shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

63 Shih vendimet nr. 31 datë 18.04.2024; nr. 29 datë 16.04.2024; nr. 18 datë 19.03.2024; nr. 14 datë 07.03.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

64 Shih vendimet nr. 19 datë 21.03.2024; nr. 17 datë 13.03.2024; nr. 10, datë 28.02.2024; nr. 24, datë 24.07.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

55. Ankimi individual ka për objekt kundërshtimin e vendimit gjyqësor në dy hipoteza: (i) kur shkak për cenimin e të drejtave ose lirive themelore të tij është bërë veprimtaria e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm; dhe (ii) kur shkak për cenimin e të drejtave ose lirive themelore të tij është bërë veprimtaria e organeve të tjera publike, akti publik i të cilave është kundërshtuar nga individ i në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe këto të fundit, nuk e kanë ndrequr ose rivendosur shkeljen e pësuar.
56. Në hipotezën e parë, bëhet fjalë për liritë dhe të drejtat themelore, garantimi dhe respektimi i të cilave është detyrim i drejtpërdrejtë i gjykatave, siç janë e drejta për proces të rregullt në të gjitha aspektet e saj, përfshirë edhe atë të gjykimit të drejtë që lidhet me mënyrën arbitrare të interpretimit të ligjit - neni 42 i Kushtetutës, i parë së bashku me parime të tilla si mosdënimi pa ligj (*nullum crimen nulla poena sine lege*) - neni 29 i Kushtetutës⁶⁵; të drejtat gjatë procesit penal - neni 31 i Kushtetutës⁶⁶; parimi i mosdeklarimit fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme - neni 32 i Kushtetutës⁶⁷; mosdënimi më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykimit sërish (*ne bis in idem*) - neni 34 i Kushtetutës⁶⁸.
57. Ndërsa në hipotezën e dytë pretendimet janë të larmishme. Ato përfshijnë pothuajse të gjitha të drejtat dhe liritë substanciale, në varësi të lëndës dhe pasojës që ka akti i nxjerrë nga organet e pushtetit publik. Mund të përmenden këtu si shembull pretendimet e lidhura me cenimin e së drejtës së pronës - neni 41 i Kushtetutës⁶⁹; lirisë personale - neni 27 i Kushtetutës⁷⁰; së drejtës së votës - neni 45 i Kushtetutës⁷¹; së drejtës së jetës private - nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës⁷²; së drejtës për pension - neni 52 i Kushtetutës⁷³. Akti në këto raste ka natyrë individuale, për kundërshtimin e të cilit rendi ynë juridik i jep të drejtën individit ta kundërshtojë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pra janë akte të ndryshme nga ato normative, pasi për këto të fundit, objekti dhe procedura e gjykimit kushtetues ka specifika të tjera.
58. Mund të ndodhë, që kur shkak i ankimit individual lidhet me veprimtarinë e organeve publike, individ i të ngrejë pretendime edhe për veprimtarinë e gjykatave, pretendime të cilat janë në njëfarë mënyre autonome ndaj atyre që i kundrejtohen aktit të pushtetit publik. Për ilustrim: një shoqëri tregtare është ankuar për cenimin e të drejtës së pronës nga akti administrativ "njoftim i detyrimeve tatimore" i lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve bazuar në një ligj të shfuqizuar, duke ngritur njëherazi edhe pretendimin se gjykatat e zakonshme, ku ai u ankua për aktin administrativ, jo vetëm që nuk ia rivendosën të drejtën, por i cenuan edhe të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të sigurisë juridike dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.⁷⁴
59. Është e kuptueshme se, kur individ i kundërshton vendimet gjyqësore, rëndësi të veçantë ka përcaktimi i saktë i shkakut juridik të ankimit, pra saktësimi i shkeljes konkrete të së drejtës ose lirisë themelore dhe gjykatën që e ka shkaktuar këtë shkelje. Saktësimi i shkakut përcakton objektin e ankimit individual dhe kufijtë e gjykimit kushtetues, pra nëse do të kërkohet dhe vendoset shfuqizimi vetëm i vendimit gjyqësor të shkallës më të lartë apo i të gjitha vendimeve gjyqësore të

65 Shih vendimin nr. 14, datë 11.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

66 Shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr.1, datë 12.01.2007; nr. 2, datë 25.01.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

67 Shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 8, datë 19.03.2018; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

68 Shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 10, datë 02.04.2009; nr. 8, datë 28.02.2012; nr.33, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

69 Shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022 dhe nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

70 Shih vendimet nr. 24, datë 27.04.2023, nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

71 Shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

72 Shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

73 Shih vendimin nr. 23, datë 25.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

74 Shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese

dhëna në çështjen e tij. Ndonëse në praktikë, Gjykata nuk ka patur ndonjë rast, ku të ketë vendosur përveç shfuqizimit të vendimeve gjyqësore, edhe shfuqizimin e aktit të pushtetit publik, në teori një mundësi e tillë nuk përjashtohet duke mbajtur në konsideratë që vetë akti i pushtetit publik mund të ketë sjellë cenimin e të drejtave themelore dhe riparimi i tyre bëhet i mundur vetëm duke e shfuqizuar atë.

60. Gjithashtu, sikurse do të analizohet dhe më poshtë, nëse ankimi kushtetues individual ka për objekt disa vendime dhe Gjykata vendos shfuqizimin vetëm të njërit prej tyre, ajo shprehet për pranimin e pjesëshëm të kërkesës⁷⁵. Ndërkohë nëse objekti ka një ose disa vendime dhe ai/ato shfuqizohen të gjitha, pavarësisht se disa pretendime mund të vlerësohen të pabazuara, vendoset pranimi (tërësisht) i kërkesës⁷⁶.

Seksioni 2

Aktet normative

61. Aktet normative janë objekt i ankimit kushtetues individual kur ato cenojnë drejtpërdrejt liritë dhe të drejtat themelore të individit. Ndonëse Kushtetuta, në nenin 131, pika 1, shkronja "f" kur rregullon të drejtën e ankimit kushtetues individual, flet për aktet e pushtetit publik, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës dhe Ligjit Organik të saj⁷⁷, është e qartë që një prej llojeve të akteve të pushtetit publik janë aktet normative.
62. Aktet normative rregullohen nga nenet 116 – 120 të Kushtetutës. Neni 116 i Kushtetutës lidhet me parimin e hierarkisë së akteve. Ai trajton llojet e akteve normative, duke bërë një kategorizim të tyre sipas sferës së fuqisë së tyre, në: (i) akte që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës, ku përfshihen Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave; (ii) akte të pushtetit vendor që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të tyre; dhe (iii) akte normative të ministrave dhe organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore, që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës, por brenda sferës së juridiksionit përkatës.
63. Ndër këto lloje aktesh normative, konceptet e Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara dhe ligjeve, të cilat janë ushtrim normal i pushtetit ligjvënës qendror, nuk kanë krijuar diskutime në praktikë në rastet e shqyrtimit të ankimeve individuale kushtetuese. Ndryshe paraqitet situata kur pushteti ekzekutiv nxjerr akte rregulluese me natyrë të përgjithshme pasi në respekt të parimit të ndarjes së pushteteve dhe atij të shtetit të së drejtës lind e nevojshme të verifikohet respektimi i kufijve të kompetencës dhe i procedurës. Këtu bëhet fjalë për aktet normative të pushtetit ekzekutiv – Këshillit të Ministrave, ministrave dhe organeve drejtuese, të cilat në shumicën e rasteve marrin formën e aktit normativ nënligjor. Në mënyrë të ngjashme, diskutimi për kufijtë kushtetues të ushtrimit të kompetencave vlen edhe për aktet e pushtetit vendor, në kushtet kur ky i fundit organizohet sipas parimit të decentralizimit dhe vepron sipas parimit të subsidiaritetit.
64. Akti nënligjor është instrumenti që bën të zbatueshëm ligjin. Ai nxirret nga organi i autorizuar nga ligji dhe sipas një procedure formale. Akti nënligjor bën pjesë në aktet normative dhe renditet në

⁷⁵ Shih vendimet nr. 23 datë 25.04.2023; nr. 21 datë 18.04.2023; nr. 16, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

⁷⁶ Shih vendimet nr.13, datë 21.03.2023; nr. 41, datë 18.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

⁷⁷ Shih nenin 49, pika 3, shkronja "e" dhe pika 4; nenin 50, pika 4.

hierarki poshtë ligjeve. Ligji e përkufizon aktin nënligjor si vendim të organit publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj dhe me karakter normativ, në kuptimin që vendos rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron në zbatimin e tij⁷⁸. Këtë koncept të aktit nënligjor duket që e ka huazuar edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, duke u shprehur se një akt nënligjor ka karakter normativ kur vendos norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektsh⁷⁹.

65. Neni 118 i Kushtetutës i jep kuptim kushtetues dhe doktrinar konceptit “rezervë ligjore”, nëpërmjet të cilit kufizohet ose orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Ai trajton në mënyrë specifike çështje që lidhen me aktet normative nënligjore, duke vendosur disa kritere në këtë drejtim: (i) nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë; (ii) ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte; (iii) organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, nuk mund t’ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.
66. Kur flitet për pushtetin normativ të Këshillit të Ministrave, duhet evidentuar edhe koncepti i *aktit normativ me fuqinë e ligjit* i parashikuar në nenin 101 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto lloj aktesh i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili duhet të mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Ato e humbasin fuqinë që nga gjeneza, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.
67. Gjykata në disa raste e ka konsideruar veprimin e qeverisë për nxjerrjen e akteve nënligjore si cenim të kufijve të rezervës ligjore kur ligji nuk ka bërë asnjë delegim tek ekzekutivi për të rregulluar një çështje konkrete (rezervë ligjore absolute) ose kur ekzekutivi ka rregulluar çështje të tjera nga ato që i ka deleguar ligjvënësi (rezerva ligjore relative). Në rastin e rezervës ligjore relative, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat, nga njëra anë, e detyrojnë ligjvënësin t’u përmbahet atyre në mënyrë rigorozë dhe, nga ana tjetër, orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore⁸⁰.
68. Në nenin 119 të Kushtetutës parashikohet se rregulloret e Këshillit të Ministrave, të ministrave e të institucioneve të tjera qendrore, si dhe urdhrat e Kryeministrit, të ministrave e të drejtuesve të institucioneve qendrore kanë karakter të brendshëm dhe janë të detyrueshme vetëm për njësitë administrative që varen prej tyre. Këto akte nxirren në bazë të ligjit dhe nuk mund të shërbejnë si bazë për të marrë vendime në lidhje me individët dhe subjektet e tjera. Rregulloret dhe urdhrat nxirren në bazë dhe për zbatim të akteve që kanë fuqi juridike të përgjithshme.
69. Ndërsa neni 120 i Kushtetutës i referohet akteve vendore të pushtetit vendor, ku vihet re se përdoret termi *akte juridike vendore*. Sipas këtij neni, parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj.

78 Neni 28, shkronja “a” i ligjit nr. 9000/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; neni 2, pika 3 i Ligjit të Gjykatave Administrative; dhe neni 2, pika 3 i Kodit të Procedurave Administrative.

79 Shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2016 dhe nr. 11, datë 09.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

80 Shih vendimet nr. 11, datë 09.03.2021; nr.7, datë 27.02.2013; nr. 12, datë 28.04.2009; nr.24, datë 24.07.2009; nr.17, datë 25.07.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

70. Duhet evidentuar se Gjykata në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se individi, si subjekt i kushtëzuar sipas nenit 134 pika 2 të Kushtetutës, legjitimohet për kundërshtimin e akteve normative vetëm kur vërteton interesin vetjak, real dhe të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, pra lidhjen shkakësore që duhet të ekzistojë midis aktit normativ dhe cenimit të lirisë dhe të drejtave themelore të tij. Në këtë kuptim, kur Gjykata arrin në përfundimin se ato nuk janë cenuar, nuk i merr në konsideratë pretendimet ndaj aktit normativ, që lidhen me parimet ose garancitë procedurale kushtetuese.⁸¹
71. Objekt i ankimit kushtetues individual mund të jetë edhe boshllëku ligjor⁸², i njohur edhe si ometim legjislativ ose *lacuna legis*. Ai lidhet me mosveprimin e pushtetit ligjvënës dhe përbën një anomali të sistemit ligjor që shkakton probleme juridike, të cilat duhen zgjidhur. Sipas nenit 76, pika 5, të Ligjit Organik të Gjykatës, kur kjo e fundit, gjatë shqyrtimit të një çështjeje, konstaton se ka boshllëk ligjor, si pasojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative për të drejtat dhe liritë themelore të individit, ajo, ndër të tjera, vendos detyrimin e ligjvënësit të plotësojë kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar.
72. Çështjen e boshllëkut ligjor Gjykata e ka trajtuar në jurisprudencën e saj që prej vitit 1997⁸³ në shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Kombëtare për Mbrojtjen Sociale të të Dënuarve. Gjykata nuk i gjeti të bazuara pretendimet e kërkuases në lidhje me aktet normative objekt kërkesë, por konstatoi boshllëk legjislativ në fushën e trajtimit të të dënuarve me heqje të lirisë me shpërblime në raste aksidentesh në punë, sëmundjesh etj., si dhe në përgjithësi të trajtimit të tyre përsa i përket kushteve të jetesës, të punës, të drejtave për edukim profesionalë e arsimor etj. Për këtë arsye, ajo rekomandoi miratimin e një ligji tërësor për të drejtat dhe detyrat e të dënuarve me heqje të lirisë, të bazuar në dispozitat kushtetuese të vendit tonë dhe rregullat e trajtimit të të burgosurve të miratuara nga Këshilli Ekonomik e Shoqëror i Kombeve të Bashkuara me rezolutat 663 C, datë 31 korrik 1957 dhe 2076, datë 13 maj 1977. Prandaj, Gjykata në dispozitiv vendosi të miratohet ligji për të drejtën e invalidëve, të aksidentuar në punë gjatë vuajtjes së dënimit me heqje të lirisë ose që kanë marrë sëmundje profesionale gjatë punës së detyruar, të përfitojnë nga Buxheti i Shtetit shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit si përfitim për paaftësinë.
73. Pas reformës kushtetuese të vitit 2016, Gjykata është shprehur disa herë për boshllëkun ligjor. Ndonëse në këto raste, jo të gjitha kërkesat nuk mund të konsiderohen tipikisht ankime kushtetuese individuale, ato vlejné të përmenden për mënyrën e analizës së boshllëkut ligjor në raport me të drejtat dhe liritë themelore.
74. Kështu, Gjykata, e vënë në lëvizje nga shoqata "Pronësi me drejtësi", shqyrtoi kushtetutshmërinë e Ligjit të Pronave në raport me të drejtën kushtetuese të pronës dhe u shpreh se, kur ligjvënësi nuk përmbush detyrimin e caktuar nga Kushtetuta për miratimin e një ligji që duhej ta miratonte në bazë të këtij detyrimi apo ligji i miratuar është i paplotë, Gjykata nuk kontrollon ligjin, sepse një i tillë nuk ekziston, por kontrollon pse nuk ka ligj ose, ndryshe, në këtë rast Gjykata nuk kontrollon ligjin, por vetë ligjvënësin. Në këtë kuptim, çdo mosveprim i mundshëm i ligjvënësit për miratimin e tërësisë së normave të zakonshme të kërkuara për materializimin e një norme të caktuar kushtetuese me qëllim zbatimin e saj, mund të sjellë boshllëk ligjor dhe, për rrjedhojë, bëhet shkak

81 Shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

82 Në kuptim të parimit të sigurisë juridike, në vendimin nr. 31, datë 19.11.2003 Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë që paraqet për funksionimin e shtetit të së drejtës shmangia e boshllëkut ligjor. Sipas saj, në qoftë se ligjvënësi nuk reagon në përgjigje të këtij boshllëku, atëherë sistemi kushtetues nuk ofron ndonjë mjet efektiv dhe kjo situatë mund të çojë në një krizë në sistemin e demokracisë përfaqësuese.

83 Shih vendimin nr. 4, datë 27.02.1997 të Gjykatës Kushtetuese.

për konstatimin e jokushtetutshmërisë. Por edhe nëse ligjvënësi nuk vepron kur ndaj tij ka lindur një detyrim për të përmirësuar ose ndryshuar aktet ligjore ekzistuese, kjo mund të kthehet në një boshllëk thelbësor nëse mosbërja e këtyre ndryshimeve sjell pasoja gjatë zbatimit në praktikë të të drejtave themelore. Antikushtetutshmëria për shkak të boshllëkut ligjor vërehet edhe kur organi ligjvënës nuk vepron për të respektuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese që deklaroi ligjin të papajtueshëm me Kushtetutën. Megjithatë, jo në çdo rast vendimi i Gjykatës Kushtetuese me efekte shfuqizuese, duhet të sjellë reagimin e ligjvënësit për miratimin e rregullimeve të reja ligjore, pasi edhe mosveprimi i ligjvënësit mund të jetë një mënyrë e zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo, ndonjëherë, mund të jetë një zgjidhje praktike ose mund të jetë e nevojshme.⁸⁴

75. Edhe në rastin kur shoqata *"Diaspora për Shqipërinë e Lirë"* iu drejtua Gjykatës duke pretenduar se ishte cenuar e drejta e votës, e parashikuar në nenin 45, pika 1, të Kushtetutës, për arsye të mosveprimit të organeve të ngarkuara nga ligji për të mundësuar votimin nga jashtë të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë Shqipërisë, Gjykata konstatoi se Kodi Zgjedhor, megjithëse krijoi pritshmëri të ligjshme për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit se ata do të ushtronin të drejtën e votës në zgjedhjet për Kuvendin, në fakt nuk ka parashikime të qarta lidhur me kohën kur organi i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve duhet të mundësojë votimin nga jashtë vendit për këtë kategori zgjedhësish. Parashikimi i bërë në nenin 184 të këtij kodi, për sa i përket nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të tij, është i formuluar në mënyrë të përgjithshme, pasi iu referohet të gjitha akteve nënligjore që duhet të nxjerrë KQZ-ja në zbatim të kodit, duke mos specifikuar si objekt rregullimi me akt nënligjor çështjen e votimit nga jashtë vendit dhe organin kompetent për nxjerrjen e tij, sikundër duke mos përcaktuar as afatin brenda të cilit organi duhet të nxjerrë aktin për këtë çështje. Gjykata çmoi se paqartësia e normave të Kodit Zgjedhor në drejtim të afatit, organit kompetent dhe parimeve në bazë të të cilave duhet të nxirren aktet nënligjore për këtë çështje jo vetëm cenon parimin e sigurisë juridike, por në fakt përbën boshllëk ligjor, që cenon të drejtën kushtetuese të votës. Me fjalë të tjera, e drejta kushtetuese e votës së kësaj kategorie për shkak të boshllëkut ligjor ka mbetur thjesht një parashikim deklarativ, i pazbatueshëm efektivisht në praktikë, duke mbetur në thelbin e saj iluzive.⁸⁵
76. Gjykata u shpreh përsëri për boshllëkun ligjor kur u vu në lëvizje nga ankimi kushtetues individual i një grupi studentësh të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë Tiranë që kundërshtuan ligjin nr. 60/2023, datë 21.07.2023 "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e Përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë". Kërkesit pretenduan se ligji cenon të drejtën për arsim dhe të drejtën e punës, në pjesën ku parashikon nënshkrimin e marrëveshjes me ministritë për arsimin, për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik, sipas së cilës, studenti duhet të punojë në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve, respektivisht, jo më pak se 5 vite, 3 vite dhe 2 vite, në institucionet shëndetësore në Shqipëri, si dhe pranon kalimin zyrtarisht të diplomës përkatëse të arsimit të lartë nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku ka përfunduar studimet, në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në shlyerjen e detyrimeve për punësim sipas afatit të lartpërmendur, me të drejtën që pas përmbushjes së detyrimit të punësimit ta tërheqë diplomën universitare. Gjykata vlerësoi se cenimi i të drejtave kushtetuese vjen edhe për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore në nenin 6 të ligjit nr. 60/2023, në drejtim të: (i) kriterëve objektive të punësimit me prioritet, (ii) trajtimit financiar në kuadër të sigurimit të mjeteve të nevojshme të jetesës, sipas nenit 49 të Kushtetutës, si dhe (iii) përllogaritjes së pagesës së periudhës në pritje

84 Shih vendimin nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

85 Shih vendimin nr. 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

në kohëzgjatjen e detyrimit për punësim, nëse shteti nuk ju siguron vend pune studentëve, sepse ata gjatë vitit të parë të pritjes nuk kanë mundësi punësimi tjetër, meqenëse nuk e disponojnë ende diplomën dhe për rrjedhojë dëmtohen nga masa e parashikuar. Prandaj në kuptim të nenit 76, pika 5, të Ligjit Organik të Gjykatës, duke qenë se mungesa e parashikimeve të mësipërme përbën boshllëk ligjor, si pasojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative në të drejtat themelore të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, Gjykata vlerësoi se ato duhet të plotësohen nga ligjvënësi duke përcaktuar ai vetë çështjet dhe parimet që duhet të zbatohen në këtë rast.⁸⁶

77. Një rast i fundit për boshllëkun ligjor, lidhet me dispozitat ligjore, që rregullojnë trashëgiminë testamentare. Gjykimi kushtetues u vu në lëvizje nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të cilat parashtuan se neni 377 i Kodit Civil, që nuk lejon trashëgimlënësin të disponojë me testament pasurinë e tij tek bashkëshorti ose te persona të tretë jashtë rrethit të trashëgimtarëve ligjorë, cenon të drejtën e pronës private, barazinë para ligjit, të drejtën për jetë private dhe sigurinë juridike. Gjykata vlerësoi se dispozita e kundërshtuar, duke mos parashikuar bashkëshortin pasjetues si trashëgimtar testamentar, vendos kufizim për sa i përket rrethit të trashëgimtarëve testamentarë, si dhe nuk garanton disponimin lirisht sipas vullnetit të trashëgimlënësit në asnjë pjesë të pasurisë së tij. Sipas saj, mungesa e këtyre parashikimeve konsiderohet e padrejtë dhe e bazuar mbi vlerësime alogjike. Kufizimi, edhe pse i përgjigjet interesit publik, nuk është proporcional sipas kritereve të vendosura nga neni 17 i Kushtetutës. Për rrjedhojë, dispozita përmban një boshllëk ligjor që sjell pasoja negative për të drejtat e trashëgimlënësit, duke cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën e tij për të disponuar pasurinë *mortis causa*⁸⁷.
78. Vlen të evidentohet se kur individi kundërshton, së bashku me vendimin gjyqësor, edhe aktin e pushtetit publik (normativ), mbi të cilin vendimi bazohet, ai ka barrën të argumentojë se antikushtetshmëria është pasojë e përmbajtjes së ligjit (dhe/ose të aktit nënligjor), ose e boshllëkut ligjor dhe jo e zbatimit të gabuar të tij. Një kompetencë e tillë vazhdon t'i përkasë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos Gjykatës së Lartë si gjykatë e shkallës së fundit së sistemit gjyqësor, përveç rastit kur rezulton se interpretimi i ligjit është haptazi arbitrar sikurse do të shpjegohet në vijim (*shih infra paragrafin 333*)⁸⁸.

Seksioni 3

Raste të veçanta

79. Në raste të veçanta, objekti i ankimit kushtetues i kundrejtohet akteve të pushtetit publik, që janë të ndryshme nga vendimet gjyqësore dhe aktet normative. Bëhet fjalë për rastet kur vetë Kushtetuta ka parashikuar shprehimisht aksesin e individit përtej nenit 131, pika 1, shkronja "f" të saj, si dhe për raste të zhvilluara nga vetë jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.
80. Kështu, neni 115, pika 2 i Kushtetutës parashikon ankimin e drejtpërdrejtë kushtetues të organit të zgjedhur drejtpërdrejt të njësisë vendore kur ai shpërndahet ose shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Në këto raste, objekti formulohet si kërkim për shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se

86 Shih vendimin nr.1, datë 25.01.2024 i Gjykatës Kushtetuese.

87 Shih vendimin nr. 69, datë 27.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese

88 A. Vorpsi, J. Bergmann, *Ankimi kushtetues individual. Përvoja gjermane dhe perspektiva shqiptare*, Maluka 2017, fq. 95 e vijues.

një gjykim, i cili ka për objekt shkarkimin nga detyra të organeve të qeverisjes vendore, është gjykim në themel i kërkesës. Gjykata, si organ kontrolli, për të çmuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës ose ligjit heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm.⁸⁹

81. Po ashtu, *nenet 140, pika 4 dhe 148/d, pika 3 të Kushtetutës* parashikojnë ankimin kushtetues respektivisht të gjyqtarit dhe prokurorit ndaj vendimit të shkarkimit nga detyra, ndërsa *neni 147/d, pika 6* i saj parashikon ankimin kushtetues të inspektorit ndaj vendimit të ILD-së për marrjen e masave disiplinore⁹⁰. Në këto raste, objekti i ankimit formulohet si kërkim për shfuqizimin, sipas rastit, të vendimit të KLGJ-së, KLP-së ose ILD-së. Duhet vënë në dukje se këto procedura ankimi kanë hyrë në fuqi pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 dhe ende nuk kanë filluar të zbatohen, pasi juridiksioni disiplinor kalimtar ushtrohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit bazuar në *nenin 179 pika 7 të Kushtetutës*.⁹¹ Gjykata ka pohuar se gjatë periudhës kalimtare të ndryshimeve kushtetuese, në të cilën ushtron mandatin KPA-ja, juridiksioni gjyqësor disiplinor i përket ekskluzivisht kësaj të fundit dhe vetëm në përfundim të mandati kushtetues të saj, juridiksioni disiplinor sipas *nenit 140, pika 4, të Kushtetutës* do të ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese⁹².
82. Një rast tjetër i veçantë i objektit të ankimit kushtetues individual lidhet me *gjykimin brenda një afati të arsyeshëm*, të zhvilluar prej jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese edhe nën ndikimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së. Konkretisht, nën dritën e vendimit të parë të GJEDNJ-së kundër shtetit shqiptar⁹³, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm, duke filluar nga viti 2006, u konsiderua si pjesë përbërëse e të drejtës për proces të rregullt ligjor, duke shënuar një kthesë të rëndësishme në gjykimin kushtetues⁹⁴.
83. Gjykata më tej mori në shqyrtim edhe kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pavarësisht se procesi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre ende nuk kishte përfunduar në të gjitha shkallët e gjyqësorit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm⁹⁵.
84. Aktualisht, për shkak të disa ndryshimeve në KPC⁹⁶, palët ndërgjyqëse në proces kanë të drejtë të kërkojnë konstatimin e shkeljes, përsheptimin e procedurave dhe shpërbelimin e drejtë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, megjithatë, së fundmi, Gjykata i ka marrë përsëri në shqyrtim kërkesa të këtij lloji, me qëllim që të vlerësojë efektivitetin e tyre në praktikë, nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret⁹⁷.
85. Ajo kavazhduar të qëndrojë në të njëjtën linjë me praktikën e GJEDNJ-së⁹⁸, sipas së cilës mjeti juridik i parashikuar në dispozitat e KPC-së është efektiv në parim, por që të jetë i tillë edhe në praktikë,

89 Shih vendimet nr.25, datë 10.05.2021, nr.15, datë 08.06.2009; nr.22, datë 07.10.2008; nr.39, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese. Gjatë ushtrimit të kontrollit kushtetues të aktit të shkarkimit të organit të qeverisjes vendore, sipas *nenit 115 të Kushtetutës*, Gjykata, fillimisht, vlerëson nëse organi procedues, Këshilli i Ministrave, i ka respektuar kërkesat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, dhe, më pas, çmon bazueshmërinë/meritën e aktit të shkarkimit.

90 Duhet vënë re se përpara i takon shkarkimit nga detyra të anëtarit të KLGJ-së, anëtarit të KLP-së, ILD-së dhe Prokurorit të Përgjithshëm, Kushtetuta në *nenet 147/c, 147/e dhe 149/c*, parashikon se vendimi merret nga Gjykata Kushtetuese, pra në këto raste Gjykata nuk shqyrtton ankimet e tyre, por gjykim disiplinor, të ndryshëm nga procedura e ankimit.

91 Shih vendimet nr. 83, datë 07.06.2021; nr. 35, datë 26.02.2021 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

92 Shih vendimin nr. 36, datë 24.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

93 Shih vendimin *Qufaj Co Shpk kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, datë 18.11.2004.

94 Shih vendimin nr. 6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

95 Shih vendimin nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

96 Ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38, datë 2017, "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar*", të cilat kanë hyrë në fuqi në datën 05.11.2017.

97 Shih vendimet nr. 33, 34 dhe 35, datë 01.11.2021, nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

98 Shih vendimin *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, datë 12.10.2021.

kërkesat për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave duhet të shqyrtohen me shpejtësi nga gjykata. Në këto raste, objekti i ankimit kushtetues formulohet si kërkim për konstatimin e shkeljes së të drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës.

86. Së fundmi, duhet të theksohet se, edhe një mosveprim i organeve publike mund të jetë objekt i ankimit individual, d.m.th. kur ekziston një detyrim për të vepruar dhe kjo kërkohet nga vetë e drejta themelore me qëllim që të materializohet⁹⁹.
87. Megjithëse për këtë çështje nuk ka ende jurisprudencë kushtetuese, nuk mund të mos përmendet rasti kur shoqata "Diaspora për Shqipërinë e Lirë" iu drejtua Gjykatës duke pretenduar se ishte cenuar e drejta e votës, e parashikuar në nenin 45, pika 1, të Kushtetutës, për arsye të mosveprimit të organeve të ngarkuara nga ligji për të mundësuar votimin nga jashtë të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë Shqipërisë. Edhe pse Gjykata çmoi se paqartësia e normave të Kodit Zgjedhor në drejtim të afatit, organit kompetent dhe parimeve në bazë të të cilave duhet të nxirren aktet nënligjore për këtë çështje jo vetëm cenon parimin e sigurisë juridike, por në fakt përbën boshllëk ligjor, që cenon të drejtën kushtetuese të votës (*shih supra paragrafin 75*)¹⁰⁰, analiza e këtij vendimi është e vlefshme në drejtim të mosveprimit të organeve publike.

99 A. Vorpsi, J. Bergmann, *Ankimi kushtetues individual. Përvoja gjermane dhe perspektiva shqiptare*, Maluka 2017, fq. 65.
100 Shih vendimin nr. 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

PJESA E DYTË

PARAQITJA DHE SHQYRTIMI PARAPRAK I KËRKESËS

Kreu I

Paraqitja e kërkesës

88. Rregullat për paraqitjen e ankimit kushtetues individual parashikohen në nenin 131, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës, i cili është konkretizuar në nenin 27 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenin 13 të Rregullores së saj.
90. Kërkesa paraqitet në Gjykatë nga vetë individi, i cili përfshin çdo person, pavarësisht moshës, shtetësisë (shqiptar, i huaj, pa shtetësi ose me dy shtetësi), racës, etnisë, gjuhës, besimit ose ndonjë statusi tjetër. Ky konkluzion bazohet në disa parime të përgjithshme të lirive dhe të drejtave themelore, të sanksionuara në nenet 15, 16 dhe 18 të Kushtetutës. Sipas tyre, të drejtat dhe liritë themelore: janë të pandashme nga çdo qenie njerëzore (neni 15, pika 1); vlejnë njëloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të të drejtave që vetë Kushtetuta i lidh me shtetësinë (neni 16, pika 1); vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive (neni 16, pika 2); të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe diskriminimi është i ndaluar (neni 18).
91. Kur individi është i mitur, kërkesa përpilohet në emër dhe për llogari të tij, nga përfaqësuesi ligjor i të miturit. Ky i fundit nënshkruan kërkesën dhe aktet e tjera të nevojshme, si dhe ushtron të gjitha të drejtat dhe respekton detyrimet në gjykimin kushtetues. Në rastin më të zakonshëm bëhet fjalë për prindërit e fëmijës. Në këtë drejtim, vlen të evidentohet arsyetimi i Gjykatës së Lartë, e cila ka pohuar se duke interpretuar në mënyrë harmonike nenin 6 të KC-së me nenin 216 të Kodit të Familjes (KF), arrihet në përfundimin, se për shkak të përmbushjes së detyrimit ligjor në drejtim të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore, prindërit konsiderohen si përfaqësues ligjorë të fëmijëve të tyre të mitur, deri sa këta të fundit të mbushin moshën 18 vjeç. Përfaqësimi ligjor i të drejtave dhe interesave të fëmijëve të mitur, bazuar në nenin 225 të KF-së, mund të ushtrohet edhe vetëm nga njëri prej prindërve, kur vërtetohen rrethanat e pamundësisë së ushtrimit të përgjegjësisë prindërore nga prindi tjetër.¹⁰¹
92. Individi madhor mund ta paraqesë kërkesën edhe nëpërmjet një përfaqësuesi, i cili duhet të jetë i zgjedhur personalisht prej tij dhe jo nga të afërmit. Kur paraqitet nga përfaqësuesi, ajo përpilohet në emër të kërkuesit, por në fund mund të nënshkruhet edhe vetëm nga përfaqësuesi i zgjedhur. Në këtë rast, pjesë e dokumentacionit, duhet të jetë edhe akti i përfaqësimit. Identifikimi i përfaqësuesit dhe paraqitja e aktit të përfaqësimit ka rëndësi sepse të gjitha njoftimet e Gjykatës në vijim i adresohen përfaqësuesit.

101 Shih vendimin nr. 00-2022-4272(584), datë 22.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

93. Në rastin e të huajit ose personit pa shtetësi, bëhet fjalë për të drejtën për të kundërshtuar një akt të pushtetit publik ose vendim gjyqësor të dhënë brenda rendit juridik shqiptar, që i ka cenuar individit personalisht një të drejtë ose liri kushtetuese.
94. Kur kërkues është personi juridik, atëherë kërkesa nënshkruhet dhe paraqitet nga përfaqësuesi i tij. Ky i fundit mund ta ketë këtë cilësi për shkak ligji, statuti të personit juridik ose në bazë të një autorizimi. Sipas rastit, kërkesës i bashkangjitet akti që dokumenton cilësinë e përfaqësuesit.
95. Vënia në lëvizje e gjykimit kushtetues ka karakter formal. Për këtë arsye, kërkesa duhet të paraqitet në formë të shkruar, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, në gjuhën shqipe, në aq kopje sa janë pjesëmarrësit në gjykim. Kriteri për qartësinë dhe kuptueshmërinë e kërkesës synon të eliminojë ato ankesa të cilat janë haptazi të palexueshme, pra nuk lidhet me rastet kur argumentet kushtetuese janë të pamjaftueshme ose të pasakta. Ndërsa kriteri për përpilimin e kërkesës në gjuhën shqipe ka të bëjë me faktin se gjykimi kushtetues në thelb është veprimtari shtetërore publike, pra veprimtari zyrtare. Për këtë arsye, neni 22 i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon parimin se gjykimi kushtetues zhvillohet në gjuhën shqipe, në përputhje me parimin themelor kushtetues se gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja, të sanksionuar në nenin 14, pika 1 të Kushtetutës.
96. Duhet vënë re se kriteri për përpilimin e kërkesës në gjuhën shqipe nuk ndalon dhe nuk pengon individin e huaj të paraqesë ankim kushtetues individual. Për këtë të fundit, ligji parashikon të drejtën e një përkthyesi, i cili sigurohet nga vetë Gjykata Kushtetuese. Kjo e drejtë ushtrohet me kërkesë nga i huaji, që do të thotë se Gjykata nuk cakton përkthyes me nismën e saj bazuar vetëm në faktin se individit është i huaj. Madje në praktikën e punës janë verifikuar raste që i huaji ka paraqitur ankim kushtetues individual të përpiluar në gjuhën shqipe dhe nuk ka kërkuar caktimin e një përkthyesi, ndaj Gjykata ka shqyrtuar çështjen në gjuhën shqipe, njësoj si për shtetasit shqiptarë¹⁰².
97. Në rastet kur Gjykata ka konstatuar se disa prej akteve të depozituara në gjykimin kushtetues kanë qenë në gjuhë të huaj, bazuar në parimin e zhvillimit të gjykimin në gjuhën shqipe, i ka tërhequr vëmendjen subjekteve pjesëmarrëse në proces të marrin masat që aktet që paraqesin në këtë Gjykatë të jenë të hartuara ose të përkthyer në gjuhën shqipe.¹⁰³
98. Kërkesa mund të paraqitet dorazi, nëpërmjet depozitimit të saj, bashkë me dokumentacionin mbështetës, në Drejtorinë Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në çdo ditë pune, përgjatë orarit zyrtar, prej orës 08:00 deri në orën 16:00.
99. Ankimi mund të paraqitet edhe nëpërmjet shërbimit postar, duke ia drejtuar Gjykatës Kushtetuese në adresën e selisë së saj Bulevardi Dëshmorët e Kombit, nr. 26, Tiranë. Në rastin e paraqitjes se kërkesës me postë, ndiqen rregullat e përgjithshme që zbatohen për procedurat gjyqësore të zakonshme, pra data e paraqitjes së saj në Gjykatën Kushtetuese konsiderohet ajo e dorëzimit në zyrën postare.
100. Ligji Organik i Gjykatës rregullon edhe situatën e kërkesave të paraqitura gabimisht në një institucion tjetër. Edhe në këtë rast, ndiqen rregullat e ngjashme që rregullojnë ankimet e ushtruara në procesin e gjykimin civil apo administrativ, dhe kërkesa konsiderohet e paraqitur brenda afatit ligjor në Gjykatën Kushtetuese, por vetëm kur provohet se gabimi në paraqitjen e kërkesës në institucionin jo kompetent ka ndodhur në mirëbesim.

102 Shih vendimin nr. 189, datë 18.09.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

103 Shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

101. Në paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, neni 13 i Rregullores së Gjykatës sjell një risi. Sipas tij, kërkesa në Gjykatën Kushtetuese mund të paraqitet edhe përmes postës elektronike (*e-mail*). Në këtë rast, kërkesa duhet të përmbajë elementet e sigurisë dhe të jetë nënshkruar në përputhje me legjislacionin që rregullon nënshkrimin elektronik. Megjithatë, duke qenë se rregulli për elementet e sigurisë dhe nënshkrimin elektronik nuk ka filluar ende të zbatohet, paraqitja e kërkesës vetëm nëpërmjet postës elektronike nuk konsiderohet e plotë, pasi ajo duhet të paraqitet edhe fizikisht në Gjykatën Kushtetuese brenda 10 ditëve; në të kundërt, kërkesa e paraqitur vetëm nëpërmjet postës elektronike konsiderohet e paparaqitur.
102. Si rregull, gjykimi kushtetues është publik, që do të thotë se të dhënat personale të pjesëmarrësve bëhen publike. Megjithatë, kërkuesi, kur paraqet kërkesën në Gjykatën Kushtetuese, ka të drejtë të kërkojë që të dhënat personale të mbahen anonime¹⁰⁴. Në këtë rast, ai duhet të paraqesë një kërkesë të posaçme, të nënshkruar prej tij, ku arsyetohen qartë pasojat që mund të sjellë publikimi i të dhënave personale për jetën e tij private dhe familjare, etj., si dhe përcaktohen konkretisht të dhënat që nuk duhet të bëhen publike dhe mënyrën e ruajtjes së anonimitit të tyre, si përjashtim nga rregulli i zakonshëm që zbatohet në shpalljen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull vjen në zbatim të të drejtës themelore për mbrojtjen e të dhënave personale të garantuar nga neni 35, pika 2 e Kushtetutës.¹⁰⁵
103. Është evidentuar një rast në praktikën e punës së Gjykatës kur kërkuesi, ka kërkuar ruajtjen e anonimitit të tij, nisur nga natyra sensitive e çështjes, si dhe nga fakti se vendimet gjyqësore objekt i ankimit kushtetues individual përmbanin, në mënyrë të shprehur, detyrimin e mospublikimit të të dhënave. Kolegji i Gjykatës bazuar në nenin 13, pika 4 të Rregullores së Gjykatës, por edhe në nenin 103, pikat 1 dhe 2, të KPP-së¹⁰⁶, mbi bazën e së cilit gjykatat e zakonshme kanë disponuar në dispozitivin e vendimeve ndalimin e publikimit të tyre, si dhe duke qenë se rezultonte se procedimet penale në kuadër të të cilave janë dhënë këto vendime kanë të bëjnë edhe me akte ose të dhëna hetimore sekrete dhe publikimin e këtyre të dhënave me karakter të klasifikuar, ka vlerësuar se faktet e ankimit kushtetues lidhen me të dhëna personale të kërkuetit, të cilat mbrohen nga ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", duke vendosur që vendimi duhet të publikohet i anonimizuar¹⁰⁷.
104. Ndonjëherë të dhënat janë anonimizuar edhe pa kërkesë të palëve. Kështu në një rast kur kërkesa ishte paraqitur në emër dhe për llogari të një të mituri, Kolegji i Gjykatës ka vlerësuar se vendimi duhej publikuar i anonimizuar duke mbajtur në konsideratë që faktet e ankimit kushtetues lidheshin me të dhëna shëndetësore të të miturit, të cilat sipas ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, konsiderohen të dhëna sensitive.¹⁰⁸

104 Neni 13, pika 4 e Rregullores së Gjykatës.

105 Neni 35, pika 2 e Kushtetutës parashikon se: "Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj".

106 Ky nen parashikon se ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv, si dhe i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake.

107 Shih vendimin nr. 20, datë 05.02.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

108 Shih vendimin nr. 2, datë 13.01.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

Seksioni 1

Elementët formalë të kërkesës

105. Nga pikëpamja formale, kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duhet të përmbajë elementët e përcaktuara në pikën 2, të nenit 27, të Ligjit Organik të Gjykatës, në të kundërt, ajo konsiderohet e paplotë nga pikëpamja administrative dhe nuk regjistrohet në regjistrin e kërkesave. Këto elementë, që janë përcaktuar shprehimisht në ligj, synojnë të dokumentojnë pa të meta se një individ, që ekziston realisht, ka vullnet të lirë për t'iu drejtuar Gjykatës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Në këtë kuptim, një ankesë anonime është e paaftë për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, pasi jo vetëm nuk arrin të përcaktojë kërkuuesin, por edhe interesin e tij për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjykata nuk ka pasur rastin që të shprehet mbi kërkesa anonime¹⁰⁹, por bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së një kërkesë konsiderohet anonime kur ajo nuk tregon asnjë element që t'i lejojë Gjykatës të identifikojë kërkuuesin¹¹⁰.
106. Elementët formalë detyrues që duhet të përmbajë kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese, janë:
- emri dhe selia e Gjykatës Kushtetuese;
 - emri, mbiemri ose emërtimi, dhe të dhënat bazë identifikuese përkatëse (numër personal ose numër regjistrimi tatimor, sipas rastit), si dhe përcaktimi i adresës së vendbanimit, vendqëndrimit ose selisë së kërkuuesit, të subjekteve të interesuara dhe/ose të përfaqësuesve të tyre;
 - përcaktimi i objektit dhe bazës ligjore të kërkesës, parashtrimi dhe argumentimi kushteve dhe i shkaqeve të saj, si dhe pasqyrimi i shkeljeve të natyrës kushtetuese të pretenduara;
 - përcaktimi dhe bashkëlidhja e dokumenteve, provave apo materialeve të tjera që shoqërojnë kërkesën, në kopje të mjaftueshme për t'ua vënë në dispozicion secilit pjesëmarrës në gjykimin kushtetues;
 - nënshkrimi i kërkuuesit ose i përfaqësuesit të tij, si dhe paraqitja e aktit të përfaqësimit të këtij të fundit.
107. Gjithashtu, kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera që lehtësojnë komunikimin e palëve, si përcaktimi i adresave elektronike ku mund të kryhen njoftimet përkatëse nga Gjykata, apo përshtkrimi dhe renditja e provave të tjera, përfshirë thirrjen e dëshmitarëve, që mund të kërkohen nga palë të treta ose kërkesa për kryerje ekspertimi.
108. Plotësimi i elementëve formalë në paraqitjen e kërkesës është i rëndësishëm, pasi mungesa ose pasaktësia e tyre kushtëzojnë regjistrimin e saj pranë regjistrin të posaçëm të kërkesave, i cili ndodhet në Drejtorinë Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Kur kërkesës i mungojnë apo ka pasaktësi të elementëve apo të të dhënave formale, Drejtoria Gjyqësore njofton kërkuuesin që brenda 10 ditëve të bëjë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen brenda afatit të caktuar nga Drejtoria Gjyqësore, kërkesa arkivohet administrativisht. Veprimet e kryera nga Drejtoria Gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese deri në këtë çast janë administrative dhe jo gjyqësore.

¹⁰⁹ Në këtë rast gjithsesi shtrohet për diskutim nëse duhet të regjistrohet një kërkesë anonime dhe të vlerësohet gjyqësisht e papranueshme, apo ajo të arkivohet administrativisht.

¹¹⁰ Shih vendimin "Blondje" kundër Hollandës, nr. 7245/09, datë 15 shtator 2009.

Nga **të dhënat statistikore** e administruara nga Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit të Gjykatës, për vitin 2023, rastet për të cilat ajo ka njoftuar kërkuesin, sipas parashikimeve të nenit 27, pika 2 të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi kërkesat e paraqitura nuk kanë plotësuar elementet formale kanë të bëjnë:

- a) 12 % e rasteve për plotësimin e të dhënave (emrin, mbiemrin ose emërtimin, vendbanimin ose vendqëndrimin) të kërkuesit dhe/ose të përfaqësuesit, të subjekteve të interesuara dhe/ose të përfaqësuesve të tyre; dokumenteve, provave, apo materialeve të tjera që shoqërojnë kërkesën; parashtrimin e shkaqeve dhe shkeljeve të natyrës kushtetuese të pretenduara.
- b) 7% e rasteve për përcaktimin e objektit të kërkesës dhe të bazës ligjore të saj.
- c) 72 % e rasteve për të kërkuar kopje të noterizuara të të gjitha vendimeve objekt kërkese, si dhe të ankimeve dhe rekurseve të paraqitura në instancat e tjera gjyqësore.
- ç) 9 % e rasteve për plotësimin e nënshkrimit të kërkuesit ose të përfaqësuesit të tij, si dhe për të kërkuar aktin e përfaqësimit të këtij të fundit.

Sikurse konstatohet lehtësisht, rastet më të shumta për të cilat kërkesat kërkohen të plotësohen administrativisht kanë të bëjnë më depozitimin e kopjeve të noterizuara të të gjitha vendimeve objekt kërkese, si dhe të ankimeve dhe rekurseve të paraqitura në instancat e tjera gjyqësore.

- 110. Me plotësimin e të gjithë elementëve formalë të kërkesës, kjo e fundit regjistrohet në regjistrin e kërkesave, dhe i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, që merr masat për caktimin me short të relatorit të çështjes, sipas Rregullores së Gjykatës. Nga ky çast, nis faza e shqyrtimit gjyqësor paraprak për vlerësimin e kriterëve të paraqitjes së ankimit kushtetues individual nga ana e Kolegjit apo Mbledhjes së Gjyqtarëve, sipas parashikimeve të nenit 31 të Ligjit Organik të Gjykatës.
- 111. Së fundmi, vlen të evidentohet se në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Gjykata Kushtetuese asistohet nga këshilltarët ligjorë që janë pjesë e Njesisë së Shërbimit Ligjor. Kjo njësi përbën bërthamën shkencore juridike të Gjykatës Kushtetuese dhe është përgjegjëse për përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm studimor dhe analitik në funksion të shqyrtimit të plotë të çështjes objekt kontrolli kushtetues. Njësia e Shërbimit Ligjor përpilon relacione dhe opinione mbi gjetjet, qasjet dhe rekomandimet kushtetuese mbështetur në kërkime shkencore ligjore. Detyrat e Njesisë së Shërbimit Ligjor caktohen nga Kryetari, Mbledhja e Gjyqtarëve dhe gjyqtari relator i çështjes konkrete duke marrë në konsideratë përvojën profesionale dhe nivelin e ekspertizës ligjore të secilit këshilltar ligjor. Roli dhe funksioni këshillues dhe ndihmës i Njesisë së Shërbimit Ligjor është domethënës në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese.

Seksioni 2

Dokumentet shoqëruese

112. Paraqitja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese bashkëshoqërohet me një sërë dokumentesh që shërbejnë për të mbështetur pretendimet e parashtruara në kërkesë, ose për të provuar se janë përmbushur kushtet paraprake që nevojiten për pranimin e kërkesës.
113. Në këtë kuadër, në rast se kërkuesi përfaqësohet nga një përfaqësues, atëherë së bashku me kërkesën duhet të paraqitet edhe akti përkatës i përfaqësimit, në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, për të mundësuar zbatimin efektiv të parimit të gjykimit kushtetues kontradiktor, bashkë me ankimin, kërkuesi duhet të paraqesë, për secilin pjesëmarrës në proces, edhe kopje të dokumenteve dhe provat mbi të cilat bazon pretendimet e tij, dhe veçanërisht kopje (të njësuara me origjinalin, kur i drejtohen Gjykatës) të të gjitha vendimeve objekt kërkesë, si dhe të ankimeve ose rekurseve të paraqitura në instancat e tjera gjyqësore.
114. Neni 14 i Rregullores parashikon se kërkesës duhet t'i bashkëlidhet edhe dokumenti që provon shlyerjen e detyrimit të pagesës së tarifës gjyqësore përkatëse, pasi në rast se një detyrim i tillë nuk është përmbushur, kërkesa nuk regjistrohet. Megjithatë, sikurse do të shpjegohet edhe në vijim, ky detyrim ka mbetur i pazbatueshëm (*shih infra paragrafin 124*).

Seksioni 3

Subjektet e interesuara

115. Përveç kërkuetit, gjykimi kushtetues zhvillohet me pjesëmarrjen edhe të atyre subjekteve që kanë interesa antagoniste me të ose për të cilët vlerësohet se kanë një interes të drejtpërdrejtë në çështjen objekt gjykimi apo konsiderohen të nevojshëm për zhvillimin efektiv të procesit kushtetues. Këto subjekte të tjerë të gjykimit kushtetues marrin emërtimin "subjekte të interesuar" dhe së bashku me kërkuetin dhe përfaqësuesit respektivë, nëse ka, quhen pjesëmarrësit e gjykimit kushtetues.
116. Rrethi i subjekteve të interesuara, përcaktohet nga neni 39 i Ligjit Organik të Gjykatës, duke i identifikuar me ato subjekte kundër të cilëve është paraqitur kërkesa ose që kanë një interes të drejtpërdrejtë në çështjen që shqyrtohet, përfshirë detyrimisht organin që ka nxjerrë aktin që kundërshtohet, ky i fundit në rastet kur objekt i ankimit kushtetues individual është akti normativ. Përcaktimi i rrethit të subjekteve të interesuara lidhet edhe me interesat konkretë që ata mund të bartinë në çështjen objekt gjykimi. Të tillë konsiderohen edhe ato subjekte pjesëmarrja e të cilëve vlerësohet e nevojshme për zhvillimin efektiv të gjykimit kushtetues¹¹¹. Gjithsesi në momentin që merr pjesë në gjykim, subjekti i interesuar zgjedh vetë nëse interesat e tij i bashkon me kërkuetin apo kundër tij në kuptim të qëndrimit që do të mbajë në gjykim.
117. Përcaktimi i hapur i konceptit të subjekteve të interesuara bën që këto subjekte të ndryshojnë në bazë të llojit të çështjes konkrete që është duke u zhvilluar përpara Gjykatës Kushtetuese, pasi kjo e fundit bën një vlerësim që i përshtatet kontekstit të rrethanave konkrete të çështjes. Kjo do të thotë se rast pas rasti bëhet i nevojshëm verifikimi nga ana e Gjykatës i legjitimitetit pasiv¹¹² (*legitimatia ad causam*) të rrethit të subjekteve të interesuara.

111 Neni 38 i Ligjit Organik të Gjykatës dhe 14 të Rregullores së Gjykatës.

112 Neni 43, shkronja "c" i Ligjit Organik të Gjykatës.

118. Normalisht subjektet e interesuara përcaktohen nga kërkuesi. Por nuk kanë munguar rastet që Gjykata me nismën e saj ka thirrur subjekte të interesuar të tjerë përtej atyre të përcaktuar nga kërkuesi, apo ka kufizuar rrethin e tyre. Gjithashtu ka pasur raste kur vetë subjektet i janë drejtuar Gjykatës për të marrë pjesë në gjykim. Gjykata ka pranuar apo refuzuar kërkesat e tyre, duke u shprehur në lidhje me interesin e tyre për të marrë pjesë në gjykim, apo nëse pjesëmarrja e tyre vlerësohet e nevojshme për gjykimin kushtetues. Kjo do të thotë në radhë të parë se mungesa e përcaktimit të subjekteve të interesuara nga ana e kërkuesit nuk përbën shkak për mospranimin e ankimit kushtetues individual. Në radhë të dytë, kjo tregon se vlerësimi i legjitimitimit pasiv të subjektit të interesuar bazohet jo vetëm në interes të subjektit, por edhe të gjykimit kushtetues. Në këtë kuptim, në gjykimin kushtetues legjitimohen si subjekte të interesuara ato që, për shkak të veprimtarisë ose rrethanave, mund të kontribuojnë në shqyrtimin e çështjes që po gjykohet, pavarësisht nëse thirren në gjykim me kërkesën e kërkuesit ose kryesisht nga Gjykata.
119. Konkretisht në gjykimin e vënë në lëvizje nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, me objekt konstatimin si antikushtetues të procesit të zgjedhjeve vendore të datës 30 qershor 2019, Shoqata për Autonomi Vendore iu drejtua Gjykatës me kërkesë për pjesëmarrje në gjykim si subjekt i interesuar, me argumentin se kishte interes të drejtpërdrejtë sepse mbronte interesat e 60 kryetarëve të bashkive anëtare, të zgjedhur nga zgjedhjet vendore të zhvilluara në datën 30.06.2019. Gjykata, pasi dëgjoi edhe përfaqësuesit e palëve në proces, dhe bazuar në përmbajtjen e dispozitave të Ligjit Organik të saj, nuk e pranoi kërkesën, pasi vlerësoi se nuk ishte paraqitur në formën dhe kohën e duhur. Ndërkohë Gjykata përveç subjekteve të interesuara të përcaktuara nga kërkuesi, vendosi të thërrasë në gjykim edhe Avokatin e Popullit, sepse u konsiderua si i nevojshëm për qëllimet e gjykimit kushtetues¹¹³. Edhe pse kërkesa në këtë rast nuk është ankim kushtetues individual tipik, analiza e Gjykatës për legjitimitimin e subjekteve të interesuara, vlen për çdo lloj gjykimi kushtetues.
120. Ndërsa në gjykimin e vënë në lëvizje nga një individ, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave për çështjen e tij në shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë, Gjykatës iu paraqit një kërkesë nga një individ tjetër për të marrë pjesë si subjekt i interesuar, i cili pretendonte se procesi ishte i rëndësishëm për të. Gjykata vlerësoi se ky i fundit nuk arriti të argumentojë interesin e tij në këtë çështje¹¹⁴.
121. Në një rast tjetër, Dhoma e Avokatisë iu drejtua Gjykatës për të kundërshtuar hartën gjyqësore (VKM nr. 495/2022). Mbi kërkesën e paraqitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) për pjesëmarrje në këtë gjykim kushtetues, Mbledhja e Gjyqtarëve, duke pasur parasysh misionin e kësaj organizate dhe natyrën e pretendimeve të parashtruara në kërkesën në shqyrtim, vlerësoi se thirrja e saj për t'u dëgjuar në cilësinë e subjektit të interesuar ishte në interes të gjykimit. Gjatë gjykimit KSHH-ja mbajti të njëjtin qëndrim me kërkuesin dhe më pas iu drejtua Gjykatës me kërkesë të mëvetshme për të kundërshtuar VKM-në nr. 495/2022. Gjykata vendosi bashkimin e kërkesës së KSHH-së me atë të Dhomës së Avokatisë. Në këtë mënyrë në çështjen konkrete KSHH-ja nga subjekt i interesuar ndryshoi pozicionin e saj në atë të kërkuesit¹¹⁵.
122. Përfshirja e subjekteve të interesuara në rrethin e pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues iu atribuon këtyre subjekteve një sërë të drejtash procedurale për të bërë të mundur zhvillimin e një procesi kushtetues të rregullt dhe ligjor, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe

113 Shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese

114 Shih vendimin nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese

115 Shih vendimin nr. 70, datë 27.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

barazisë së palëve. Veçanërisht, subjektet e interesuara kanë të drejtë të njoftohen dhe të marrin pjesë në seancën plenare, të paraqesin prova, të njihen dhe të marrin kopje të të gjithë akteve të procesit, të paraqesin kërkesa dhe parashtrime, të pyeten dhe të dëgjohen, si dhe të kërkojnë marrjen e dokumenteve tek të tretë, thirrjen e dëshmitarëve, të ekspertëve apo marrjen në pyetje të subjekteve të tjerë të procesit¹¹⁶.

123. Gjatë gjykimit kushtetues të një ankimi individual, i cili në objektin e tij kishte shfuqizimin e vendimit gjyqësor dhe të një dispozite ligjore procedurale, Gjykata me nismën e saj thirri Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave, si subjekte të interesuara, bazuar në nenin 39, pika 1, shkronjat "b" dhe "c", të Ligjit Organik të Gjykatës. Në këtë cilësi, Këshilli i Ministrave paraqiti prapësime me shkrim, duke kundërshtuar jo vetëm pretendimet për antikushtetutshmërinë e ligjit, por edhe pretendimet që lidheshin me procesin gjyqësor të zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm. Kërkuessa i kërkoi Gjykatës që ajo pjesë e prapësimeve të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që kundrejtohej ndaj procesit gjyqësor dhe vendimit të Gjykatës së Lartë, në të cilin ai nuk kishte qenë palë ndërgjyqëse, nuk duhej të konsiderohej. Gjykata evidentoi se subjektet e interesuara ishin thirrur prej saj, bazuar në interesin e drejtpërdrejtë të tyre në gjykimin kushtetues për kërkimin që lidhet me shfuqizimin e akteve normative, për shkak se në procesin ligjvënës ato ushtrojnë respektivisht kompetencat e propozimit dhe të miratimit të ligjeve. Në këtë kuptim, Gjykata vlerësoi se kërkesa paraprake e kërkuesses ishte e bazuar, ndaj shqyrtoi në gjykim vetëm atë pjesë të prapësimeve të Këshillit të Ministrave që lidhej me kontrollin e kushtetutshmërisë së dispozitës ligjore.¹¹⁷

Seksioni 4

Shpenzimet gjyqësore

124. Gjykimi kushtetues, si gjykimet e tjera penale, civile apo administrative shoqërohet pashmangësisht me një sërë shpenzimesh gjyqësore. Ligji Organik i Gjykatës përcakton se shpenzimet e procesit gjyqësor që zbatohen në gjykimin kushtetues përcaktohen në ligjin për tarifën gjyqësore¹¹⁸.
125. Shpenzimi i parë i procesit gjyqësor kushtetues lidhet me vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese nga kërkuessi, i cili ka detyrimin të paguajë tarifën gjyqësore 5.000 lekë¹¹⁹. Pa kryerjen e tarifës, kërkesa nuk regjistrohet në regjistrin përkatës. Rregullorja e Gjykatës përcakton edhe mundësinë e përjashtimit nga pagesa e tarifës gjyqësore me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Duhet vënë re se masa e tarifës është përcaktuar shprehimisht në ligjin nr. 98/2017 për tarifën gjyqësore, megjithatë deri më sot ende nuk kanë dalë aktet e nevojshme nënligjore për mënyrën e zbatimit të kësaj tarife, ndaj ky detyrim nuk ka filluar të aplikohet në praktikë.
126. Shpenzimet e tjera të gjykimit kushtetues, në mungesë të një përcaktimi të posaçëm, ndjekin rregullat e zakonshme të gjykimeve të ngjashme gjyqësore apo administrative¹²⁰, përfshirë dhe mundësinë për të përfituar nga ndihma juridike falas në përputhje me rregullat në fuqi¹²¹.

¹¹⁶ Nenet 28, 29, 30, 32 dhe 33 të Rregullores së Gjykatës.

¹¹⁷ Shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

¹¹⁸ Neni 28 i Ligjit Organik të Gjykatës.

¹¹⁹ Neni 5 pika 4 i ligjit nr. 98/2017, datë 02.11.2017 për tarifën gjyqësore dhe neni 14 i Rregullores së Gjykatës.

¹²⁰ Rregulli i përgjithshëm është ai i parapagimit të këtyre shpenzimeve nga personi që i kërkon ato, në bazë të lirisë kontraktore apo të tarifave të përcaktuara për shërbimet përkatëse. Nenet 102 e vijues të KPC-së.

¹²¹ Neni 14 i Rregullores së Gjykatës. Kuadri rregullator në fuqi për ndihmën juridike falas të garantuar nga Shteti, aktualisht përbëhet nga Ligji nr. 111/2017, "Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti", dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij: Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 18, datë 5.8.2020, "Për miratimin e tarifave të përfaqësimit në kuadër të ndihmës juridike dytësore".

127. Në përfundim të gjykimit, kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, Gjykata Kushtetuese shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi¹²².
128. Një shpenzim tjetër që mund të lindë në gjykimin kushtetues ka të bëjë me shpërdorimin e të drejtave që individi gëzon për të vënë në lëvizje këtë gjykim apo me keqpërdorjen e të drejtave procedurale nga palët në gjykimin kushtetues. Ligji Organik i Gjykatës, parashikon mundësinë e vendosjes së sanksionit administrativ, gjobë, në shumën nga 100.000 deri në 500.000 lekë, kur Gjykata Kushtetuese konstaton se kërkuesi ose përfaqësuesi i tij abuzojnë me të drejtën për të paraqitur ankim. Abuzimi me të drejtën përfshin paraqitjen e kërkesave haptazi të paarsyeshme ose të përsëritura, për të njëjtin shkak dhe me të njëjtin objekt, ndërkohë që ajo është shqyrtuar më parë nga Gjykata Kushtetuese, ose kur kërkuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor, përgjatë gjykimit, përdorin gjuhë kërcënuese, ofenduese, provokuese apo fshehin ose shtrembërojnë fakte dhe rrethana që lidhen me çështjen¹²³. Masa e gjobës përcaktohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve dhe vendimi përkatës përbën titull ekzekutiv.¹²⁴
129. Në një rast, Mbledhja e Gjyqtarëve i caktoi ankuesit gjobë prej 100 000 lekë, me arsyetimin se kërkuesi gjendej në situatën e abuzimit me të drejtën për të paraqitur kërkesë, pasi pavarësisht se ai ishte paralajmëruar disa herë dhe i ishte tërhequr vëmendja për vendosjen e gjobës, ka vijuar të paraqesë kërkesa të përsëritura, me të njëjtin shkak dhe objekt, me atë të shqyrtuar një herë nga Gjykata¹²⁵.
130. Ndërsa në një rast tjetër, Mbledhja e Gjyqtarëve i caktoi kërkuesit gjobë prej 100 000 lekë për abuzim me të drejtën e paraqitjes së ankimit kushtetues, duke arsyetuar se kërkuesi i ishte drejtuar në mënyrë të vazhdueshme Gjykatës dhe përgjatë harkut kohor 2020 – 2023, kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve kishin dhënë një numër tepër të lartë vendimesh për moskalimin e ankimeve të tij në seancë plenare, për shkak se nuk plotësonin kriteret paraprake. Në një numër të konsiderueshëm rastesh, shkak i moskalimit lidhej me natyrën jopërfundimtare të vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, ndaj kërkuesi ishte në dijeni të plotë dhe i mirëinformuar për qëndrimin e Gjykatës se objekt i ankimit kushtetues individual mund të jenë vetëm vendimet gjyqësore përfundimtare. Megjithatë, ai, me vetëdije, kishte vazhduar të paraqiste një numër të lartë ankimesh ndaj vendimeve jopërfundimtare, duke treguar qartësisht se qëllimi i tij ishte i ndryshëm nga ai për mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave themelore. Gjithashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve vuri re se kërkuesi ishte paralajmëruar në mënyrë konsistente për mundësinë e gjobitjes, por ai sërish kishte vijuar të paraqiste ankime në Gjykatë. Duke marrë parasysh rrethanat e çështjes konkrete, si dhe në veçanti moshën 72-vjeçare të kërkuesit, Mbledhja e Gjyqtarëve i caktoi atij gjobën në vlerën minimale të parashikuar nga ligji¹²⁶.
131. Gjobitja e individit për abuzim me të drejtën është përdorur rrallë nga Gjykata, e cila ka përdorur më shpesh tërheqjen e vëmendjes dhe paralajmërimin për gjobë në tekstin e vendimit, me idenë për të lehtësuar aksesin e individit në gjykimin kushtetues.

122 Nenet 28 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe 14 të Rregullores së Gjykatës.

123 Nenet 31/c të Ligjit Organik i Gjykatës dhe 20 të Rregullores së Gjykatës.

124 Gjykata e ka aplikuar vendosjen e gjobës për herë të parë në vendimin nr. 71, datë 05.04.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Ky qëndrim u rikonfirmua në vendimin nr. 94, datë 02.05.2023 po të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

125 Shih vendimin nr. 71, datë 05.04.2023 dhe të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

126 Shih vendimin nr. 94, datë 02.05.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

Kreu II

Kriteret për të ushtruar ankimin kushtetues individual

132. Kriteret për të ushtruar ankimin kushtetues individual janë të përcaktuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës, ndërkohë që detajohen në Rregulloren e Gjykatës. Ato përbëjnë kushtet për shqyrtim në themel të kërkesës, ose sikurse përcaktohet në nenin 23 të Rregullores, kriteret e pranueshmërisë së kërkesës për shqyrtim në seancë plenare dhe dallojnë nga elementët formalë që duhet të përmbajë kërkesa për t'u depozituar në Gjykatë. Nëse plotësimi i këtyre të fundit verifikohet nga administrata e Gjykatës, ndaj përbën veprimtari administrative (*shih supra paragrafët 104-109*), përmbushja e kriterëve të pranueshmërisë përbën veprimtari gjyqësore dhe realizohet, si rregull, nga Kolegji i Gjykatës ose Mbledhja e Gjyqtarëve gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere do të trajtohen më poshtë.

Seksioni 1

Juridiksioni kushtetues

133. Juridiksioni kushtetues e merr përcaktimin e natyrës dhe kufijve të tij drejtpërdrejt nga neni 124 i Kushtetutës, i cili ka këtë përmbajtje: "1. Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. 2. Gjykata Kushtetuese i nënshtrohet vetëm Kushtetutës". Në të njëjtën linjë, neni 2 i Ligjit Organik të Gjykatës, parashikon se Gjykata është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.
134. Juridiksioni në kuptimin e gjerë është kompetenca e organit publik për të shqyrtuar dhe vendosur mbi një çështje të caktuar në përputhje me ligjin, që konkretizohet në veprimtarinë e tij për të zbatuar dhe interpretuar normat juridike në çështjen konkrete. Në këtë këndvështrim, juridiksioni kushtetues është kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kushtetuese. Gjykata ka pohuar se neni 124 i Kushtetutës përcakton funksionin themelor të saj, që lidhet me dhënien e drejtësisë kushtetuese nëpërmjet interpretimit përfundimtar të normës kushtetuese, ndërkohë që juridiksioni kushtetues detajohet në dispozitat e tjera të Kushtetutës, ku veçanërisht neni 131 parashikon kompetencën kushtetuese sipas natyrës së çështjes, por pa u kufizuar në të, për sa kohë që Gjykata ka për detyrë të vendosë edhe për çështje që janë të parashikuara shprehimisht në norma të tjera kushtetuese. Kjo sepse neni 131 i Kushtetutës, që përcakton kompetencat kryesore të saj, dhe neni 134, që përcakton subjektet që e vënë në lëvizje, nuk mund të lexohen të shkëputura nga dispozitat e tjera kushtetuese materiale ose procedurale, të cilat përkufizojnë kompetencën, si dhe përcaktojnë mekanizmin dhe procedurën për vënien në lëvizje të Gjykatës.¹²⁷
135. Sa i takon konceptit "*interpretim përfundimtar*" të nenit 124, Gjykata është shprehur se interpretimi i ligjit themelor të shtetit është ndër funksionet më të rëndësishme të saj, të cilin ajo e ushtron sa herë që vihet në lëvizje për t'u shprehur për një nga çështjet e parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës dhe në normat e tjera kushtetuese që lidhen me kompetencën e saj. Kontrolli kushtetues, në çdo rast, nuk mund të bëhet pa interpretimin e kuptimit të normave kushtetuese që lidhen me çështjen konkrete në shqyrtim. Interpretimi përfundimtar që bën Gjykata nuk ka si qëllim shtimin e normave të reja në sistemin e normave detyruese ligjore, por deklarimin ose pohimin e

¹²⁷ Shih vendimet nr. 38, datë 09.12.2022; nr. 36 datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

përmbajtjes së këtyre normave.¹²⁸

136. Për sa më lart, ekzistenca e një mosmarrëveshje kushtetuese është *conditio sine qua non* për përcaktimin e juridiksionit kushtetues. Prandaj në një rast të marrë në shqyrtim nga Gjykata, në të cilin objekti i ankimit kushtetues individual lidhej me zbatimin e një vendimi të saj të mëparshëm, ajo theksoi se në parim pretendimet e individit për moszbatimin e vendimeve të saj mund të përbëjnë një çështje të re në raport me atë tashmë të marrë në shqyrtim prej saj, nëse veprimet ose mosveprimet e organeve të ngarkuara për zbatimin e vendimeve të Gjykatës krijojnë mosmarrëveshje kushtetuese. Kjo do të thotë se Gjykata nuk ka juridiksion të shqyrtojë thjesht masën ose mënyrën se si po zbatohet një vendim i saj dhe se ankimi kushtetues individual nuk mund të përdoret si mjet për kontrollin e kushtetutshmërisë së ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve shtetërore jashtë kufijve të kompetencave të kësaj Gjykate.¹²⁹
137. Duhet vënë re se juridiksioni kushtetues ndryshon nga juridiksioni gjyqësor i gjykatave të zakonshme i parashikuar nga nenet 135, pika 1³⁰ dhe 141³¹ të Kushtetutës. Juridiksioni gjyqësor ka të bëjë me kompetencën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për zbatimin dhe interpretimin e normave ligjore mbi një kuadër faktesh të provuara gjyqësisht, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konkrete civile, penale ose administrative.
138. Përcaktimi i kufijve juridiksionalë merr rëndësi në shtetin e së drejtës, i cili përfshin sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike.¹³² Shteti i së drejtës i detyron të gjitha institucionet shtetërore të veprojnë sipas së drejtës në fuqi, si dhe garanton supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Ai nuk konsiston vetëm në detyrimin për zbatimin e tërësisë së normave juridike, por në sigurimin e kontrollit gjyqësor se si autoritetet i respektojnë ato¹³³.

1.1 Juridiksioni kushtetues kundrejt atij gjyqësor

139. Ndonjëherë në praktikë lind e nevojshme të kuptohet ndarja midis juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor, nga njëra anë për të ofruar siguri juridike dhe proces të rregullt ligjor, pra që individi të jetë i qartë se cila është gjykata e caktuar me ligj që duhet të zgjidhë mosmarrëveshjen e tij dhe, nga ana tjetër, për të respektuar shtetin e së drejtës, i cili kërkon që organet publike, përfshirë gjykatat, të ushtrojnë kompetencat e tyre brenda kufijve të caktuar nga normat kushtetuese dhe ligjore.
140. Sistemi ynë normativ parashikon se aktet nënligjore mund të kontrollohen jo vetëm nga Gjykata Kushtetuese sipas nenit 131, pika 1, shkronja "c" e Kushtetutës, por edhe nga gjykatat administrative sipas nenit 7, shkronja "a" e Ligjit të Gjykatave Administrative. Në këtë mënyrë, mund të krijohet situata që të dyja juridiksionet të vihen në lëvizje në të njëjtën kohë për të kontrolluar të njëjtin akt nënligjor dhe rreziku që të japin rezultate gjykimi të ndryshme.
141. Në një rast të tillë, Gjykata Kushtetuese ka pohuar se në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga Kushtetuta, ajo e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti,

128 Shih vendimet nr. 36, datë 04.11.2021; nr. 7, datë 24.02.2016; nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

129 Shih vendimin nr. 20, datë 05.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

130 Neni 135, pika 1 e Kushtetutës parashikon: "Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj".

131 Neni 141 i Kushtetutës parashikon: "1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. 2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit".

132 Shih vendimin nr. 29, datë 09.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

133 Shih vendimin nr. 29, datë 02.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

gjithmonë duke mbajtur në konsideratë natyrën kushtetuese të pretendimeve. Ky konkluzion duhet kuptuar në kontekstin e mosmarrëveshjes konkrete që iu paraqit Gjykatës për shqyrtim, në të cilën subjekti i interesuar pretendonte se juridiksioni kushtetues nuk duhej të ushtrohej pasi pengohej nga ai i gjykatave të zakonshme, të cilat kishin filluar shqyrtimin e çështjes, që kishte në objektin e saj të njëjtat akte nënligjore, për të cilat ishte vënë në lëvizje edhe gjykimi kushtetues. Gjykata theksoi se funksioni i saj është garantimi i respektimit të Kushtetutës, interpretimi përfundimtar dhe sigurimi i epërsisë së saj në sistemin ligjor nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese, që parashikohen në nenet 124, 131 dhe 132 të Kushtetutës.¹³⁴

142. Gjykata Kushtetuese është organi që ka fjalën e fundit në lidhje me pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjeve dhe akteve të tjera normative, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës. Kjo dispozitë kushtetuese, duke përcaktuar kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, ka përcaktuar kufijtë ndarës midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, në rastin konkret atij administrativ, për shkak të dallimeve thelbësore mes tyre. Juridiksioni kushtetues nuk zëvendësohet nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor. Natyra e pretendimeve të ngritura para kësaj Gjykate është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje konkrete.¹³⁵
143. Kjo do të thotë se kur kundërshtohet një akt nënligjor normativ, edhe pse mund të verifikohet ekzistenca e njëkohshme e dy mjeteve të ndryshme të ankimit, që i përkasin juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor të zakonshëm, për kontrollin e ligjshmërisë së aktit normativ vihet në lëvizje Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa për kontrollin e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën, vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 131, pika 1, shkronja "c", të Kushtetutës.¹³⁶ Pra juridiksioni gjyqësor në lidhje me pajtueshmërinë e akteve nënligjore me ligjin, nuk e vë në dyshim, nuk e pengon dhe as e zëvendëson juridiksionin kushtetues për kontrollin e pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

1.2 Juridiksioni kushtetues kundrejt atij të organeve të rivlerësimit kalimtar

144. Më lart u shpjegua që juridiksioni për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të shkarkimit nga detyra të gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të zyrës së ILD-së, aktualisht ushtrohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit bazuar në nenin 179, pika 7 të Kushtetutës (*shih supra, paragrafin 81*). Përveç këtyre ankimeve, Gjykata ka përfunduar nga juridiksioni i saj kontrollin e vendimeve të organeve të procesit të rivlerësimit kalimtar (KPK-së dhe/ose KPA-së). Ajo është shprehur se referuar përmbajtjes së nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës, gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese funksionon me dy kolegje. Neni F, pika 1 i Aneksit të Kushtetutës parashikon se KPA-ja është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të KPK-së. Kurse juridiksioni i Gjykatës në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për kontrollin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit është i kufizuar nga juridiksioni që dispozitat e Kushtetutës dhe Aneksit të saj u kanë dhënë organeve të rivlerësimit. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, organet e rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës

¹³⁴ Shih vendimin nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

¹³⁵ *Ibid.*

¹³⁶ *Ibid.*, paragrafi nr. 26. Gjykata shprehet se Ligji i Gjykatave Administrative i ka njohur kompetencën gjykatës administrative të shqyrtojë edhe mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative normative (neni 7, shkronja "a"), por ai ka parashikuar edhe se gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet, të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese (neni 8, shkronja "a").

dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ai konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit.¹³⁷ Ky ishte qëndrimi që mbajti Gjykata në rastet kur ka shqyrtuar ankesat kushtetuese të subjekteve të rivlerësimit kalimtar ndaj vendimeve të KPA-së.¹³⁸

145. Pas vendimit të GJEDNJ-së në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*¹³⁹, e cila ka gjetur shkelje të nenit 6 § 1, të KEDNJ-së në lidhje me parimin e “gjykatës të krijuar me ligj”, Gjykata është vënë në lëvizje nga disa subjekte të rivlerësimit kalimtar me kërkesa për rishikimin e vendimeve të KPA-së. Në këto raste Kolegjet e Gjykatës¹⁴⁰, në përputhje me qëndrimin që kjo e fundit ka mbajtur në shqyrtimin e kërkesave që kundërshtojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, kanë ritheksuar se juridiksioni i saj në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për këto çështje është i kufizuar nga vetë Kushtetuta, ndaj pretendimet që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e këtyre organeve, qofshin të natyrës kushtetuese, ku përfshihet e drejta për një proces të rregullt, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë. Subjektet e rivlerësimit nuk legjitimohen t’i drejtohen Gjykatës, nëpërmjet ankimit kushtetues individual, për pretendime ose kërkesa që i përkasin atij procesi, i cili, siç vlerëson edhe GJEDNJ-ja, ka natyrë përfundimtare brenda sistemit të brendshëm të ankimeve. Prandaj Kolegjet, duke konstatuar se në vendimin e GJEDNJ-së të paraqitur nga kërkuesi si shkak rishikimi nuk ka asnjë gjetje ose konstatim që lidhet me juridiksionin kushtetues, kanë vlerësuar se edhe këto çështje nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues për sa kohë që objekt i kërkimit është rishikimi i vendimit të një organi tjetër kushtetues, KPA-së.

Seksioni 2

Legjitimimi i kërkuesit

146. Koncepti i legjitimitimit (*locus standi*), pra i të drejtës për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, nënkupton ekzistencën e disa premisave paraprake, mungesa e të cilave nuk lejon fillimin e gjykimit të elementëve thelbësorë të kërkesës. Juridiksioni i Gjykatës, pra kompetenca e saj për të shqyrtuar ankimet kushtetuese individuale ka tre dimensione të lidhura me legjitimitimin: *ratione personae*; *ratione temporis* dhe *ratione materiae*.

2.1. Legjitimimi *ratione personae*

147. Shprehja *ratione personae* do të thotë “për shkak personi”, dhe ka të bëjë me natyrën ose pozicionin e tij. Pra, legjitimimi *ratione personae* i përgjigjet pyetjes se cili individ mund të paraqesë ankim kushtetues. Në jurisprudencën e Gjykatës me termin legjitimimi *ratione personae* nënkuptohet verifikimi i interesit të kërkuesit që ka paraqitur ankesë, si kusht për kalimin e çështjes në seancë plenare.

¹³⁷ Shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

¹³⁸ Shih vendimin nr. 57, datë 23.04.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

¹³⁹ Shih vendimin *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, datë 4.10.2022, (aplikanti ka qenë subjekt i rivlerësimit kalimtar), ku është gjetur shkelje e nenit 6§1, të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e ankuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”. GJEDNJ-ja “ka vendosur se ekzistonte një pretendim i argumentueshëm për një shkelje të qartë të rregullit themelor të ligjit vendës, i cili ka ndikuar në mënyrë të pafavorshme në emërimin e L.D. si gjyqtar i KPA-së. Për sa më sipër dhe duke pasur në konsideratë veçanërisht faktin se gjykatat vendëse nuk trajtojnë në mënyrë të duhur pyetjet e ngritura nga ankuesi në lidhje me Konventën, Gjykata arrin në përfundimin se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës, për shkak se L.D. ishte pjesë e trupës gjyqësore të KPA-së, e cila shqyrtoi çështjen e ankuesit”, § 115, 116.

¹⁴⁰ Shih vendimet nr. 42, datë 22.02.2023; nr. 48, datë 28.02.2023; nr. 54, datë 13.03.2023; nr. 69, datë 04.04.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

148. Neni 134, pika 2, i Kushtetutës, duke listuar subjektet që mund të vënë në lëvizje Gjykatën, i ka ndarë këto subjekte në dy grupe: subjekte me legjitimitet të pakushtëzuar dhe subjekte me legjitimitet të kushtëzuar. Subjektet e grupit të dytë, ku përfshihen edhe individët, kur vënë në lëvizje Gjykatën, duhet të justifikojnë interesin e tyre. Ndërsa neni 71, pika 1 i Ligjit Organik të Gjykatës, parashikon se çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues. Natyrshëm lind pyetja se kush përfshihet në konceptin individ.

2.1.1 Personi fizik

149. Individ konsiderohet në radhë të parë, personi fizik, qoftë edhe me shtetësi të huaj, me dy shtetësi ose, pa asnjë shtetësi, pra çdo njeri që, si i tillë, është titullar i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, të cilit i kanë ardhur pasoja negative të drejtpërdrejta dhe reale.

150. Gjykata, që në vitet e para të veprimtarisë së saj, sqaroi se të legjitimuar t'i drejtohen asaj për shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk janë vetëm "qytetarët e thjeshtë, por edhe ata që gjykojnë qytetarët, d.m.th., gjyqtarët" kundër masave (administrative - juridiksionale) që kanë të bëjnë me statusin e tyre juridik¹⁴¹.

2.1.2 Personat juridikë

151. Sipas nenit 16, pika 2 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve. Në këtë mënyrë, personat juridikë, janë bartës të të drejtave dhe lirive themelore, ndaj ato mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues njësoj si individët.

152. Kur personat juridikë, pavarësisht formës së organizimit dhe veprimtarisë që kryejnë, i janë drejtuar Gjykatës si palë ndërgjyqëse e procesit gjyqësor që kanë kundërshtuar, ajo gjithmonë ka njohur legjitimitetin e tyre, duke i konsideruar dhe barazuar ata, në këtë drejtim, me individët.¹⁴²

153. Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës kërkesa e parë e marrë në shqyrtim në themel nga Gjykata daton në vitin 2000. Edhe pse e legjitimoi personin juridik për kërkesën e tij, Gjykata nuk arsyetoi në mënyrë eksplicite mbi këtë fakt.¹⁴³

154. Sikurse u përmend, për legjitimitimin e personave juridikë, është e nevojshme të fillohet nga leximi i nenit 16, pika 2 i Kushtetutës, i cili parashikon që të drejtat dhe liritë themelore mund të ushtrohen edhe nga këta subjekte. Prandaj, Gjykata, edhe përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, nuk ka treguar as më të voglin dyshim në lidhje me njohjen e legjitimitetit aktiv të personave juridikë privatë (si titullarë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë atë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor)¹⁴⁴, por as nuk ka hezitur të hapë dyert e gjykimin kushtetues edhe për personat juridikë publikë. Ajo, faktikisht, gjithmonë është shprehur se legjitimiteti i kërkuarit

141 Shih vendimin nr. 8, datë 03.11.1994, në lidhje me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në rast të transferimit të një gjyqtari nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (organ i qeverisjes së pushtetit gjyqësor) pa konsensusin e tij.

142 Shih vendimet nr. 72 datë 17.11.2017; nr. 38 datë 05.07.2012; nr. 26, datë 15.12.2008; nr. 8, datë 13.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

143 Shih vendimin nr. 69, datë 16.10.2000 të Gjykatës Kushtetuese.

144 Shih vendimet nr. 28, datë 22.05.2015; nr. 73, datë 14.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

nuk kushtëzohet nga karakteri, publik ose privat i personit juridik, por nga natyra e shkeljeve që ai pretendon në kërkesë dhe që duhet të kenë të bëjnë me shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

155. Kështu, në vitin 2003 Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Prefekturës së Qarkut Tiranë, si palë e paditur në një proces gjyqësor ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin e vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Duke vënë në diskutim legjitimitimin e tij, Gjykata iu referua nenit 16, pika 2 të Kushtetutës duke theksuar se personat juridikë të së drejtës private, janë përfitues të të drejtave e lirive dhe si të tillë, mund ta venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pretendime për proces jo të rregullt, sipas nenit 42 e 131, shkronja "f" të Kushtetutës. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe partitë politike e organizatat e tjera që kanë qëllim të mbrojnë liri e të drejta të veçanta të individëve si psh., të drejtën e zgjedhjes e lirinë e besimit. Sa u takon personave juridikë publikë, ata ushtrojnë funksione shtetërore e marrin vendime pa qenë bartësa të të drejtave e lirive themelore. Rregullimet e aktet që nxjerrin këto organe nuk mund të bëhen objekt i të drejtave themelore nga vetë ata sepse mungon lidhja e tyre me qënien njerëzore. Qëllimi themelor i të drejtave e lirive është mbrojtja e sferës private të individit nga shteti, prandaj organizmat e vetë shtetit nuk mund të bëhen subjekte të të drejtave dhe lirive themelore gjatë kryerjes së detyrave shtetërore. Si përjashtim, personat juridikë publikë, mund ta venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese kur ata marrin pjesë në qarkullimin civil e cenohen njëlloj si të ishin qytetarë të thjeshtë si dhe në rastet kur janë ngarkuar drejtëpërdrejt me mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore që shërbejnë direkt për të forcuar autonominë e tyre. Në rastin e fundit do të trajtoheshin si individë që venë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "g" në lidhje me nenin 16, pika 2 të Kushtetutës edhe organet e pushtetit lokal, universitetet dhe stacionet radio-televizive. Sipas Gjykatës, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Prefekturës së Qarkut Tiranë, në çështjen në shqyrtim, kundërshtonte gjykimin e Gjykatës së Lartë për një vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave të Bashkisë, pra për një çështje që nuk ka të bëjë me të drejtën subjektive të vetë komisionit, por me veprimtarinë vendimmarrëse të tij për kthimin e pronave ish-pronarëve. Duke u nisur nga kjo dhe nga fakti që ai nuk vërtetoi t'i jetë prekur ndonjë interes tjetër juridik, në kuptim të nenit 134, pika 2 të Kushtetutës, Gjykata arriti në përfundimin se kërkesa duhet të rrëzohet për mungesë legjitimitimi.¹⁴⁵
156. Në një rast tjetër në vitin 2006, Gjykata Kushtetuese legjitimoi Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, e cila pretendonte cenimin e së drejtës për proces të rregullt si palë ndërgjyqëse në një gjykim. Gjykata theksoi se ka dallim midis legjitimitit të personave juridikë publikë, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale, nga legjitimiti i subjekteve të së drejtës publike, që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. Shteti ose organet përbërëse të tij, me disa përjashtime, nuk mund të konsiderohen subjekte përfitues të të drejtave e lirive themelore substanciale dhe si rrjedhojë nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për këto të drejta. E kundërta ndodh kur personi juridik publik pretendon cenimin e parimeve procedurale kushtetuese (ajo e ankimit dhe e aksesit në gjykatë në rastin në shqyrtim). Këto parime nuk mund të cenohen, sepse janë elementë të së drejtës në tërësi që rrjedhin nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Prandaj, dhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkeljen e tyre mund të paraqitet nga çdo subjekt duke përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë¹⁴⁶. Të njëjtin qëndrim mbajti Gjykata edhe në vitin 2009¹⁴⁷.

¹⁴⁵ Shih vendimin nr. 39, datë 23.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata edhe në vendimin nr. 14, datë 15.10.2004.

¹⁴⁶ Shih vendimin nr. 22, datë 26.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁴⁷ Shih vendimin nr. 14, datë 03.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

157. Në kontekstin e kësaj jurisprudence, duhet të theksohet se personat juridikë publikë, kur ushtrojnë funksione të Shtetit, siç ndodh zakonisht, konsiderohen si organe që shprehin vullnetin e tyre për të tretët, kështu që ata nuk mund të jenë mbartës të të drejtave dhe lirive themelore të një natyre substanciale, por, më së shumti, mund të pretendojnë, gjithmonë në emër dhe për llogari të vetë Shtetit, të drejtën për proces të rregullt ligjor (nëse kanë qenë palë e procesit gjyqësor që kundërshtojnë). Nga ana tjetër, personat juridikë publikë që e kanë misionin e tyre të lidhur drejtpërdrejt me fushën e të drejtave themelore të njeriut dhe e ndjekin atë në mënyrë të pavarur nga Shteti, ose të paktën, në mënyrë të veçantë ose autonome prej tij, duhet të vlerësohen ndryshe, siç janë, për shembull, organet e pushtetit vendor, universitetet publike, radiot dhe televizionet publike.
158. Ky qëndrim i Gjykatës u konfirmua në vitin 2010¹⁴⁸, kur u theksua se personat juridikë publikë legjitimohen të venë në lëvizje një gjykim kushtetues kur ata marrin pjesë në qarkullimin civil dhe cenohen njëlloj si të ishin qytetarë të thjeshtë, si dhe në rastet kur janë ngarkuar drejtpërdrejt me mbrojtjen e një fushe të caktuar të drejtash themelore që shërbejnë direkt për të forcuar autonominë e tyre. Në këtë vështrim, personat juridikë publikë do të trajtohen si individë, në kuptim të nenit 134, pika 1, shkronja "g" në lidhje me nenin 16, pika 2 të Kushtetutës.
159. Nisur nga kjo jurisprudence e Gjykatës, duket qartazi se ndryshimi i nenit 71 të Ligjit Organik të saj, në drejtim të përfshirjes së personave juridikë si pjesë e konceptit të individit që mund të ushtrojë ankimi kushtetues individual, është reflektim dhe pasqyrim i praktikës së konsoliduar të Gjykatës.
160. Sa i takon *organizatave jo fitimprurëse*, edhe ato kanë personalitet juridik, ndaj si të tilla përfshihen në konceptin e individit dhe mund të paraqesin ankim kushtetues individual sipas nenit 134, pika 1, shkronja "f" e Kushtetutës. Kur ato veprojnë si individ, në mënyrë të njëjtë me këtë të fundit, kanë të drejtë të kërkojnë shfuqizimin e akteve të pushtetit publik, përfshirë ligjet ose aktet normative dhe shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, të një procesi gjyqësor, në të cilin kanë qenë palë, por gjithmonë me kushtin, që zbatohet për individin - pra të tregojnë se nga akti ose vendimi i kundërshtuar u është cenuar një e drejtë apo liri themelore. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se organizatat legjitimohen për të paraqitur ankim kushtetues individual kur provojnë se çështja lidhet me liritë dhe të drejtat e tyre themelore.
161. Duhet vënë në dukje se Kushtetuta i ka dhënë organizatave mundësinë e ankimit kushtetues të dyfishtë. Përveç ankimit kushtetues, si individ, ato përmenden shprehimisht në nenin 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës si subjekt që vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, por edhe në këtë rast, ashtu siç është theksuar në jurisprudence kushtetuese, ato bëjnë pjesë në grupin e subjekteve të kushtëzuara dhe legjitimohen kur arrijnë të provojnë se çështja lidhet me interesat e tyre¹⁴⁹, sipas nenit 134 pika 2 të Kushtetutës. Legjitimimi i tyre në këto raste nuk varet nga aktiviteti jo fitimprurës, por nga qëllimet e veprimtarisë së tyre¹⁵⁰. Shoqatat kanë kërkuar shpesh ndërhyrjen e Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar antikushtetutshmërinë e akteve normative nën këtë hipotezë, pra duke provuar se çështja kushtetuese lidhet me qëllimet e veprimtarisë së tyre, veprimtari e cila në rastet më të shumta përkon edhe me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore. Ndërkohë në jurisprudence e Gjykatës nuk janë evidentuar ende raste kur organizatat jo fitimprurëse t'i jenë

148 Shih vendimin nr. 36, datë 10.11.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

149 Shih vendimet nr. 4 datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

150 Elementi përcaktues i legjitimitetit të organizatës për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues, i pranuar nga jurisprudence konstante e Gjykatës, është lidhja e drejtpërdrejtë dhe e individualizuar midis objektit të veprimtarisë së kërkuar dhe çështjes kushtetuese të paraqitur për shqyrtim (shih vendimet nr. 39, datë 15.12.2023; nr. 37, datë 01.12.2022; nr. 4, datë 15.02.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 33, datë 08.06.2016; nr. 14, datë 21.03.2014; nr. 43, datë 06.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

drejtuar asaj me ankim kushtetues në cilësinë e individit për shfuqizimin e ndonjë akti të pushtetit publik.

162. Përmendja e organizatave shprehimisht në listën e subjekteve që vënë në lëvizje gjykimin kushtetues nuk është e rastit. Organizatat e shoqërisë civile, si shprehje e lirisë kushtetuese të organizimit të qytetarëve, luajnë rol të rëndësishëm në demokratizimin e shoqërisë nëpërmjet monitorimit të mënyrës se si ushtrohet pushteti publik dhe krijimit të forumeve për debatimin e politikave publike. Në këtë mënyrë, veprimtaria e organizatave civile është e domosdoshme në funksionimin e shtetit të së drejtës, pasi jo vetëm nxit debatin publik dhe ndërgjegjëson qytetarët për çështje me interes të gjerë, por ato shërbejnë edhe si mekanizma të dialogut konstruktiv midis qytetarëve dhe autoriteteve publike. Organizatat e shoqërisë civile, duke qenë të pavarura, janë partnerë jetikë të shtetit demokratik. Ato kanë aftësinë që me veprimtarinë e tyre vullnetare dhe të pavarur ta bëjnë shtetin në të gjitha nivelet më të përgjegjshëm, llogaridhënës, gjithëpërfshirës dhe efektiv, duke i forcuar atij legjitimitetin dhe besimin e qytetarëve.
163. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata edhe për legjitimitimin e *organeve të bashkësive fetare*, kur ato i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar antikushtetutshmërinë e akteve normative, për të cilat tregonin se kishin interes të drejtpërdrejtë¹⁵¹, ose për të kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, për të cilat vërtetonin se kishin qenë palë ndërgjyqëse e procesit të kundërshtuar¹⁵².
164. Konkretisht, Gjykata ka marrë në analizë legjitimitimin *ratione personae* të komuniteteve fetare kur objekt i ankimit të tyre ka qenë Ligji i Pronave. Fillimisht, Gjykata ka vënë në dukje se komunitetet fetare janë persona juridikë dhe se neni 10 i Kushtetutës garanton asnjësinë shtetërore në çështjet e besimit fetar, duke përcaktuar se marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave, të cilat ratifikohen në Kuvend. Po kështu, sipas kësaj dispozite, bashkësitë fetare janë persona juridikë, të cilat kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve. Nga ana tjetër, në nenin 22 të ligjit nr. 10056, datë 22.01.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”, përcaktohet se kërkuesi përfiton nga të drejtat që u njihen ish-pronarëve të pasurive të paluajtshme të marra në mënyrë të paligjshme nga regjimi komunist dhe, për rrjedhojë, nga Ligji i Pronave.¹⁵³ Për këtë arsye është çmuar se Komuniteti legjitimohet *ratione personae*, në kushtet kur dispozitat e kundërshtuara prekin pasuritë e kërkuesit, përdorimi i të cilave i shërben ushtrimit të veprimtarisë së tij.¹⁵⁴ Nënkuptohej se kjo analizë vlen edhe nëse komunitetet fetare i drejtohen Gjykatës me ankim kushtetues individual.

151 Shih vendimin nr. 110, datë 16.09.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

152 Shih vendimin nr. 1, datë 25.01.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

153 Konkretisht, kjo dispozitë parashikon: “1. Shteti i nje Komunitetit Mysliman të Shqipërisë të drejtën e pronës mbi sende të luajtshme dhe të paluajtshme me të gjitha elementet përbërëse të saj. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë rinjehet sipas kësaj Marrëveshje si trashëgimtar i pronave përkatëse të tij. 2. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, shteti trajton me përparësi kërkesat e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për kthimin dhe kompensimin e pronave të veta. 3. Në rastet kur objektet e kultit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë nuk gjenden të regjistruara në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronësinë do ta vërtetojë (provojë) nëpërmjet dokumenteve të Arkivit Qendror të Shtetit.”.

154 Shih vendimin nr. 5, datë 13.02.2024 të Gjykatës Kushtetuese dhe nr. 110, datë 16.09.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

2.1.3 I huaji

165. Në lidhje me shtetasit e huaj, neni 16, pika 1, i Kushtetutës parashikon se “të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”. Duke konsideruar se Kushtetuta nuk ka parashikuar asnjë kufizim të veçantë për ankimin kushtetues individual, legjitimohen t’i drejtohen Gjykatës Kushtetuese edhe individët jo shqiptarë.
166. Jurisprudenca kushtetuese ka regjistruar disa raste në këtë drejtim. Kështu, në vitin 2011 një qytetar i huaj (i cili nuk kishte vendbanim apo vendqëndrim në Shqipëri) u ankua për cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të mosekzekutimit brenda afatit të arsyeshëm, të vendimit të formës së prerë.¹⁵⁵ Kërkuesi ishte shtetas grek dhe parashitroi se nuk po ekzekutoheshin vendimet gjyqësore të dhëna në Greqi, sipas të cilave ai kishte të drejtë të takonte djalin e tij, dhe ish – bashkëshortja me banim në Shqipëri nuk ia lejonte. Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nuk formulohet asnjë vlerësim apo deklaram mbi shtetësinë e kërkuesit, apo vendbanimin ose vendqëndrimin e tij, çka të bën të mendosh që Gjykata ka pranuar se nuk ekziston asnjë pengesë apo kriter tjetër për legjitimitimin e të huajve (apo personave pa shtetësi) për t’iu drejtuar drejtësisë kushtetuese. Ky qëndrim është konfirmuar në vijim në jurisprudencën kushtetuese.¹⁵⁶
167. Në një rast tjetër, kërkuesja si person juridik i huaj, ka pretenduar se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë, e cila kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Gjykata theksoi se bazuar në nenin 16 të Kushtetutës, të huajt kanë të njëjtat të drejta e liri themelore të parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë, prandaj kërkuesja legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar.¹⁵⁷
168. Gjithashtu, Gjykatës i është drejtuar me kërkesë një person juridik i huaj, i organizuar në formën e shoqatës, që ishte regjistruar jashtë Shqipërisë dhe sipas statutit të tij, vepronte për të realizuar ushtrimin e të drejtës së votës nga diaspora. 23 anëtarë të saj mbanin shtetësinë shqiptare, megjithatë shoqata nuk ishte regjistruar në gjykatat shqiptare. Ajo pretendonte se ishte cenuar e drejta e votës, e parashikuar në nenin 45, pika 1, të Kushtetutës, për arsye të mosveprimit të organeve të ngarkuara nga ligji për të mundësuar votimin nga jashtë të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë Shqipërisë.¹⁵⁸ Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae* të kërkueses Gjykata u nis nga përmbajtja e nenit 46 të Kushtetutës¹⁵⁹ për të drejtën e organizimit dhe regjistrimit të shoqatave sipas ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, të ndryshuar¹⁶⁰,

¹⁵⁵ Shih vendimin nr. 12, datë 15.04.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵⁶ Shih vendimet nr. 3, datë 19.02.2013; nr. 3, datë 26.01.2015; nr. 17, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese; nr. 189, datë 18.09.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese; nr. 76 datë 13.04.2023; nr. 19 datë 05.02.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵⁷ Shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵⁸ Shih vendimin nr. 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵⁹ Neni 46 i Kushtetutës parashikon: “1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. 2. Regjistrimi në gjykatë i organizatave ose i shoqatave bëhet sipas procedurës së parashikuar me ligj. 3. Organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara sipas ligjit.”

¹⁶⁰ Neni 12, pika 2, i ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 parashikon: “Organizatat jofitimprurëse të huaja janë ato organizata të themeluara, të njohura dhe regjistruara si të tilla sipas ligjit të një shteti tjetër. Organizatat jofitimprurëse të huaja lejohen të ushtrojnë një a disa veprimtari të caktuara në territorin shqiptar, me kusht që ato të mos vijnë në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislatcionin shqiptar.”

duke u shprehur se liria e organizimit kolektivisht është nga më të rëndësishmet në një shoqëri demokratike, e cila ka për qëllim dhënien e mundësisë shtetasve për t'u grumbulluar dhe organizuar të lirë dhe sipas preferencës, për synime dhe objektiva të përbashkëta. Duke mbajtur në konsideratë qëllimin e veprimtarisë së kërkueses, anëtarësinë e saj, natyrën e pretendimeve që lidhet me të drejtën kushtetuese për të votuar të shtetasve shqiptarë me banim jashtë shtetit dhe faktin se paraqitja e kërkesës në Gjykatë nuk përbën veprim në kundërshtim me Kushtetutën dhe legjislacionin shqiptar, përkundrazi, lejohet prej tyre, Gjykata vlerësoi se kërkuesja, pavarësisht se nuk është regjistruar në gjykatat shqiptare, legjitimohej *ratione personae* për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi justifikon interesin e saj të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar. Një interpretim i kundërt i kësaj dispozite kushtetuese, do të binte ndesh me vetë frymën e Kushtetutës, e cila mbron lirinë e organizimit për qëllime të ligjshme, si dhe njeh të drejtën e aksesit në gjykimin kushtetues të organizatave që provojnë se çështja lidhet me interesat e tyre.

169. Si përfundim, mund të thuhet se Gjykata në jurisprudencën e saj nëpërmjet një sërë përpjekjesh hermeneutike të vlerësueshme, ka vepruar duke zgjeruar listën e subjekteve të aftë për të vënë në lëvizje një gjykim kushtetues, pra për të ushtruar ankimin kushtetues individual. Kjo qasje është më e dukshme përpara ndryshimeve të vitit 2016, pasi në atë kohë sikurse u theksua individit mund t'i drejtohej Gjykatës vetëm për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kjo duket të jetë arsyeja që dispozitat e reja të Ligjit Organik të Gjykatës që lidhen me kriteret e legjitimitetit *ratione personae* në thelb u miratuan duke iu përgjigjur zhvillimeve të jurisprudencës kushtetuese. Po ashtu, vlen të theksohet se, edhe pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, Gjykata i ka qëndruar jurisprudencës së saj, duke sjellë risi të mëtejshme.

2.1.4 Justifikimi i interesit

170. Individit, sipas nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen e parashtruar. Gjykata ka pohuar se, individit është subjekt i kushtëzuar, ndaj ai mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të drejtat themelore të tij. Kjo do të thotë se individit duhet të provojë legjitimitetin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial¹⁶¹.
171. Interesi i individit justifikohet nga pasoja që atij i vjen në të drejtat themelore për shkak të aktit të pushtetit publik ose vendimit ligjor. Pasoja, e njohur ndryshe edhe si dëmi i pësuar, material ose jomaterial, i jep individit cilësinë e viktimës së shkeljes së të drejtave të njeriut. Në thelb, pasoja për qëllime të interesit të individit duhet të ketë tre tipare, që do të thotë se ajo duhet të jetë: (a) vetjake; (c) reale; dhe (ç) e drejtpërdrejtë. Në këtë drejtim, nuk mund të mos mbahet në konsideratë edhe mënyra sesi GJEDNJ-ja e ka elaboruar në jurisprudencën e saj nocionin e viktimës, në kuptim të nenit 34 të KEDNJ-së. Konkretisht, ajo e ka interpretuar këtë nocion në mënyrë autonome dhe të pavarur nga rregullat e së drejtës së brendshme, duke theksuar se zbatimi i tij duhet të bëhet pa shumë formalizma¹⁶², pra pa qenë e nevojshme të zhvillohet një hetim i thelluar për ekzistencën e tij. GJEDNJ-ja ka mundur të pranojë, rast pas rasti, ankimin e një viktime të quajtur "potenciale",

¹⁶¹ Shih vendimet nr. 64, datë 30.11.2023 dhe nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁶² Shih vendimet *Gorraiz Lizarraga e të tjerë kundër Spanjës*, nr. 62543/00, datë 27.04.2004, § 38; *Stukus e të tjerë kundër Polonisë*, nr. 12534/03, datë 01.04.2008, § 35; *Ziętal kundër Polonisë*, nr. 64972/01, datë 12.05.2009, §§ 54-59.

domethënë të aplikantëve që pasojat mund t'u vinin në të ardhmen.¹⁶³ Gjithashtu, kur ekziston një lidhje e veçantë dhe personale midis viktimës direkte dhe kërkuesit, GJEDNJ-ja ka pranuar ankimin individual të një personi që konsiderohet si viktimë indirekte.¹⁶⁴

172. Duhet theksuar se vlerësimi nëse një subjekt i kushtëzuar ka interes që të vërë në lëvizje Gjykatën bëhet, rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë dhe në varësi të objektit të ankimit kushtetues individual, pra nëse ai është vendim gjyqësor ose akt normativ.

a) Interesi për kundërshtimin e vendimit gjyqësor

173. Kur objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi gjyqësor ose konstatimi i cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, individi (person fizik apo juridik) nëse ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë, është konsideruar se ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar, pra dhe është legjitimuar *ratione personae*.
174. Në këtë kuptim në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, person fizik ose juridik, si një prej subjekteve të kushtëzuara, kur kundërshton procesin ligjor, ka detyrimin të provojë se në ç'mënyrë është prekur në të drejtat e tij kushtetuese si pasojë e parregullsisë së këtij procesi. Interesi i tij për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak, dhe ai duhet të konsistojë tek e drejta e shkelur dhe te dëmi real i shkaktuar.¹⁶⁵
175. Sa më lart, si rregull, pjesëmarrja e individit në proces gjyqësor provon elementët e pasojës vetjake, reale dhe të drejtpërdrejtë për individin, në kushtet kur procesi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ka natyrë konkrete dhe ka në objekt mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave kushtetues dhe ligjorë të individit apo akuzat e ngritura ndaj tij.
176. Të njëtin arsyetim ka mbajtur Gjykata edhe në rastet kur individi i është drejtuar asaj duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutim të një vendimi gjyqësor (të dhënë në favor të tij) brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e ekzekutimit, në rastet kur ky i fundit nuk ka përfunduar.¹⁶⁶

163 Gjykata pranoi se ankuesit konsideroheshin viktimë në vendimet *Klass e të tjerë kundër Gjermanisë*, nr. 5029/71, datë 6.09.1978, § 34 dhe e mori në shqyrtim themelin e ankimit të tyre; *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14038/88, datë 7.07.1989, megjithëse ekstradimi nuk ishte zbatuar ende, Gjykata vuri në dukje se nëse ekstradimi do të realizohej do të kishte pasur cenim të nenit 3 të KEDNJ-së. Nga ana tjetër Gjykata nuk e pranoi statusin e viktimës në vendimet *Vijayanathan dhe Pusparajah kundër Francës*, nr. 17550/90 dhe 17825/91, datë 27.08.1992, § 46 – megjithëse ankuesve u ishte sugjeruar të largoheshin nga territori francez, kjo nuk ishte zbatuar pasi mungonte një urdhër formal dëbimi; *Senator Lines GmbH kundër pesëmbëdhjetë shteteve anëtare të BE* [DHM], nr. 56672/00, datë 10.03.2004 – vetëm dyshimi se kompanisë mund t'i vendosej një gjobë nuk ishte i mjaftueshëm për të justifikuar statusin e viktimës; *Rossi e të tjerë kundër Italisë*, nr. 55185/08, 55483/08, 55516/08, 55519/08, 56010/08, 56278/08, 58420/08 dhe 58424/08 datë 16.12.2008 – ankuesit individë nuk kishin lidhje familjare me pacientët në gjendje vegjetative, ndërsa ankuesit shoqata nuk cenoheshin në veprimtarinë e tyre të ushtrimit të aktivitetit të tyre.

164 Shih për shembull vendimet: *McCann e të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 18984/91, datë 27.09.1995 – bashkëshortja e viktimës; *Yaşa kundër Turqisë*, nr. 63/1997/847/1054, datë 2.09.1998, § 66 – nipi i viktimës (për nenin 2 – e drejta e jetës); *Kurt kundër Turqisë*, nr. 15/1997/799/1002, datë 25.05.1998 – nëna e një njeriu të zhdukur gjatë privimit nga liria; *Çakıcı kundër Turqisë* [DHM], nr. 23657/94, datë 8.07.1999, §§ 98-99 – vëllai i një individi të zhdukur nuk është konsideruar viktimë (për nenin 3 – ndalimi i torturës); *Brudnicka e të tjerë kundër Polonisë*, nr. 54723/00, datë 3.03.2005, §§ 26 e vijues – për mbrojtjen e reputacionit të të afërmeve marinarë që kanë humbur jetën në një stuhinë në det (për nenin 6 § 1); *Nölkenbockhoff kundër Gjermanisë*, nr. 10300/83, datë 25.08.1987, § 33 – bashkëshortja e një individi, e cila pretendonte cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë për bashkëshortin e akuzuar për kryerjen e një veprë penale para se të humbte jetën (për nenin 6 § 2); *Dalban kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28114/95, datë 28.09.1999, § 39 – bashkëshortja e një individi i cili ishte akuzuar për shpifje nëpërmjet shtypit mund të pretendojë cenimin e lirisë së shprehjes megjithëse vet personit ka humbur jetën (për nenin 10 – liria e shprehjes); *Agrotexim e të tjerë kundër Greqisë*, nr. 14807/89, datë 24.10.1995, § 62 – ankuesit nuk mund të pretendojnë se ishin viktimë të shkeljes së të drejtës së pronës së shoqërisë së tyre (për nenin 1 të Protokollit nr. 1).

165 Shih vendimin nr. 12, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

166 Shih vendimin nr. 39, datë 14.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

177. Kjo vlen edhe në të kundërt, pra kur individ i ngre pretendime për një proces gjyqësor, në të cilin nuk ka qenë palë, atëherë interesi i tij për çështjen kushtetuese të parashtruar vihet në dyshim. Në kushtet kur një vendim gjyqësor i juridiksionit të zakonshëm sjell efekte vetëm për palët në proces, atëherë si rregull një vendim i tillë nuk sjell pasoja vetjake për individin. Për ilustrim, një qytetare kundërshtoi procesin gjyqësor që i përkiste një shoqërie ndërtimi, në të cilin gjykata kishte vendosur detyrimin e bashkisë të nxirrte një leje ndërtimi. Ankuesja ngriti pretendimin se leja e ndërtimit nuk i shërbente interesit publik. Kolegji i Gjykatës, evidentoi se kërkesja jo vetëm që nuk rezultonte të ishte palë në atë proces gjyqësor apo të kishte kërkuar të marrë pjesë në të, por ajo nuk kishte arritur as të provonte nëse i ishte cenuar ndonjë e drejtë substanciale nga objekti i vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme¹⁶⁷. Me të njëjtin arsyetim, Kolegji i Gjykatës ka vendosur mospranimin e ankimit të një individ, që ndër të tjera, kërkonte shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, të dhënë në një proces gjyqësor që i përkiste një individ tjetër¹⁶⁸.
178. Gjithsesi ky rregull ka edhe përjashtime. Për ilustrim po paraqitet një rast konkret i shqyrtuar nga Gjykata. Një individ nuk ishte legjitimuar nga gjykatat e zakonshme si avokat i palës ndërgjyqëse dhe ishte refuzuar pjesëmarrja e tij në gjykim, madje gjykata e shkallës së parë i kishte caktuar gjobë sepse ai, pa u legjitimuar si palë pjesëmarrëse në gjykim, kishte kërkuar përjashtimin e gjyqtarit të çështjes. Kërkuesi iu drejtua Gjykatës me ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimin e ndërmjetëm për atë pjesë që kishte vendosur dënimin e tij me gjobë, si edhe vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë që nuk kishin pranuar ankimin ndaj vendimit të gjobës. Gjykata vërejtë se duke qenë se për masën e gjobës së caktuar ndaj kërkuetit ishte disponuar jo me vendim të veçantë, por me vendimin për mospranimin e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit, kërkuesi nuk kishte pasur asnjë mundësi që të kundërshtonte në mënyrë të drejtpërdrejtë masën e dhënë ndaj tij. Prandaj edhe pse kërkuesi nuk ishte palë ndërgjyqëse në vendimet e kundërshtuara, për sa kohë që ato, ndër të tjera, kishin caktuar nominalisht ndaj tij, si përfaqësues i kallëzuesit një gjobë, e cila përbënte edhe objekt të ankimit kushtetues individual të kërkuetit, u konsiderua se ai justifikonte interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar ndaj legjitimohej *ratione personae* në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1, të nenit 134 të Kushtetutës.¹⁶⁹
179. Mund të ndodhë, që individ i jetë trashëgimtar i një prej palëve ndërgjyqëse, i cili ka ndërruar jetë gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Është e qartë, që në këtë rast, individ i si përfitues i të drejtave dhe detyrimeve të trashëgimlënësit, konsiderohet se ka interes për çështjen kushtetuese që lidhet me procesin gjyqësor¹⁷⁰.
180. Në praktikën e Gjykatës janë vënë re disa situata, ku edhe pse kërkuesi formalisht ka qenë palë e procesit gjyqësor të kundërshtuar, Gjykata nuk e ka marrë të mirëqenë interesin e tij, por është ndalur për ta analizuar hollësisht atë për shkak të rrethanave të veçanta dhe prapësimeve të subjekteve të interesuara.
181. Kështu, në një rast, një shoqëri tregtare, me pretendimin se i ishte cenuar e drejta e procesit të rregullt dhe parimi i sigurisë juridike, paraqiti ankim kushtetues individual me objekt shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, për rishikimin e vendimit të mëparshëm të saj për nxjerrjen çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe vazhdimin e gjykimit në shkallë të parë. Subjekti i interesuar prapësoi interesin e kërkueses, duke argumentuar se në kohën e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, gjykata e shkallës së parë kishte filluar shqyrtimin e çështjes në zbatim të vendimit

167 Shih vendimin nr. 194, datë 25.09.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

168 Shih vendimin nr. 23, datë 05.02.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese

169 Shih vendimin nr. 22, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

170 Shih vendimin nr. 267, datë 19.12.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese

të Gjykatës së Lartë, por në vijim e kishte pushuar gjykimin, bazuar në kërkesën e subjektit të interesuar (paditës në atë gjykim) dhe me pëlqimin e kërkueses (e paditur në atë gjykim). Vendimi i pushimit nuk u ankimua nga asnjë prej palëve. Si rezultat, në kohën e shqyrtimit të ankimit kushtetues individual, në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kishte një proces gjyqësor që të shqyrtonte sërish të drejtën ose interesin e ligjshëm të kërkueses, që me vendim gjyqësor përfundimtar ishte nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor. Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se, edhe pse gjykata e shkallës së parë kishte vendosur pushimin e gjykimit në atë juridiksion, vendimi i pushimit, në bazë të dispozitave ligjore procedurale, ishte vendim jopërfundimtar dhe nuk përbënte pengesë për ringritjen e padisë në të ardhmen (nenet 127 dhe 300 të KPC-së), duke e bërë në këtë mënyrë të zbatueshëm vendimin e kundërshtuar të Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, ajo vlerësoi se kërkuesja kishte interes të drejtpërdrejtë në çështjen kushtetuese të parashtruar, ndaj ajo legjitimohej *ratione personae*.¹⁷¹

182. Kur bëhet fjalë për cenim të të drejtës së jetës, është e qartë që familjarët e afërt të të ndjerit kanë interes të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar procedimin penal të fajtorit, pa qenë e nevojshme të vërtetojnë se janë një prej trashëgimtarëve të tij. Kështu, në një rast, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se kërkuesi legjitimohej *ratione personae*, pasi në cilësinë e viktimës së veprës penale (babai i së ndjerës) kishte vënë në lëvizje me kallëzim procedimin penal, për pushimin e të cilit kishte ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë provonte interesin e tij në çështjen e parashtruar.¹⁷² **Në mënyrë të ngjashme**, Kolegji, në një rast tjetër, ka vlerësuar se motra e të ndjerit, e cila kishte paraqitur kallëzim penal, provonte interesin në çështjen e parashtruar dhe legjitimohej *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, për të kundërshtuar pushimin e procedimit penal¹⁷³.
183. Ky qëndrim është mbajtur dhe përpara ndryshimeve të vitit 2016, në një vendim përfundimtar të Gjykatës. Në atë rast, vëllai i kërkuesit, i dënua me burgim për kryerjen e një veprë penale, kishte ndërruar jetë në spital. Prokuroria mbi bazën e kallëzimit të komisariatit të policisë, kishte vendosur mosfillimin e procedimit penal, i cili ishte ankimuar nga kërkuesi. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kishin refuzuar ankimin e kërkuesit, duke arsyetuar se bazuar në nenin 291 të KPP-së, ai nuk legjitimohej të kundërshtonte vendimin e mosfillimit të procedimit penal të prokurorisë, përderisa nuk ishte subjekti që kishte paraqitur kallëzim apo ankim. Kërkuesi i ishte drejtuar Gjykatës duke pretenduar cenimin e të drejtës së aksesit në gjykatë për shkak të interpretimit të gabuar që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kishin bërë nenit 291 të KPP-së, si dhe për shkak të anashkalimit prej tyre të nenit 58 të KPP-së, i cili i njehtë dëmtuarit ose trashëgimtarëve të tij të drejtën për të kërkuar procedimin e fajtorit. Gjykata edhe në këtë rast, e legjitimoi kërkuesin *ratione personae*, duke u mjaftuar me faktin se ai kishte qenë palë e procesit gjyqësor të kundërshtuar me ankimin kushtetues individual.¹⁷⁴

171 Shih vendimin nr. 18, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

172 Shih vendimin nr. 56, datë 17.03.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

173 Shih vendimin nr. 33 datë 16.02.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

174 Shih vendimin nr. 67, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese. Në shqyrtim e çështjes në themel Gjykata gjithsesi vërejtë se sipas nenit 58 të KPP-së personi i dëmtuar ose trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e autorit dhe shpërblimin e dëmit, kanë të drejtë të parashtrorin kërkesa në organin procedues dhe të kërkojnë marrjen e provave. Në këtë kuptim, kërkuesi apo familjarët e tjerë të viktimës nuk kanë pasur asnjë pengesë ligjore që të kërkonin të dhëna dhe informacione nga organi i akuzës apo që të paraqisnin kallëzim për shkak të dyshimeve për shkaqet e vdekjes së viktimës. Për sa kohë që kërkuesi nuk ka vënë në lëvizje organin e akuzës për fillimin e procedimit penal, ai nuk legjitimohet në paraqitjen e ankimit ndaj këtij vendimi. Edhe pse në dukje dispozita e nenit 291 të KPP-së cenon të drejtën e aksesit, duke e parë këtë dispozitë në harmoni me dispozitat e tjera të KPP-së si dhe me përfundimet e vendimit nr. 2, datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Gjykata vlerësoi se nuk preket në thelb e drejta e aksesit.

184. Vlen të përmendet edhe rasti i një kërkuesi, të cilit i ishte vendosur sekuestro konservative mbi pasurinë, për shkak të procesit penal në ngarkim të djalit të tij, edhe ky i fundit pronar i pasurisë. Kërkuesi pretendonte se atij i rrjedhin interesa të ligjshëm nga kjo pasuri, arsye për të cilën i ishte drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të kundërshtuar vendosjen e masës së sigurimit mbi të. Gjykata nuk e vuri në dyshim në këtë rast legjitimitimin *ratione personae* të kërkuesit. Ajo u shpreh se interesi i tij në çështjen në shqyrtim buronte nga e drejta e pretenduar e pronës, që pretendohet se ishte cenuar nga vendosja e sekuestros konservative.¹⁷⁵
185. Edhe kur vendimi gjyqësor ka sjellë pasojë në të drejtat themelore për një kohë relativisht të shkurtër, Gjykata ka çmuar se interesi i kërkuesit justifikohet. Kështu, kur një i arrestuar paraqiti ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimin për *vleftësimin e arrestit në flagrancë*, Gjykata vlerësoi se ai legjitimohej *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës "l", të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi në drejtim të pasojave negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale vendimi i kundërshtuar i kishte kufizuar kërkuesit lirinë personale, edhe pse për një kohë të shkurtër.¹⁷⁶
186. Rregulli i mësipërm, për justifikimin e interesit me pozicionin procedural në gjykimin e juridiksionit të zakonshëm, ka disa përjashtime. Përjashtimet kanë të bëjnë me rastet kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar ka rezultuar haptazi se nuk i sillte pasoja vetjake, reale dhe të drejtpërdrejta kërkuesit, në të drejtat themelore.
187. Kështu gjatë shqyrtimit paraprak të një ankimi kushtetues të një shoqërie tregtare, Mbledhja e Gjyqtarëve konstatoi se kërkuesja nuk kishte ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual ndaj vendimit të sekuestros, për të cilin legjitimitimi i saj procedural dhe substancial nuk do të vihej në dyshim. Vendimin e sekuestros ajo nuk e kishte ankimuar as në gjykatën e apelit. Kërkuesja kishte zgjedhur të paraqiste recurs dhe në vijim, edhe ankim kushtetues individual vetëm ndaj vendimit të gjykatës së apelit, në pjesën që kishte disponuar lënien e një pjese të sendit të sekuestruar në përdorim të të tretëve. Lidhur me këtë vendimmarrje të gjykatës së apelit, Mbledhja e Gjyqtarëve vërejtë se kërkuesja nuk kishte argumentuar se si kalimi i së drejtës së përdorimit të një pjese të sendit të sekuestruar (pra në administrim të organeve shtetërore) tek të tretët sillte pasoja të drejtpërdrejta dhe reale në të drejtën e pronës së kërkueses. Kjo e fundit i ishte kufizuar kërkueses nga vendimi i caktimit të sekuestros, për të cilin ajo nuk kishte asnjë kundërshtim¹⁷⁷.
188. Mungesa e pasojës *reale* mund të ilustron edhe me një rast tjetër, ku kërkuesit i ishte kthyer kërkesëpadija nga gjykata e shkallës së parë për shkak të mosplotësimit të të metave formale në paraqitjen e saj dhe mospagimit të taksës për shpenzimet gjyqësore. Kërkuesi nuk i kishte plotësuar të metat, por kishte zgjedhur të kundërshtonte vendimin e kthimit të akteve në Gjykatën Administrative të Apelit, madje duke vënë në lëvizje, për të njëjtin proces gjyqësor, Gjykatën e Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm për shkak të mosshqyrtimit të çështjes në apel. Duke qenë se Gjykata e Lartë kishte vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, ai iu drejtua Gjykatës për cenimin e afatit të arsyeshëm. Mbledhja e Gjyqtarëve vuri në dukje se sipas nenit 154/a, paragrafi 4, i KPC-së, padia e kthyer për shkak të mospagimit të tarifës së padisë konsiderohet se nuk është paraqitur. Në këto kushte, në rrethanat e mosplotësimit të të metave fillestare të padisë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se kërkuesi nuk kishte arritur të provonte interesin për vënien në

175 Shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

176 Shih vendimin nr.72, datë 08.04.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

177 Shih vendimin nr. 90, datë 30.04.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

lëvizje të gjykimit kushtetues.¹⁷⁸

189. Mungesa e pasojës *vetjake* është vënë në dukje po ashtu në një rast, ku individi kundërshtonte procesin penal të dënimit të një vëzhguesi në qendrën e votimit, me pretendimin se ai kishte penguar familjarët e tij për të ndihmuar nënën, e cila për shkak të moshës dhe të gjendjes shëndetësore kishte pasur vështirësi për të votuar. Për këtë arsye, ata ishin konfliktuar në grup dhe kërkuesi së bashku me familjarë të tjerë të tij kishin pësuar dëmtime fizike. Kolegji evidentoi se, referuar përcaktimeve kushtetuese për ushtrimin e së drejtës së votës dhe përmbajtjes së pretendimeve të kërkuesit, thelbi i tyre lidhej me të drejtën për të votuar të nënës së kërkuesit. Duke qenë se kërkuesi pretendonte se e drejta e votës i ishte cenuar nënës së tij, Kolegji vlerësoi se ankimi kushtetues individual drejtuar Gjykatës duhet të ishte paraqitur prej saj, në kushtet kur ajo ka pësuar cenim të drejtpërdrejtë dhe vetjak të së drejtës kushtetuese të pretenduar. Për rrjedhojë, Kolegji arriti në përfundimin se kërkuesi, nuk legjitimohej *ratione personae* për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi nuk mund të mbronte një të drejtë kushtetuese të një personi tjetër edhe pse kishte lidhje të afërt familjare me të.¹⁷⁹
190. Ndërsa mungesa e pasojës së *drejtpërdrejtë* mund të ilustruhet me rastin e një individi, i cili i ishte drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm me kërkesëpadi me objekt detyrimin e organit publik, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për kryerjen e veprimit administrativ të refuzuar, kërkesë për marrje informacioni dhe pajisjen me vërtetim mbi gjendjen gjyqësore të të përfaqësuarit të tij. Duke qenë se ato nuk e kishin pranuar padinë e tij, ai paraqiti ankim kushtetues duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt dhe asaj për ushtrimin e profesionit të avokatit për shkak të mosvënies në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të dëshmisë së gjendjes gjyqësore. Kolegji i Gjykatës arriti në përfundimin se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione personae* pasi nuk provonte pamundësinë e tij për të ushtruar profesionin si pasojë e sjelljes së organit administrativ dhe, më pas, të vendimeve gjyqësore që kanë shqyrtuar çështjen e iniciuar prej tij.¹⁸⁰
191. Në vlerësimin e interesit të individit për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, merr rëndësi edhe çështja nëse kërkuesi e ka humbur cilësinë e viktimës në kohën që ka paraqitur ankimin kushtetues. Kjo situatë ndodh sidomos në ankimet që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurave, për shkak se gjykata mund të ketë përfunduar së shqyrtuari çështjen që po zgjatej ose mund t'i ketë caktuar dëmshpërblim individit. GJEDNJ-ja ka pohuar se, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave çështja nëse kërkuesi ka marrë riparim për dëmin e shkaktuar, që krahasohet me shpërblimin e drejtë, sipas nenit 41 të Konventës, është një çështje e rëndësishme. Aty ku autoritetet vendase kanë gjetur shkelje dhe vendimet e tyre përbëjnë korrigjim të mjaftueshëm, pala e interesuar nuk mund të pretendojë më se është viktimë në kuptim të nenit 34 të Konventës. Për këtë qëllim GJEDNJ-ja ka përcaktuar disa karakteristika që një mjet i tillë korrigjues duhet të ketë, duke pasur parasysh faktin se pretendimi për statusin e viktimës do të varet nga korrigjimi që mjeti i brendshëm do t'i ketë dhënë kërkuesit.¹⁸¹
192. Edhe Gjykata ka mbajtur të njëjtin qëndrim. Në një rast, Gjykata kishte vendosur konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në procesin gjyqësor të kërkueses, duke urdhëruar Gjykatën

178 Shih vendimet nr. 86, datë 13.07.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese; nr. 124, datë 30.09.2022; nr. 162 datë 23.11.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

179 Shih vendimin nr. 162, datë 12.07.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

180 Shih vendimin nr. 122 datë 30.09.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

181 Shih vendimet Apicella kundër Italisë [DhM], nr. 64890/01, datë 29.03.2006, §§ 70-71; Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DhM], nr. 36813/97, datë 29.03.2006 § 182.

Administrative të Apelit ta përfundonte gjykimin brenda 6 muajve. Mbi bazën e këtij vendimi, kërkesja kishte ngritur padi në gjykatën e shkallës së parë për shpërblimin e dëmit nga shkelja, e cila ishte pranuar pjesërisht, por vendimi ishte apeluar nga organet shtetërore të ngarkuara për shpërblimin e dëmit. Në kushtet kur gjykimi në shkallë të dytë për shpërblimin e dëmit të kërkeses po tejzgjatej, kërkesja vuri në lëvizje sërish Gjykatën me ankim kushtetues individual. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae* të saj, Gjykata vërejti se kërkesja, edhe pse kishte kaluar rreth 1 vit nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, që i akordonte asaj shpërblimin e dëmit, jo vetëm që nuk kishte mundur ta ekzekutonte këtë vendim, por ishte ende në pritje të shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit, e cila nuk po merrte masa për shqyrtimin me përparësi të çështjes. Në këto kushte, Gjykata vlerësoi se kërkesja nuk e kishte humbur statusin e viktimës, në drejtim të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të mjetit kompensues, duke e legjitimuar atë.¹⁸² Në të njëjtën linjë arsyetimi, Gjykata, në një rast tjetër, vlerësoi se kërkesi kishte interes të drejtpërdrejtë edhe në rastin kur ai u ankua për cenimin e të drejtës së procesit të rregullt ligjor, për shkak të mosekzekutimit plotësisht të vendimit gjyqësor në favor të tij, duke vënë në dukje se kërkesi ishte ende në pritje të ekzekutimit të plotë të vendimit gjyqësor, si dhe të shqyrtimit të ankimit në gjykatën e apelit për dëmshpërblimin nga vonesa në ekzekutim¹⁸³.

b) Interesi për kundërshtimin e ligjit ose aktit normativ

192. Kur objekt i ankimit kushtetues është ligji ose akti tjetër normativ (ose boshllëku ligjor), Gjykata është shprehur se individi, person fizik ose juridik, duhet të provojë se ai personalisht ka pësuar dëm real dhe të drejtpërdrejtë në ndonjë prej të drejtave themelore¹⁸⁴, për të përmbushur kushtin që vendosin në mënyrë të kombinuar nenet 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i" të Kushtetutës, si dhe neni 49, pika 3, shkronja "e" i Ligjit Organik të Gjykatës.
193. Lidhur me kërkesën që *dëmi të jetë vetjak*, individi duhet të provojë se është viktimë e një shkeljeje, në kuptimin që ligji ose akti normativ, me zbatimin e tij, i ka prekur situatën juridike¹⁸⁵, duke i mohuar ose zvogëluar të drejtat kushtetuese¹⁸⁶. Kjo do të thotë që individi nuk mund të paraqesë ankim kushtetues individual për të mbrojtur të drejtat e tjerëve. Kështu, në një rast, një qytetar paraqiti ankim ndaj akteve të organeve të qeverisjes vendore (me karakter normativ dhe individual), që kishin të bënin me ndërprerjen e bonusit të qirasë për banorët e prekur nga tërmeti. Kolegji arriti në përfundimin se ajo nuk legjitimohej *ratione personae*, pasi nuk justifikonte interesin e saj vetjak, në kushtet kur i ishte drejtuar Gjykatës për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve¹⁸⁷. Një qytetar tjetër paraqiti ankim kushtetues individual për shfuqizimin e shprehjes "*duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së tij të brendshme*" në pikën 2 të nenit 3 të Ligjit të Statusit të Magjistratëve, me pretendimin se, bazuar në këtë shprehje, magjistratët gjyqtarë dhe prokurorë japin vendime të padrejta ndaj qytetarëve. Sipas tij, ata nuk vlerësojnë faktet dhe provat e paraqitura nga palët, duke bërë të kundërtën. Kolegji evidentoi se pretendimet ishin me natyrë përgjithësuë dhe mungonin argumentet për pasojat që vetë ankuesit i vinin në të drejtat e tij themelore nga zbatimi i normës ligjore të kundërshtuar, ndaj kërkesi nuk justifikonte interesin në çështjen e parashtruar¹⁸⁸.

182 Shih vendimin nr. 44, datë 26.09.2023 i Gjykatës Kushtetuese.

183 Shih vendimin nr. 64, datë 30.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

184 Shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

185 Shih vendimin nr.111, datë 16.09.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

186 Shih vendimin nr. 161, datë 12.07.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

187 Shih vendimin nr. 188, datë 15.09.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

188 Shih vendimin nr. 81, datë 19.04.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

194. Edhe sipas GJEDNJ-së, Konventa nuk parashikon të drejtën e paraqitjes së një *actio popularis* për interpretimin e të drejtave të parashikuara në të ose t'i lejojë individët të ankohen për një dispozitë të një ligji kombëtar vetëm sepse ata konsiderojnë, pa u prekur drejtpërdrejt nga ajo, se mund të bjerë ndesh me Konventën. Megjithatë, kërkuesit mund të pretendojnë se një ligj shkel të drejtat e tyre, kur mungon një akt individual që e bën atë të zbatueshëm, nëse ata i përkasin një kategorie individësh që rrezikojnë të preken drejtpërdrejt nga legjislacioni ose nëse u kërkohet të modifikojnë sjelljen e tyre ose rrezikojnë të ndiqen penalisht.¹⁸⁹
195. Vlen të përmendet edhe rasti kur kërkuesi iu drejtua Gjykatës për shfuqizimin e vendimit të ILD-së, që kishte vendosur arkivimin e ankesës të paraqitur nga kërkuesi ndaj dy gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe të vendimit të një komisioni të KLGJ-së, që kishte refuzuar ankimin administrativ të tij. Mbledhja e Gjyqtarëve vërejti se procesi administrativ i vënë në lëvizje nga kërkuesi kishte pasur në objektin e tij verifikimin e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit. Si i tillë, ai ishte një proces me rëndësi publike dhe nuk lidhej me të drejtat personale të individit. Për këtë të fundit, legjislacioni garanton të drejtën e ankimit ndaj vendimit të ILD-së në një organ *quasi gjyqësor*, siç është komisioni i posaçëm i krijuar pranë KLGJ-së, si një mjet transparence dhe për të rritur përgjegjshmërinë e organeve që administrojnë sistemin e drejtësisë. Pozicioni i individit si ankues në këtë procedurë nuk e kthen çështjen e përgjegjësisë personale të magjistratit në interes personal të kërkuesit. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve theksoi se kërkuesi kishte paraqitur ankesë në ILD për shkak të një procesi gjyqësor për të drejtën e pronësisë dhe në këtë kuptim, të drejtat dhe interesat e tij ishin objekt i atij gjykimi. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione personae* në kërkimet e tij¹⁹⁰.
196. Një shembull tjetër është ankimi i një qytetareje për shfuqizimin, ndër të tjera, të ligjit për miratimin e marrëveshjes së administrimit të Parkut Kombëtar të Butrintit, me pretendimin se ai binte ndesh me Konventën e Parisit "Për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore", me identitetin kombëtar dhe trashëgiminë kulturore, si dhe parimet e shtetit të së drejtës, ligjshmërisë dhe hierarkisë së akteve të parashikuara nga Kushtetuta. Kolegji evidentoi se kërkuesja nuk kishte paraqitur ndonjë argument ose fakt që të ishte përfshirë, si palë ose në rolin e përfaqësueses së ndonjë pale apo grupi interesi, që kishte lidhje të drejtpërdrejtë me marrëveshjen për administrimin e Butrintit. Thënë ndryshe, kërkuesja nuk kishte parashtruar asnjë argument se në **çfarë mënyre prekej prej akteve që kundërshtonte, përkundrazi interesi i saj rezultonte i parashtruar me premisa teorike për cenimin e interesit publik që aktet e kundërshtuara kishin sjellë**. Në përfundim, Kolegji arriti në përfundimin se kërkuesja nuk justifikonte interesin e saj, ndaj ajo nuk legjitimohej *ratione personae* për t'iu drejtuar Gjykatës¹⁹¹.
197. Sa i takon kërkesës që *dëmi të jetë real*, është e nevojshme që pretendimet për dëmin të jenë konkrete, pasi nëse janë me natyrë përgjithësuese dhe nuk tregohet se cila është pasoja negative, e ardhur ose e pritshme, në të drejtat e tij themelore nga zbatimi i normës ligjore të kundërshtuar, atëherë arrihet në përfundimin se individit nuk justifikon interesin e tij në çështjen kushtetuese të parashtruar.¹⁹²
198. Rëndësia e pasojës reale në justifikimin e interesit është vënë në dukje disa herë nga Kolegjet e Gjykatës. Kështu, një shoqëri tregtare, me objekt veprimtarie financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e tre hidrocentraleve, sipas një

189 Shih vendimin *Sejdic dhe Finci kundër Bosnje dhe Hercegovinës*, nr. 27996/06 dhe nr. 34836/06, datë 22.12.2009, § 28.

190 Shih vendimin nr. 33, datë 22.02.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve

191 Shih vendimin nr. 43, datë 22.02.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

192 Shih vendimin nr. 8, datë 19.04.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

kontrate koncensionare, iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit nr. 98/2022, i cili përcaktonte detyrimin për pagesën e kontributit të solidaritetit nga të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike, rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë, që tregtojnë këtë produkt me çmime të liberalizuara, ku përfshihej edhe vetë kërkuesja. Për rrjedhojë, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë objektin e veprimtarisë së saj dhe faktin se ligji zbatohet edhe për kërkuesen, vlerësoi se kërkuesja justifikonte interesin në çështjen e parashtruar dhe legjitimohej *ratione personae*¹⁹³.

199. Në një rast tjetër, një banor i qytetit të Durrësit paraqiti ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e ligjit nr. 79/2022, që miratonte marrëveshjen për projektin strategjik “Marina dhe Jahtet e Durrësit”, me pretendimin se ai banonte në njësinë administrative ku do të zbatohet projekti. Sipas tij, projekti në fjalë cenonte parimet dhe të drejtat e lidhura me pronën publike dhe tjetërsimin e saj pa konkurrencë, sigurinë kombëtare dhe atë publike, si dhe binte në kundërshtim me MSA-në. Kolegji vlerësoi se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione personae*, me arsyetimin se pretendimet ishin me natyrë përgjithësuese dhe se mungonin argumentet mbi pasojat negative të ardhura ose të pritshme që vetë ankuesit i vinin nga zbatimi i ligjit të kundërshtuar. Në këtë mënyrë, sipas Kolegjit, individit nuk kishte justifikuar interesin e tij lidhur me cenimin e së drejtës së pronës publike, parimet e konkurrencës dhe tregut të lirë, sigurinë dhe ekonominë kombëtare, subsidiaritetin dhe respektimin e MSA-së¹⁹⁴.
200. Ndërsa përsa i përket kërkesës që *pasoja të jetë e drejtpërdrejtë*, ajo ka të bëjë me efektin e drejtpërdrejtë që ligji ose akti normativ ka në të drejtat themelore të individit. Bëhet fjalë për rastet kur ligji ose një dispozitë e caktuar e tij nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore, pra është drejtpërdrejt i zbatueshëm. Është e qartë se kur ligji parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore, atëherë individit duhet të ankohet ndaj këtyre të fundit sepse ato zbatohen drejtpërdrejt ndaj tij.
201. Për ta ilustruar, një individ u ankua në Gjykatën Kushtetuese dhe kërkoi shfuqizimin e disa ligjeve dhe VKM-ve, që lidheshin me ndërtimin e aeroportit të Vlorës, duke pretenduar se nëpërmjet këtyre akteve, institucionet shtetërore i kishin cenuar të drejtën e pronës të garantuar nga nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës. Kolegji, referuar përmbajtjes së nenit 49, pika 3, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe pretendimeve konkrete të kërkuesit, evidentoi, ndër të tjera, se ligji i kundërshtuar nuk ishte automatikisht i zbatueshëm ndaj individit, por linte diskrecion për organet e pushtetit publik, në mënyrë që këto të fundit të vepronin ndaj individit me anë të akteve nënligjore të mëtejshme. Me këtë arsye, Kolegji vlerësoi se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione personae* për kërkimet që lidheshin me shfuqizimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore, pasi nuk provohej se ato mund t'i kishin shkaktuar kërkuesit cenim të drejtpërdrejtë në të drejtën kushtetuese të pronës¹⁹⁵.
202. Në kuptim të kërkesës që *pasoja të jetë e drejtpërdrejtë*, kur një individ iu drejtua Gjykatës për shfuqizimin e disa dispozitave të një VKM-je, me pretendimin se i cenonin lirinë dhe jetën private, Kolegji i Gjykatës vërejti se dispozitat e kundërshtuara kishin përmbajtje deleguese për miratimin e rregulloreve të brendshme të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale, prandaj vlerësoi se ato nuk ishin drejtpërdrejt të zbatueshme ndaj kërkuesit. Kolegji theksoi se vetëm nëse dispozita e kundërshtuar do të ishte drejtpërdrejt e zbatueshme, pra zbatimi i saj do të bëhej pa ndërhyrjen e organeve të tjera të pushtetit publik, atëherë pasoja do të ishte individuale dhe kërkuesi do të justifikonte fillimin e gjyqimit kushtetues. Pra, vetëm në rast të një akti individual të dalë në zbatim të VKM-së, nga i cili t'i ketë ardhur një pasojë negative konkrete dhe për të cilin

193 Shih vendimin nr. 178, datë 18.07.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

194 Shih vendimin nr. 53, datë 13.03.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

195 Shih vendimin nr. 161, datë 12.07.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

duhet të shterohen mjetet efektive të ankimit, kërkuesi mund t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe neneve 49, pika 3, shkronja "e", e 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës. Prandaj Kolegji arriti në përfundimin se kërkuesi nuk justifikonte interesin e tij dhe ankimi kushtetues individual ishte i papranueshëm *ratione personae*.¹⁹⁶

203. Në një rast tjetër, individi kishte kundërshtuar në gjykatat administrative një akt nënligjor normativ, mbi bazën e të cilit ishte ndaluar të kandidonte në një pozicion shtetëror, por pa kundërshtuar brenda atij procesi edhe vendimin e ndalimit të kandidimit. Gjykata Administrative e Apelit kishte vendosur mospranimin e padisë së tij, me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohej në ngritjen e padisë, pasi ligji të drejtën e kundërshtimit të akteve administrative nuk ia njihte individit, i cili mund dhe duhet t'i mbrojë interesat e tij duke kundërshtuar akte administrative individuale. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, në zbatim të aktit normativ, kishte dalë edhe vendimi administrativ, me natyrë individuale, i cili sipas kërkuesit i kishte cenuar atij të drejtën për t'u kualifikuar dhe ndaj të cilit ai kishte ngritur padi në gjykatë. Gjykata e Lartë e kishte lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, me të njëjtin arsyetim. Sipas Gjykatës së Lartë, akti normativ i kundërshtuar i kishte sjellë efektet te kërkuesi me aktin administrativ individual, i cili nuk rezultonte të ishte kundërshtuar prej tij në padinë e paraqitur dhe as të ishte kërkuar gjatë gjykimit shtimi i objektit, për rrjedhojë nuk kishte qenë pjesë e shqyrtimit gjyqësor. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, pasi analizoi përmbajtjen e aktit normativ dhe të akteve administrative individuale për ndalimin e kandidimit të kërkuesit, vuri në dukje se akti i cili prodhonte efekte të drejtpërdrejta dhe individuale te kërkuesi ishte vendimi për kualifikimin ose ndalimin e tij dhe jo akti nënligjor, mbi bazën e të cilit ishte disponuar kjo vendimmarrje. Me këtë arsyetim, Kolegji vlerësoi se individi nuk legjitimohej *ratione personae* për kundërshtimin e procesit gjyqësor, në objekt të të cilit kishte qenë kontrolli i aktit normativ.¹⁹⁷
204. Mund të ndodhë, që individi të kundërshtojë në Gjykatën Kushtetuese jo vetëm vendimin gjyqësor, por njëkohësisht edhe ligjin e zbatueshëm në çështjen e tij. Në këto raste, Gjykata ka verifikuar nëse ligji i kundërshtuar është zbatuar drejtpërdrejt në çështjen gjyqësore të kërkuesit dhe nëse po, ajo ka vlerësuar nëse interesi për çështjen e parashtruar është justifikuar.¹⁹⁸
205. Në një rast, kërkuesja kundërshtoi në Gjykatë vendimin e Gjykatës së Lartë, në të cilin ajo ishte palë ndërgjyqëse, si dhe përmbajtjen e neneve 482, paragrafi 3, të KPC-së dhe 61, pika 2 të Ligjit të Gjykatave Administrative. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, ajo pretendoi se ishte rrjedhojë e një procesi, për të cilin ajo nuk ishte njoftuar rregullisht dhe se Gjykata e Lartë, përmes mënyrës së interpretimit të ligjit dhe gjësë së gjykuar, i kishte cenuar parimin e sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Për sa u takon dispozitave ligjore, kërkuesja pretendoi se ato nuk parashikonin njoftimin individual, ndaj zbatimi i tyre i kishte cenuar të drejtën për t'u njoftuar rregullisht, të drejtën për t'u dëgjuar e për t'u mbrojtur në atë gjykatë. Gjykata vërejti se në procesin gjyqësor të kërkueses gjenin zbatim drejtpërdrejt dispozitat ligjore të kundërshtuara, të cilat rregullonin procedurën e njoftimit të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, si dhe përbërjen e trupit gjykues. Në këtë drejtim, Gjykata konstatoi se ato dispozita ligjore nuk parashikonin nxjerrjen e akteve nënligjore dhe zbatoheshin drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë në shqyrtimin e rekursit, duke përmbushur në këtë mënyrë kushtin e efektit të drejtpërdrejtë, që parashikohet nga neni 49, pika 3, shkronja "e" i Ligjit Organik të Gjykatës. Dispozitat ligjore të kundërshtuara ishin përdorur nga Gjykata e Lartë për të kryer njoftimin e kërkueses për çështjen e saj, duke shpallur në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve në ambientet fizike listën e

196 Shih vendimin 111, datë 16.09.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

197 Shih vendimin nr. 23, datë 05.02.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

198 Shih vendimin nr. 5, datë 12.01.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

gjykimeve për seancat gjyqësore, si dhe përbërjen e trupit gjykues, ku përfshihej edhe çështja e kërkueses. Prandaj Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesja legjitimohej *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi kishte interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar¹⁹⁹.

2.2. Shterimi i mjeteve juridike efektive

206. Një kriter tjetër për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është shterimi i mjeteve juridike efektive në dispozicion, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja "a", të Ligjit Organik të Gjykatës, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet gjykatës; ii) ose kur legjislati brendshëm nuk parashikon mjete efektive në dispozicion.
207. Shterimi i mjeteve juridike kërkon që kërkuesi t'i shfrytëzojë të gjitha mundësitë procedurale të ofruara nga legjislati për mbrojtjen e të drejtës së tij, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Mjetet juridike konsiderohen të ezauruara kur, sipas rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera juridike në dispozicion.
208. GJEDNJ-ja ka pohuar se shterimi i mjeteve s'ka asgjë absolute dhe nuk mund të zbatohet automatikisht²⁰⁰. Prandaj, ajo shpesh ka theksuar se ky rregull duhet zbatuar me një lloj fleksibiliteti dhe pa formalizma të skajshëm, duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut²⁰¹.
209. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, në të njëjtën linjë me jurisprudencën e GJEDNJ-së, ka theksuar se rregulli për shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion të individit zbatohet nën dritën e rrethanave të veçanta që paraqet çështja konkrete. Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Për këtë arsye, mjetet juridike në dispozicion të kërkuesit nuk përfshijnë vetëm ankimin kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, por çdo ankim ose kundërshtim, të cilat i ofrojnë mundësi organeve publike dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të luajnë rolin e tyre subsidiar për t'i garantuar individit mbrojtjen e të drejtave kushtetuese para se ai t'i drejtohet Gjykatës. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime dhe ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese.²⁰²
210. Analiza e kriterit të shterimit të mjeteve juridike nxjerr në pah disa çështje juridike, që duhen mbajtur në konsideratë, kur përpilohet një ankim kushtetues individual. Këto çështje lidhen me (i) shterimin formal dhe substancial të pretendimeve; (ii) mungesën e mjeteve efektive në dispozicion; (iii) natyrën përfundimtare të aktit të pushtetit publik ose vendimit gjyqësor, që kundërshtohet; (iv)

199 Shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

200 Shih vendimin *Kozacioğlu kundër Turqisë*, nr. 2334/03, datë 19.02.2009, § 40.

201 Shih vendimin *Ringeisen kundër Austrisë*, nr. 2614/65, datë 16.07.1971, § 89.

202 Shih vendimin nr. 72, datë 29.06.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

mjetet e reja që duhen shteruar kur pretendohet cenimi i të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm; dhe (v) veçantitë e shterimit të mjeteve kur kundërshtohet ligji ose akti normativ.

2.2.1 Shterimi formal dhe substancial i pretendimeve

211. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, pra të ketë përdorur të gjitha mjetet e zakonshme të ankimit të parashikuara nga ligji. Në rastin e vendimeve gjyqësore, ato mund të bëhen objekt i shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese, kur individit ka përdorur edhe mjetin e fundit të ankimit gjyqësor, të lejuar nga ligji procedural. Në këtë kuptim, flitet për *shterim formal të mjeteve ankimore* në dispozicion të individit brenda juridiksionit të gjykatave të zakonshme.
212. Për ilustrim, në rastin e një dënimi penal të dhënë nga gjykata e shkallës së parë²⁰³, individit duhet të ketë paraqitur me radhë, apel dhe rekurs respektivisht në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë. I njëjti detyrim, është i vlefshëm edhe për çështjet civile²⁰⁴ ose ato administrative²⁰⁵. Nëse gjatë shqyrtimit paraprak, verifikohet se individit nuk ka paraqitur ankim në gjykatat më të larta, atëherë vendoset moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare për shkak se nuk është përbushur detyrimi për shterimin e mjeteve juridike²⁰⁶.
213. Kur ligji, bazuar në nenin 43 të Kushtetutës²⁰⁷, nuk lejon ankim në gjykatat më të larta, atëherë ankimi kushtetues paraqitet drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese dhe kriteri i shterimit të mjeteve juridike konsiderohet i përbushur. Për ilustrim shërben rasti i një individit, i cili paraqiti ankim kushtetues për shfuqizimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, me të cilin ishte rrëzuar ankimi i tij për caktimin e gjobës nga policia rrugore për shkelje të sinjalizimit rrugor. Kolegji i Gjykatës vlerësoi se kërkuesi e kishte plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion pasi vendimi gjyqësor i kundërshtuar, bazuar në ligjin për gjykatat administrative, ishte i paankimueshëm në gjykatat më të larta të juridiksionit të zakonshëm²⁰⁸.
214. Në këtë pikë duhet bërë kujdes për të dalluar situatën kur ligji nuk e lejon ankimin nga situata, kur gjykata e zakonshme në mënyrë të gabuar i ka hequr individit të drejtën e ankimit në gjykatën më të lartë, duke i vënë në dyshim atij të drejtën themelore të ankimit, të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës. Kështu, Gjykata ka marrë në shqyrtim rastet kur Gjykata Administrative e Apelit në dispozitiv ka shënuar se vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë dhe nuk është shprehur për të drejtën e ankimit të kërkuesit dhe ky i fundit nuk ka ushtruar rekurs ndaj tyre. Mbledhja e Gjyqtarëve evidentoi se e drejta e ankimit duhet kuptuar si mundësi e çdo individit për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar, në një gjykatë më të lartë, vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët, mundësi e cila i garanton individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi²⁰⁹. Po ashtu, ajo vuri në dukje se është ligji ai që përcakton rastet dhe mjetet e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore, pra që njeh, garanton ose kufizon të drejtën e palës për të kundërshtuar një vendim të gjykatës më

203 Shih vendimin nr. 21, datë 26.09.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

204 Shih vendimin nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

205 Shih vendimin nr. 31, datë 18.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

206 Shih vendimin nr. 50, datë 02.03.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

207 Sipas nenit 43 të Kushtetutës kushdo ka të drejtë të ankojë kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimi i të drejtave vendoset me ligj, për një interes publik dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar.

208 Shih vendimin nr. 45, datë 28.02.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

209 Shih vendimin nr. 62, datë 04.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

të ulët në një gjykatë më të lartë, duke mos e lënë këtë çështje në diskrecion të gjykatës. Me këtë arsyetim, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se kërkuesi duhej t'i drejtohej fillimisht Gjykatës së Lartë për të marrë përgjigje për pretendimet e tij, e cila, gjithashtu, ka në kompetencë të shprehet për çështjen e lejimit ose jo të së drejtës së ankimit ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit. Prandaj, ajo arriti në përfundimin se kërkuesi duhet të shteronte mjetet ligjore në dispozicion para se t'i drejtohej Gjykatës dhe nuk e pranoi për shqyrtim në themel ankimin kushtetues.²¹⁰

215. Vlen të evidentohet se shterimi formal i mjeteve të ankimit nuk mjafton sepse ky kriter ka edhe *anën substanciale* të tij, që do të thotë se individit pretendimet që ngre në Gjykatë duhet t'i ketë paraqitur më parë në instancat gjyqësore të juridiksionit të zakonshëm. Kjo kërkesë bazohet në lidhjen e ngushtë që shterimi i mjeteve ka me parimin e subsidiaritetit në kuptimin që individit, pretendimet për të drejtat dhe liritë kushtetuese, që paraqet në ankimin kushtetues, duhet t'i ketë ngritur në çdo shkallë të gjykimit të zakonshëm (sigurisht sipas shkallës së gjykimit ku ndodh cenimi)²¹¹.
216. Ky ishte qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese i shfaqur që në vendimet e para të saj, kur është marrë në shqyrtim çështja e legjitimitetit të kërkuesit²¹² dhe që u konsolidua dhe nuk u ndryshua në vijim në jurisprudencën e saj²¹³. Në këto vendime Gjykata u shpreh se çështja e shterimit të mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet përmbushur nga kërkuesi, pasi kontrolli i ushtruar nga kjo Gjykatë, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Rregulli i shterimit të mjeteve nënkupton jo vetëm që ankuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por edhe që të gjitha pretendimet (shkaqet) që ngre në këtë Gjykatë, t'i ketë paraqitur më parë në të gjitha instancat e zakonshme gjyqësore, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural.

2.2.2. Mungesa e mjeteve efektive në dispozicion

217. Shterimi i mjeteve juridike nuk mund të kthehet në pengesë për aksesin e individit në gjykimin kushtetues. Për këtë arsye, kuadri normativ (neni 131, pika 1, shkronja "f" i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a" i Ligjit Organik të Gjykatës) përcakton se bëhet fjalë për shterimin e atyre mjeteve, që jo vetëm janë në dispozicion të individit, por janë edhe efektive, përndryshe, ky i fundit shkarkohet nga detyrimi për plotësimin e këtij kriteri.
218. Në fakt, që nga çështja *Qufaj CO. Shpk kundër Shqipërisë* (vendim i datës 30.03.2005), Gjykata e Strasburgut ka theksuar se, megjithëse neni 35§1 i Konventës parashikon detyrimin për të shteruar mjetet e brendshme, kjo nuk nënkupton përdorimin e mjeteve jo të duhura dhe jo të përshtashme të ankimit. Sikurse u theksua më sipër, sipas GJEDNJ-së shterimi i mjeteve juridike duhej zbatuar me një lloj fleksibiliteti dhe pa formalizma të skajshëm, duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Edhe jurisprudenca kushtetuese shqiptare, duke iu përshtatur këtij qëndrimi, ka theksuar se është e rëndësishme të përcaktohet se cilat mjete, në varësi të rastit, janë në

210 Shih vendimin nr. 37, datë 04.03.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

211 Kërkuesi duhet të kundërshtojë në Gjykatën Kushtetuese vendimet e dhëna në shkallët e ndryshme të gjykimit, duke nisur nga ai ku ka ndodhur cenimi.

212 Shih vendimet nr. 29, datë 23.03.1999; nr. 30, datë 23.03.1999 të Gjykatës Kushtetuese.

213 Shih vendimet nr. 17, datë 18.07.2005; nr. 15, datë 18.04.2007; nr. 27, 20.06.2007; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 1, datë 19.01.2009; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 1, datë 25.01.2010; nr. 17, datë 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

dispozicion të individit dhe nëse i ofrojnë atij mundësi të vërteta për të zgjidhur mosmarrëveshjen në mënyrë të kënaqshme.

219. Në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se mjetet për të qenë efektive duhet të ofrojnë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe të jenë të përshtatshme dhe efektive në çështjen konkrete²¹⁴. Ekziston mundësia që individit t'i drejtohet direkt Gjykatës Kushtetuese (pra pa nevojën e shterimit të mjeteve juridike) jo vetëm kur legjislacioni i brendshëm nuk siguron mjete efektive, por edhe kur pasojat negative që mund të prodhohen do të bëhen të pariparueshme (d.m.th. duke penguar plotësisht rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar) në pritje të shterimit të mjeteve të lartpërmendura.²¹⁵
220. Sa i takon *mungesës së mjeteve në dispozicion të individit*, vlen të silltet në vëmendje qëndrimi i Gjykatës gjatë shqyrtimit të ankesave individuale kundër dekretit të Presidentit për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm. Ajo ka shqyrtuar dy ankesa të tilla, një në vitin 2002 dhe një në vitin 2008. Në të dyja rastet, Gjykata vuri në dukje se kërkuesi nuk mund të vinte në lëvizje ndonjë organ tjetër shtetëror për shqyrtimin e tyre veç Gjykatës Kushtetuese, sepse asnjë prej organeve të tjera shtetërore nuk kishte në kompetencë shqyrtimin e këtyre kërkesave. Sipas përmbajtjes që nenet 324 e 333 të KPC-së kishin në atë kohë, gjykatat e zakonshme nuk mund të shqyrtonin aktet me karakter administrativ, të cilat ishin rezultat i procedurave parlamentare. Dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, si një akt individual me karakter administrativ, nuk mund të trajtohej në të njëjtën mënyrë si aktet e tjera administrative, të cilat shqyrtoheshin nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Veçantia e këtij dekreti qëndronte në faktin, se ai ishte i lidhur pazgjidhshmërisht me procedurat parlamentare në bazë të të cilave kishte dalë vendimi i Kuvendit që ishte një premisë e domosdoshme për nxjerrjen e dekretit. Duke qenë se dekreti i kundërshtuar ishte rezultat i procedurave parlamentare në bazë të të cilave ishte kërkuar shkarkimi i Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ishte miratuar komisioni hetimor dhe ishte miratuar raporti i këtij komisioni me propozimin për shkarkim që i bëhej Presidentit të Republikës, Gjykata konsideroi se ish-in shteruar mjetet juridike në dispozicion të kërkuesit.²¹⁶ Duhet vënë re se kjo jurisprudencë i referohet kuadrit kushtetues të mëparshëm, që parashikonte një formulë të ndryshme të emërimit dhe të shkarkimit nga Presidenti i Republikës të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe kohës kur gjykatat administrative nuk ekzistonin, ndaj qëndrimi i Gjykatës ka vlerë vetëm në parim për standardin kur legjislacioni në fuqi nuk parashikon mjete ankimi ndaj një akti të pushtetit publik.
221. Në një rast tjetër, Mbledhja e Gjyqtarëve evidentoi se kur gjatë procedimit penal, organi procedues ushtron kontroll personal ose të vendeve, prej të cilit nuk gjenden sende për t'u sekuestruar me cilësinë e provave materiale, atëherë individit mund të paraqesë ankim drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, nëse nga kontrolli i cenohen të drejtat themelore. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Mbledhja e Gjyqtarëve u bazua në faktin se ligji procedural penal nuk parashikon ankim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ndaj një vendimi të tillë²¹⁷.
222. Ndërsa sa i përket *efektivitetit të mjeteve juridike*, Gjykata ka pohuar se shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase²¹⁸. Me fjalë të tjera, po sipas Gjykatës, ky kriter

214 Shih vendimet nr. 43, datë 12.07.2016; nr. 9, datë 15.03.2013 të Gjykatës Kushtetuese.

215 A. Vorpsi, J. Bergmann, *vep. cit.*, fq. 99 e vijues.

216 Shih vendimet nr. 76, datë 25.04.2002 dhe nr. 21, datë 01.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

217 Shih vendimin nr. 265, datë 12.12.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

218 Shih *ex plurimus* vendimet nr. 6, datë 31.03.2006; nr. 27, datë 20.06.2007; nr. 1, datë 19.01.2009, nr.52, datë 20.07.2015, nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

nënkupton ato mjete që janë efektive dhe të mjaftueshme për të realizuar ndreqjen e shkeljeve të lejuara.²¹⁹

223. Në karakterizimin e efektivitetit të mjeteve juridike, Gjykata duket se është mbështetur në parimin e efektivitetit të të drejtave të njeriut, të zhvilluar nga GJEDNJ-ja, sipas të cilit KEDNJ-ja është përgatitur të garantojë të drejtat që janë praktike dhe efikase, dhe jo teorike apo iluzionare.²²⁰ Në çështjen *Akdivar kundër Turqisë*, datë 16.09.1996, GJEDNJ-ja ka theksuar se kërkuesi duhet të shfrytëzojë ato mjete që janë efektive dhe të mjaftueshme për garantimin e shkeljes së pretenduar. Sipas saj, mjetet duhet të jenë efektive jo vetëm në abstrakt, por edhe në konkret. Nëse ka më shumë se një mjet juridik potencialisht efektiv, aplikantit i kërkohet të ketë përdorur vetëm njërin prej tyre²²¹. Në të vërtetë, kur është përdorur një mjet juridik nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër që ka në thelb të njëjtin qëllim²²² dhe i takon aplikantit të zgjedhë mjetin më të përshtatshëm në çështjen e tij²²³.
224. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka pohuar se nuk ka nevojë të përdoren mjete juridike diskrecionale ose të jashtëzakonshme, për shembull duke kërkuar nga gjykata rishikimin e vendimit të saj.²²⁴ Mjeti i ankimit duhet të jetë në gjendje të ofrojë korrigjim në lidhje me pretendimet e kërkuarit dhe të ofrojë perspektivë të arsyeshme suksesi²²⁵. Megjithatë, thjesht prania e dyshimeve në lidhje me mundësitë për suksesin e një mjeti specifik, i cili nuk është dukshëm i kotë, nuk është një arsye e vlefshme për mosshkrimin e asaj forme korrigjimi.²²⁶
225. Mënyra se si vlerësohet në praktikë efektiviteti i një mjeti juridik mund të ilustruhet me një rast, ku individit ishte shkarkuar nga funksioni publik me vendim të Kuvendit. Ai iu drejtua drejtpërdrejt Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke parashtruar se, ndonëse vendimi i Kuvendit ishte akt administrativ individual, ai nuk pengohej nga rregulli për shkrimin e mjeteve juridike. Sipas tij, legjislati nuk ofronte mjete të tjera efektive në dispozicion për shqyrtimin e pretendimeve të tij dhe, kontrolli kushtetues dhe kontrolli gjyqësor i zakonshëm janë mjete plotësuese, që nuk përjashtojnë njëra-tjetrën.
226. Kolegji i Gjykatës vuri në dukje se kushti për shkrimin e mjeteve juridike nënkupton jo vetëm ekzistencën e një mjeti juridik në dispozicion të kërkuarit, por edhe efektivitetin e këtij mjeti në drejtim të përshtatshmërisë së tij për mbrojtjen thelbësore të së drejtës kushtetuese, që kërkuesi pretendon se i është cenuar. Megjithëse natyra e mjetit juridik mund të jetë e ndryshme në varësi të natyrës së ankimit të kërkuarit, efektiviteti i tij vlerësohet jo vetëm nga parashikimi ligjor, por edhe nga rezultati i zbatimit të ligjit. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vërejtë se legjislati në fuqi i njihte kërkuarit të drejtën e padisë në gjykatat administrative. Edhe jurisprudenca kushtetuese,

219 Shih vendimin nr. 5, datë 26.01.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

220 Shih vendimin *Airey kundër Irlandës*, nr. 6289/73, datë 09.10.1979, § 24. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur GJEDNJ-ja në vendimet *N.D. dhe N.T. kundër Spanjës* [DHM], nr. 8675/15 dhe 8697/15, datë 13 shkurt 2020, §171, dhe *Ilgar Mammadov kundër Azerbajxhanit* (procedime për shkeljen) [DHM], nr. 15172/13, 29 maj 2019, §215.

221 Shih vendimin *Karakó kundër Hungarisë*, nr. 39311/05, datë 28.04.2009, § 14.

222 Shih vendimin *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* [DHM], nr. 41720/13, datë 25.06.2019, § 177.

223 Shih vendimet *Fabris dhe Parziale kundër Italisë*, nr. 41603/13, datë 19.03.2020, ku aplikanti nuk ishte në gjendje të ngrinte një padi civile për shkak të ndërprerjes së procedimit penal pas shtatë vitesh që ai ishte bashkuar si palë civile, §§ 49-59; *O'Keefe kundër Irlandës* [DHM], nr. 35810/09, datë 28.01.2014, §§ 110-111; *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* [DHM], nr. 41720/13, datë 25.06.2019, § 176, në lidhje me zgjedhjen e bërë nga një kërkuar për t'u bashkuar në procedurën penale si palë civile dhe për të mos ushtruar një padi të veçantë civile.

224 Shih vendimet *Çınar kundër Turqisë* (vendim), nr. 48155/99, datë 15.01.2004 dhe *Prystavka kundër Ukrainës* (vendim pranueshmërie), nr. 21287/02, datë 17.12.2002.

225 Shih vendimet *Karácsony dhe të tjerë kundër Hungarisë* [DHM], nr. 42461/13 dhe 44357/13, datë 17.05.2016, §§ 75-82; *Selahattin Demirtaş kundër Turqisë* (nr. 2) [DHM], nr. 14305/17, datë 22.12.2020, § 205.

226 Shih vendimet *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* [DHM], § 69-77, 25.03.2014 dhe *Bakiu dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, § 80, nr. 43928/14, datë 10.04.2018.

pas fillimit të funksionimit të gjykatave administrative, e kishte cilësuar vendimin e Kuvendit në këto lloj rastesh si akt administrativ me natyrë individuale, për të cilin kërkuesi duhet të shterojë paraprakisht rrugën e kontrollit gjyqësor të zakonshëm. Po ashtu, Kolegji evidentoi se vendimi i Kuvendit në raste të ngjashme i ishte nënshtruar kontrollit gjyqësor të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe se të interesuarit kishin pasur sukses në përdorimin e këtyre mjeteve. Për rrjedhojë, Kolegji arriti në përfundimin se kërkuesi kishte në dispozicion mjete të tjera juridike, të cilat nga pikëpamja e efektivitetit ishin në gjendje të riparuarin gjendjen e cenuar dhe të ofronin premisa suksesi. Mjetet juridike në dispozicion të kërkuesit, që ofrohen nga legjislacioni në fuqi, nuk janë plotësuese të ankimit individual kushtetues në rastin e kundërshtimit të akteve administrative individuale, por janë kriter paraprak që duhet plotësuar për marrjen në shqyrtim të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese.²²⁷

227. Së fundmi për këtë çështje, duhet vënë në dukje se praktika e Gjykatës i është nënshtruar edhe kritikave të studiuesve, në veçanti për rastet që lidhen me të drejtat e fëmijëve dhe detyrimet pozitive të Republikës së Shqipërisë nga e drejta ndërkombëtare. Një studiuese ka evidentuar se në praktikë janë vënë re luhatje dhe pasaktësi në dallimin midis mjeteve juridike që duhet të shterohen nga individi dhe masave pozitive që duhet të merren nga shteti, të cilat shpjegohen edhe nga përvoja e pakët dhe juridiksioni i kufizuar i Gjykatës para vitit 2016. Ajo ka theksuar se shterimi i mjeteve juridike nuk duhet zbatuar sikur përfshin detyrën e kërkuesit për të parashtruar masat pozitive që duhet të ndërmerren nga shteti në kuadrin e zbatimit të detyrimeve të tij pozitive. Detyra e individit për shterimin e mjeteve shtrihet ndaj mjeteve ligjore të parashikuara nga legjislacioni, të cilat vihen në lëvizje me kërkesë. Madje, në lidhje me këto të fundit, nuk është e nevojshme të bëhen kërkesa të përsëritura²²⁸.

2.2.3. Natyra përfundimtare e aktit që kundërshtohet

228. Siç u theksua, shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, e cila mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor²²⁹. Për këtë arsye, gjatë verifikimit të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, analizohet nëse legjislacioni në fuqi parashikon mundësinë e ankimit në gjykatë ndaj aktit të pushtetit publik dhe nëse po, atëherë kontrollohet nëse vendimi gjyqësor i kundërshtuar ka natyrë përfundimtare.
229. Në koncept, vendimi përfundimtar është akti i gjykimit të themelit të çështjes, qoftë ajo penale, civile apo administrative, i cili përmbyll procesin gjyqësor të vënë në lëvizje për mbrojtjen e një të drejte ose interesi kushtetues apo të ligjshëm. Një vendim i tillë bëhet përfundimtar kur ndaj tij nuk mund të ushtrohen mjetet e zakonshme të ankimit dhe tipari kryesor i tij është fuqia detyruese dhe ekzekutueshmëria.
230. Duke iu referuar këtij përkufizimi, nuk ka dyshim për natyrën përfundimtare të vendimeve penale që zgjidhin çështjen e fajësisë së individit dhe eventualisht dënimin penal të tij; vendimeve civile që zgjidhin themelin e mosmarrëveshjeve për të drejtat private të njohura nga ligji apo për vendimet gjyqësore administrative që vendosin për ligjshmërinë e një veprimi administrativ apo të një marrëdhënie punësimi. Mund të ndodhë, që individi pas procesit gjyqësor të themelit, të kërkojë

227 Shih vendimin nr. 76, datë 03.07.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

228 Shih A. Anastasi *Shterimi i mjeteve juridike në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e pasojave të divorcit*, Jeta Juridike, nr. 3, viti 2019, faqe 6, 12,13

229 Shih vendimet nr. 8, datë 03.03.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

nga gjykata e zakonshme saktësimin ose interpretimin e vendimit gjyqësor dhe kjo kërkesë e tij të mos ketë sukses deri në Gjykatën e Lartë, ndaj ai paraqet ankim kushtetues individual. Në një rast të tillë, Gjykata Kushtetuese, teksa ka konstatuar se kërkuesi kishte paraqitur pretendime me natyrë kushtetuese, është shprehur se, për nga natyra dhe qëllimi, ky lloj vendimi i bashkohet si pjesë përbërëse vendimit përfundimtar që ka disponuar për themelin e çështjes dhe për rrjedhojë, në kushtet kur procesi gjyqësor ka përfunduar dhe kërkuesi ka shteruar mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, Gjykata ka vlerësuar se ankimi kushtetues e plotësonte këtë kriter²³⁰.

231. Përtej rasteve që dukshëm bien në konceptin e vendimit gjyqësor përfundimtar, praktika e Gjykatës është e pasur me raste, në të cilat është analizuar çështja nëse vendimi gjyqësor i kundërshtuar ka natyrë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues. Jurisprudenca është zhvilluar gradualisht në këtë drejtim, duke mbajtur në konsideratë juridiksionin kushtetues, i cili në fillim kufizohej tek e drejta për proces të rregullt dhe vetëm në vitin 2016 u zgjerua, duke përfshirë të drejtat materiale. Në këtë kontekst, vetëm së fundmi jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar testin që zbatohet për të identifikuar nëse vendimi gjyqësor është përfundimtar në kuptimin kushtetues.
232. Zhvillimi i parë jurisprudencial lidhej me *vendimin gjyqësor për fazën e parë të pjesëtimit të pasurisë*. Në vitin 2008, Gjykata vlerësoi se kërkuesit kishin shteruar mjetet juridike, për vendimet e dhëna mbi bazën e padisë për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, pasi për shkak të veçorisë së çështjes kërkuesit nuk kishin mjete të tjera në dispozicion. Ajo u shpreh se gjykimi për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore, apo sendeve në bashkëpronësi, është një nga llojet e gjykimeve të posaçme që parashikohen nga KPC-ja. Megjithëse gjykimi për pjesëtimin e pasurisë trashëgimore vihet në lëvizje nga një padi, e cila në thelb kërkon t'i japë fund regjimit të bashkëpronësisë, KPC-ja parashikon se ky proces gjykimi realizohet në dy faza. Faza e parë e gjykimit ka për objekt shqyrtimi përcaktimin e rrethit të bashkëpronarëve, sendet që do të pjesëtohen dhe pjesët takuese të bashkëpronarëve mbi sendet objekt pjesëtimi, ndërsa me vendimin e fazës së dytë bëhet ndarja në natyrë e sendeve objekt pjesëtimi. Gjykata, bazuar në dispozitat procedurale që rregullojnë gjykimin e pjesëtimit gjyqësor konstatoi, se çështjet që zgjidhen në fazën e parë të këtij gjykimi nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi gjyqësor në fazën e dytë, fazë e cila fillon kur vendimi i fazës së parë ka marrë formë të prerë. Me këtë arsye, Gjykata arriti në konkluzionin, se vendimi i fazës së parë të pjesëtimit është përfundimtar dhe si rrjedhojë, kërkuesit i kishin shteruar mjetet juridike.²³¹
233. Më vonë, në vitin 2011, Gjykata analizoi kriterin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion për vendimin e caktimit të masës së sigurimit "arrest në burg", i cili për nga natyra e tij, jepet gjatë një procesi penal, është i ndryshueshëm në varësi të rrethanave të reja dhe nuk përcakton themelin e fajësisë së individit. Një i pandehur, i akuzuar për veprën penale të kontrabandës me mallra që paguhet akcizë, u ankua në Gjykatën Kushtetuese për vendimin gjyqësor, me të cilin ishte rrëzuar kërkesa e tij për zëvendësimin e masës së sigurimit "arrest në burg" me një masë më të lehtë, pasi ishte ankuar pa sukses deri në Gjykatën e Lartë. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se, duke qenë se mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në Gjykatë vetëm pasi

230 Shih vendimin nr. 12, datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

231 Shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve. Duke qenë se kërkuesi i ka shteruar mjetet e ankimit për “masën e arrestit në burg” dhe ankohet ndaj një vendimi të Gjykatës së Lartë, karakteri i këtij vendimi të ndërmjetëm, duke qenë se ndikon në lirinë personale të tij, e kërkon, si përjashtim, që ai të konsiderohet përfundimtar për qëllimet e nenit 131 pika 1 shkronja “f” të Kushtetutës.²³²

234. Gjykata ka pranuar gjithashtu se edhe vendimet gjyqësore për caktimin e masës të sigurimit personal me karakter shtrëngues “arrest në shtëpi” që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bëjnë atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.²³³
235. Duke pasur si pikënisje këtë qëndrim, Gjykata ka pohuar se edhe vendimet gjyqësore për vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë, pavarësisht heqjes së lirisë për një kohë të shkurtër, iu nënshtrohen të njëjtave standarde dhe kritere kushtetuese si në rastin e masës së sigurimit të arrestit, duke i konsideruar ato përfundimtare për efekt të kontrollit kushtetues²³⁴, sikundër nuk ka pranuar të marrë në shqyrtim vendimet gjyqësore, që caktojnë masa sigurimi personale, të cilat nuk privojnë lirinë, siç është masa e sigurimit e detyrimit për paraqitje në policinë gjyqësore²³⁵.
236. Rezultojnë evidente në këto raste ndikimi i GJEDNJ-së²³⁶, që, edhe pse normalisht nuk i ka konsideruar si përfundimtare, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, procedurat paraprake apo vendimet gjatë gjykimit, në raste përjashtimore, ka çmuar të zbatojë nenin 6 të Konventës edhe në lidhje me këto të fundit nëse ato mund të konsiderohen përfundimtare për interesat e kërkuesit.
237. Në vitin 2021, Gjykata duke vënë theksin tek natyra përfundimtare e gjykimit kushtetues, përcaktoi testin që duhet të zbatohet kur duhet identifikuar nëse një vendim i ndërmjetëm përjashtimisht i nënshtrohet kontrollit kushtetues individual. Ky test ka të bëjë me plotësimin e njëkohshëm të tre kritereve: (i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; (ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) dhe vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë.²³⁷ Pikërisht këtyre kritereve i është referuar më tej Gjykata në jurisprudencën e saj kur i është dashur të përcaktojë nëse një vendim i ndërmjetëm mund të konsiderohet përfundimtar për efektet e gjykimit kushtetues.²³⁸
238. Edhe për vendimet e ndërmjetme për sekuestrimin e pasurisë jurisprudenca kushtetuese ka njohur të njëjtin zhvillim gradual. Kështu, në vitin 2015, Gjykata mori në shqyrtim ankimin e një individ, për shfuqizimin e vendimit gjyqësor që kishte caktuar masën e sekuestrimit konservativ ndaj një pasurie të paluajtshme, në kuadër të procedimit penal ende të papërfunduar. Ajo vlerësoi se ky lloj vendimi gjyqësor nuk është përfundimtar, pasi masa e sekuestrimit konservativ është një masë sigurimi pasuror, që caktohet me vendim të ndërmjetëm të gjykatës dhe efektet e saj pushojnë

232 Shih vendimin nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

233 Shih vendimin nr. 17, datë 13.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

234 Shih vendimin nr. 72, datë 08.04.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

235 Shih vendimin nr. 84, datë 18.04.2024 të Kolegjit të Gjykatës.

236 Shih vendimet *Wiot kundër Francës*, nr. 43722/98, datë 15.03.2003; *APIS a.s. kundër Sllovakisë*, nr. 39754/98, datë 13.01.2002; *Libert kundër Belgjikës*, nr. 44734/98, datë 08.07.2004.

237 Shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

238 Shih vendimin nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese; vendimet nr. 56 dhe nr. 57, datë 31.03.2021; nr. 86, datë 22.06.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes penale ka marrë formë të prerë. Sekuestroja konservative, si masë sigurimi pasuror, është në funksion të procesit penal që zhvillohet ndaj të pandehurit dhe vendosja e saj mund të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar të këtij procesi. Sipas Gjykatës, në vështrim të mjeteve të lejueshme dhe mundësive procedurale që parashikon legjislacioni në fuqi, kërkuesi ka ende mjete për vendosjen në vend të kësaj të drejte, pasi përveç ankimit bashkë me vendimin përfundimtar, sipas nenit 407 të KPP-së, mund t'u drejtohet gjykatave të juridiksionit të zakonshëm referuar dispozitave të KC-së.²³⁹

239. Në vitin 2022, Gjykata mori në shqyrtim një ankim tjetër, objekti i të cilit lidhej me shfuqizimin e masës së sekuestrimit të pasurisë bazuar në Ligjin Antimafia. Në këtë rast, Gjykata zbatoi testin me tre kritere të vendimit përfundimtar dhe vërejtje se masa e sekuestrimit ishte bërë objekt shqyrtimi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, të cilat e kishin lënë në fuqi. Për shkak të kësaj mase, kërkuesve u ishte kufizuar e drejta kushtetuese e pronës, pasi ata nuk mund ta dispononin lirisht atë. Megjithatë, vendimi i sekuestrimit ishte i përkohshëm, nuk cenonte thelbin e së drejtës së pronës dhe nuk kishte natyrë përfundimtare, pasi në çdo kohë kërkuesit mund t'i drejtoheshin gjykatës së juridiksionit të zakonshëm për revokimin e masës sipas neneve 12/b dhe 13 të ligjit nr. 10192/2009. Për më tepër, vendimmarrja për sekuestrimin nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i konfiskimit të pasurisë, vendimi i të cilit ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur efektet që sekuestrimi ka sjellë.²⁴⁰ Me këtë arsytim, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuesit kishin ende mjete në dispozicion që parimet dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara gjatë fazës së sekuestrimit t'i shërojnë nëpërmjet procedurës së konfiskimit dhe se vendimi i kundërshtuar për sekuestrimin e pasurisë nuk konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës.
240. Çështja e natyrës së masës së sekuestrimit pësoi zhvillime të mëtejshme jurisprudenciale. Në vitin 2024, Gjykata rishikoi qasjen e saj duke marrë parasysh dy arsye, të cilat i deklaroi shprehimisht në vendimin e saj: (i) arsyeja e parë lidhej me zgjerimin e juridiksionit kushtetues edhe për të drejtat substanciale të individit, pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016; dhe (ii) arsyeja e dytë lidhej me detyrimin kushtetues, të sanksionuar në nenin 17 të Kushtetutës, për të garantuar standardet minimale të mbrojtjes së të drejtave substanciale të ofruar nga KEDNJ-ja dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së. Duke iu referuar qasjes së GJEDNJ-së²⁴¹, e cila kishte pranuar për shqyrtim ankime të tilla, Gjykata arriti në përfundimin se përjashtimi i vendimeve të caktimit të masës së sekuestrimit nga kontrolli kushtetues do të sillte mohim të mbrojtjes së të drejtave substanciale të individit, ndërkohë që ankimi kushtetues individual synon të shërbejë si një mjet efektiv brenda sistemit të brendshëm, me qëllim garantimin dhe mbrojtjen sa më të përshtatshme të të drejtave dhe lirive themelore të individit²⁴². Ajo e rikonfirmoi këtë qëndrim edhe në një rast të dytë, kur u vu në lëvizje nga një individ që kërkonte shfuqizimin e vendimit të prokurorisë që i kishte sekuestruar një shtëpi pushimi.²⁴³
241. Gjykata ka analizuar edhe *vendimet që vendosin gjobë për avokatin* gjatë gjykimit të zakonshëm. Në një rast kërkuesi kundërshtoi përmes ankimit kushtetues individual vendimin e ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë për atë pjesë që kishte vendosur dënimin e tij me gjobë, si edhe

239 Shih vendimin nr. 48, datë 06.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

240 Shih vendimin nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

241 Shih vendimet *Çapăţină kundër Rumanisë*, nr. 911/16, datë 28.02.2023, § 32; *Łysak kundër Polonisë*, nr. 1631/16, datë 07.10.2021, § 65; *Džinić kundër Kroacisë*, nr. 38359/13, datë 17.05.2016, § 48; *Benet Praha, Spol. S R.O. kundër Republikës së Çekisë*, nr. 33908/04, 7937/05, 25249/05, 29402/05, 33571/06, datë 24.02.2011, §§ 77, 81.

242 Shih vendimin nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

243 Shih vendimin 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë që nuk kishin pranuar ankimin ndaj vendimit të gjobës. Ai nuk ishte palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në të cilin është dhënë vendimi i ndërmjetëm dhe nuk ishte më as përfaqësues ligjor i kallëzuesit, sepse me vendim të ndërmjetëm gjykata e shkallës së parë kishte pranuar kërkesën e prokurorit për përjashtimin e tij. Gjykata arsyetoi se vendimi i kundërshtuar kishte sjellë pasoja të drejtpërdrejta ndaj kërkuarit, ishte kundërshtuar në shkallët më të larta dhe kishte një masë autonomie nga procesi i themelit, pasi kërkuari, nuk kishte asnjë mundësi që të ankimonte vendimin përfundimtar dhe bashkë me të edhe vendimin e gjobës, pra se nuk kishte ndonjë garanci që procesi i themelit të mund të riparonte pasojat e vendimit të ndërmjetëm. Prandaj sipas Gjykatës përjashtimi i tij nga kontrolli kushtetues do të sillte mohim të së drejtës për ankim kushtetues substancial, e për rrjedhojë e konsidero vendimin në fjalë përfundimtar për efektet e nenit 131, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës.²⁴⁴

242. Praktika e Gjykatës përfshin një gamë të larmishme rastesh kur vendimet e ndërmjetme nuk janë konsideruar përfundimtare. Ato përfshijnë: vendimin gjyqësor që urdhëron kthimin e çështjes për rigjykim; vendimin për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit të zbatueshëm; vendimi mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit, vendimi për refuzimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, vendimet mbi kompetencat; vendimet mbi kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, vendimet për masat e sigurimit të padisë. Duhet vënë re se kjo listë nuk është shteruese, pasi vlerësimi i natyrës përfundimtare të vendimit nuk varet tipikisht nga lloji i disponimit, por nga mënyra se si ai ndërhyr në të drejtat themelore (*shih supra paragrafin 237*).
243. Për vendimin gjyqësor që urdhëron rigjykimin e çështjes, Gjykata ka vlerësuar se mjetet juridike nuk janë shteruar, duke vënë në dukje se procesi vazhdon dhe individit ka ende mjete të tjera ankimi për të rivendosur të drejtën gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatat e sistemit gjyqësor.²⁴⁵ Po ashtu, Gjykata ka pohuar se cenimi i së drejtave kushtetuese, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeli dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të tyre. Ky përbën një qëndrim të konsoliduar të Gjykatës në këtë drejtim, si përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, ashtu edhe pas tyre.²⁴⁶
244. Situata e kthimit të çështjes për rigjykim në një gjykatë më të ulët ka përjashtimet e saj. Këto përjashtime lidhen ngushtësisht me natyrën kushtetuese të pretendimeve, në veçanti me parimin e sigurisë juridike.
245. Kështu, kur gjykata më e lartë vihet në lëvizje mbi bazën e një ankimi të paraqitur jashtë afatit ligjor dhe urdhëron rigjykimin e çështjes, individit në disfavor të të cilit është dhënë ky vendim, mund t'i drejtohet Gjykatës me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në kuptimin që atij i është vënë në dyshim një e drejtë e fituar me vendim gjyqësor përfundimtar. Në një rast të tillë, Gjykata e ka pranuar për shqyrtim ankimin e individit, duke vlerësuar se, edhe pse gjykimi i çështjes ishte ende në gjykatën e apelit dhe për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Lartë që kishte urdhëruar rigjykimin dukej jopërfundimtar, natyra e pretendimit të ngritur, përkatësisht shkelja e parimit *res judicata*, justifikonte shqyrtimin e çështjes në nivel kushtetues. Për sa kohë që një shkelje e tillë

244 Shih vendimin nr. 22, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

245 Shih vendimet nr. 2 datë 10.01.2024; nr. 222 datë 31.10.2023; nr. 33 datë 29.03.2022; nr. 132, datë 27.06.2014 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

246 Shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 39, datë 06.07.2016; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet nr. 59 datë 23.03.2023; nr. 102, datë 19.07.2022; nr. 96 datë 15.07.2022; nr. 81 datë 06.07.2022; nr. 33, datë 29.03.2022; nr. 34, datë 26.02.2021; 227, dt. 12.10.2017; nr. 123, datë 22.09.2015; nr. 110, datë 29.05.2014; nr. 145, datë 10.12.2013 të Kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese.

dhe pasojat e saj nuk mund të riparoheshin më gjatë rigjyqimit të çështjes, pra në procesin gjyqësor që ishte duke u zhvilluar në juridiksionin e zakonshëm, Gjykata vlerësoi se kërkuesi nuk kishte mjete të tjera ligjore efektive në dispozicion për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, ndaj shqyrtoi themelin e pretendimeve të tij ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë.²⁴⁷

246. Me arsyetim të ngjashëm, Gjykata ka pranuar edhe ankimet ndaj vendimeve të Gjykatës së Lartë që kanë pranuar rishikimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar dhe kanë urdhëruar rigjykimin e çështjes. Në këto lloj rastesh, Gjykata ka vlerësuar se kriteri i shterimit të mjeteve juridike konsiderohej i plotësuar, duke arsyetuar se, edhe pse çështja kthehet për rigjykim dhe procesi gjyqësor vazhdon, në aspektin e shterimit të mjeteve ka rëndësi fakti, se kërkuesi, nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara në instancën e fundit të gjyqimit dhe se shqyrtimi gjyqësor rishtazi, nuk pretendon të ndreqë këto shkaqe, por të gjykojë çështjen në themel. Në rrethana të tilla, është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, të vlerësojë sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shteruar ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara²⁴⁸. Ajo shtoi se në kushtet kur rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm, vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, ndaj kërkuetit nuk kanë mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën për rishikim²⁴⁹.
247. Duke iu kthyer rasteve të vendimeve jopërfundimtare, Gjykata ka vlerësuar se as *vendimi i pranimit ose jo të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit* nuk është përfundimtar, për efekt të gjyqimit kushtetues. Në këto lloj rastesh, individit i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë gjyqimit të çështjes në themel, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese sa u përket pretendimeve lidhur me paanësinë e gjykatës²⁵⁰.
248. Vendimi i gjykatës së zakonshme për *pezullimin e gjyqimit të çështjes dhe inicimin e kontrollit incidental* nuk është konsideruar përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, jo vetëm për shkak të natyrës së ndërmjetme të tij, por edhe sepse ai nuk vendos në mënyrë përfundimtare për të drejtat e kërkuetit, të cilat ai synon të mbrojë përmes inicimit të gjyqimit në gjykatat e zakonshme. Një vendim i tillë, edhe pse i marrë gjatë procesit të themelut, nuk sjell pasojat e drejtpërdrejta në të drejtat e kërkuetit, por ai është mjeti procedural i aksesit në gjykimin kushtetues, përmes të cilit synohet të verifikohet pajtueshmëria me Kushtetutën e normës ligjore të zbatueshme nga gjykata në zgjidhjen e çështjes konkrete. Ndërsa vënia në lëvizje e gjyqimit kushtetues, në kuptim të neneve 134, pika 1, shkronja "dh" dhe 145, pika 2, të Kushtetutës, është një detyrim kushtetues për gjyqtarët e zakonshëm nëse vlerësojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, është vetëm Gjykata ajo që vendos në mënyrë përfundimtare në lidhje me kushtetutshmërinë e normës ligjore, pra është vetëm ky vendim që mund të sjellë pasojat e drejta të zgjidhjes së çështjes konkrete ku kërkuesi është palë.²⁵¹
249. Po ashtu, nuk është vlerësuar si vendim përfundimtar as *vendimi për mospranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të rekursit*. Gjykata është shprehur se mosushtrimi i rekursit brenda afatit procedural të përcaktuar nga ligji ose kur rekursi nuk rivendoset në afat, për nga pasojat juridike është i njëjtë me rastin kur rekursi nuk është ushtruar, ose kur pretendimi nuk është parashtruar më parë në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara

247 Shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

248 Shih vendimet nr. 17, datë 18.07.2005; nr. 5, datë 26.01.2007; nr. 6, datë 16.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

249 Shih po aty dhe vendimet nr. 5, datë 01.03.2018; nr.18, datë 23.04.2013; nr. 18, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

250 Shih vendimet nr. 90 dhe 91, datë 19.10.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

251 Shih vendimin nr. 254, datë 07.12.2023 e Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

në ligjin procedural²⁵². Me këtë arsytim, Gjykata nuk i ka konsideruar si të shteruara mjetet juridike në dispozicion të kërkuarit.

250. *Vendimet për shpalljen e moskompetencës lëndore janë konsideruar gjithashtu vendime jopërfundimtare. Gjykata, në një rast të tillë, arriti në përfundimin se pretendimet e palëve në lidhje me kompetencën e gjykatës nuk i mënjanohen kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi një pretendim i tillë mund të paraqitet lirisht jo vetëm para gjykatës që shqyrton çështjen, por mund të parashtrahet më tej në gjykatat më të larta si shkak për apel apo për rekurs. Për rrjedhojë, Gjykata çmoi se kërkuari nuk kishte shteruar mjetet ligjore për t'ju drejtuar asaj në kuptim të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës²⁵³.*
251. *Gjykata nuk ka vënë në dyshim karakterin e ndërmjetëm si të vendimit për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë, ashtu edhe të vendimit për mospranimin e kërkesës për revokimin e vendimit të pezullimit, i cili, sipas pikës 6 të nenit 479 të KPC-së, parashikohet si një mjet i ri ankimi që u jep mundësi palëve ndërgjyqëse të kërkojnë rivendosjen e së drejtës së shkelur. Ajo, gjithashtu, ka ritheksuar qëndrimin e mbajtur prej saj se, në parim, vendime të kësaj natyre, për marrjen e masës provizore të pezullimit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, nuk mund të konsiderohen si përfundimtare për efekt të gjyqimit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Në të tilla raste kërkuarit i kanë të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tyre gjatë shqyrtimit të çështjes në themel, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese.²⁵⁴*
252. *Gjykatës i janë paraqitur edhe ankime, që kishin në objektin e tyre vendime të ndërmjetme gjatë proceseve gjyqësore, për të cilat individët pretendonin se u cenonin të drejta dhe liri themelore. Vendime të tilla lidheshin me masat për sigurimin e padisë në procesin civil.*
253. *Duhet evidentuar se për këto lloj masash, GJEDNJ-ja është shprehur se neni 6, pika 1, i KEDNJ-së vihet në zbatim kur ekziston një mosmarrëveshje për një "të drejtë civile", e cila njihet nga ligji i brendshëm, pavarësisht nëse mbrohet edhe nga Konventa. Procedurat paraprake, siç janë ato që kanë të bëjnë me dhënien e një mase të përkohshme, ku përfshihet edhe masa e sigurimit të padisë, si rregull nuk përcaktojnë të drejta dhe detyrime civile, prandaj ato nuk përfshihen në mbrojtjen e nenit 6. Por shpesh, procedimet paraprake dhe ato të themelit vendosin të njëjtat "të drejta ose detyrime civile" dhe kanë të njëjtat efekte që zgjasin në kohë ose janë të përhershme. Prandaj, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se procedurat e masave të sigurimit të padisë nuk karakterizohen automatikisht si jopërcaktuese të të drejtave ose detyrimeve civile. Po ashtu, ajo është shprehur se nuk krijohet bindja se një defekt në një procedurë të tillë do të riparohej domosdoshmërisht në një fazë të mëvonshme, pra në procedurat e themelit, për të cilat zbatohet neni 6, pasi çdo dëm i pësuar mund të jetë bërë ndërkohë i pakthyeshëm dhe me pak mundësi reale për ta riparuar atë, përveçse, ndoshta, mundësisë së kompensimit në para.²⁵⁵*
254. *Në lidhje me këto vendime, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se ato nuk janë përfundimtare për efektet e nenit 131 të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se vendimet gjyqësore për marrjen e masës së sigurimit të padisë edhe kur e pranojnë kërkesën, nuk janë përfundimtare në lidhje me të drejta themelore. Ato janë masa të përkohshme të marra gjatë procedurës së themelit të çështjes dhe nuk konsiderohen si një procedurë e veçantë, e ndarë nga ajo kryesore²⁵⁶. Për më tepër, palët*

252 Shih vendimin nr. 36, datë 10.11.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

253 Shih vendimin nr. 53, datë 22.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

254 Shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

255 Shih vendimin *Micallef kundër Maltës*, nr. 17056/06, datë 15.10.2009, §§ 78 – 80.

256 Shih vendimin nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

ndërgjyqëse, sipas rregullave procedurale, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjen ndërmjet tyre, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, gjersa vendimi bëhet përfundimtar, me kërkesa të reja për sigurimin e padisë, nëse ajo është refuzuar nga gjykata, por edhe me kërkesa për ndryshimin ose zëvendësimin e masës, kur gjykata e ka pranuar një të tillë²⁵⁷.

2.2.4. Shterimi i mjeteve për gjykimin brenda afatit të arsyeshëm

255. Një çështje që meriton trajtim specifik në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike lidhet me ankimin kushtetues individual që ka për objekt konstatimin e cenimit të së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së.
256. Përpara ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, në kërkesat për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, të cilat Gjykata i bëri pjesë të juridiksionit të saj (*shih supra paragrafët 82-85*), kriteri për shterimin e mjeteve nuk është vënë ndonjëherë në diskutim.²⁵⁸
257. Në datën 30.03.2017 ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 38/2017 "Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile", i cili ka përfshirë dispozita të reja në KPC, ku është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*).
258. Ndryshimet ligjore hynë në fuqi në datën 05.11.2017 dhe pas këtij momenti, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni vendas parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore.²⁵⁹
259. Lidhur me kërkesat për konstatimin e të drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, vlen të risillet edhe njëherë në vëmendje kërkesa për efektivitetin e mjeteve juridike në dispozicion të individit. Sa i takon mjeteve të reja të parashikuara nga KPC-ja, GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se mjeti juridik i parashikuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së në parim është efektiv, por që të jetë i tillë edhe në praktikë, kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në bazë të nenit 399/6, pika 1, të KPC-së, duhet të shqyrtohet me shpejtësi nga gjykata.²⁶⁰ Nën dritën e kësaj jurisprudence edhe Gjykata theksoi se mjetet e parashikuara nga KPC-ja, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret.²⁶¹
260. Aktualisht për kërkesat për gjykimin apo ekzekutimin e vendimit brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata ka konsideruar se individit nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion nëse paraprakisht nuk ka ushtruar mjetet e parashikuara nga KPC-ja (*nenet 399/1 e vijues*);²⁶² ndërsa nëse këto mjete janë përdorur nga individit por nuk kanë marrë ende përgjigje nga gjykatat e juridiksionit të

257 Shih vendimin nr. 71, datë 05.04.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

258 Shih vendimet nr. 12, datë 05.03.2012; nr. 14, datë 15.04.2010; nr. 9, datë 01.04.2009; nr. 6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

259 Shih vendimin nr. 80, datë 18.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

260 Shih vendimin *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, cituar më lart, §§ 07 dhe 119.

261 Shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

262 Shih vendimet nr. 14, datë 05.02.2021; nr. 26, datë 12.02.2021; nr. 97, datë 28.07.2021; nr. 119, datë 14.10.2021 të Kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese.

zakonshëm, brenda afateve të përcaktuara nga KPC-ja, individi konsiderohet se i ka shteruar mjetet juridike;²⁶³ sikurse nuk ka asnjë dyshim që nëse mjetet procedurale janë ushtruar, por nuk kanë pasur rezultat pozitiv për individin, ai i ka përmbushur kriterin për shterimin e mjeteve juridike.²⁶⁴

261. Sa i takon mënyrës së paraqitjes së kërkesave për përshpejtim në gjykatat e zakonshme, Gjykata ka theksuar se ato nuk kanë nevojë për formalizma të tepruar. Konkretisht Gjykata në një rast vërejtë se kërkesa për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit dhe përshpejtimin e procedurave në Gjykatën e Lartë ishte paraqitur nga vetë kërkuuesi në cilësinë e tij si avokat dhe ish-gjyqtar në GJEDNJ. Megjithatë ajo kërkesë ishte kthyer pa veprime nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë, për shkak të mungesës së nënshkrimit të saj nga një avokat, që sipas ligjit duhet të përfaqësojë palën. Gjykata vlerësoi se ky veprim kishte **bërë që kërkuuesi të mos merrte përgjigje për përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij në atë gjykatë, duke mos pasur as një vendim përfundimtar në lidhje me këtë kërkesë. Për rrjedhojë, interpretimi i bërë nga kancelari i Gjykatës së Lartë shkonte përtej përmbajtjes dhe frymës së nenit 399/5, pika 2, shkronja "ç", të KPC-së²⁶⁵ dhe përbënte një formalizëm të tepruar. Në këtë mënyrë, nga një rregull garantues procedural, ai ishte kthyer në një mjet pengues të aksesit në Gjykatën e Lartë. Me këtë arsyetim, Gjykata arriti në përfundimin se kërkuuesi ishte shkarkuar nga detyrimi për të shteruar këtë mjet juridik përpara paraqitjes së ankimit kushtetues.²⁶⁶**
262. Sikurse lehtësisht mund të konstatohet nga rastet e mësipërme, jurisprudenca kushtetuese është e konsoliduar në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike duke pasur parasysh faktin se ky kriter kërkohej edhe në rastet kur ankimi kushtetues individual kishte për objekt vetëm për të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih supra paragrafin 32*).
263. Pas këtyre konsideratave dhe duke marrë parasysh situatën e vështirë me të cilën është përballur dhe aktualisht përballë sistemi gjyqësor shqiptar, i cili nuk është totalisht efektiv për shkak të procedurave të *vetting*-ut, pyetja që shtrohet është nëse duhet ose jo të zbatohet (formalisht) kriteri i shterimit të mjeteve juridike.
264. Në fakt, për shkak të situatës së evidentuar më lart nuk mund të përjashtohet mundësia që një subjekt i cenuar në të drejtat e tij themelore dhe, për pasojë, një aplikant i mundshëm për t'iu drejtuar drejtësisë kushtetuese, mund të gjendet në situatën paradoksale të cenimit për faktin se një kërkesë/mjet specifik gjyqësor (për shembull, rekursi në Gjykatën e Lartë/ankimi në gjykatën e apelit) nuk mund të ushtrohet për shkak të mungesës së *quorum*-it strukturor të organit të cilit i drejtohet ajo kërkesë/mjet. Problematika e kësaj çështjeje ka qenë e evidente në periudhën e paralizës së Gjykatës së Lartë (2018-mars 2020), por ekziston edhe aktualisht për shkak të vonesave në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Nëse do të pranohej zgjidhja formaliste (sipas së cilës personi i interesuar për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese do të duhet të presë që, përveç vetë kësaj të fundit, të funksionojnë të gjitha organet e tjera gjyqësore, ndaj të cilave drejtohen instrumentet e zakonshëm të mbrojtjes së të drejtave, ekziston edhe rreziku i cenimit i një të drejte tjetër të garantuar nga Kushtetuta, atë të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit (e cila përfshihet në të drejtën për një proces të rregullt ligjor). Nga ana tjetër, nëse do të pranohej zgjidhja substanciale (që përbën edhe qëndrimin e mbajtur nga GJEDNJ-ja), sipas së cilës ngërçi aktual i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm përjashtimisht

263 Shih vendimet nr. 39, datë 14.04.2024; nr. 33 datë 01.11.2021; nr. 34 datë 01.11. 2021 të Gjykatës Kushtetuese.

264 Shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

265 Neni 399/5, pika 2, shkronja "ç", i KPC-së që parashikon: "*Bashkë me kërkesën duhet të depozitohen edhe: ç) prokura, nëse kërkesa është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit*".

266 Shih vendimin nr. 37, datë 05.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

nuk e detyron individin të shterojë mjetet që nuk janë efektive dhe e bën ankimin kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese të vetmin mjet efektive të respektimit të të drejtave dhe lirive të individit, rreziku mund të jetë ai i mbingarkesës së vetë Gjykatës Kushtetuese²⁶⁷.

265. Gjykata i është përmbajtur zgjidhjes formaliste. Kështu, pretendimet e kërkuesve për tejzgjatje të gjykimit pa ushtruar mjetin e posaçëm sipas KPC-së (nenet 399/1 e vijues), me argumentin se nuk janë efektive, janë konsideruar si të pamjaftueshme në aspektin kushtetues për të pretenduar mospërdorimin e tyre.²⁶⁸

2.2.5. Shterimi i mjeteve në gjykimin me objekt ligjin ose aktin normativ

266. Edhe në rastet kur ankimi kushtetues individual ka për objekt ligjin (përfshirë boshllëkun ligjor) ose aktet nënligjore, jurisprudenca kushtetuese ka përcaktuar standardet e përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve. Gjykata është shprehur se kërkuesi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese që cenon ligji i kundërshtuar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individit duhet, së pari, t'i kundërshtojë ato para gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislacioni nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Meqenëse mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij.²⁶⁹
267. Kështu në një rast individit kundërshtoi nenin 62/1 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikonte si prag zgjedhor kombëtar marrjen e 1% të votave të përgjithshme për të gjitha subjektet zgjedhore. Gjykata, pasi konstatoi se kërkuesi ishte kandidat për deputet i propozuar nga zgjedhësit dhe kishte pretenduar cenimin e së drejtës kushtetuese për t'u zgjedhur, vlerësoi se në rastin konkret dispozita ligjore e kundërshtuar nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e saj, por është drejtpërdrejt e zbatueshme ndaj kërkuesit që prej momentit kur ai është regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhje. Në këto kushte, kërkuesi nuk ka mjete të tjera në dispozicion për të shteruar përveç paraqitjes së kërkesës për kontrollin e pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën.²⁷⁰
268. Në rastin kur është kundërshtuar urdhri nr. 561, datë 23.12.2021 "Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit COVID-19, për punonjësit e administratës publike, punonjësit e supermarketeve dhe qendrave tregtare" të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Kolegji i Gjykatës duke u bazuar në të njëjtat standarde u shpreh se pretendimet e kërkuesit për kundërshtimin e urdhrit nr. 561/2021 janë hipotetike, të pamaterializuara dhe nuk rezultojnë të ketë një akt konkret të institucionit shtetëror ku ai punon, përmes të cilit atij t'i jenë kufizuar të drejtat kushtetuese e konventore të pretenduara. Prandaj në atë rast u arrit në përfundimin se kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike në dispozicion.²⁷¹

267 Sipas informacionit të Gjykatës së Lartë në maj 2024 janë ende pa u shqyrtuar rreth 21.348 çështje, shumë prej të cilave, në teori, mund të gjenerojnë një mbingarkesë në Gjykatën Kushtetuese. Shih https://gjykata-media.s3.eu-central-1.amazonaws.com/statistika_Maj_2024_037969c87b.pdf, aksesuar për herë të fundit më 14.06.2024.

268 Shih vendimin nr. 93, datë 14.07.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

269 Shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

270 Po aty.

271 Shih vendimin nr. 38, datë 30.03.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

269. Në një rast tjetër, ankuesi kundërshtonte ligjin për amnistinë, i cili e përjashtonte atë nga kategoria e të dënuarve përfitues. Kolegji konstatoi se KPP-ja dhe ligji nr. 8331/1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale", i ndryshuar, parashikojnë procedurën e shqyrtimit nga gjykata të çështjeve që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale dhe të drejtën e të dënuarit për të paraqitur kërkesë në gjykatën e vendit të ekzekutimit, duke përfshirë edhe kërkesën për shuarjen e dënimit penal nga ligji për dhënie amnistie. Megjithatë, ky mjet juridik, sipas nenit 471, pika 2, të KPP-së nuk i ofronte premisa suksesi kërkesit, pasi neni 4, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 5/2020 përjashtonte në mënyrë të shprehur nga përfitimi i amnistisë të dënuarit për një listë shteruese të veprave penale kundër jetës, tek të cilat përfshihej edhe rasti i kërkesit. Nën këtë analizë, Kolegji vlerësoi se kërkesi nuk kishte mjete juridike efektive në dispozicion pasi paraqitja e kërkesës te administrata e IEVP-së në rrugë administrative dhe më pas në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk ofronte premisa suksesi. Sipas Kolegjit në këtë rast kriteri i shterimit të mjeteve juridike ishte përmbushur nga kërkesi.²⁷²
270. Në disa raste ankimi kushtetues individual është përdorur si mjeti nëpërmjet të cilit synohet: (i) shfuqizimi i vendimeve gjyqësore që kanë ardhur si rezultat i zbatimit të një akti normativ antikushtetues; (ii) shfuqizimi i vetë aktit normativ. Pra objekt i ankimit kushtetues individual kanë qenë si vendimet gjyqësore ashtu edhe akti normativ ku ato bazohen. Gjykata në këto çështje ka pasur rastin për të vlerësuar se paraqitja e kërkesës për iniciimin e kontrollit incidental të normës (së kundërshtuar) gjatë procesit gjyqësor nuk përbën element të domosdoshëm në këndvështrim të përmbushjes së kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, megjithatë, si një formë jo e drejtpërdrejtë e aksesit në gjykimin kushtetues, palët në proces mund të zgjedhin t'i kërkojnë gjykatës së zakonshme (që shqyrton çështjen) që të investojë Gjykatën Kushtetuese.²⁷³
271. Gjithashtu, në disa raste Gjykata ka mbajtur qëndrim edhe kur objekt i ankimit kushtetues individual ka qenë si shfuqizimi i vendimit gjyqësor ashtu edhe shfuqizimi i dispozitës ku bazohet ai vendim për shkak të ometimit ligjor.
272. Për ilustrim Mbledhja e Gjyqtarëve pasi ka konsideruar se kërkesi nuk ka shteruar mjetet për vendimin gjyqësor, është shprehur se lidhur me objektin tjetër të ankimit kushtetues individual - kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 506 të KPP-së, për shkak të ometimit në lidhje me parashikimin e së drejtës së ankimit ndaj vendimit gjyqësor që lejon ekzekutimin e letërporosisë, ritheksohet se pretendime të kësaj natyre duhet të analizohen të lidhura ngushtësisht me vendimet gjyqësore të dhëna bazuar në dispozitën ligjore të kundërshtuar. Për rrjedhojë, në kushtet kur kontrolli kushtetues ndaj vendimit gjyqësor të kundërshtuar nuk mund të vihet në lëvizje për shkak të natyrës jo përfundimtare të tij, nuk do të vijohet më tej me analizën për pajtueshmërinë me Kushtetutën të nenit 506 të KPP-së.²⁷⁴
273. Në një rast tjetër kërkesit kundërshtuan në Gjykatë vendimet gjyqësore të dhëna në shkallë të parë dhe të dytë, për të cilat ata kishin paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Në rekurs kërkesit pretenduan se gjykatat më të ulëta kishin zbatuar keq ligjin material që lidhej me masën e shpërbimit të drejtë për pronën e tyre. Gjithsesi, ata ushtruan ankim kushtetues individual pa pritur vendimarrjen e Gjykatës së Lartë, me pretendimin se rekursi i paraqitur prej tyre nuk ishte mjet efektiv ankimi për shkak të boshllëkut ligjor të neneve 485 të KPC-së dhe 63 të Ligjit të Gjykatave Administrative, që nuk i jepnin Gjykatës së Lartë mundësinë të dispononte zgjidhjen në themel

272 Shih vendimin nr. 74, datë 03.07.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

273 Shih vendimin nr. 4, datë 08.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

274 Shih vendimin nr. 95, datë 14.07.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

të çështjes së tyre. Kolegji u shpreh se neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës përcakton se shterimi i të gjitha mjeteve juridike efektive është kusht paraprak që duhet të përmbushet në çdo rast nga kërkuesit përpara se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese me ankim kushtetues individual. Kjo nënkupton se ata duhet të prisnin vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë për pretendimet për cenimin e të drejtave të tyre, duke përfshirë edhe interpretimin e ligjit, që pretendonin se kishte boshllëk ligjor dhe nëse rekursi i tyre nuk do të ishte i suksesshëm, atëherë, mund të vinin në lëvizje Gjykatën Kushtetuese si mjet juridik subsidiar.²⁷⁵

274. Një shembull tjetër lidhet me ankimin kushtetues të një të dënuari me burgim të përjetshëm. Ai kërkoi në Gjykatë shfuqizimin e vendimit të shkallës së parë për mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë të dënimit me burgim të përjetshëm. Gjithashtu, ai kërkoi deklarimin si të papajtueshme me Kushtetutën të neneve 450, pika 1, shkronja "e", 452, 453 të KPP-së si dhe plotësimin e boshllëkut ligjor në KPP, që do të mundësonte rigjykimin e personave të gjykuar në mungesë, të ekstraduar. Ai kishte paraqitur ankim në gjykatën e apelit ndaj vendimit të mospranimit të rishikimit, por gjatë kohës të shqyrtimit paraprak të ankimit kushtetues individual, ai e kishte tërhequr apelin dhe gjykata e apelit, kishte vendosur mospranimin e tij. Në këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve vuri në dukje se kërkuesi, ndonëse kishte filluar të ushtronte të drejtën e ankimit sipas parashikimeve të KPP-së, e kishte ndërprerë me vullnetin e tij këtë procedurë, pa u dhënë mundësi gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësonin dhe të shpreheshin në mënyrë përfundimtare për pretendimet e tij lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, si dhe për papajtueshmërinë kushtetuese dhe boshllëkun ligjor të neneve 450, 452 dhe 453 të KPP-së. Prandaj, Mbledhja e Gjyqtarëve çmoi se kërkuesi nuk legjitimohej për shkak se nuk kishte shteruar mjetet juridike në dispozicion të tij, sipas KPP-së, përpara se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese me ankim individual kushtetues.²⁷⁶
275. Si një konsideratë e fundit dhe e përgjithshme mbi shterimin e mjeteve juridike, duhet evidentuar lidhja që ka ai me kriterin e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues. Ashtu siç do të shpjegohet në vijim, ecja e afatit është e lidhur me kohën e vendimit që është dhënë mbi mjetin më të fundit juridik në dispozicion të individit (*shih infra paragrafët 287-289*). Në këtë kuptim, shterimi i mjeteve juridike i lidhur me afatin e paraqitjes së ankimit përcaktojnë në një farë mënyre juridiksionin *ratione temporis* të Gjykatës. *Për këtë arsye, në praktikë Gjykata gjithnjë e shqyrton shterimin e mjeteve juridike në radhë përpara se të shqyrtojë përmbushjen e afatit të paraqitjes së ankimit.*

275 Shih vendimin nr. 2, datë 08.01.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese. Pavarësisht se u konsiderua se kërkuesi nuk i kishte shteruar mjetet juridike, Kolegji theksoi se pretendimi i kërkuesve se rekursi në Gjykatën e Lartë në procesin e tyre gjyqësor nuk përbën mjet efektiv për mbrojtjen e të drejtave të cenuara, dhe se ligji ka boshllëk ligjor, është haptazi i pabazuar. Gjykata e Lartë, sipas nenit 141 të Kushtetutës, shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Për shkak të kësaj kompetence kushtetuese, neni 58 i Ligjit të Gjykatave Administrative përcakton se ndër shkaqet për rekurs në Gjykatën e Lartë përfshihen rastet e zbatimit të gabuar të ligjit material, me rëndësi themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe rastet kur vendimi gjyqësor i rekursuar është i ndryshëm nga praktika e mëparshme gjyqësore e Gjykatës së Lartë. Duke iu referuar këtij konteksti kushtetues dhe ligjor për kompetencat e Gjykatës së Lartë dhe të drejtën e rekursit të palëve, vlerësimi apriori i kërkuesve mbi mungesën e efektivitetit të vendimmarrjes eventuale të Gjykatës së Lartë dhe të boshllëkut ligjor përbën një prezumim të pabazuar në ligj ose fakte për kompetencën që Gjykata e Lartë ka për interpretimin dhe zbatimin e ligjit.

276 Shih vendimin nr. 12, datë 02.02.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

2.3. Afati për paraqitjen e ankimit

276. Afati është një prej kriterëve procedurale për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, i cili u rishikua me reformën kushtetuese të vitit 2016, duke u ulur nga 2 vjet në 4 muaj²⁷⁷. Shkurtimi i afatit kohor kishte për qëllim forcimin e sigurisë juridike dhe i shërbeu shmangies së periudhave të gjata përpara arritjes së rezultatit përfundimtar të një çështjeje të caktuar²⁷⁸.
277. Afati 4 mujor parashikohet në nenet 71/a, pika 1, shkronja "b" dhe 50, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës. Kjo do të thotë se afati i paraqitjes së ankimit kushtetues është i caktuar nga ligji dhe ka natyrë prekluzive, pra që nuk mund të zgjatet apo shkurtohet as me vendim të Gjykatës dhe as me marrëveshje të palëve.
278. Në thelb, afati shënon distancën kohore, brenda të cilës ankimi kushtetues individual mund të paraqitet në Gjykatë, duke u treguar individëve dhe organeve publike periudhën përtej së cilës Gjykata Kushtetuese nuk mund të marrë në shqyrtim çështjen. Afati ka ditën e fillimit (*dies a quo*) dhe të fundit (*dies ad quem*).
279. Afati 2 vjeçar ishte vlerësuar problematik në drejtim të parimit të sigurisë juridike pasi lejonte rihapjen e procedurave gjyqësore pas një kohe relativisht të gjatë. Nga ana tjetër, zgjerimi i të drejtës së ankimit kushtetues individual për të gjitha të drejtat dhe liritë themelore e bënte afatin 2 vjeçar të papërshtatshëm në drejtim të mbingarkesës së Gjykatës Kushtetuese. Afati i ri është vlerësuar se përbën një afat të arsyeshëm në dispozicion të individit për të përgatitur ankimin kushtetues, përfshi edhe zgjedhjen e një mbrojtësi. Sigurisht që shkurtimi i afatit ndihmon edhe në shqyrtimin brenda një afati të arsyeshëm të pretendimeve për cenimin e të drejtave themelore.
280. Shkurtimi i afatit krijon një filtër më shtrëngues në drejtim të aksesit në gjykimin kushtetues, megjithatë duhet mbajtur në konsideratë se ekzistenca e filtrave, përfshi edhe atë të afatit, janë të zakonshme në sistemet kushtetuese që lejojnë ankimin e plotë individual, për të shmangur rrezikun e mbingarkimit të gjykatave kushtetuese, por gjithmonë duke siguruar një balancë të kujdesshme midis këtij rreziku dhe aksesit individual efektiv në gjykimin kushtetues²⁷⁹.
281. Ripërcaktimi i afatit të ri kohor, edhe pse në respekt të parimit të sigurisë juridike²⁸⁰, e uli në mënyrë drastike hapësirën kohore për të paraqitur ankim në krahasim me të kaluarën. Për këtë arsye, neni 86, pika 3, i Ligjit Organik të Gjykatës, parashikoi datën 1 mars 2017 për zbatimin e tij²⁸¹, pra më vonë krahasimisht me hyrjen në fuqi të shtesave dhe ndryshimeve, që u prezantuan me të njëjtin ligj²⁸². Ky rregull kalimtar u mendua t'i shërbente metabolizimit më të mirë nga njëra anë të ndryshimit rrënjësor të vetë ankimit kushtetues individual dhe nga ana tjetër të afatit të ri jo vetëm nga individët, por edhe nga vetë profesionistët, duke filluar nga avokatët²⁸³.
282. Duhet evidentuar se fillimisht zbatimi i afatit 4 mujor nga Gjykata krijoi problematikë në praktikë, e cila u konstatua si shkelje e procesit të rregullt nga GJEDNJ-ja. Kështu, në një rast, ankuesi

277 Parashikimi i këtij afati ka ndjekur modelin e afatit 4 mujor të përcaktuar nga neni 35, pika 1 i KEDNJ-së (i modifikuar me protokollin nr. 15) për t'iu drejtuar GJEDNJ-së.

278 Shih vendimet *Supergrav kundër Shqipërisë*, nr. 20702/18, datë 09.05.2023, § 19; Çela kundër Shqipërisë, nr. 73274/17, datë 29.11.2022, § 23.

279 Shih raportin e rishikuar të Komisionit të Venecias për aksesin individual në drejtësinë kushtetuese, CDL-AL (2021)001, § 76, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)001-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)001-e),

280 Shih vendimet nr. 12 dhe nr. 13, datë 17.01.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

281 Shih vendimet nr. 56, datë 25.07.2017, nr. 84, datë 26.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese; vendimet nr. 49, datë 13.03.2017, nr. 62, datë 29.03.2017, nr. 71, datë 31.03.2017 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

282 Ligji nr. 99/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" u miratua në datën 06.10.2016 dhe hyri në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 210, datë 08.11.2016.

283 Shih vendimin nr. 52, datë 18.02.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

paraqiti ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese në datën 02.06.2017, pra pas hyrjes në fuqi të rregullit ligjor për shkurtimin e afatit. Vendimi gjyqësor më i fundit i kundërshtuar prej tij ishte i datës 11.11.2016, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimit ligjor. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese me vendimin e datës 29.06.2017 vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare me arsyetimin se ankimi ishte paraqitur tej afatit të ri 4-mujor, duke theksuar se ndryshimi ligjor për afatin kishte hyrë në fuqi në datën 01.03.2017²⁸⁴. Në vijim, ankuesi iu drejtua GJEDNJ-së, e cila vlerësoi se ishte shkelur e drejta për proces të rregullt ligjor, në aspektin e aksesit, me arsyetimin se megjithëse shkurtimi i afatit në 4 muaj synonte forcimin e sigurisë juridike, ndiqte një qëllim të ligjshëm dhe nuk ishte në vetvete në kundërshtim me nenin 6 § 1 të Konventës, ai vinte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Sipas GJEDNJ-së, ligji ishte i paqartë pasi nuk specifikonte nëse afati i ri 4 - mujor do të zbatohet për vendimet e gjykatave të zakonshme të cilat bëheshin përfundimtare nga data 1 mars 2017 e në vijim. Meqenëse ligji kishte krijuar paqartësi se si do të llogaritej afati i ri për paraqitjen e ankimit kushtetues, Gjykata Kushtetuese duhej të sqaronte mënyrën e saktë që do të përdorej në përlllogaritjen e këtij afati²⁸⁵.

283. Afati 4-mujor është kriter, përmbushja e të cilit vlerësohet kryesisht nga Gjykata, edhe nëse subjektet e interesuara në gjykimin kushtetues nuk e kundërshtojnë atë. Analiza e këtij kriteri pranueshmërie vlerësohet nga Gjykata si aspekt i legjitimitetit *ratione temporis*.
284. Në zbatim të Ligjit Organik të Gjykatës, afati fillon të ecë nga konstatimi i cenimit dhe llogaritet deri në datën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë. Momenti i konstatimit të cenimit përkon me ditën kur kërkuesi pëson cenimin e të drejtave themelore nga zbatimi i aktit të kundërshtuar – vendim gjyqësor, akt normativ ose akt tjetër i pushtetit publik. Ndërsa sa i takon datën e paraqitjes së ankimit, bëhet fjalë për datën e dorëzimit të ankimit dhe jo për datën që ankuesi shënon vetë në tekstin e ankimit²⁸⁶. Kur ankimi paraqitet nëpërmjet shërbimit postar, atëherë si ditë e paraqitjes së tij llogaritet ajo e depozitimit në postë²⁸⁷. I njëjti rregull vlen edhe nëse ankimi është paraqitur në një organ tjetër nga Gjykata Kushtetuese, pra si datë e paraqitjes së tij llogaritet ajo e paraqitjes në organin jokompetent. Po ashtu, kur ankimi kushtetues paraqitet i paplotë administrativisht dhe Drejtoria Gjyqësore i kërkon ankuesit plotësimin administrativ të të metave, ai konsiderohet se është paraqitur në datën e dorëzimit të aktit të parë me të meta²⁸⁸. Nën të njëjtën logjikë, kur Kolegji gjyqësor vendos kthimin e ankimit për plotësim dhe ankuesi i plotëson të metat rregullisht, ankimi konsiderohet se është paraqitur në datën e dorëzimit të aktit të parë²⁸⁹.
285. Sa i takon llogaritjes së afatit janë të vlefshme të gjitha rregullat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 15 të Rregullores së Gjykatës. Kështu, meqë afati është i caktuar në muaj, ai llogaritet me muaj sipas kalendarit të zakonshëm, pra nuk llogaritet me ditë. Ai përfundon me kalimin e asaj dite të muajit të fundit që ka të njëjtin numër me atë të ditës nga e cila ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të atij muaji. Dita e fundit e afatit 4 mujor vazhdon deri në orën 16.00 kur mbaron orari zyrtar. Ditët e pushimit javor ose festiv përgjatë afatit 4 mujor nuk e pezullojnë ecjen e tij dhe as e zgjasin atë. Megjithatë, nëse

284 Shih vendimin nr. 163, datë 29.06.2017 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

285 Shih vendimin Çela kundër Shqipërisë, cituar më lart. I njëjti qëndrim u konfirmua edhe në vendimin *Supergrav kundër Shqipërisë*, cituar më lart.

286 Shih vendimin nr. 172, datë 06.12.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

287 Shih vendimet nr. 68, datë 20.05.2020; nr. 79, datë 29.04.2021; dhe nr. 187, datë 19.12.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

288 Shih vendimin nr. 93, datë 20.10.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

289 Shih vendimet nr. 6 datë 20.01.2023; nr. 100 datë 15.05.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese (në rastet kur Kolegji e ka legjitimuar kërkuesin *ratione temporis*) dhe vendimet nr. 10 datë 20.01.2023; nr. 34 datë 22.02.2023; nr. 35 datë 22.02.2023 (në rastet kur Kolegji nuk e ka legjitimuar kërkuesin *ratione temporis* edhe pasi kërkesa është kthyer për plotësim).

afati përfundon në ditë pushimi javor ose festë zyrtare, atëherë ai shtyhet në ditën pasardhëse të punës²⁹⁰.

286. Neni 11, pika 3, shkronja ç) e Rregullores së Gjykatës parashikon se Mbledhja e Gjyqtarëve lidhur me procedurat gjyqësore ka në kompetencë të vendosë pezullimin e afateve në përputhje me rregullimet ligjore. Një rregull i tillë ka mbajtur në konsideratë situatat e jashtëzakonshme të shkaktuara nga forcat madhore, siç ishte rasti i pandemisë Covid-19, që rezultoi me izolimin e popullatës dhe ndërprerjen e përkohshme të veprimtarive zyrtare, përfshirë atë gjyqësore.
287. Nuk është e tepërt të evidentohet edhe një herë, se llogaritja e *dies a quo* është e lidhur rreptësisht me kriterin e shterimit të mjeteve juridike për shkak të natyrës përfundimtare që ka mbrojtja kushtetuese e lirive dhe e të drejtave themelore. Nga ana praktike, kjo do të thotë se llogaritja e afatit i referohet vendimit gjyqësor që ka natyrë përfundimtare në kuptimin kushtetues, që zakonisht përkon me vendimin e Gjykatës së Lartë. Këtu nuk përfshihen rastet kur individi i drejtohet drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese për shkak se nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion ose ato rezultojnë se nuk janë efektive.
288. Kur gjykata e zakonshme ka shënuar në vendimin e saj gabimisht se ankuesi kishte të drejtën e rekursit dhe në vijim, ka vendosur mospranimin e rekursit duke ndrequr gabimin e bërë, Gjykata ka konsideruar se konstatimi i cenimit fillon nga dita që ankuesi është njoftuar për vendimmarrjen e mospranimit të rekursit, me arsyetimin se afati duhet të përlllogaritet në mënyrën që garanton të drejtën e aksesit në gjykatë të individit²⁹¹.
289. Duhet vënë re se paraqitja e një kërkesë për rishikim, që nuk pranohet nga gjykata, nuk përcakton ditën se kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar është bërë përfundimtar, me qëllim përlllogaritjen e afatit ligjor 4 – mujor të paraqitjes së ankimit individual kushtetues. Kërkesa për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, kur nuk pranohet nga gjykata, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të një procesi gjyqësor. Për më tepër, ashtu siç individëve iu kërkohet që për efekte të shterimit të mjeteve juridike të përdorin vetëm mjetet normale të ankimit, duke mos i detyruar të përdorin mjete të jashtëzakonshme të ankimit (sikurse është edhe kërkesa për rishikim), në të njëjtën linjë, individët nuk mund të pretendojnë përmbushjen e afatit ligjor 4 – mujor për paraqitjen e ankimeve kushtetuese duke u bazuar në përdorimin e mjeteve të jashtëzakonshme të ankimit, të cilat janë refuzuar nga gjykata si haptazi të pabazuara në ligj²⁹².
290. Është e qartë që data e paraqitjes së ankimit dokumentohet zyrtarisht sipas rastit, nga Gjykata ose shërbimi postar, ndërsa data e konstatimit të cenimit është një fakt, për të cilin barrën e provës e ka ankuesi. Gjykimi kushtetues vihet në lëvizje nga vetë individi, që do të thotë se ai, nga njëra anë, prezumohet se është në dijeni të kritereve paraprake dhe jurisprudencës së Gjykatës mbi to dhe, nga ana tjetër, ka barrën e paraqitjes së akteve provuese që mbështesin pretendimet e tij, sidomos kur asistohet në procedurën e ankimit nga avokati²⁹³.
291. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuksi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të

290 Shih vendimet nr. 17, datë 19.12.2019; nr. 6, datë 10.01.2020; nr. 92, datë 20.10.2020; dhe nr. 23, datë 03.02.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

291 Shih vendimin nr. 189, datë 20.12.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

292 Shih vendimin nr. 12, datë 02.02.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

293 Shih vendimin nr. 68, datë 04.04.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

ndryshme²⁹⁴. Ky qëndrim lidhet me përmbajtjen e neneve 142, pika 1 dhe 146, pika 2, të Kushtetutës, të cilat parashikojnë detyrimin për arsyetimin e vendimeve gjyqësore dhe për shpalljen publikisht të tyre në çdo rast. Në këtë mënyrë, prezumimi ligjor është që vendimi gjyqësor shpallet i arsyetuar, ndaj i takon barra ankuesit të provojë se ai ka marrë dënim për vendimin gjyqësor në një datë të mëvonshme nga shpallja e tij²⁹⁵.

292. Hipoteza e fundit bën fjalë për rastet kur asyrtimi i vendimit i njoftohet kërkuesit pas shpalljes së vendimit, pasi siç ka theksuar GJEDNJ-ja ndonëse afatet kohore janë në parim kufizime të ligjshme të së drejtës për t'u drejtuar gjykatës, mënyra në të cilën ato zbatohen në një çështje të caktuar mund të shkaktojë shkelje të të drejtës për proces të rregullt, në aspektin e aksesit, për shembull nëse afati kohor për paraqitjen e ankimit fillon të ecë në momentin kur pala nuk e dinte dhe nuk mund ta dinte në mënyrë efektive përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar të gjykatës më të ulët²⁹⁶.
293. Në të njëjtën linjë me qëndrimin e GJEDNJ-së, Gjykata është shprehur se momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave kushtetuese, nga i cili fillon të rrjedhë afati i paraqitjes së ankimit kushtetues, konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar është bërë efektivisht i disponueshëm për kërkuesin dhe ai është njohur me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e kundërshtuar të asaj gjykate²⁹⁷. Në rastin e vendimeve të Gjykatës së Lartë, vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, nëse individ i ka lënë të dhënat elektronike të kontaktit²⁹⁸.
294. Provat, të cilat janë pranuar se vërtetojnë një datë të ndryshme nga ajo e shpalljes së vendimit gjyqësor, në rastet më të zakonshme përmbledhin dëftesat e komunikimit të gjykatës, përfshi komunikimet elektronike²⁹⁹, vërtetim nga administrata gjyqësore që dëshmon për datën e arsyetimit dhe të nënshkrimit nga gjyqtarët të vendimit të kundërshtuar³⁰⁰ apo çdo akt tjetër zyrtar me fuqi të plotë provuese, në kuptimin që të jetë lëshuar nga organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së tij.
295. Në një rast të marrë në shqyrtim nga Kolegji i Gjykatës, u konstatua se nuk mund të përcaktohej data e arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që në faqen e saj zyrtare, për çështjen e kërkuesit, gabimisht ishte publikuar një vendim që i përkiste një çështjeje tjetër gjyqësore. Ndërkohë, kërkuesi nuk kishte depozituar të dhënat elektronike të kontaktit (*e-mail*), duke e bërë të pamundur njoftimin elektronik të vendimit të arsyetuar. Në këtë situatë, Kolegji vërejti se kërkuesit nuk i ishte dhënë informacioni i nevojshëm që ai të kujdesej për t'u njohur efektivisht me vendimin gjyqësor (vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Lartë), që, sipas tij, i kishte cenuar të drejtat kushtetuese. Duke mbajtur në konsideratë se vetëm njohja me vendimin e arsyetuar u mundëson palëve ta ankimojnë atë nëse e shohin të arsyeshme, si dhe se individ nuk mund të mbajë një barrë të tepruar për shkak të gabimeve të administratës së gjykatës, është vlerësuar se në rastin konkret, si moment i konstatimit të cenimit nga kërkuesi duhet konsideruar data kur ai pati mundësi efektive për të marrë dënim për vendimin e arsyetuar objekt ankimi, pra data kur ishte paraqitur në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dhe kishte marrë kopje të vendimit.³⁰¹

294 Shih vendimet nr.84, datë 26.12.2017; nr.80, datë 18.12.2017; nr.79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

295 Shih vendimet nr. 19 datë 03.02.2023; nr. 29 datë 13.02.2023; nr. 41 datë 22.02.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

296 Shih vendimet Çela kundër Shqipërisë, cituar më lart, § 36, datë 29.11.2022 dhe *Supergrav kundër Shqipërisë*, cituar më lart, § 23.

297 Shih vendimin nr. 141, datë 26.06.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

298 Shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese

299 Neni 141 i KPC-së dhe urdhri nr. 131, datë 02.07.2021 "Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve" i zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

300 Shih vendimet nr. 31, datë 28.01.2020 dhe nr. 9, datë 20.01.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

301 Shih vendimin nr. 128, datë 13.06.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

296. Në një rast tjetër, ankuesi pretendonte se i ishin cenuar të drejtat për t'u njoftuar dhe e aksesit sipas nenit 42 të Kushtetutës, me argumentin se vendimi gjyqësor përfundimtar i shkallës së parë, i shpallur në mungesë të tij nuk i ishte njoftuar nga gjykata dhe ai kishte qenë në pamundësi të merrte kopje të vendimit për shkak të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore prej pandemisë Covid-19. Sipas tij, ai kishte marrë dijeni për cenimin e të drejtave në datën që gjykata i kishte dërguar vendimin me shkresë, ku i bëhej me dije se njoftimi i vendimit nuk ishte detyrim për gjykatën. Kolegji i vlerësoi pretendimet e ankuesit në këndvështrim të detyrimit ligjor të organeve të administratës gjyqësore për njoftimin e vendimeve gjyqësore për palët në mungesë, duke vënë në dukje se është detyrë e gjykatave që në çdo rast t'u njoftojnë palëve në gjykim vendimet përfundimtare dhe jopërfundimtare të çështjes. Me këtë arsyetim, Kolegji vlerësoi se ankimi ishte paraqitur në afat, duke e llogaritur atë nga data e shkresës së dërguar nga kryetari i gjykatës³⁰².
297. Duhet vënë re se nuk janë pranuar me fuqi provuese për kohën e mëvonshme të konstatimit të cenimit kopjet e vendimit të kundërshtuar, në të cilin është vendosur shënimi i administratës për datën e tërheqjes së tyre nga ankuesi ose përfaqësuesi i tij. Në këto raste, Kolegjet e Gjykatës janë shprehur në mënyrë konstante se paraqitja e vendimit gjyqësor me shënimin *"u tërhoq në datën [...]"* nuk provon datën e marrjes dijeni efektivisht prej ankuesit, sepse një shënim i tillë mund të vendoset nga sekretaria gjyqësore në çdo rast dhe në çdo ditë kur një palë ndërgjyqëse paraqitet për të tërhequr kopje të vendimit gjyqësor³⁰³. Në një rast tjetër, nuk është pranuar si provë komunikimi elektronik i vendimit gjyqësor nga avokati tek ankuesi, me arsyetimin se nuk përbënte provë bindëse për të justifikuar vonesën e paraqitjes së ankimit³⁰⁴. Po ashtu, nuk është pranuar me fuqi provuese vetëm deklarata noteriale, sipas të cilës ankuesi ka qenë me vendbanim jashtë shtetit, pasi është vlerësuar se sipas provave të tjera ankuesi rezultonte se kishte hyrë në territorin shqiptar disa herë³⁰⁵.
298. Në të njëjtin drejtim, nuk është pranuar pretendimi se paraqitja e ankesës pas më shumë se 4 vjetëve ishte rezultat i aftësive të kufizuara të ankuesit, me arsyetimin se kalimi kaq haptazi i afatit nuk mund të justifikohet thjesht me deklarin e aftësisë së kufizuar, gjendje në të cilën ai ndodhej që prej vitit 1967³⁰⁶. Po ashtu, nuk është pranuar pretendimi se vonesa në paraqitjen e ankimit lidhej me moshën dhe gjendjen e rënduar shëndetësore, për të cilën ankuesi kishte paraqitur si provë fletëdaljen spitalore, sipas të cilës 5 ditë pas shpalljes së vendimit, ai ishte shtruar për 9 ditë në spital me Covid-19. Në këtë rast, Kolegji vlerësoi se argumentet e tij nuk justifikonin vonesën në paraqitjen e ankimit, në kushtet kur ai rezultonte të ishte asistuar edhe nga një avokat³⁰⁷.
299. Kur individ i është izoluar për shkak të arrestit në burg ose dënimit penal me burgim, kjo rrethanë është vlerësuar se e ka penguar ankuesin të marrë dijeni për vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë përmes njoftimit me shpallje në ambientet fizike ose në faqen zyrtare të asaj gjykate. Në këto raste, Gjykata duke konstatuar se kishte një tejkallim të lehtë të afatit 4 mujor, i ka dhënë përparësi aksesit të ankuesit në gjykimin kushtetues³⁰⁸ dhe ka vlerësuar se ankimi ishte paraqitur brenda afatit.

302 Shih vendimin nr. 97, datë 16.11.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

303 Shih vendimet nr. 5, datë 02.12.2019; nr. 26, datë 20.12.2019; nr. 11, datë 14.01.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

304 Shih vendimin nr. 159, datë 18.11.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

305 Shih vendimin 9, datë 14.01.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

306 Shih vendimin nr. 28, datë 20.12.2019 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

307 Shih vendimin nr. 98, datë 28.07.2021 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

308 Shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese; vendimin nr. 194, datë 22.12.2022 të Mbledhjes së Gjyqtarëve; dhe vendimin nr. 129, datë 02.11.2021 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

300. Në këtë drejtim, merr rëndësi situata në të cilën ndodhet i gjykuari në mungesë, i cili pretendon se nuk ka marrë dijeni të procesit gjyqësor në ngarkim të tij. Deri më tani, nuk rezulton të ketë precedentë të kësaj natyre në jurisprudencën kushtetuese në periudhën *post reformës* së vitit 2016. Sidoqoftë, në përputhje me jurisprudencën e mëparshme kushtetuese, duhet të mendohet se edhe në këtë rast kërkuesi ka barrën e provës në lidhje me njoftimin dhe/ose njohjen e vendimit që ai kundërshton.
301. Vlen të theksohet se Gjykata është shprehur edhe për afatin e paraqitjes së shtimit të objektit të ankimit, që përmban si shkak cenimin e disa të drejtave kushtetuese, pretendime të cilat nuk i ka ngritur në ankimin fillestar. Nisur nga përmbajtja e kombinuar e neneve 1, pika 2 dhe 43/b, pika 2 të Ligjit Organik të Gjykatës, si dhe nenit 185, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), Gjykata vërejtë se kërkuesi, në çdo fazë të gjykimit kushtetues, deri në kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare ka të drejtë të shtojë objektin e ankimit kushtetues, por pa ndryshuar njëkohësisht edhe shkaqet e tij. Në këtë situatë, Gjykata vlerësoi se kërkimi i ri shton njëkohësisht objektin dhe shkaqet e ankimit fillestar, ndaj përbën çështje të re, të paraqitur përtej afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë nuk mund të merret në shqyrtim.³⁰⁹
302. Kur një e drejtë themelore cenohet nga një burim normativ, me natyrë ligjore ose nënligjore merr rëndësi të sqarohet në mënyrë të qartë llogaritja e *dies a quo*. Në parantezë, duhet të analizohet situata, megjithëse shumë e pamundur, që Kuvendi ose Qeveria, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës që shpall ligjin, me aktin e vet të passjellë një *vulnus* të rëndë dhe të menjëhershëm të sistemit ligjor përmes shkeljes së një të drejte themelore, si p.sh. e drejta e pronës, që do të shkaktonte jo vetëm një papajtueshmëri kushtetuese të aktit, por edhe të shfuqizimit *tout court* të tij, që do ishte patologjia më e "rëndë" e antikushtetutshmërisë së aktit. Duke qenë se asnjë mjet tjetër juridik efikas, gjyqësor ose jo, nuk do të ishte i konceptueshëm, por edhe sepse në çdo rast *periculum in mora* do të ishte jashtëzakonisht i dukshëm, e vetmja rrugëdalje do të ishte ajo e ankimit të drejtpërdrejtë kushtetues, brenda katër muajve nga hyrja në fuqi e aktit. Në fakt, në këtë rast as kufiri kohor nuk duhet të zbatohet në respekt të parimit *salus rei publica suprema lex esto*.³¹⁰
303. Përveç këtyre rasteve ekstreme, të cilat është jashtëzakonisht e vështirë që të ndodhin, dhe që jo vetëm ndikojnë në gëzimin e së drejtës themelore së një personi, por rrezikojnë vetë ekzistencën e rendit juridik, normalisht *dies a quo*, duhet të llogaritet nga momenti në të cilin subjekti konkretisht vuan pasojat negative të veprimit të autoriteteve publike. Në këtë drejtim, duhet të ritheksohet që, zakonisht, ligjet dhe aktet e tjera normative, për zbatimin e tyre të plotë, kërkojnë nxjerrjen e akteve nënligjore apo administrative. Kjo passjell një zhvendosje përpara në kohë të mundësinë për t'iu drejtuar Gjykatës dhe për të njëjtën arsye të *dies a quo*. Në fakt, kërkuesi duhet fillimisht, të presë që akti administrativ të publikohet (nëse ka natyrë të përgjithshme) ose t'i njoftohet (nëse ka natyrë individuale); pastaj të shterojë mjetet juridike efektive që ka në dispozicion për të mbrojtur të drejtën e vet; dhe, në fund, nëse do të ketë rezultat negativ pas ushtrimit të secilit prej tyre, të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në çdo rast, do të jetë pashmangësisht jurisprudenca kushtetuese që do zgjidhë, në një të ardhme, që shpresohet të jetë e afërt, dyshimet e mbetura që ende ekzistojnë në këtë pikë.

309 Shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023 dhe nr. 28, datë 11.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

310 F. Papajorgji, V. Teotonico, *Reflections on individual constitutional complaint in Albania*, Evolution, Journal of life sciences and society, Vol I, Issue 1, July 2020, fq. 17.

304. Gjykata në jurisprudencën e saj ende të re në këtë drejtim, ka evidentuar se konstatimi i cenimit nga aktet normative si rregull nuk përkon me çastin e hyrjes në fuqi të ligjit ose aktit normativ. Afati ligjor llogaritet nga çasti kur akti fillon të prodhojë efekte për ankuesin ose, thënë ndryshe, kur ndaj tij zbatohet ligji ose akti normativ me anë të: (i) aktit të nxjerrë nga organi administrativ³¹¹; ose (ii) vendimit gjyqësor përfundimtar³¹². Për këtë të fundit, ashtu si edhe në raste të tjera që objekt ankimi është vendimi gjyqësor, Gjykata është shprehur se afati llogaritet nga çasti kur vendimi gjyqësor përfundimtar është bërë efektivist i disponueshëm për ankuesin dhe ai është njohur me shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen e kundërshtuar të asaj gjykate³¹³.
305. Sa i takon gjykimit kushtetues, i cili në objektin e tij ka konstatimin e shkeljeve vazhduese, afati 4 mujor nuk mund të merret në konsideratë. Kështu kur individ i është drejtuar Gjykatës për konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm dhe Gjykata e Lartë nuk është shprehur për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të paraqitur prej tij sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së, Gjykata ka vlerësuar se kërkuesit i lind e drejta t'i drejtohet asaj në çdo kohë përgjatë periudhës që shkelja vazhdon³¹⁴. Në këtë kuptim, Gjykata ka pohuar se ankime të tilla mund të paraqiten edhe përpara vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë mbi kërkesën për përshpejtim, nëse kjo vendimmarrje dukshëm nuk ka respektuar afatet ligjore³¹⁵.
306. Së fundmi, duhet evidentuar se Gjykata në praktikën e saj ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës së të njëjtit individ, me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, ka argumentuar një shkak të ri për antikushtetutshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por me kushtin që ankimi i dytë duhet të jetë paraqitur brenda afatit ligjor³¹⁶. Nën të njëjtën logjikë, kur ankuesi paraqet në një ankim të vetëm, dy kërkime autonome nga njëri-tjetri, të tilla që kanë objekt dhe shkak kushtetues të ndryshëm, atëherë afati llogaritet veçmas për secilin kërkim³¹⁷.

2.4. Legjitimimi *ratione materiae*

307. Legjitimimi *ratione materiae* i individit lidhet me kompetencën lëndore të Gjykatës për të zgjidhur mosmarrëveshjen kushtetuese në themel nëpërmjet vendimit përfundimtar, që rrezon ose pranon ankimin e paraqitur. Në praktikën e punës të saj, ky kriter është zbatuar duke vlerësuar përmbajtjen e pretendimeve që parashtrohen në ankimin kushtetues.
308. Nga pikëpamja procedurale, Gjykata, si rregull, e shqyrton paraprakisht çështjen e kompetencës së saj *ratione materiae*, pra në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesës. Nëse vlerësohet se pretendimet nuk hyjnë në kompetencën e saj, atëherë, sipas rastit, Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve vendos moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Megjithatë, ashtu siç është verifikuar edhe në praktikë, Gjykata nuk ka pengesë ta shqyrtojë atë (për një pjesë³¹⁸ apo të gjitha pretendimet e ngritura³¹⁹) edhe gjatë gjykimit dhe në këtë rast, vendos rrëzimin e kërkesës.

311 Shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

312 Shih vendimin nr. 4, datë 21.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

313 Shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

314 Shih vendimet nr. 33, 34 dhe 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

315 Shih vendimin nr. 148, datë 09.11.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

316 Shih vendimin nr. 21, datë 29.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

317 Shih vendimet nr. 19, datë 04.04.2023 të Gjykatës Kushtetuese; nr. 54, datë 13.05.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

318 Shih vendimet nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 23 datë 10.10.2022; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

319 Shih vendimin nr. 22, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

309. Janë katër elementë që i japin kompetencë Gjykatës për të shqyrtuar themelin e një ankimi kushtetues individual: (i) natyra kushtetuese e pretendimeve; (ii) bazueshmëria *prima facie* e pretendimeve; (iii) mungesa e një vendimmarrje të mëparshme për pretendimet; dhe (iv) mundësia e rivendosjes të së drejtës së shkelur.

2.4.1 Natyra kushtetuese e pretendimeve

310. Sipas nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës, individi nëpërmjet ankimit kushtetues individual mund të pretendojë cenimin e të drejtave dhe lirive të garantuara në Kushtetutë. Kjo do të thotë që pretendimet e kërkuesit të hyjnë në kompetencën e Gjykatës, duhet që e drejta/të drejtat e pretenduara të cenuara nga kërkuesi të mbrohen nga Kushtetuta.
311. Gjykata është shprehur se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f” të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, në lidhje me përmbajtjen e pretendimeve (*ratione materiae*) të ngritura në ankimin kushtetues individual, kontrolli kushtetues ndaj akteve të pushtetit publik kufizohet vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë³²⁰.
312. Duhet bërë kujdes se ndonëse neni 131, pika 1, shkronja “f” flet vetëm për të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, në fakt vetë ligji themeltar merr në mbrojtje dhe ato të parashikuara nga KEDNJ-ja dhe Protokollat e saj në fuqi. Këto të fundit përfshihen në kompetencën e Gjykatës jo vetëm për shkak të parimit themelor kushtetues³²¹, sipas të cilit Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, por edhe për efekt të statusit të veçantë që KEDNJ-ja ka në Kushtetutën shqiptare, e cila në nenin 17 parashikon se kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore nuk mund të cenohen thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ³²². Për rrjedhojë, ankimi kushtetues individual duhet të ketë në përmbajtje të tij pretendime për cenimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese ose konventore.
313. Këtu është rasti për t’u përmendur sërish se me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, kompetenca lëndore e Gjykatës është zgjeruar lidhur me ankimin kushtetues individual, duke përfshirë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të individit. Duke ndjekur këtë zhvillim të rëndësishëm normativ, jurisprudenca e Gjykatës, e cila më parë përmbante vetëm raste për të drejtat procedurale nën suazën e procesit të rregullt ligjor, tashmë është pasuruar me raste mbi të drejtat substanciale, siç janë e drejta e pronës private (neni 41 i Kushtetutës)³²³, liria personale (neni 27 i Kushtetutës³²⁴); e drejta e votës (neni 45 i Kushtetutës)³²⁵; e drejta e jetës private (nenet 35, 36 dhe 37 të Kushtetutës)³²⁶, e drejta për pension (neni 52 i Kushtetutës)³²⁷, e drejta për punë dhe e drejta për arsim (nenet 49 dhe 57 të Kushtetutës)³²⁸ apo e drejta e jetës (neni 21 i Kushtetutës)³²⁹.

320 Shih vendimet nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 8, datë 23.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

321 Neni 5 i Kushtetutës.

322 Neni 17 i Kushtetutës.

323 Shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

324 Shih vendimet nr. 19, datë 04.04.2023; nr. 4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

325 Shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

326 Shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

327 Shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 81, datë 18.12.2017; nr. 33, datë 24.06.2010; nr. 9, datë 26.02.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

328 Shih vendimin nr. 1, datë 25.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

329 Shih vendimin nr. 42, datë 29.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

314. Neni 131, shkronja "a" i Kushtetutës parashikon se Gjykata vendos për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Për rrjedhojë, mund të nxirret përfundimi se kur objekt i ankimit kushtetues individual është akti normativ, kontrolli kushtetues shtrihet edhe në raport me marrëveshjet ndërkombëtare, nëse këto të fundit marrin në mbrojtje të drejta të njeriut të garantuara njëkohësisht edhe nga Kushtetuta, por gjithnjë duke mbajtur parasysh parimin themelor të sanksionuar në nenin 5 të Kushtetutës, sipas të cilit Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.
315. Sa më lart, nëse e drejta e pretenduar si e cenuar nuk gjen mbrojtje në katalogun e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, KEDNJ ose marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, Gjykata nuk ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual (shih *supra* paragrafin 49). Pavarësisht kësaj kur ajo përcakton kuptimin e koncepteve të Kushtetutës, pra të drejtave dhe lirive të sanksionura në të, Gjykata, nëse është rasti mund dhe duhet të marrë parasysh elementet e së drejtës ndërkombëtare.
316. Në këtë mënyrë, pjesa më e madhe e vendimeve të moskalimit në seancë plenare për shkak të moslegjitimitit *ratione materiae* të individit lidhen me kufijtë e fushës së zbatimit të neneve të Kushtetutës, që parashikojnë të drejtat dhe liritë themelore të individit. Edhe pse në pamje të parë, duket një çështje juridike e thjeshtë, në praktikë rezulton e kundërta. Janë disa faktorë që ndikojnë në këtë drejtim, të cilat lidhen me mungesën e kulturës së nevojshme juridike në përpilimin e ankimit kushtetues individual, por edhe me ndryshimet kushtetuese, që zgjeruan kompetencën e Gjykatës për shqyrtimin e ankimeve individuale për të gjitha liritë dhe të drejtat themelore.
317. Për të plotësuar kriterin "pretendimet e kërkuarit të hyjnë në kompetencën lëndore të Gjykatës dhe të merren në shqyrtim prej saj", është e domosdoshme që parashtrimet e paraqitura prej individit të mos bazohen mbi argumenta të përgjithshme, por të përcaktojnë në mënyrë të qartë faktet e çështjes së tij dhe lidhja që ato kanë me të drejtat dhe liritë themelore që pretendohen se janë cenuar, pra që pretendimet të jenë të ngritura në nivel kushtetues.³³⁰
318. Po ashtu, është e rëndësishme që kur individi i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues, duhet të sigurohet që faktet e çështjes së tij tregojnë cenimin e një të drejte kushtetuese, që do të thotë se jo çdo vendim gjyqësor apo akt i pushtetit publik, që është në disfavor të tij lidhet automatikisht me një të drejtë kushtetuese. Për ta ilustruar, një avokat u dënua me 10 000 lekë gjobë gjatë një procesi gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me arsyetimin se kishte abuzuar me të drejtën për të kërkuar përjashtimin e gjyqtarit të çështjes së tij. Ai u ankua në Gjykatë duke pretenduar se në caktimin e gjobës i ishte cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Gjykata arriti në përfundimin se kërkuari nuk legjitimohej *ratione materiae* për kërkimet e tij, duke arsyetuar se vendimi që kishte caktuar gjobën ndaj kërkuarit nuk hyn në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës. Bazuar në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe argumenteve të paraqitura nga kërkuari, natyrën e gjobës, qëllimin për të cilin ajo është vendosur, dhe kryesisht masën e saj, Gjykata në të njëjtën linjë me qëndrimin e GJEDNJ-së³³¹, vlerësoi se caktimi i gjobës nuk kishte prekur apo ndërhyrë në të drejtat kushtetuese të kërkuarit³³².
319. Mund të ndodhë që juridikisht individi faktet e paraqitura t'i cilësojë në mënyrë të pasaktë nga pikëpamja kushtetuese, në kuptimin që t'ia bashkangjisë ato një të drejte apo lirie të pasaktë.

330 Shih vendimet nr. 9, datë 23.02.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

331 Shih vendimet Žugić kundër Kroacisë, nr.3699/08, datë 31.05.2011, § 63; Gestur Jónsson dhe Ragnar Halldór Hall kundër Islandës [DhM], nr. nr. 68273/14 dhe 68271/14, datë 22.12.2020, §§ 81 dhe 89; dhe Adil Aktay kundër Turqisë, nr. 56064/16, datë 09.01.2024, § 45

332 Shih vendimin nr. 22, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese

Megjithatë kjo pasaktësi e individit, gjithmonë me kushtin që argumentet të jenë paraqitur në mënyrë konkrete, nuk e pengon shqyrtimin e pretendimeve. Në vlerësimin nëse përmbajtja e pretendimeve ka natyrë kushtetuese, pra nëse ato bien në kompetencën e Gjykatës, kjo e fundit ka theksuar se, bazuar në parimin *iura novit curia* (shih *supra* paragrafin 45), ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar kushtetuese, që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi³³³. Kjo do të thotë se për të përmbushur kriterin *ratione materiae* është e mjaftueshme që individit të parashtrorë argumentet thelbësore që bazon pretendimet e tij dhe Gjykata vlerëson *ex officio* nëse ato bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, të ndryshme nga ajo e referuar nga kërkuesi.

320. Zbatimi i parimit *iura novit curia* mund të ilustruhet me *dyraste praktike*. Kështu, dy ekspertë kontabël të autorizuar kishin kryer një ekspertim në një çështje penale, sipas detyrave të caktuara nga gjykata e apelit. Më pas, ata ngritën padi kundër gjykatës së apelit, me objekt detyrimin e shpërblimit për punën e kryer. Ndonëse padia e tyre u pranua në shkallë të parë, gjykata e apelit vendosi rrëzimin e padisë, me arsyetimin se marrëdhënia juridike nuk ishte e natyrës civile. Vendimi i saj u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë. Ata iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar se gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kishin gabuar në përcaktimin e natyrës së marrëdhënies juridike dhe se nuk i kishin dhënë zgjidhje mosmarrëveshjes. Gjykata vlerësoi se pavarësisht nga mënyra e formulimit të kërkesës, pretendimet e kërkuesit, bazuar në parimin *iura novit curiae* duhet të trajtoheshin në këndvështrimin e respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.³³⁴ Në një rast tjetër, kërkuesi pretendoi se Gjykata Administrative e Apelit nuk e kishte njoftuar për gjykimin e çështjes dhe se Gjykata e Lartë e shqyrtoi çështjen në mungesë të palëve, pa i njoftuar për datën dhe orën e gjykimit. Gjykata vlerësoi t'i trajtonte këto pretendime në këndvështrimin e respektimit të së drejtës së aksesit në gjykatë.³³⁵
321. Duhet vënë re se parimi *iura novit curiae* ka lidhje vetëm me cilësimin juridik të fakteve, që do të thotë se Gjykata nuk mundet me nismën e saj të ndryshojë faktet. Me fjalë të thjeshta, nëse individit ka paraqitur pretendime me natyrë ligjore, duke parashtruar argumente për të drejtat që merren në mbrojtje nga ligji dhe jo Kushtetuta, Gjykata nuk mundet që me nismën e saj t'i ngrejë ato në nivel kushtetues.
322. Në praktikën e Gjykatës çështja më e diskutuar nën kriterin *ratione materiae*, në rastet kur individët kanë kundërshtuar vendimet gjyqësore, ka qenë interpretimi i ligjit dhe vlerësimi i provave. Në këtë drejtim në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që Gjykata ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave³³⁶.
323. Në fakt juridiksioni i Gjykatës në fushën e garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor është një temë shumë e diskutuar. Jo pak herë Gjykata është "kritikuar" se ndërhyr në kompetencën

333 Shih vendimet nr. 27, datë 09.05.2012; nr. 27, datë 19.05.2016; nr. 5, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

334 Shih vendimin nr. 25, datë 10.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

335 Shih vendimin nr. 48, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

336 Shih vendimet nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

e Gjykatës së Lartë, duke u konsideruar si një gjykatë “rishikimi”.³³⁷ Pikërisht për shkak të këtyre kritikave, jurisprudencës kushtetuese i është dashur të përcaktojë një vijë kufiri gjithmonë e më të saktë, edhe pse në fakt kufiri është tepër delikat. Në këto përpjekje, Gjykata është bazuar edhe në rezultatet e arritura nga gjykatat homologe dhe nga GJEDNJ-ja.

324. Kështu në vitin 2005, Gjykata theksoi se pretendimet e parashtruara si në Gjykatën e Lartë ashtu edhe në ankimin kushtetues, janë të rëndësishme për verifikimin e kushtetutshmërisë së procesit të zhvilluar në gjykatat e zakonshme. Gjykata e Lartë duhet të investojë në ekzaminimin e tyre dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to, sepse kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131, pika 1, shkronja f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do t'a kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj³³⁸. Në këtë vendim edhe pse Gjykata ka pranuar kërkesën e individit, nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e tij për cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, “duke ia lënë” këtë kompetencë Gjykatës së Lartë.
325. Ndërsa kur Gjykatës Kushtetuese i është dashur të rivlerësojë provat, që në vendimet e para të saj, ajo është shprehur se ajo “nuk shqyrton mënyrën e vlerësimit dhe as nuk bën analizën e provave të administruara në proceset gjyqësore, pasi ato janë çështje që u përkasin gjykatave të zakonshme, gjykimi i të cilave nuk i përshatet dhe nuk mund të jetë i njëjtë me mënyrën e zhvillimit të një gjykimi tepër të veçantë, siç është gjykimi kushtetues”.³³⁹
326. Në këtë aspekt, Gjykata Kushtetuese që përpara ndryshimeve të vitit 2016, ka theksuar se, për çështje që kanë të bëjnë me kërkesa të individëve për shkelje të të drejtave të parashikuara në Kushtetutë, kontrolli kushtetues përqëndrohet vetëm në respektimin e parimeve për të garantuar një proces të rregullt ligjor dhe nuk i hyn analizës së provave dhe zgjidhjes së çështjes në themel.³⁴⁰
327. Edhe kur kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë një procesi penal, i kanë mbështetur vendimet vetëm në mendime personale të disa personave të thirrur me cilësinë e dëshmitarëve, Gjykata u shpreh se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm “thënie e një numri personash të pyetur me cilësinë e dëshmitarit i kanë vlerësuar si burim provash e indicjesh, të cilat në tërësinë e tyre u kanë shërbyer për të krijuar bindje për çështjen konkrete dhe për vendimet e marra. Nëse ky vlerësim është ose jo i drejtë e i bazuar, kjo është çështje e vetë gjykatave dhe nuk mund të përbëjë objekt kontrolli për Gjykata Kushtetuese. Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët e mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por kurrësesi jo për mënyrën e vlerësimit të këtyre provave. Kjo për faktin se kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete”.³⁴¹
328. Kur kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor sepse gjykatat e zakonshme nuk kanë dëgjuar dëshmitarë dhe ekspertë, të cilët sipas tij kanë patur rëndësi për sqarimin e rrethanave dhe të fakteve, Gjykata Kushtetuese në një kohë relativisht të hershme ka pohuar se “mbetet detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të vlerësuar në kuadrin e të

337 Shih vendimet nr. 5, datë 07.02.2001; nr. 20, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

338 Shih vendimin nr. 41, datë 29.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese

339 Shih vendimin nr. 7, datë 28.02.2000 të Gjykatës Kushtetuese.

340 Shih vendimin nr. 90, datë 25.07.2001 të Gjykatës Kushtetuese.

341 Shih vendimin nr. 95, datë 27.07.2001 të Gjykatës Kushtetuese.

gjithë provave të tjera rëndësinë e marrjes ose jo të tyre. Në pozicionin që mban Gjykata Kushtetuese në raport me gjykatat e zakonshme, konkludon se një pretendim i tillë i kërkuesit që ka të bëjë me mënyrën e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave, të cilat i përkasin problemeve që lidhen me themelin e çështjes, nuk përbën juridiksion kushtetues³⁴².

329. Duke përmbledhur parimet ut supra të evidentuara, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se "interpretimi i ligjit material e procedural, si dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues".³⁴³
330. Përpara reformës të vitit 2016 për vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të ankimit kushtetues individual, Gjykata ka vlerësuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këtë mënyrë Gjykata i ka shqyrtuar *ratione materiae* pretendime të këtij lloji.
331. Kështu, në një rast të marrë në shqyrtim nga Gjykata, kërkuesi pretendonte cenimin e parimit të gjësë së gjykuar pasi ishte ekstraduar për të njëjtën vepër penale, për të cilën gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ishin shprehur më parë me vendim, duke refuzuar kërkesën për ekstradim. Ky pretendim me natyrë kushtetuese edhe pse i ngritur në rekurs nuk kishte marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë, arsye për të cilën Gjykata konstatoi cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit.³⁴⁴ Ishte pikërisht natyra kushtetuese e pretendimit, e cila përcaktoi kompetencën lëndore të Gjykatës dhe shqyrtimin e këtij pretendimi prej saj.
332. Edhe në një tjetër vendim,³⁴⁵ Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë nuk i kishte analizuar pretendimet e ngritura nga kërkuesja në shkaqet e rekursit, edhe pse ato kishin rëndësi në përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, duke ngritur dyshime për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Prandaj Gjykata vlerësoi se ky pretendim i kërkueses hyn *ratione materiae* në kompetencën e saj.
333. Nga ana tjetër, sikurse u theksua më lart, Gjykata ka pohuar se mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatave të zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit që vë në lëvizje këtë Gjykatë, në kuptimin që procesi në tërësinë e tij rezulton haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar.³⁴⁶
334. Kështu në një vendim³⁴⁷ të saj të fundit, Gjykata ka konstatuar se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë dhe Gjykata Administrative e Apelit kanë interpretuar dhe zbatuar në mënyra diametralisht të kundërta dispozitat ligjore të ligjit për shpronësimin. Pavarësisht këtij fakti, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka konsideruar këto pretendime të subjektit të shpronësuar si çështje të vlerësimit të provave, edhe pse ato, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit që parashikon mënyrën e njoftimit të individëve për aktin e pushtetit publik për shpronësim (njoftim individual ose nëpërmjet publikimit), prej të cilit varet edhe momenti i fillimit të afatit të ankimit në gjykatë. Gjykata arriti në përfundimin se Gjykata e Lartë duhej të mbante një qëndrim në lidhje me këtë

³⁴² Shih vendimet nr. 205, datë 24.12.2001 dhe nr. 93, datë 13.05.2002 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁴³ Shih vendimet në vendimet nr. 23, datë 17.05.2010; nr. 45, datë 10.10.2010; nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁴⁴ Shih vendimin nr. 6, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁴⁵ Shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁴⁶ Shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

³⁴⁷ Shih vendimin nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

interpretim të bërë nga gjykatat më të ulëta dhe të ushtronte funksionin e saj subsidiar, duke i dhënë përgjigje të arsyetuar subjektit të shpronësuar për pretendimin e tij, duke e konsideruar arsyetimin e vendimit të pamjaftueshëm. Edhe në këtë rast ishte natyra kushtetuese e pretendimit ajo që përcaktoi shqyrtimin *ratione materiae* të pretendimit të kërkuesit.

335. Edhe kur parashikimet ligjore nuk janë zbatuar nga Gjykata e Lartë në nivel të mjaftueshëm qartësie dhe ato lidhen me cenimin e parimeve kushtetuese, Gjykata i ka marrë në shqyrtim *ratione materiae* pretendimet e kërkuesit. Kështu në rastin kur Gjykata e Lartë ka vendosur se ndaj vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs sepse vlera monetare e njohur në dispozitivin e gjykatës së apelit është më e vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi (neni 56, shkronja "ç" të Ligjit të Gjykatave Administrative), duke mos iu referuar vlerës së mosmarrëveshjes së përcaktuar nga objekti i saj (neni 61, paragrafi 1 i KPC-së), Gjykata ka pohuar se mënyra e zbatimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, në dukje është e paarsyetuar dhe ka vendosur ndaj kërkuesit një barrë joproporcionale, e cila nuk respekton në këtë mënyrë balancën e drejtë dhe të nevojshme midis qëllimit legjitim për të garantuar respektimin e kushteve formale për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, nga njëra anë, dhe së drejtës për t'iu drejtuar asaj gjykate, nga ana tjetër.³⁴⁸
336. Edhe kërkesat për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, pavarësisht mjetit të ri përshpejtues/parandalues të parashikuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, hyjnë në kompetencën lëndore të Gjykatës. Efektiviteti i këtyre mjeteve të reja është marrë në analizë edhe nga GJEDNJ-ja³⁴⁹ dhe bazuar në analizën e saj, Gjykata Kushtetuese u shpreh se "*mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së në parim janë efektive. Për sa i takon efektivitetit të tyre në praktikë, Gjykata vlerëson se duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në këtë aspekt, ajo mban në konsideratë edhe faktin se për zbatimin e mjeteve juridike të parashikuara nga KPC-ja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nuk ka ende një qëndrim të konsoliduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se janë mjete relativisht të reja*".³⁵⁰ Po në këtë aspekt Gjykata vuri në dukje se "*gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe t'i shqyrtojnë këto kërkesa me përparësi, përndryshe ky mjet juridik do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi. Gjykatat [e zakonshme], në shqyrtimin e këtyre kërkesave, duhet të kenë parasysh kritere të tilla, si: lloji i së drejtës objekt kërkimi dhe natyra e çështjes së themelit për të cilën kërkohet përshpejtimi, dëmi i mundshëm që mund t'i vijë kërkuesit, kohëzgjatja e çështjes në shkallë të zakonshme të gjyqimit, organizimi i brendshëm i punës në gjykatë, si dhe çdo kriter tjetër i rëndësishëm, me qëllim që të mos cenohet thelbi i së drejtës*".³⁵¹
337. Kur ankimi kushtetues individual ka për objekt kundërshtimin e aktit normativ, në lidhje me kriterin *ratione materiae* kërkuesi duhet të pretendojë papërputhshmërinë e tij me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se papajtueshmëria midis dispozitave të ligjeve të ndryshme, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronjat "a" dhe "c", të Kushtetutës, nuk hyn në juridiksionin e saj. Gjykata ka evidentuar se nuk është detyrë e saj shqyrtimi i përplasjeve dhe papajtueshmërive mes dy ligjeve të ndryshme ose ligjeve dhe kodeve. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së

348 Shih vendimin nr. 23, datë 25.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

349 Shih vendimin *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, cituar më lart. Pavarësisht kësaj, GJEDNJ-ja është shprehur se qëndrimi i saj në këtë vendim mund të bëhet objekt rishikimi në të ardhmen, në varësi të kapaciteteve të gjykatave vendase për të zhvilluar dhe mbajtur një jurisprudencë të qëndrueshme për zbatimin e mjetit juridik, në përputhje me kriteret e KEDNJ-së (§ 120).

350 Shih vendimet nr. 33, 34 dhe 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

351 *Ibid.*

drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër, *lex superior derogat inferiori*. Ndërsa në rastin e normave me të njëjtën fuqi juridike, zbatohen parimet, sipas të cilave norma e posaçme ka epërsi ndaj normës së përgjithshme (*lex specialis derogat generali*) dhe se norma që ka hyrë në fuqi më vonë ka përparësi nga norma e mëparshme. Në këtë kuptim, mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata.³⁵²

338. Në praktikë ka ndodhur që Gjykatës i është kërkuar të shprehet edhe për pajtueshmërinë me Kushtetutën të akteve normative të shfuqizuara. Për këtë, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se, si rregull, normat juridike i nënshtrohen kontrollit kushtetues nëse janë në fuqi në kohën e kontrollit ose, e thënë ndryshe, nëse janë akte të vlefshme që prodhojnë pasojë juridike.³⁵³ Përrjashtimisht, kontrollit kushtetues i nënshtrohen edhe normat juridike të shfuqizuara, kur këto, si pjesë e së drejtës pozitive, duhet të zbatohen për rregullimin e pasojave juridike që zgjasin në kohë dhe janë të lidhura me ekzekutimin periodik ose me afat të detyrimeve juridike civile që rrjedhin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën e ligjit të shfuqizuar.³⁵⁴ Të njëjtin qëndrim ritheksoi Gjykata edhe kur objekt i ankimit kushtetues individual ishte urdhri i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që parashikonte vetëkarantinimin e detyrueshëm për një periudhë 14-ditore për të gjithë shtetasit që hynin në Republikën e Shqipërisë përmes rrugëve ajrore, tokësore ose detare nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia, nga data 20.04.2021 deri në datën 03.05.2021, i cili i kishte përfunduar efektet e tij para paraqitjes së kërkesës në Gjykatë. Ky urdhër, sipas kërkuësës, e kishte bërë të pamundur për ata shtetas ushtrimin e së drejtës së votës në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, duke parashikuar karantinimin e detyrueshëm.
339. Gjykata në atë rast konstatoi se urdhri i kundërshtuar nuk zbatohet për rregullimin e pasojave juridike që kishin zgjatur në kohë dhe as nuk ishte i lidhur me ekzekutimin periodik ose me afatin e detyrimeve juridike civile që rridhnin nga marrëdhënie juridike të krijuara në kohën kur ai ishte në fuqi. Nga ana tjetër, Gjykata çmoi se nuk mund të gjente zbatim as neni 51, pika 2 i Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit kur një ligj ose akt normativ, ose pjesë të tij, që janë objekt shqyrtimi para Gjykatës, shfuqizohen ose ndryshohen para se ajo të marrë vendim, gjykimi pushohet, me përjashtim të rasteve kur ajo çmon se gjykimi duhet të vazhdojë për shkak të një interesi publik ose shtetëror. Ndonëse e drejta e votës të shtetasve shqiptarë me banim jashtë vendit mbart në vetvete interesin publik, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet në rastin konkret, për sa kohë që urdhri i kundërshtuar i kishte pushuar efektet e tij përpara se kërkesa të paraqitej në Gjykatë.³⁵⁵

2.4.2 Bazueshmëria *prima facie* e pretendimeve

340. Sipas nenit 31/a, pika 2, shkronja e) të Ligjit Organik të Gjykatës, Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare kur kërkesa është haptazi e pabazuar. Kjo hipotezë përfshin rastet kur pretendimet janë dukshëm të pasakta, lidhur me faktet ose të drejtat kushtetuese. Ajo mundëson që gjykimi kushtetues të vihet në lëvizje vetëm për çështje që kanë thelb kushtetues, duke skualifikuar ankimet e paarsyeshme dhe abuzive. Është e rëndësishme të

352 Shih vendimet nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 9, datë 01.03.2021; nr. 5, datë 05.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

353 Shih vendimin nr. 9, datë 19.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

354 Shih vendimet nr. 8, datë 07.02.2017; nr. 2, datë 31.01.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

355 Shih vendimin nr. 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

vihet re që bëhet fjalë për situata të dukshme, pra që nuk kanë nevojë për shqyrtim të thelluar dhe as për debat gjyqësor, pra që lejon marrjen e vendimit të moskalimit në fazën e shqyrtimit paraprak.

341. Për të ilustruar këtë hipotezë mund të shërbejnë dy raste praktike. Në rastin e parë, kërkuesi paraqiti kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar procedimin penal të një gjyqtareje dhe një sekretareje gjyqësore, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Prokurorja e çështjes vendosi mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se mungonin elementet e veprës penale. Ky vendim u kundërshtua në të gjitha shkallët e gjykimit, ku u vendos rrëzimi i kërkesës. Kërkuesi, në ankimin kushtetues individual pretendoi se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kishin vendosur në kundërshtim me provat që u ishin vënë në dispozicion, siç ishin kërkesa e gjyqtarës për heqjen dorë nga gjykimi, mospërdorimi i sistemit të regjistrimit audio, teksti i vendimit të gjyqtarës, shkresa e një gjyqtari tjetër dhe komunikimi i kërkuesit me një gjyqtare tjetër, ku tregohet adresa e kërkuesit. Kolegji i Gjykatës në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, vërejtë se kërkuesi nuk kishte identifikuar ndonjë të drejtë ose liri themelore të cenuar nga vendimet gjyqësore, por thjesht kishte parashtruar se prokuroria dhe më pas gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në kundërshtim me provat e vëna në dispozicion prej tij, kishin nxjerrë përfundimin se vepra penale e kallëzuar nuk ekzistonte. Për pasojë, Kolegji arriti në përfundimin se kërkuesi nuk legjitimohej *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij, në thelb, kishin të bënin me vlerësimin e fakteve dhe provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndaj ato nuk mund të merreshin në shqyrtim.³⁵⁶
342. Në rastin e dytë, një individ të arrestuar në flagrancë për kryerjen e veprës penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, pas vleftësimit të arrestit në flagrancë, iu caktua masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” nga gjykata e shkallës së parë. Ai e kundërshtoi masën në gjykatat më të larta, por pa sukses. Në këto rrethana, kërkuesi paraqiti ankim kushtetues individual duke pretenduar se i ishte cenuar e drejta e jetës familjare, pasi sipas tij ai ishte shoqëruar në komisariat dhe për shkak se kishte refuzuar prangat, ishte mbajtur në izolim në kushte të vështira, ku nuk iu lejua komunikimi me mbrojtësin e zgjedhur sipas ligjit dhe iu tejkaluan afatet. Kolegji i Gjykatës vërejtë se pretendimet e tij ishin sintetike (të përpiluara me shkrim dore në vetëm një faqe), të paqarta dhe të formuluara në mënyrë të përgjithshme. Në përmbajtje të tyre, teksa mungonin çështjet kushtetuese që lidheshin me caktimin e masës së sigurimit, paraqiteshin fakte të hershme në kohë, që nuk lidheshin me ngjarjen për të cilën ishte i dyshuar, kërkohej mbrojtja e jetës së çdo shqiptari jashtë dhe brenda kufijve, ndërsa një pjesë e pretendimeve lidhej me gjykimin në themel të akuzës - kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik, i cili nuk rezultonte të ishte bërë përfundimtar. Prandaj Kolegji çmoi se kërkesa është haptazi e pabazuar.³⁵⁷

2.5.3 Res judicata

343. Në të drejtën kushtetuese parimi *res judicata* njihet si një nga tri format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal procedural “gjë e gjykuar” nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë detyruese të vendimit. Tipar karakteristik

³⁵⁶ Shih vendimin nr. 83, datë 18.04.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

³⁵⁷ Shih vendimin nr. 147, datë 05.07.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur Gjykata nuk është shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me Kushtetutën të normës juridike, kërkuesi nuk ndalohej të paraqesë përsëri të njëjtën kërkesë (duke respektuar afatin për paraqitjen e saj) për kontrollin e pajtueshmërisë së kësaj norme me Kushtetutën. Kjo varet nga pjesa arsyetuese e vendimit, sepse rrëzimi i kërkesës mund të jetë vendosur për shkaqe të tjera.³⁵⁸

344. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje.³⁵⁹
345. Bazuar në këto standarde kur objekt i ankimit kushtetues individual janë kërkime të cilat kanë qenë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës, kjo e fundit ka vlerësuar se nuk mund t'i rishqyrtojë ato, përveç rastit kur paraqiten shkaqe të reja. Në rastet kur individët i janë drejtuar Gjykatës për kontrollin e kushtetutshmërisë së disa dispozitave të Ligjit të Pronave, të cilat ishin marrë më parë në shqyrtim prej saj, Gjykata vlerësoi se ato kishin të njëjtën natyrë me ato të marra në shqyrtim prej saj, prandaj vendosi moslegjitimitimin *ratione materiae të kërkuesve*.³⁶⁰

2.5.4. Rivendosja e së drejtës së shkelur të individit

346. Një koment meriton edhe dispozita, gjithashtu e shtuar me ndryshimet ligjore të vitit 2016, sipas së cilës ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur kjo “do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit”³⁶¹.
347. Formulimi në pamje të parë krijon paqartësi në drejtim të përsëritjes së panevojshme të fjalëve “rivendosje në vend” dhe të gjerësisë së konceptit “e drejtë e shkelur”, që tejkalon të drejtat kushtetuese dhe nuk përmend liritë themelore. Në parim, kur akti i pushtetit publik ose vendimi gjyqësor shkel një të drejtë ose liri themelore, atëherë ai është të paktën i paligjshëm, ndaj duke iu referuar nenit 44 të Kushtetutës, që parashikon të drejtën e rehabilitimit dhe/ose të zhdëmtimit, mund të nxirret përfundimi se e drejta e shkelur rivendoset me anë të: (i) rehabilitimit përmes rikthimit zyrtarisht të të drejtës ose lirisë së humbur; ose (ii) zhdëmtimit përmes shpërblimit zyrtarisht për dëmin e pësuar (dëm pasuror ose jopasuror). Me fjalë të tjera, kur haptazi nuk ekziston ndonjë prej këtyre dy mundësive, atëherë ankimi kushtetues nuk duhet të kalojë për shqyrtim në themel.
348. Në këtë këndvështrim, ky kriter bazohet në parimin *restitutio in integrum*, sipas të cilit kur gjykimi kushtetues konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive themelore, atëherë organet shtetërore, sipas roleve dhe funksioneve të tyre, janë të detyruara t'i japin fund shkeljes dhe të rregullojnë pasojat e saj në atë mënyrë që siguron sa më shumë të jetë e mundur rikthimin e situatës që ekzistonte përpara shkeljes. Ky është një detyrim i drejtpërdrejtë kushtetues që buron nga parimet themelore të sanksionuara në nenet 3 dhe 15 të Kushtetutës. Sipas tyre, të drejtat dhe liritë e njeriut janë pjesë e bazës së shtetit, i cili ka për detyrë t'i mbrojë dhe respektojë ato (neni 3), ndërsa organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet t'i respektojnë ato dhe të kontribuojnë për realizimin e tyre (neni 15).

358 Shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

359 Shih vendimin nr. 2, datë 11.02.2021 i Gjykatës Kushtetuese.

360 Shih vendimet nr. 44, 45, 46 dhe 47 datë 18.03.2021 të Mbledhjes së Gjykatës Kushtetuese.

361 Neni 71/a, pika 1, shkronja ç i Ligjit Organik të Gjykatës.

349. Po ashtu, vetë Gjykata përmes kontrollit kushtetues dhe organet e tjera shtetërore të përfshira, janë të detyruara të veprojnë në këtë drejtim edhe bazuar në kërkesat e KEDNJ-së dhe natyrën subsidiare të mbrojtjes që ajo ofron. Në këtë kuptim, Republika e Shqipërisë, si çdo shtet anëtar i Konventës, përmes institucioneve të saj, duhet të sigurojë që individit ka në dispozicion mjetet e duhura dhe nëse ato dështojnë, atëherë vepron GJEDNJ-ja, e cila përcakton detyrime konkrete për institucionet, përfshi edhe të drejtën e shpërblimit financiar të individit³⁶².
350. Rastet në të cilat gjyqtarët kushtetues, përmes vendimeve të tyre, janë në gjendje të rivendosin të drejtën e shkelur, në substancë kanë të bëjnë, nga njëra anë, me shfuqizimin e aktit normativ dhe/ose administrativ, dhe, nga ana tjetër, me shfuqizimin e vendimit gjyqësor dhe kthimin e çështjes për shqyrtim normalisht në shkallën e gjyqimit (të zakonshëm) në të cilën është kryer shkelja.
351. Bëhet fjalë për një kriter shtesë të pranueshmërisë së ankimit, i cili ka të bëjë me themelin e tij, pra me lirinë ose të drejtën themelore të shkelur, që do të thotë se është i lidhur me juridiksionin *ratione materiae* të Gjykatës. Ai shërben për të skualifikuar që në fazën paraprake ankimet individuale të cilat bazohen në një shkelje jo thelbësore në veprimtarinë e organit publik ose gjykatave, e cila nuk ndikon drejtpërdrejt ose në mënyrë të rëndësishme në të drejtat themelore të individit.
352. Gjykata në praktikën e saj të mëparshme i është referuar këtij kriteri për rrëzimin e ankimeve kushtetuese për proces të rregullt ligjor, duke u shprehur se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues dhe se ndikim të drejtpërdrejt në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit³⁶³.
353. Një kriter të ngjashëm parashikon edhe neni 35 i KEDNJ-së për ankimet drejtuar GJEDNJ-së, i formuluar në përmbajtje si “mungesa e disavantazhit domethënës”. Ai është shtuar me Protokollin nr. 14, hyrë në fuqi më 1 qershor 2010, për t’iu përgjigjur situatës së ngarkesës në rritje të GJEDNJ-së, duke lejuar që ajo të refuzonte çështjet e konsideruar si të “vogla” bazuar në parimin se gjyqtarët nuk duhet të merren me çështje të tilla (“*de minimis non curat praetor*”)³⁶⁴.
354. Një pjesë e doktrinës e ka vlerësuar këtë kriter të ri si të përshtatshëm, me argumentin se ai përbën një faktor në zvogëlimin e numrit të kërkesave të pasuksesshme në Gjykatë, dhe për këtë arsye në lehtësimin e punës së saj, duke e bërë kështu ndërhyrjen e saj më efektive në shqyrtimin e çështjeve kushtetuese me të vërtetë të rëndësishme³⁶⁵ dhe si të tilla të denja për vëmendje.
355. Së fundmi, duhet evidentuar se për këtë kriter paraprak relativisht të ri, jurisprudenca e kushtetuese është ende e pakonsoliduar. Në disa raste, Gjykata ka vendosur rrëzimin e ankimit, për shkak të ndarjes së qëndrimeve të gjyqtarëve³⁶⁶ mbi kuptimin e kriterit paraprak të rivendosjes së të drejtës së shkelur kur ankuesi pretendonte cenimin e të drejtave themelore në procedurat e promovimit të gjyqtarëve, të cilat në kohën e shqyrtimit të ankimit individual kishin përfunduar. Sipas njërit qëndrim, plotësimi i vendeve vakante ku ankuesi kishte konkuruar nuk mund të konsiderohet “pamundësi e rivendosjes së të drejtave kushtetuese” pasi cenimi i të drejtave dhe lirive themelore i shkakton dëm të vërtetë jo vetëm individit, por njëkohësisht edhe funksionimit normal të shtetit të

362 Shih A. Buyse, Lost and Regained? Restitution as a Remedy for Human Rights Violations in the Context of International Law, ZaöRV 68 (2008), 129-153

363 Shih vendimet nr. 13 datë 21.03.2023; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.05.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

364 Shih Guidën për pranueshmërinë e ankimeve në GJEDNJ, përditësuar në datën 31 gusht 2022, fq. 78-79 https://www.echr.coe.int/Documents/Admissibility_guide_ENG.pdf

365 A. Vorpsi, J. Bergmann, *vep. cit.*, fq. 113 e vijues.

366 Neni 73, pika 4 i Ligjit Organik të Gjykatës.

së drejtës, dëm i cili duhet të riparohet. Ndërsa sipas qëndrimit tjetër, plotësimi i vendeve vakante nuk rivendoste në vend të drejtat e shkelura të ankuesit, pasi nuk ekzistonte më mundësia për të shfuqizuar vendimet e kundërshtuara dhe "detyruar" organet të veprojnë në mënyrën më efektive për të rivendosur të drejtën kushtetuese³⁶⁷.

356. Në çdo rast, derisa të ketë një qëndrim të qartë dhe të konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje, duhet të besohet se individët nuk do të heqin dorë nga i vetmi instrument i brendshëm që garanton të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara me Kushtetutë.
357. Formulimi i këtij kriteri në pamje të parë përbën një avancim në krahasim me të kaluarën kur Gjykata, në rastet kur në shqyrtimin e çështjes kufizohej vetëm në konstatimin e shkeljes së të drejtës, ka dhënë vendime pa ndonjë efekt të dobishëm për kërkuesin³⁶⁸. Në lidhje me këtë, GJEDNJ-ja ka vërejtur se vetë gjykimi kushtetues rezulton të mos jetë (ose të paktën jo gjithmonë) një mjet efektiv, veçanërisht në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë dhe mosrespektimin e parimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjyqimit³⁶⁹.
358. Zgjedhja e ligjvënësit, megjithatë, nuk është pa kufizime. Së pari, mundësia e rivendosjes së të drejtës së shkelur është parashikuar si kriter seleksionues i ankimeve individuale, pra nuk i përgjigjet saktësisht problematikës së efektit të dobishëm të vendimmarrjes së Gjykatës për zgjidhjen në themel të çështjes kushtetuese. Së dyti, ligjvënësi mund të kishte zgjedhur t'i jepte Gjykatës Kushtetuese, sipas modelit të GJEDNJ-së, mundësinë për shpërblimin e dëmit, si një alternativë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.
359. Në gjendjen aktuale, mund të imagjinohet se Gjykata Kushtetuese, megjithëse e privuar nga kjo mundësi, mund të vazhdojë të marrë, sikurse në fazën para-reformës, të ashtuquajturat vendime "paralajmëruese"³⁷⁰, të cilat edhe pse nuk e rivendosin të drejtën e shkelur, nuk janë plotësisht *inutiliter data* duke pasur parasysh që, të paktën, ato kanë një vlerë dekurajuese, por edhe edukuese ndaj pushteteve publike që të mos kryejnë në të ardhmen veprime që nuk respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
360. Në përmbyllje të kriterëve paraprake për të ushtruar ankimin kushtetues individual, duhet përmendur se jurisprudenca kushtetuese gjithashtu do të duhet të përballet dhe me një problematikë tjetër, plotësisht të re dhe, si e tillë, e paprecedentë. Bëhet fjalë për shqyrtimin e mosveprimeve, për të cilat do të jetë e nevojshme përshtatja (aspak e lehtë) e kriterëve paraprake (interesi për të vepruar, shterimi i mjeteve, llogaritja e *dies a quo*, mundësia e rivendosjes së të drejtës së shkelur).

367 Shih vendimet nr. 4 datë 08.02.2023; nr. 26 datë 27.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

368 Shih vendimet n. 1, datë 21.01.2016, n. 6, datë 23.02.2016, n. 22, datë 20.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

369 Shih *supra*, footnote nr. 43.

370 Shih vendimin nr. 40, datë 18.07.2012. Gjykata Kushtetuese në këtë rast ka vlerësuar të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit edhe pse masa e sigurimit personal, të cilën ai kundërshtonte, ishte shuar gjatë procesit të themelimit, me qëllim respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut si dhe për të parandaluar shkeljen e tyre në të ardhmen.

Kreu III

Shqyrtimi paraprak i kërkesës

361. Procesi kushtetues nuk fillon me nismën e Gjykatës Kushtetuese³⁷¹, sado e rëndësishme të jetë një mosmarrëveshje kushtetuese. Ai fillon vetëm me kërkesë të subjekteve të legjitimuara për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues dhe derivat i këtij rregulli është edhe parimi i kufijve të shqyrtimit të çështjes, sipas të cilit Gjykata e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të paraqitura në kërkesë (shih supra paragrafët 46-48).
362. Çdo kërkesë ankimore e paraqitur në Gjykatën Kushtetuese i nënshtrohet një procesi paraprak kontrolli përmes të cilit verifikohet nëse përmbushen kriteret ligjore formale për pranimin e saj. Ky proces kryhet nga Kolegji dhe në raste specifike nga Mbledhja e Gjyqtarëve. Shqyrtimi paraprak është proces i domosdoshëm pasi në përfundim të tij vendoset nëse çështja do t'i nënshtrohet apo jo shqyrtimit të mëtejshëm në seancë plenare. Detyrimi për kryerjen e këtij procesi parashikohet në nenin 31 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe trajtohet më hollësisht në Rregulloren e Gjykatës.
363. Kërkesa ankimore shqyrtohet nga kolegji me tre gjyqtarë, njëri prej të cilëve është relatori i çështjes. Në rast se kërkesa është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është paraqitur nga subjekti legjitim, por nuk është e plotë për ndonjë arsye që nuk lidhet me kërkesat formale të parashikuara në nenin 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, Kolegji ia kthen kërkuarit për plotësim.³⁷² Në këtë rast, Kolegji jep arsyet pse e kthen, si dhe cakton afat për plotësimet e nevojshme. Në praktikë, Kolegji ka kthyer kërkesat për plotësimin e aktit të përfaqësimit³⁷³, për legjitimitimin e tij *ratione temporis*³⁷⁴, si dhe për justifikimin e interesit për paraqitjen e kërkesës³⁷⁵. Vlen gjithashtu për t'u përmendur se kthimi për plotësim tashmë bëhet me vendim të ndërmjetëm.
364. Nëse kërkuarisi nuk e paraqet kërkesën ankimore të plotësuar, çështja mbyllet dhe konsiderohet se ankimi kushtetues nuk është paraqitur. Në rast se kërkesa paraqitet përsëri brenda afatit të caktuar nga Kolegji, por e paplotësuar, Kolegji vendos moskalimin për gjykim në seancë plenare. Kur kërkesa ankimore, e plotësuar, paraqitet përsëri brenda afatit të caktuar, i njëjti Kolegj vijon me shqyrtimin e kërkesës, duke verifikuar një për një përmbushjen e kriterëve për pranueshmërinë e saj. Si datë e paraqitjes së kërkesës ankimore konsiderohet data e paraqitjes së saj për herë të parë në gjykatë.
365. Shqyrtimi paraprak i kërkesës ankimore duhet të kryhet brenda 3 muajve nga data e regjistrimit të saj³⁷⁶, afat i cili zbatohet edhe për ankimin kushtetues individual. Bëjnë përjashtim nga ky rregull rastet kur Ligji Organik i Gjykatës përcakton afate të tjera, por kjo nuk gjen zbatim për ankimin kushtetues individual, pasi ligji në këtë rast nuk parashikon ndonjë situatë përjashtimore të rregulluar ndryshe. Në llogaritjen e afatit tre mujor nuk përfshihen 40 ditët e lejes vjetore të

371 Përpara miratimit të Kushtetutës, Gjykata organizohej dhe funksiononte bazuar në ligjin kushtetues nr.7561, datë 29.04.1992, i cili në nenin 25 parashikonte se Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë ose edhe me nismën e saj. Ajo e ka përdorur edhe në praktikë procedurën e vënies në lëvizje me nismën e saj, shih për ilustrim vendimin nr. 4, datë 02.06.1995.

372 Neni 31, pika 2 i Ligjit Organik të Gjykatës.

373 Shih vendimet nr. 43, datë 06.02.2020, nr. 16, datë 17.01.2020 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

374 Me vendimin e datës 19.05.2023 Mbledhja e Gjyqtarëve ka vlerësuar se kërkesa duhet t'i kthehet kërkuarit për plotësim, me qëllim paraqitjen e provave lidhur me afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit, në kuptim të momentit të njohjes së kërkuarit me vendimin gjyqësor të kundërshtuar.

375 Shih vendimet nr. 80, datë 06.07.2022, nr. 74, datë 30.06.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

376 Neni 47 i Ligjit Organik të Gjykatës.

gjyqtarëve (e cila sipas ligjit merret gjatë periudhës gusht-shtator të çdo viti³⁷⁷), ditët e caktuara si afat për plotësimin e kërkesës ose ditët që shqyrtimi i çështjes është pezulluar³⁷⁸.

Seksioni 1

Rastet e moskalimit të çështjes në seancë plenare

366. Që një kërkesë ankimore të kalohet në seancë plenare, ajo duhet të plotësojë *bashkërisht* kriteret e mëposhtme³⁷⁹:
- a) kërkesa ankimore është paraqitur nga një subjekt që ka legjitimitet në kuptimin e individit titullar të drejtës ose lirisë themelore që kërkohet të mbrohet ose të autorizuarit prej tij. Në këtë kuptim, kërkuesi provon se ka interesin e duhur për t'a vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, në kuptimin që shkelja e të drejtës ose lirisë themelore t'i ketë ndodhur realisht dhe drejtpërdrejt atij (*ratione personae*);
 - b) kërkuesi ka shteruar mjetet juridike të ankimit të parashikuara nga legjislacioni në fuqi ose provon se ato nuk janë efektive në kuptimin që ankimi kushtetues të jetë mjeti i fundit. Kërkesa ankimore është paraqitur brenda afatit 4 mujor të parashikuar nga Ligji Organik i Gjykatës, afat i cili fillon të llogaritet nga momenti i konstatimit të cenimit (*ratione temporis*);
 - c) kërkimet e paraqitura në kërkesën ankimore përfshihen në juridiksionin kushtetues, në kuptim të nenit 131 të Kushtetutës, pra lënda e ankimit të lidhet me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutë ose në KEDNJ dhe protokollet e saj, si dhe që të mos jetë trajtuar më herët me vendim prej Gjykatës Kushtetuese. Shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste të drejtën e shkelur të individit, në kuptimin e efektivitetit të gjyqimit kushtetues në raport me rëndësinë e shkeljes. Po ashtu, pretendimet e ngritura në kërkesën ankimore nuk janë haptazi të pabazuara në kuptimin e ekzistencës së shkakut juridik, për të cilin ankuesi kërkon mbrojtje kushtetuese (*ratione materiae*).
367. Kriteret e mësipërme të lexuara në të kundërt nxjerrin përfundimin se kërkesa ankimore nuk pranohet dhe çështja nuk dërgohet për shqyrtim në seancë plenare, nëse vërtetohet qoftë edhe një prej rasteve në vijim³⁸⁰:
- a) objekti i kërkesës ankimore nuk përfshihet në kompetencën lëndore të Gjykatës Kushtetuese;
 - b) kërkesa ankimore nuk është paraqitur nga subjekti që ka legjitimitetin për t'iu drejtuar Gjykatës;
 - c) kërkesa ankimore është paraqitur nga një person i paautorizuar;
 - ç) kërkesa ankimore është paraqitur jashtë afatit ligjor 4 mujor;
 - d) kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive;
 - dh) legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive që nuk janë shfrytëzuar nga kërkuesi;
 - e) për kërkimet e paraqitura në kërkesën ankimore ka një vendim të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese;
 - ë) nuk është e mundur rivendosja e së drejtës së shkelur;

³⁷⁷ Neni 18/1/b i Ligjit Organik të Gjykatës.

³⁷⁸ Shih vendimin nr. 84, datë 30.04.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, ku evidentohet se shqyrtimi i çështjes u pezullua deri në shpalljen e vendimit përfundimtar të Gjykatës për një çështje tjetër, në të cilën ishin ngritur të njëjtat pretendime.

³⁷⁹ Neni 23, pika 1 e Rregullores së Gjykatës

³⁸⁰ Neni 31/a, pika 2 i Ligjit Organik të Gjykatës.

g) kërkesa është haptazi e pabazuar.

368. Rastet nga a – ë lidhen me kriteret për të ushtruar ankimin kushtetues individual, të cilat gjerësisht u trajtuan në kreun II të kësaj pjese. Sa i takon vlerësimin se çështja është haptazi e pabazuar, vlen të theksohet se Kolegji (ose Mbledhja e Gjyqtarëve) gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës, kryen një shqyrtim juridiko-formal të bazueshmërisë në themel të kërkesës, që siç e ka shpjeguar Gjykata³⁸¹, është një procedurë, në të cilën organi juridiksional nuk zhvillon hetim për përcaktimin e fakteve, pra nuk shqyrton dhe debaton provat me qëllim përcaktimin e fakteve dhe rrethanave. Kjo do të thotë se gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji apo Mbledhja e Gjyqtarëve analizon vetëm *prima facie* nëse pretendimet e paraqitura në ankimin kushtetues individual, në përmbajtjen e tyre i përmbushin apo jo kriteret për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Seksioni 2

Vendimmarrja e Kolegjit

369. Gjykata Kushtetuese funksionon me tri kolegje, secili prej të cilëve i përbërë nga tre anëtarë.³⁸² Caktimi i gjyqtarëve në kolegje bëhet çdo vit kalendarik, brenda datës 15 janar, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Në procesin e caktimit të gjyqtarëve në kolegje merret në konsideratë vjetërsia dhe ekspertiza profesionale e tyre. Vendimi i caktimit të gjyqtarëve në kolegje publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës³⁸³.
370. Kolegji kryesohet nga gjyqtari më i vjetër në detyrë, me përjashtim të Kolegjit ku bën pjesë Kryetari i Gjykatës. Ky kolegji drejtohet prej tij/saj, pavarësisht vjetërsisë në detyrë.
371. Kryesuesi i Kolegjit drejton dhe organizon punën dhe veprimtarinë e tij në përputhje me kërkesat e Ligjit Organik të Gjykatës dhe të Rregullores së saj.
372. Votimi në kolegji bazohet në parimin një anëtar një votë. Në rast se një nga gjyqtarët e Kolegjit nuk merr dot pjesë në Kolegji, sepse është dorëhequr, përjashtuar apo për shkaqe objektive, edhe nëse është relator i çështjes, zëvendësohet për atë rast nga një gjyqtar tjetër që caktohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve.
373. Mbledhja e Kolegjit, si rregull, zhvillohet çdo të premte, por mund të mblidhet sa herë çmohet e nevojshme, e arsyeshme dhe kërkohet nga anëtarët e tij.³⁸⁴ Të gjitha diskutimet e zhvilluara në Kolegji, përfshirë bisedimet e vendimmarrjes janë konfidenciale, pra zhvillohen në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e të tretëve. Gjyqtari relator, së bashku me këshilltarin ligjor që është caktuar për çështjen përkatëse, marrin masat për përgatitjen e saj për shqyrtimin paraprak. Përveç kërkesës ankimore, Kolegji shqyrton të gjithë dokumentacionin për çështjen, duke përfshirë projektvendimin dhe aktet e tjera të përgatitura nga këshilltari ligjor, sipas udhëzimeve të gjyqtarit relator. Të paktën dy ditë para mbledhjes së Kolegjit, gjyqtarët duhet të kenë në dispozicion kërkesën ankimore dhe dokumentacionin përkatës. Relatimi i çështjes në Kolegji bëhet nga gjyqtari relator.

381 Shin vendimin nr. 1, datë 23.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

382 Neni 31 i Ligjit Organik të Gjykatës dhe neni 22 i Rregullores.

383 Shih https://www.gjk.gov.al/web/Perberja_e_Kolegjeve_2177_1.php

384 Neni 24, pika 2 i Rregullores së Gjykatës.

374. Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës Kolegji vendos kalimin ose moskalimin e çështjes në seancë plenare. Vendimet e Kolegjit për kalimin apo moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare merren njëzëri³⁸⁵. Në rast se ndonjë nga gjyqtarët e Kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët (për kalimin ose moskalimin e çështjes në seancë plenare), çështja i përcillet për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve.³⁸⁶
375. Në rast se Kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare, ky vendim regjistrohet menjëherë në Regjistrin e Vendimeve të Moskalimit. Procesverbal i votimit dhe vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Kolegjit.
376. Sipas nenit 24 të Rregullores vendimi i Kolegjit për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare përmban këto elemente: përbërjen e Kolegjit, kryesuesin e tij dhe relatorin e çështjes; të dhënat e kërkuarit; objektin e kërkesës dhe bazën ligjore; rrethanat e çështjes; pretendimet e kërkuarit; shkakun/shkaqet e mospranimit; bazën ligjore të vendimmarrjes; dispozitivin dhe datën e tij. Një kopje e këtij vendimi i vendoset në dispozicion kërkuarit ose përfaqësuesit të tij. Vlen të theksohet se në praktikën e Gjykatës pjesa më e madhe e ankimeve kushtetuese individuale (rreth 75 %) përfundojnë me vendime moskalimi.
377. Koha, mënyra e votimit dhe aktet e përgatitura nga këshilltari hidhen prej tij në sistemin për menaxhimin e çështjeve. Bëhet fjalë për një sistem elektronik të brendshëm të administrimit të çështjeve të regjistruara në Gjykatën Kushtetuese.

Seksioni 3

Vendimmarrja e Mbledhjes së Gjyqtarëve

378. Çështja kalohet për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve kur anëtarët e Kolegjit nuk arrijnë të marrin vendim njëzëri për moskalimin ose kalimin e çështjes për shqyrtim³⁸⁷.
379. Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit, të paktën 5 ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen, i vë në dispozicion Mbledhjes së Gjyqtarëve:
- kërkesën;
 - relacionin e arsyetuar të gjyqtarit relator, për kalimin për shqyrtim në Mbledhjen e Gjyqtarëve;
 - projektvendimin; dhe
 - çdo akt tjetër që ka lidhje me çështjen.
380. Mbledhja çelet nga Kryetari, ndërsa çështja relatohet nga gjyqtari relator. Diskutimet nisin nga anëtarët e Kolegjit që ka kryer shqyrtimin paraprak, dhe më pas me radhë nga gjyqtari më i ri në detyrë deri tek kryetari i Gjykatës, nëse ky i fundit nuk ka qenë në përbërje të Kolegjit që ka përcjellë çështjen në mbledhje. Në përfundim të diskutimit votohet, sipas së njëjtës renditje, projektvendimi i paraqitur nga gjyqtari relator. Rendi i diskutimit ka natyrë funksionale për të lehtësuar jo vetëm diskutimin në mbledhje për vendimmarrje, por edhe për të forcuar gradualisht aktivizimin dhe aftësinë vendimmarrëse të çdo gjyqtari të ri në detyrë.

385 Nenet 31/a, pika 1 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe 24, pika 4 të Rregullores së Gjykatës.

386 Neni 31, pika 3 i Ligjit Organik të Gjykatës.

387 Neni 31, pika 4 i Ligjit Organik të Gjykatës.

381. Mbledhja e Gjyqtarëve shprehet me vendim:
- a) për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, nëse nuk plotësohet qoftë edhe një prej kriterëve të pranueshmërisë;
 - b) kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, nëse plotësohen të gjitha kriteret e pranueshmërisë.
382. Vendimet merren me shumicën e votave të gjyqtarëve që marrin pjesë në mbledhje³⁸⁸. Barazia e votave konsiderohet si vendim për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Ashtu si në rastin e shqyrtimit paraprak në Kolegj, të dhënat lidhur me datën dhe mënyrën e votimit, si dhe aktet e përgatitura nga këshilltari pasqyrohen në sistemin e menaxhimit të çështjeve.
383. Vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare përmban këto elemente:
- përbërjen dhe pjesëmarrjen;
 - kryesuesin;
 - relatorin e çështjes;
 - të dhënat e kërkuarit;
 - objektin e kërkesës;
 - bazën ligjore;
 - rrethanat e çështjes;
 - pretendimet e kërkuarit;
 - shkakun/shkaqet e mospranimit;
 - bazën ligjore të vendimmarrjes;
 - dispozitivin dhe datën e tij;
 - mënyrën e votimit të gjyqtarëve.
384. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet kërkuarit ose përfaqësuesit të tij. Ndryshe nga Kolegji, ku vendimet merren njëzëri, Mbledhja e Gjyqtarëve, i merr vendimet me shumicë të thjeshtë. Në rastin e vendimit të moskalimit të çështjes në seancë plenare, gjyqtarët në pakicë duhet ta shprehin mendimin e tyre dhe mund ta përpilojnë me shkrim atë.
385. Edhe në rastin e kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare Kolegji apo Mbledhja e Gjyqtarëve shprehen me vendim. Vendimi i Kolegjit ose i Mbledhjes së Gjyqtarëve për kalimin e në seancë plenare nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në mbledhje dhe përmban këto elementë:
- përbërjen e trupës dhe kryesuesin;
 - datën e mbledhjes dhe të dhënat e kërkesës (kërkuari dhe objekti);
 - bazën ligjore;
 - mënyrën e votimit.

388 Nenet 31/a, pika 1 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe 25, pika 5 të Rregullores së Gjykatës.

386. Vendimi shoqërohet nga procesverbali i votimit, ku përcaktohet nëse shqyrtimi i çështjes do të bëhet në seancë plenare publike ose seancë plenare në dhomë këshillimi (pa pjesëmarrjen e palëve), duke shqyrtuar dokumentet përkatëse. Vendimi për mënyrën e shqyrtimit merret duke vlerësuar interesin që ka gjykimi kushtetues dhe natyra e çështjes. Në procesverbal përcaktohen edhe subjektet që do të thirren në gjykim, të cilat përfshijnë subjektet kundër të cilave është paraqitur kërkesa ose me interes të drejtpërdrejtë për çështjen që shqyrtohet; organin që ka nxjerrë aktin; dhe subjekte të tjera, pjesëmarrja e të cilëve çmohet e nevojshme për zhvillimin sa më efektiv të gjykimit kushtetues.³⁸⁹
387. Në disa raste, në varësi të lëndës së gjykimit kushtetues, është vendosur edhe marrja e mendimeve nga subjekte të tjera si Avokati i Popullit, Komisionerët e pavarur e të tjerë.³⁹⁰
388. Kur çështja kalon në seancë plenare, të gjitha kriteret për pranueshmërinë e kërkesës i nënshtrohen shqyrtimit në seancë, pavarësisht nëse Kolegji apo Mbledhja e Gjyqtarëve kanë pasur ose jo dyshime për të.

389 Neni 26 i Rregullores së Gjykatës.

390 Shih vendimet nr. 8 datë 22.02.2023; nr. 39 datë 15.12.2022; nr. 37 datë 01.12.2022; nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

PJESA E TRETË

GJYKIMI KUSHTETUES

Kreu I

Shqyrtimi në seancë plenare

Seksioni 1

Kuptimi i gjyqimit kushtetues

389. Kur çështja kalon për shqyrtim në seancë plenare, i hapet rruga gjyqimit në themel të saj, përfundimi i të cilit shprehet përmes vendimit të Gjykatës. Gjyqimi zhvillohet nëpërmjet një procesi që synon përcaktimin e fakteve kushtetuese, mbi të cilat Gjykata zbaton dhe interpreton në mënyrë përfundimtare normat kushtetuese dhe nëse është rasti, edhe ato ndërkombëtare, për të zgjidhur mosmarrëveshjen kushtetuese të paraqitur përpara saj.
390. Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës përdorin si fjalën "gjykim", ashtu edhe atë "proces", koncepte të cilat janë analizuar nga Mbledhja e Gjyqtarëve gjatë vendimmarrjes³⁹¹. Duke i analizuar këto koncepte kushtetuese sipas kontekstit që ato janë përdorur në rregulla të ndryshme kushtetuese³⁹², Mbledhja e Gjyqtarëve vlerësoi se "proces" i referohet kuptimit formal të veprimtarisë gjyqësore për shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje, ndërsa "gjykim" i referohet së njëjtës veprimtari në kuptimin substancial, duke përfshirë në këtë mënyrë edhe vetë vendimmarrjen, nëpërmjet së cilës gjyqtari gjykon mosmarrëveshjen duke përcaktuar faktet dhe zbatuar ligjin. Vendimmarrja e gjyqarit materializohet në vendimin gjyqësor që përmban disponimin e gjykatës për mosmarrëveshjen, duke treguar analizën e fakteve dhe të ligjit. Edhe nga interpretimi gjuhësor i këtyre koncepteve del e njëjta përbajtje, pasi fjala "gjykim" ka kuptimin e mendimit të formuar për dikë a diçka dhe i shprehur si vlerësim përfundimtar, ndërsa fjala "proces" ka kuptimin e një vargu veprimesh të lidhura që sjellin një përfundim të caktuar ose tërësinë e veprimeve gjyqësore kur gjykohet një çështje, në rastin e procesit gjyqësor.³⁹³ Në përmbledhje të kësaj analize, Mbledhja e Gjyqtarëve evidentoi

391 Edhe pse rasti i marrë në shqyrtim ka pasur të bëjë më gjykim incidental, analiza shërben për çdo lloj kompetence të Gjykatës, përfshirë ankimin kushtetues individual.

392 Mbledhja e Gjyqtarëve vërejt se, përveç nenit 145, Kushtetuta përdor fjalën "gjykim" edhe në disa nene të tjera të saj, siç është rregulli për ndalimin e gjyqimit sërish (neni 34), e drejta e gjyqimit të drejtë (neni 42, pika 2), gjyqimi përfundimtar i ankesave individuale (neni 131, pika 1, shkronja "f"), pranimi i ankesave për gjykim (neni 133), përjashtimi nga objekti i gjyqimit të referendumit prej Gjykatës Kushtetuese (neni 152, pika 2), transferimi i çështjeve në gjykim (neni 179, pika 8) ose gjykim i cekët, gjykim i papërshtatshëm dhe gjykim i dobët, në kuptim të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit (neni E i Aneksit të Kushtetutës). Nga ana tjetër, Kushtetuta përmban edhe konceptin "proces", në kuptimin e veprimtarisë gjyqësore, siç është procesi penal dhe të drejtat gjatë tij (neni 31), ndalimi për kontrollin vetjak jashtë procesit penal (neni 37, pika 3) dhe procesi i rregullt ligjor (neni 42, pika 1).

393 Fjalori i Gjuhës Shqipe të Akademisë së Shkencave, Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, viti 2006, faqet 365 dhe 847.

se procesi realizohet në funksion të gjykimit, i cili materializohet me vendimin përfundimtar të gjykatës.³⁹⁴

391. Gjykata, që në vitin 1994 ka vënë në dukje se gjykimet në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese grupohen në gjykime kushtetuese abstrakte, konkrete dhe incidentale. Ajo u shpreh se natyra e gjykimit kushtetues është i rëndësishëm për të vlerësuar legjitimitimin e subjekteve që i drejtohen asaj. Duke konstatuar se teksti kushtetues përmend në mënyrë të shprehur e taksative subjektet që legjitimohen për ta vënë në lëvizje këtë gjykatë, pa u specifikuar rastet konkrete për secilin subjekt, ajo theksoi se kjo mungesë specifikimi nuk nënkupton që secili subjekt kur e çmon të nevojshme, mund të fillojë pa asnjë kufizim çdonjërin prej gjykimeve në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, të grupuar si gjykime kushtetuese abstrakte, konkrete dhe incidentale. Legjitimimi i secilit subjekt duhet të përcaktohet duke u nisur nga lloji i çështjes kushtetuese dhe nga lidhja që ka me të subjekti përkatës³⁹⁵. Edhe pse ky vendim ka interpretuar normat e ligjit kushtetues nr. 7561, datë 29.04.1992 për organizimin e drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese, pasi Kushtetuta nuk ishte miratuar ende, interpretimi është i vlefshëm edhe aktualisht, pasi teksti kushtetues³⁹⁶ ka ndjekur të njëjtën teknikë duke përcaktuar llojin e kompetencës së Gjykatës në nenin 131 dhe subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën në nenin 134, pa specifikuar rastet konkrete për secilin subjekt.
392. Nën këtë optikë, gjykimi kushtetues, i vënë në lëvizje nga ankimi i individit ka natyrë konkrete, që do të thotë se pajtueshmëria me Kushtetutën e aktit të kundërshtuar nga kërkuesi, edhe kur ai është ligj apo akt normativ, kontrollohet nën dritën e fakteve konkrete të çështjes së kërkuesit, pra nën dritën e interesit vetjak, real dhe të drejtpërdrejtë që lidhet me çështjen (*shih supra paragrafët 169 e vijues për justifikimin e interesit*).

Seksioni 2

Parimet e gjykimit kushtetues

393. Përpara analizës së shqyrtimit të ankimit kushtetues individual në seancë plenare, është e rëndësishme të evidentohen *parimet e gjykimit kushtetues*, të cilat gjejnë zbatim gjatë shqyrtimit të çdo kërkesë të paraqitur në Gjykatë. Parimet janë të njëjta, pavarësisht natyrës së çështjes apo llojit të kompetencës së Gjykatës.
394. *Shqyrtimi kolegjal* është një prej tyre, i parashikuar në nenin 20 të Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet kolegjalisht. Vendimi merret vetëm nga ata gjyqtarë që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes. Ky parim edhe pse nuk është i shprehur gjen parashikim edhe në nenin 133 të Kushtetutës, i cili parashikon se *“pranimi i ankesave për gjykim vendoset nga një numër gjyqtarësh, siç përcaktohet me ligj. Gjykata Kushtetuese merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj”*.
395. Shqyrtimi kolegjal reflektohet edhe në mënyrën sesi organizohen dhe funksionojnë Kolegjet dhe Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës (*shih pjesën e dytë të këtij Manuali*). Ligji Organik i Gjykatës nuk

394 Shih vendimin nr. 38, datë 04.03.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

395 Shih vendimin nr. 5, datë 15.04.1994 të Gjykatës Kushtetuese.

396 Megjithatë, Ligji Organik i Gjykatës ka bërë një përpjekje në këtë drejtim, veçanërisht pas ndryshimeve të vitit 2016.

parashikon asnjë përjashtim nga ky rregull. Kolegjialiteti ka efekte cilësore në vendimmarrje, ai balancon idetë dhe konceptet e gjyqtarëve individualë, duke siguruar arritjen e një dakordësie korrekte në vendimmarrje. Siç ka evidentuar Mbledhja e Gjyqtarëve, kolegjialiteti, edhe në rastin kur gjykimi përfundon edhe me mendim pakice, ofron mundësinë e shkëmbimit të ideve dhe pikëpamjeve profesionale në funksion të krijimit të bindjes së brendshme³⁹⁷. Kolegjialiteti është edhe aspekt i pavarësisë së Gjykatës, ai përbën një garanci për subjektet që i drejtohen Gjykatës Kushtetuese dhe synon krijimin e një jurisprudence kushtetuese të qëndrueshme.

396. Gjykata në jurisprudenten e saj e ka vlerësuar parimin e kolegjialitetit nën dritën e funksionalitetit të saj. Ajo është shprehur se gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në emërimin e pasardhësit të tij. Rregulli i vazhdimësisë së qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues është parashikuar për të garantuar, mbi të gjitha, funksionimin normal të Gjykatës në rast të krijimit të vendeve vakante, si pasojë e mosveprimit të ndonjërit prej organeve, të cilave Kushtetuta u njeh një rol të veçantë në këtë moment për zëvendësimin e gjyqtarëve të vjetër me gjyqtarë të rinj. Nisur edhe nga natyra kolegjiale e këtij organi të pavarur kushtetues, çdo mosveprim do të kishte pasoja në funksionimin e Gjykatës³⁹⁸. Ndërsa në rastin kur u kërkua përjashtimi nga shqyrtimi i çështjes së disa anëtarëve të Gjykatës, ajo vuri në dukje se përjashtimi i gjyqtarëve do të çonte në mosarritjen e numrit të nevojshëm për shqyrtimin e çështjes në seancë plenare (kuorumit) dhe, për rrjedhojë, ajo do të bllokohej për të vazhduar shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit objekt shqyrtimi (për pastërtinë e figurës)³⁹⁹ dhe se në raste të tilla, duhet të sigurohet që Gjykata të vazhdojë të funksionojë si një institucion demokratik dhe se mundësia e mosmarrjes pjesë në gjykim e gjyqtarëve nuk duhet të rezultojë në pamundësinë e Gjykatës për të marrë një vendim. Në kushtet kur ekziston prezumimi se gjyqtarët e Gjykatës veprojnë në mirëbesim, Gjykata nuk ka asnjë pengesë ligjore për marrjen në shqyrtim të pretendimeve të paraqitura para saj⁴⁰⁰.
397. Shqyrtimi kolegjial nuk do të thotë se në marrjen e vendimit nuk reflektohet mënyra e vendimmarrjes së secilit gjyqtar që merr pjesë në votim. Përveç kësaj Kushtetuta⁴⁰¹ dhe Ligji Organik i Gjykatës⁴⁰² parashikojnë se mendimi i pakicës publikohet së bashku me vendimin përfundimtar. I njëjti parashikim gjendet në Rregulloren e Gjykatës për mendimin paralel (gjithmonë nëse ka të tillë)⁴⁰³.
398. Një parim tjetër ka të bëjë me *procesin publik*, i cili në rastin e gjykimit të zakonshëm përbën një të drejtë individuale të kujtudo bazuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, por njëherazi edhe garanci institucionale për mënyrën se si administrohet drejtësia. Në këtë kuptim, procesi publik jep mundësinë që drejtësia t'i nënshtrohet shqyrtimit publik dhe të kontribuojë në respektimin e ligjeve prej kujtudo. Në ndryshim nga gjykimi që zhvillohet në juridiksionin e zakonshëm, në rastin e Gjykatës Kushtetuese për shkak të veçantive të gjykimit kushtetues, Ligji Organik e lë këtë çështje në vlerësim të vetë Gjykatës rast pas rasti. Kështu, neni 21 parashikon rregullin se shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet në seancë plenare publike ose mbi bazë të dokumenteve. Në praktikë, Gjykata vendos shqyrtimin e çështjes në seancë publike për çështje me interes publik ose kur është e nevojshme përcaktimi i fakteve përmes debatit gjyqësor aty për aty të palëve.

397 Shih vendimin nr. 149, datë 13.12.2021 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

398 Shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

399 Shih vendimin nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

400 Shih vendimin nr. 2 datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

401 Neni 132, pika 3 e Kushtetutës.

402 Nenet 26, pika 1 dhe 72, pika 8 e Ligjit Organik të Gjykatës.

403 Neni 40, pika 2 e Rregullores.

399. *Përdorimi i gjuhës shqipe* bën pjesë po ashtu në parimet e gjykimit kushtetues. Lidhur me këtë, neni 22 i Ligjit Organik të Gjykatës përcakton se në shqyrtimin e çështjeve përdoret gjuha shqipe. Pjesëmarrësit në gjykim, që nuk dinë gjuhën shqipe, përdorin gjuhën e tyre. Ata marrin dijeni për të gjithë zhvillimin e procesit me anë të përkthyesit, që si rregull sigurohet nga Gjykata Kushtetuese, me kërkesë të palës. Ashtu siç është evidentuar më lart (*shih supra paragrafët 94-96*), përdorimi i gjuhës shqipe në gjykimin kushtetues lidhet me natyrën zyrtare të kësaj veprimtarie. Në këtë drejtim, duhet theksuar se gjuha përbën pjesë të identitetit tonë kombëtar, që është një prej vlerave themelore e rendit tonë kushtetues, ndaj Kushtetuta në nenin 14, kur trajton parimin themelor për simbolet tona shtetërore, përcakton se gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja, ndërsa në nenin 59, pika 1 shkronja g) të saj parashikon se kujdesi i veçantë për gjuhën shqipe përbën një prej objektivave socialë të synuar prej shtetit. Gjithsesi, parimi i përdorimit të gjuhës shqipe nuk nënkupton cenimin e të drejtave të të huajit, përfshi edhe diskriminimin e tij për shkak gjuhe, pasi në këto raste bëhen të zbatueshme garancitë procedurale kushtetuese dhe ligjore për vënien në dispozicion atij të një përkthyesi, përfshi edhe mekanizmat për mbrojtjen nga diskriminimi.
400. Sa i takon parimit të *mbrojtjes në gjykimin kushtetues*, sipas neni 24 të Ligjit Organik pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Kjo do të thotë se kërkuesi zgjedh vetë nëse do të mbrohet nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Në praktikë, jo gjithmonë kërkuesit kanë zgjedhur të përfaqësohen në paraqitjen e ankimit kushtetues individual nga avokatë. Situata ndryshon kur çështja kalon për gjykim dhe objekt kërkese është një ligj ose akt normativ, pasi në këtë rast kërkuesi përfaqësohet në gjykim me avokat ose përfaqësues ligjor të specializuar. Është lehtësisht e kuptueshme se në këtë rast kompleksiteti i objektit kërkon praninë e një personi të specializuar në fushën ligjore.
401. Një parim tjetër, që zbatohet gjatë gjykimit kushtetues, është ai i *paanshmërisë* i parashikuar nga neni 25 i Ligjit Organik të Gjykatës, sipas të cilit gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese në shqyrtimin e çështjeve është i paanshëm dhe bazohet në kryerjen e detyrave të tij vetëm në Kushtetutë dhe në ligj. Në veprimtarinë e tij, gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese merr pjesë me cilësinë e tij vetjake dhe nuk përfaqëson asnjë organ shtetëror, organizatë shoqërore, parti ose shoqatë politike, grup etnik ose social. Rastet e heqjes dorë apo të përjashtimit të gjyqtarit kushtetues gjejnë trajtim në paragrafët vijues të Manualit (*shih infra paragrafët 421-424*).

Seksioni 3

Veprimet paraprake të gjykimit kushtetues

402. Kur çështja kalon për shqyrtim në seancë plenare, njoftohen palët pjesëmarrëse në gjykim dhe subjekteve të interesuara u dërgohet edhe një kopje e kërkesës dhe materialeve bashkëlidhur saj. Palëve u kërkohet të paraqesin parashtrimet e tyre në lidhje me çështjen brenda një afati 30- ditor, në atë kopje sa janë palët e gjykimit, përveçse kur Mbledhja e Gjyqtarëve vendos një afat më të shkurtër bazuar në natyrën e çështjes. Atyre mund t'u drejtohen edhe pyetje specifike në lidhje me çështjen ose t'u kërkohet çdo dokument tjetër me rëndësi për gjykimin. Kur paraqitet nevoja, gjyqtari relator mund të kërkojë edhe marrjen e informacionit nga subjekte ose organe të tjera që nuk janë palë në proces, duke përcaktuar edhe afatin për këtë qëllim. Pas përfundimit të afatit dhe përcjelljes së parashtrimeve përkatëse secilës palë në proces, Kryetari merr konfirmimin nga

gjyqtari relator për plotësimin e çështjes dhe pasi e diskuton në Mbledhjen e Gjyqtarëve, cakton datën dhe orën e seancës plenare, e cila u komunikohet palëve.⁴⁰⁴

403. Njoftimet për seancën plenare bëhen nga Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit. Gjyqtari relator, nëpërmjet këshilltarit, cakton detyrat dhe ndjek veprimet administrative lidhur me aktet që u vihen në dispozicion gjyqtarëve, kryerjen e njoftimit të palëve, kryqëzimin e parashtrimeve dhe provave të tyre, si dhe çdo veprim të nevojshëm për hetimin gjyqësor të çështjes.
404. Kryqëzimi i parashtrimeve dhe provave, i shërben zhvillimit të gjykimit me “karta të hapura mbi tavolinë”, që është i vlefshëm edhe për gjykimet e juridiksionit të zakonshëm. Në këtë mënyrë, sigurohet gjykimi i drejtë, si kërkesë themelore e sundimit të ligjit, duke eliminuar situatën ku një palë fshihet dhe zë kundërshtarit në pritë, sikundër nuk duhet që palët të lënë Gjykatën në hall për të kuptuar se cila është mbrojtja ndaj pretendimeve⁴⁰⁵.
405. Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit përgatit dosjen përkatëse për secilin gjyqtar, në bazë të formularit tip të akteve që do të shpërndahen për zhvillimin e seancës gjyqësore, i cili plotësohet dhe verifikohet nga këshilltari i çështjes, ku përfshihen, por pa qenë shteruese, këto akte:
- a) data dhe ora e gjykimit të çështjes;
 - b) kopje e kërkesës dhe akteve të paraqitura nga kërkuesi;
 - c) parashtrimet dhe aktet e paraqitura nga subjektet e interesuara;
 - ç) projektvendimi i gjyqtarit relator, aktet e përgatitura nga këshilltari ligjor sipas udhëzimeve të tij, si dhe çdo akt tjetër që vlerësohet nga gjyqtari relator se ka rëndësi për çështjen.⁴⁰⁶
406. Në rast se gjyqtarët janë njohur me këto akte në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesës nga Mbledhja e Gjyqtarëve, atyre u vihen në dispozicion vetëm materialet e reja. Drejtoria Gjyqësore njofton për orën dhe datën e zhvillimit të seancës plenare, publike ose mbi bazë të dokumenteve, si rregull, 30 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës, përveç rasteve kur gjykata vendos ndryshe. Kaktimi i këtij afati i shërben përgatitjes sa më të mirë të çështjes, si për palët pjesëmarrëse, ashtu edhe për gjyqtarët kushtetues.
407. Njoftimi i personave, pjesëmarrja e të cilëve është e nevojshme për zhvillimin efektiv të gjykimit kushtetues, bëhet me shkresë zyrtare, me fletëthirrje postare, me telegram, si dhe përmes e-mail-it nëse palët kanë rënë dakord për këtë formë njoftimi. Kur vendqëndrimi i palëve pjesëmarrëse është jashtë vendit apo i pasaktë, njoftimi bëhet me letërporosi, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile dhe me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese, të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare. Në rastet se procedura e njoftimit ka qenë e rregullt, por palët nuk paraqiten në seancë plenare ose nuk dërgojnë dokumente shtesë, seanca plenare zhvillohet në mungesë. Në rastet kur ka parregullsi në njoftime, seanca plenare shtyhet dhe kryhen njoftimet përkatëse për datën e re.⁴⁰⁷
408. I njëjti rregull vlen edhe kur seanca zhvillohet mbi bazë dokumentesh. Nëse kërkuesi apo subjekti i interesuar nuk paraqesin respektivisht parashtrimet apo prapësimet brenda afatit të përcaktuar në njoftim dhe pa shkaqe të përligjura gjykimi zhvillohet vetëm mbi bazën e kërkesës dhe/ose dokumenteve shoqëruese të saj të paraqitura në momentin e regjistrimit.

404 Neni 29 i Rregullores së Gjykatës.

405 Shih T. Bingham, *Sundimi i Ligjit*, Botimi në shqip, Shtëpia botuese Albas, 2022, faqe 125, 139 dhe 140.

406 Neni 29 i Rregullores së Gjykatës.

407 Neni 28 i Rregullores së Gjykatës.

409. Rëndësia e respektimit të afatit për paraqitjen e parashtrimeve dhe prapësimeve është vënë në dukje gjatë gjykimit të një ankimi kushtetues individual, ku kërkuesja pretendoi se subjekti i interesuar, Kuvendi i kishte paraqitur parashtrimet e tij jashtë afatit të caktuar nga Gjykata dhe nuk kishte kërkuar zgjatje të tij, ndaj sipas kërkueses, e drejta për të paraqitur prapësime kishte rënë në dekadencë dhe çdo material i paraqitur prej subjektit të interesuar jashtë afatit nuk duhej të merrej në konsideratë dhe as të analizohet nga Gjykata. Kjo e fundit, duke analizuar nenet 38, pika 6, të Ligjit Organik dhe 28 pika 5 të Rregullores, theksoi se rregulli për pasojën e mosrespektimit të afatit synon të disiplinohet sjelljen e palëve në funksion të efektivitetit të gjykimit kushtetues. Për këtë arsye, Gjykata kujdeset që afatet e caktuara të jenë të arsyeshme për palët, ndërsa këto të fundit kanë detyrimin jo vetëm të respektimit të tyre, por edhe të njoftojnë zyrtarisht nëse verifikohet ndonjë rrethanë e përligjur që i pengon t'i respektojnë ato. Gjykata vërejtë se subjekti i interesuar ishte thirrur nga Gjykata për të marrë pjesë në gjykimin kushtetues, duke vlerësuar se ishte i rëndësishëm dëgjimi i tij, në cilësinë e organit që kishte miratuar normat ligjore të kundërshtuara. Po ashtu, Gjykata evidentoi se prapësimet e paraqitura me vonesë nga subjekti i interesuar, i ishin njoftuar rregullisht dhe në kohën e duhur kërkueses, e cila kishte paraqitur edhe kundërgjegjësi për to, jo vetëm për aspektin formal të afatit, por edhe për themelin e prapësimeve. Në këtë situatë, Gjykata, duke ritheksuar rëndësinë e respektimit të afateve të caktuara prej saj nga të gjitha palët në proces, si dhe duke vlerësuar në tërësi rrethanat konkrete, arriti në përfundimin se kjo kërkesë paraprake nuk duhej pranuar⁴⁰⁸.
410. Ky rast i shërbeu Gjykatës edhe për përmirësimin e standardit të njoftimeve të drejtuara palëve në gjykimin kushtetues, në të cilat tashmë atyre iu tërhiqet vëmendja për rëndësinë e paraqitjes së parashtrimeve apo prapësimeve brenda afatit të caktuar, si dhe detyrimin për të njoftuar Gjykatën për rrethana që mund t'i pengojnë në respektimin e afatit, duke i paralajmëruar njëkohësisht se mosrespektimi i afatit pa shkaqe të justifikuar passjell zhvillimin e gjykimit vetëm mbi bazën e dokumenteve të paraqitura në afat.

Seksioni 4

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues

411. Pjesëmarrës në gjykimin kushtetues janë:
- Subjekti që ka paraqitur kërkesën ose përfaqësuesi i tij;
 - Subjektet kundër të cilëve është paraqitur kërkesa ose me interes të drejtpërdrejtë në çështjen që shqyrtohet;
 - Organi që ka nxjerrë aktin, kur objekt i ankimit kushtetues individual është akti normativ.⁴⁰⁹
412. Pjesëmarrësit në procesin e gjykimit para Gjykatës Kushtetuese kanë këto të drejta: a) të njihen me dokumentet e dosjes, të marrin ekstrakte ose fotokopje të tyre; b) të marrin pjesë në shqyrtimin e provave; c) të paraqesin prova; ç) t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit, dëshmitarëve, ekspertëve e specialistëve; d) të paraqesin kërkesa; dh) të japin shpjegime me shkrim ose me gojë; e) të paraqesin përfundimet e tyre; ë) të kundërshtojnë kërkesat e palëve të tjera, përfundimet dhe shpjegimet e tyre, si dhe të paraqesin pretendime përfundimtare.⁴¹⁰

408 Shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

409 Neni 39 i Ligjit Organik të Gjykatës.

410 Neni 30 i Rregullores së Gjykatës.

413. Pjesëmarrësit në gjykim mund t'i drejtohen me kërkesë Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit për t'u njohur me aktet e dosjes gjyqësore, por jo me aktet e ndërmjetme (aktet ose materialet e përgatitura nga këshilltari ose strukturat e tjera për qëllime të vendimmarrjes; shënimet e relatorit; projektvendimet; procesverbalet e vendimmarrjes dhe të votimit të gjyqtarëve). Për të përmbushur të drejtën e njohjes me aktet, caktohet një specialist i kësaj Drejtorie dhe një orar i përshtatshëm, i cili i njoftohet palës së interesuar. E drejta për t'u njohur me materialet e dosjes përfshin edhe të drejtën për të kërkuar kopje të akteve të dosjes. Pjesëmarrësve në gjykim, nëse është e mundur, mund t'u dërgohen kopje të akteve të dosjes edhe me e-mail. Për kopje të thjeshta të akteve si dhe kopje me shënimin "vërtetohet njësisë me origjinalin", zbatohen tarifa gjyqësore të përcaktuara në udhëzimin përkatës. Palët në proces mund të kërkojnë me shkrim marrje informacioni për statusin e çështjes. Ky informacion përgatitet nga Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit dhe lëshohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Për personat e tjerë që nuk janë palë në proces, zbatohen rregullat për të drejtën e informimit.⁴¹¹
414. Kërkuesi, në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë me shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit, ndërsa përsa i takon shkaqeve ato mund të ndryshohen ose shtohen deri në momentin kur vendoset kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare (*shih supra paragrafin 301*).
415. Po ashtu, kërkuesi ka të drejtë edhe ta tërheqë kërkesën e paraqitur. Në rastin e heqjes dorë Gjykata vendos pushimin e gjykimit të çështjes.⁴¹² Nëse çështja, në të cilën kërkuesi ka hequr dorë, është në fazën e shqyrtimit në seancë plenare, Gjykata, pasi njofton palët, mund të vendosë shqyrtimin e çështjes me përparësi në seancë të mbyllur. Gjykata mund të vendosë të mos e pranojë kërkesën për heqje dorë kur vlerëson se shqyrtimi i çështjes paraqet interes publik, duke parashtruar në vendimin përfundimtar edhe arsyet e mospranimit të kësaj kërkesë.⁴¹³ Duhet evidentuar se deri më sot, heqjet dorë nga kërkesa kanë rezultuar në një numër të ulët rastesh dhe në asnjë prej tyre, Gjykata nuk ka konstatuar interes publik për shqyrtimin e çështjes, ndaj ka vendosur pushimin e gjykimit⁴¹⁴.

Seksioni 5

Zhvillimi i seancës plenare

416. Seanca plenare mund të zhvillohet mbi bazë dokumentesh ose në prani të palëve. Si rregull, seanca plenare zhvillohet publike kur pjesëmarrja e palëve është e nevojshme për përcaktimin e fakteve të gjykimit ose kur nevojitet transparenca e gjykimit për shkak të ndjeshmërisë publike të çështjes në shqyrtim. Për arsye të mbrojtjes së moralit publik, të rendit publik, të sigurisë kombëtare, të së drejtës së jetës private ose të të drejtave vetjake Gjykata vendos zhvillimin e saj tërësisht ose pjesërisht me dyer të mbyllura,⁴¹⁵ vetëm me praninë e palëve. Kushdo mund të marrë pjesë në seancat plenare publike, nëse hapësira fizike në dispozicion e mundëson këtë.⁴¹⁶ Gjithsesi gjatë periudhës së Covid – 19, Gjykata në përputhje me rregullat në fuqi në atë kohë, nuk lejonte pjesëmarrjen e publikut në seancat publike, përtej numrit të caktuar nga kufizimet përkatëse. Së

411 Neni 32 i Rregullores së Gjykatës.

412 Shih vendimin nr. 5, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

413 Neni 31 i Rregullores së Gjykatës.

414 Shih për ilustrim, vendimin nr. 40, datë 21.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese

415 Rregullat janë të përcaktuara në nenin 5 të Rregullores së Gjykatës.

416 Neni 33 i Rregullores së Gjykatës.

fundmi, Gjykata për të rritur transparencën e veprimtarisë së saj, ka hapur edhe kanalën e saj në Youtube, ku transmetohen drejtpërdrejt (*live stream*) seancat publike.

417. Kur Gjykata vendos shqyrtimin e çështjes mbi bazë dokumentesh, debati i palëve realizohet me shkrim, përmes shkëmbimit respektiv dhe në kohën e duhur të parashtrimeve, prapësimeve dhe provave dokumentare të paraqitura. Edhe pse shqyrtimi i çështjes bëhet mbi bazë dokumentesh, vendimi përfundimtar në çdo rast shpallet publikisht, ai botohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të Gjykatës.
418. Si rregull, Gjykata Kushtetuese i shqyrton çështjet në seancë plenare me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të saj. Në çdo rast kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e seancës plenare nuk mund të jetë nën dy të tretat e tyre, pra 6 gjyqtarë. Seanca plenare thirret dhe drejtohet nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese. Në rastet kur kryetari është në pamundësi për të marrë pjesë në gjykim, seanca kryesohet nga gjyqtari më të vjetër në detyrë.⁴¹⁷
419. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë të detyruar të përgatiten për çështjen për gjykim, të marrin masat e duhura për zhvillimin e seancës plenare, të votojnë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe të ruajnë sekretin e diskutimeve dhe të votimit.
420. Ata kanë të drejtën të njihen me përmbajtjen dhe materialet e çështjes në shqyrtim, të marrin pjesë në bisedimet përfundimtare dhe të shfaqin lirisht mendimin e tyre për mënyrën e zgjidhjes së çështjes që shqyrtohet. Gjatë shqyrtimit ata mund t'u drejtojnë pyetje e të kërkojnë shpjegime nga pjesëmarrësit në gjykim, si dhe nga personat e thirrur si dëshmitarë ose ekspertë, nëse ka.
421. Një gjyqtar mund të kërkojë heqjen dorë apo mund të përjashtohet nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur:
- a) ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi;
 - b) ka deklaruar publikisht qëndrimin ndaj çështjes;
 - c) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim i vihet në dyshim paanshmëria;
 - ç) i vihet në dyshim paanshmëria për shkaqe të tjera.⁴¹⁸
422. Gjykata Kushtetuese është shprehur në jurisprudencën e saj se, në kuadrin e parimeve kushtetuese që qëndrojnë në themel të një procesi të rregullt gjyqësor, respektimi i parimit të paanshmërisë mundëson krijimin e besimit që gjykatat duhet të gëzojnë në një shoqëri demokratike dhe në një shtet të sunduar nga ligji. Paanshmëria e gjyqtarëve (*nemo iudex in causa sua*) kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet, por dhe të shihet që bëhet. Në demokraci, ligjshmëria e rolit të gjyqtarit varet jo vetëm nga qenia e tij, por dhe nga shfaqja e tij i paanshëm dhe i pavarur, duke qenë roli i tij në mënyrë esenciale pasiv dhe *super partes*⁴¹⁹.
423. Kërkesa për heqje dorë ose për përjashtimin nga gjykimi shqyrtohet menjëherë nga Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila vendos për pranimin ose jo të saj. Përjashtimi i gjyqtarit vendoset me votat e shumicës së gjyqtarëve që marrin pjesë në shqyrtimin e çështjes. Gjyqtari objekt përjashtimi, dëgjohet, por nuk merr pjesë në votim. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, përjashtimi merret i mirëqenë.

417 Neni 12, pika 1 i Ligjit Organik të Gjykatës.

418 Neni 36 i Ligjit Organik të Gjykatës.

419 Shih vendimin nr.23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

424. Në praktikë ka ndodhur që palët kanë kërkuar përjashtimin e më shumë se një gjyqtari nga gjykimi kushtetues për kushtetutshmërinë e një ligji, me pretendimin se ata ishin subjekte të ligjit dhe gjendeshin në situatën e konfliktit të interesit. Gjykata, bazuar edhe në opinionin *amicus curiae* të Komisionit të Venecias, vuri në dukje se në qoftë se disa anëtarë të saj përjashtoheshin, atëherë nuk do të arrihej kuorumi i nevojshëm prej 6 gjyqtarësh për shqyrtimin e çështjes dhe vendimmarrjen, që përcakton Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës dhe, për rrjedhojë, ajo do të bllokohej institucionalisht për të vazhduar shqyrtimin e kushtetutshmërisë së ligjit. Në këto kushte, Gjykata vlerësoi se gjykimi lidhur me kërkesën për përjashtimin e disa gjyqtarëve duhet të mbështetet në vlerësimin e rëndësisë që ka paanshmëria e gjyqtarëve, por edhe në nevojën për kontrollin e ligjeve të Kuvendit nga Gjykata Kushtetuese⁴²⁰. Duket që ky qëndrim jurisprudencial u konsiderua nga ligjvënësi, i cili me ndryshimet e Ligjit Organik të Gjykatës të vitit 2016, parashikoi në mënyrë të shprehur se kur objekt shqyrtimi është një ligj ose akt normativ, i cili mund të ketë efekte edhe për gjyqtarin kushtetues, heqja dorë e tij ose kërkesa për përjashtim për këtë shkak nuk pranohet⁴²¹.
425. Kryesuesi i seancës merr masa për hetimin e plotë të rrethanave të çështjes, orienton diskutimet mes palëve, duke mos lejuar që diskutimet të dalin jashtë objektit të çështjes apo juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese.
426. Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare ndjek këto rregulla: ⁴²²
- a) Deklarohet çelja e seancës plenare nga kryesuesi i saj.
 - b) Verifikohet paraqitja e pjesëmarrësve, kur seanca është publike, ose marrja dijeni nga palët, kur seanca zhvillohet mbi bazë dokumentesh.
 - c) Verifikohet legjitimiteti i pjesëmarrësve ose i përfaqësuesve të tyre.
 - ç) Pyeten pjesëmarrësit, kur seanca është publike, nëse kanë kërkesa paraprake dhe në rast të paraqitjes së tyre dëgjohen edhe palët e tjera në gjykim. Në këtë rast nuk lejohen replika. Pasi dëgjon kërkesat e palëve trupa mund të tërhiqet në dhomën e këshillimit për të vendosur në lidhje me to.
 - d) Gjyqtari relator paraqet në mënyrë të përmbledhur rrethanat e çështjes dhe pretendimet e kërkuarit.
 - dh) Kryesuesi i seancës fton palët të parashtrojnë pretendimet e tyre, duke filluar nga subjekti që ka paraqitur kërkesën, më pas subjektet e interesuara dhe subjektet e tjera të thirrura në gjykim nëse është rasti, siç janë ekspertët ose dëshmitarët.
427. Kufijtë e shqyrtimit të çështjes janë brenda objektit të kërkesës dhe shkaqeve të parashtruara në të. Kur ka lidhje midis objektit të kërkesës dhe akteve të tjera normative, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë të zgjerojë kufijtë e shqyrtimit. Koha që i jepet secilës palë për të parashtruar çështjen është, si rregull, 20 minuta, por kryesuesi i seancës mund të caktojë një kohë të ndryshme nisur nga rrethanat e çështjes, që mund të lidhen me kompleksitetin e saj ose numrin e madh të pretendimeve. Si rregull, pala e përfaqësuar komunikon me Gjykatën me anë të përfaqësuesit, përveçse kur gjyqtarët vendosin të komunikojnë drejtpërdrejt me të përfaqësuarit.
428. Pasi dëgjohet secila palë, kryesuesi u jep fjalën gjyqtarëve, duke filluar nga relatori, për parashtrimin e pyetjeve për palët, nëse kanë të tilla. Pas përfundimit të pyetjeve nga gjyqtarët, vetë palët kanë

420 Shih vendimin nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese, duke vënë re se çështja nuk ishte ankim kushtetues individual.

421 Neni 36, pika 2 i Ligjit Organik të Gjykatës.

422 Nenet 43 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe 33, pika 5 të Rregullores së Gjykatës.

të drejtë t'i drejtojnë pyetje njëra-tjetrës, dëshmitarëve ose ekspertëve nëse është rasti, si edhe të kundërshtojnë parashtrimet e palës tjetër. Në këto raste kryesuesi i seancës merr masat për të orientuar diskutimet e palëve. Në përfundim administrohen provat, nëse ka të tilla, që së bashku me një kopje të parashtrimeve të palëve i bashkohen fashikullit të gjykimit dhe u kërkohet palëve të parashtrajnë kërkesat përfundimtare. Pas kësaj, kryesuesi deklaron mbylljen e seancës plenare. Seanca, si rregull, zhvillohet pa ndërprerje, por nëse anëtarët e trupës gjyqësore e vlerësojnë të arsyeshme ose kur kërkohet nga palët, kryesuesi mund ta ndërpresë atë dhe të njoftojë palët për kohën e rifillimit të saj.

429. Gjykata mund të shtyjë shqyrtimin e çështjes nëse ajo e vlerëson të nevojshme paraqitjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve përkatës, marrjen e provave të tjera, hetimin e mëtejshëm të çështjes ose formimin e plotë të trupit gjykues. Shqyrtimi i çështjes rifillon nga çasti i ndërprerjes, me përjashtim të rastit kur seanca riçelet për formimin e plotë të trupit gjykues, në të cilin shqyrtimi fillon *ex novo*.

5.1 Solemniteti

430. Gjatë zhvillimit të seancës rregullat e solemnitetit dhe të sigurisë respektohen nga anëtarët e trupës gjyqësore, si dhe nga të gjithë pjesëmarrësit në proces. Rregullat e solemnitetit përfshijnë:⁴²³
- a) respektimin e orarit të caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore nga pjesëmarrësit;
 - b) respektimin e rendit dhe qetësisë gjatë zhvillimit të seancës;
 - c) mbajtjen e togës së posaçme nga avokatët/prokurorët dhe të veshjes serioze dhe të përshtatshme nga palët e tjera ose të pranishmit e tjerë në sallë;
 - ç) respektimin e kohës së vënë në dispozicion pjesëmarrësve në gjykim për të parashtruar pretendimet e tyre;
 - d) respektimin e trupës gjyqësore dhe të njëri-tjetrit, dhe ndalimin e përdorimit të fjalorit të papërshtatshëm ose fytes;
 - dh) zbatimin e urdhrave të kryesuesit të seancës;
 - e) mospërdorimin e pajisjeve elektronike për të penguar zhvillimin normal të seancës plenare.
431. Në rast moszbatimi, kryesuesi i seancës mund të tërheqë vëmendjen apo t'i paralajmërojë për largim nga seanca, t'i heqë palës ose përfaqësuesit të saj të drejtën e fjalës, të vendosë largimin e personit/ave nga salla e gjykimit, t'ia referojë sjelljen e përfaqësuesit të institucioneve ose avokatit respektivisht të titullari i institucionit dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Për sigurimin e solemnitetit dhe garantimin e zhvillimit normal të seancës kujdeset punonjësi i sigurisë së Gjykatës.

5.2 Amicus Curiae

432. Kur çështja ka kaluar për shqyrtim në seancë plenare, çdo gjyqtar mund të propozojë marrjen e një opinionit këshillimor (*amicus curia*) nga organizata të treta. Në raste të tilla Gjykata vendos për pezullimin e shqyrtimit të çështjes, duke njoftuar edhe palët për vendimin.
433. Një i tillë mund të kërkohet nga GJEDNJ bazuar në Protokollin nr. 16 të KEDNJ-së, hyrë në fuqi në 1 gusht 2018, në të cilin Republika e Shqipërisë ka qenë një prej 10 shteteve të para nënshkruese dhe

423 Neni 34 i Rregullores së Gjykatës.

ratifikuese. Protokoll nr. 16 i lejon gjykatave më të larta të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës t'i kërkojnë GJEDNJ-së opinion këshillimor mbi çështje parimore që lidhen me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në KEDNJ dhe protokollet e saj. Deri më sot një mundësi e tillë nuk është përdorur ende nga Gjykata Kushtetuese.

434. Gjykata mund të kërkojë *amicus curiae* edhe nga Komisioni i Venecies ose organizma të tjerë (tek këto të fundit në praktikë janë përfshirë rastet e Avokatit të Popullit ose komisionerëve përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave themelore).
435. Në praktikën e saj të punës, Gjykata i është drejtuar disa herë Komisionit të Venecies⁴²⁴ për çështje të ndryshme kushtetuese, të ndryshme nga ankimi kushtetues individual, por në të cilat janë analizuar edhe liritë dhe të drejtave themelore. Të tilla janë (i) në gjykimin kushtetues⁴²⁵ për kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar vlefshmërinë e zgjedhjeve vendore⁴²⁶; (ii) në gjykimin kushtetues⁴²⁷ për ligjin mbi procesin e kthimit të pronave⁴²⁸; (iii) në gjykimin kushtetues⁴²⁹ për ligjin mbi procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve⁴³⁰; (iv) në gjykimin kushtetues⁴³¹ për ligjin mbi procesin e pastërtisë së figurave të funksionarëve të lartë shtetërorë⁴³²; (v) në gjykimin kushtetues⁴³³ për pranueshmërinë e kërkesës për referendum shfuqizues të ndryshimeve kushtetuese⁴³⁴; (vi) në gjykimin kushtetues⁴³⁵ për ligjin e procesit të legalizimit të ndërtimeve informale⁴³⁶; dhe (vii) në gjykimin kushtetues⁴³⁷ për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave në procedurat e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese⁴³⁸.
436. Vendimi për kërkimin e një opinion këshillimor merret *ex officio* ose mbi bazën e një kërkesë nga palët në gjykim. Kërkesa nënshkruhet nga kryetari i Gjykatës. Ajo duhet të përmbajë: a) çështjet parimore të lidhura me interpretimin ose zbatimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose protokollet e saj dhe standardet ndërkombëtare; b) shkaqet e kërkesës dhe rrethanat ligjore e të faktit në lidhje me çështjen në shqyrtim. Me ardhjen e opinionit ose *amicus curiae*, Mbledhja e Gjyqtarëve, e thirrur nga kryetari, konstaton rënien e shkakut të masës së pezullimit dhe cakton datën dhe orën e seancës plenare, e cila, së bashku me një kopje të përkthyer të opinionit zyrtar, u njoftohen pjesëmarrësve në gjykimin kushtetues.⁴³⁹

5.3 Ekspertët dhe dëshmitarët

437. Nenet 40 dhe 41 të Ligjit Organik të Gjykatës parashikojnë mundësinë e thirrjes së ekspertit apo dëshmitarit në gjykimin kushtetues. Rregullat e detajuara për këtë qëllim gjenden në nenin 36 të

424 Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit – i njohur si Komisioni i Venecies sepse mblidhet në Venecie, Itali – është organ këshillimor i Këshillit të Evropës mbi çështjet kushtetuese. Roli i tij është të sigurojë këshilla juridike për shtetet anëtare dhe në veçanti, t'i ndihmojë përpjekjet e tyre për të përputhur strukturat ligjore dhe institucionale me standardet evropiane dhe përvojat ndërkombëtare në fushat e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës.

425 Shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

426 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)037-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)037-e)

427 Shih vendimin nr. 1, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

428 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)023-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)023-e)

429 Shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

430 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036-e)

431 Shih vendimin nr. 9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

432 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2009\)044-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2009)044-e)

433 Shih vendimin nr. 25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese.

434 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2009\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2009)007-e)

435 Shih vendimin nr. 35, datë 10.01.2007 të Gjykatës Kushtetuese.

436 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2007\)029-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2007)029-e)

437 Shih vendimin nr. 2, datë 19.01.2005 të Gjykatës Kushtetuese.

438 [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2004\)034-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2004)034-e)

439 Nenet 44/b të Ligjit Organik të Gjykatës dhe 35 të Rregullores së Gjykatës.

Rregullores së Gjykatës. Sipas këtij të fundit, kur faktet e pretenduara nuk mund të provohen me asnjë mënyrë tjetër ose kur për sqarimin e tyre nevojiten njohuri të posaçme në fushën e shkencës, teknikës ose artit, me kërkesën e pjesëmarrësve në gjykim ose kryesisht, Gjykata mund të thërrasë e të pyesë në seancë plenare persona me cilësinë e dëshmitarit ose të ekspertit. Kërkesa nga palët duhet të paraqitet të paktën 10 ditë para seancës plenare dhe të përmbajë të dhënat e dëshmitarit/ ekspertit, shkaqet për të cilat nevojitet marrja e dëshmisë dhe ajo çka kërkohet të provohet ose faktet për të cilat kërkohet kryerja e aktit të ekspertimit. Në rast se kërkesa pranohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve, njoftohen edhe palët e tjera në proces. Pala që ka kërkuar thirrjen e dëshmitarit merr masat për njoftimin e tij, kurse për zgjedhjen e ekspertit zbatohen rregullat përkatëse procedurale.

438. Në një rast, Gjykata për shkak të veçorive të çështjes ka vendosur thirrjen e tre ekspertëve të fushës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilët janë pyetur në seancë në lidhje me kriteret që vendosin dispozitat e kundërshtuara në llogaritjen dhe diferencimin e kontributeve⁴⁴⁰. Nuk kanë munguar rastet kur palët si përfaqësues të tyre kanë paraqitur në seancë edhe ekspertë të fushës. Në këto raste ata janë dëgjuar si çdo përfaqësues i subjekteve pjesëmarrëse në gjykim⁴⁴¹.
439. Kur dëshmitari thirret kryesisht nga Gjykata, ajo e njofton për faktet për të cilat kërkohet dëshmia, datën dhe orën e seancës plenare ku ai do të dëgjohet. Gjykata i përcakton ekspertit çështjet për të cilat kërkohet mendimi i tij, si dhe i vë në dispozicion të gjitha aktet e nevojshme për ushtrimin e detyrës. Shpenzimet për dëshmitarin ose/dhe ekspertin i ngarkohen palës që ka kërkuar thirrjen e tij, ndërsa në vendimin përfundimtar Gjykata përcakton edhe masën e detyrimit për shpenzimet përkatëse. Në rastet kur ata thirren nga Gjykata kryesisht, shpenzimet paguhen nga buxheti i saj.
440. Në praktikën e saj Gjykata nuk ka pasur raste kur ka thirrur kryesisht dëshmitarë dhe as ka pranuar kërkesat e palëve për thirrjen e tyre.

Seksioni 6

Pezullimi i akteve ligjore

441. Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, mund të urdhërojë pezullimin e ligjit ose të aktit, objekt të ankimit kushtetues individual, kur vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve.⁴⁴² Ky rregull gjen zbatim për çdo kërkesë ankimore që i drejtohet Gjykatës, pra jo vetëm për ankimet kushtetuese individuale. Vendimi për masën e pezullimit jepet i arsyetuar dhe i njoftohet organit përkatës që ka nxjerrë ligjin ose aktin, si dhe publikohet. Pezullimi mbetet në fuqi deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, me vendim në seancë plenare, Gjykata mund të vendosë për heqjen e masës së pezullimit. Gjykata Kushtetuese duhet të shprehet në vendimin përfundimtar për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit.
442. Duhet vënë në dukje se, për shkak të numrit të ulët të ankimeve individuale kushtetuese, që kanë pasur në objektin e tyre kundërshtimin e aktit normativ, praktika e Gjykatës në këtë drejtim nuk është e pasur. Një prej rasteve të pakta lidhej me pezullimin e ligjit nr. 60/2023 "Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë 'Mjekësi e

440 Shih vendimin nr. 60, datë 16.09.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

441 Shih vendimin nr. 15, datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ankim kushtetues individual, sepse kërkesa i është drejtuar Gjykatës nga një parti politike, por vendimi është marrë si shembull sepse i njëjti rregull zbatohet për çdo lloj kërkesë që e vë Gjykatën në lëvizje, pra edhe për ankimin kushtetues individual.

442 Nenet 45 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe 27 të Rregullores së Gjykatës.

Përgjithshme' në institucionet publike të arsimit të lartë", me arsyetimin se zbatimi i tij sillte pasoja të rënda në të drejtat për punë dhe për arsim të studentëve të mjekësisë. Gjykata e pranoi kërkesën për pezullimin e ligjit dhe në përfundim të gjyqimit, vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës (për themelin e saj)⁴⁴³.

Seksioni 7

Procesverbali

443. Seancat plenare publike transmetohen drejtpërdrejt (*livestream*) dhe regjistrohen audio⁴⁴⁴. Gjatë seancës mbahet procesverbal i përmbledhur, ndërsa regjistrimi audio transkriptohet tërësisht dhe nënshkruhet nga sekretari gjyqësor që e ka përpiluar dhe vistrohet (kontrollohet nga pikëpamja e saktësisë kundrejt nënshkrimit) nga kryetari i Gjykatës. Në seancat plenare mbi bazë dokumentesh mbahet procesverbal i përmbledhur. Procesverbali mbahet me mjete teknike dhe nëse nuk është i mundur, me shkrim dore. Procesverbali nënshkruhet nga kryesuesi i seancës dhe nëpunësi përgjegjës i Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit. Palët në proces kanë të drejtën e pajisjes me evidenca të diskutimeve të seancës plenare në formën e kopjeve të regjistrimit audio të seancës plenare publike, transkripteve të plota ose të pjesëshme të këtij të fundit, si dhe kopje të procesverbalit të seancës plenare, kundrejt pagesës.⁴⁴⁵

Seksioni 8

Riçelja e seancës plenare

444. Sipas nenit 73 të Ligjit Organik të Gjykatës, nëse pas mbylljes së seancës plenare çmohet e domosdoshme të sqarohen rrethana që kanë rëndësi të veçantë për çështjen në shqyrtim, vendoset riçelja e saj. Vendimi për riçeljen e seancës plenare merret me shumicë votash nga gjyqtarët që kanë qenë të pranishëm në seancën plenare. Vendimi u njoftohet pjesëmarrësve në gjykim, të cilët nëse e kërkojnë, u jepet fjala për të parashtruar argumentet e tyre. Një rast i tillë, ka ndodhur gjatë gjyqimit të një kërkesë të paraqitur nga një grup deputetësh dhe shkaku lidhej me marrjen në shqyrtim të një raporti të lëshuar nga një organizatë ndërkombëtare, që lidhej drejtpërdrejt me objektin e gjyqimit⁴⁴⁶.

445. Riçelja e seancës bëhet edhe në rast se gjatë vendimmarrjes nuk arrihet të formohet shumica absolute e anëtarëve të Gjykatës, që përbën kuorumin e nevojshëm për marrjen e vendimit, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2 të Ligjit Organik të Gjykatës, dhe ekziston mundësia për përfshirjen në këtë gjykim të gjyqtarëve të tjerë, që më parë nuk kanë marrë pjesë në të. Në këto raste shqyrtimi i çështjes fillon nga e para. Në periudhën kur Gjykata nuk funksiononte me kuorumin e plotë prej 9 gjyqtarëve, situata për mosformimin e shumicës absolute të votave (5 gjyqtarë) ishte më e lartë, prandaj nuk kanë munguar rastet e riçeljes së seancës, nëse ndërkohë ishin emëruar gjyqtarë të tjerë.⁴⁴⁷

443 Shih vendimin nr. 1, datë 25.01.2024 të Gjykatës Kushtetuese

444 Shih kanalën e Gjykatës Kushtetuese në Youtube Gjykata Kushtetuese Live Stream.

445 Neni 37 i Rregullores së Gjykatës.

446 Shih vendimin nr. 34, datë 24.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese

447 Shih vendimet nr. 4, datë 08.02.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

Kreu II

Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese

446. Pas përfundimit të seancës plenare dhe përpara fillimit të diskutimit për marrjen e vendimit, gjyqtarëve u vihen në dispozicion të gjitha aktet e paraqitura nga palët në proces.
447. Kur për marrjen e vendimit çmohet e domosdoshme përgatitja e materialeve ose kërkimeve shtesë, Mbledhja e Gjyqtarëve mund të ngarkojë gjyqtarin relator për përgatitjen dhe paraqitjen e tyre, duke caktuar edhe afatin përkatës. Mbledhja e Gjyqtarëve udhëzon gjyqtarin relator mbi drejtimit ku duhet të ndalet kërkimi ose informacioni.
448. Mbledhja për marrjen e vendimit zhvillohet në dhomën e këshillimit, sa më parë të jetë e mundur. Në rast pamundësie objektive për të marrë vendim menjëherë, diskutimet rihapen sa më parë të jetë e mundur.
449. Në rast se një ose më shumë prej gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes mungon në bisedime ose në votim, Mbledhja e Gjyqtarëve shtyhet për një datë tjetër. Në qoftë se pjesëmarrja e gjyqtarit/ëve nuk mund të sigurohet brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vendos në mungesë të tij/tyre për çështjen. Për marrjen e vendimit duhet të formohet shumica absolute e anëtarëve të saj. Në rast se kjo shumicë nuk formohet dhe ekziston mundësia për përfshirjen në këtë gjykim të gjyqtarëve të tjerë, që nuk kanë marrë pjesë më parë në të, seanca riçelet dhe shqyrtimi i çështjes fillon rishtazi. Në rast se nuk arrihet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.⁴⁴⁸
450. Sipas nenit 39 të Rregullores, diskutimet bëhen mbi bazën e projektvendimit të përgatitur nga gjyqtari relator. Ato nisin nga relatori i çështjes e më pas gjyqtarët e tjerë, sipas vjetërsisë në detyrë, duke filluar nga më i riu. Diskutimet dhe votimi për marrjen e vendimit janë të mbyllura dhe konfidenciale. Në to marrin pjesë vetëm gjyqtarët që kanë marrë pjesë në seancën plenare.
451. Pas përfundimit të diskutimeve gjyqtarët votojnë. Përpara votimit përfundimtar gjyqtari ka të drejtë të ndryshojë qëndrimin e shprehur gjatë diskutimeve të çështjes. Procedura e votimit nis nga gjyqtari relator, e më pas gjyqtarët e tjerë, duke filluar nga më i riu tek më i vjetri në detyrë. Kryetari i Gjykatës voton i fundit. Në procesin e votimit të gjyqtarëve nuk lejohet abstenimi.
452. Në rastet e çështjeve komplekse, gjyqtarët, nën drejtimin e kryetarit, mund të diskutojnë dhe vendosin veçmas për secilin pretendim të palëve. Në rast se nuk arrihet shumica e votave ose votat ndahen në mënyrë të barabartë, për të gjitha pretendimet, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.
453. Mënyra e zhvillimit të procesit të votimit dhe rezultati i tyre pasqyrohen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e pranishëm në shqyrtimin e çështjes. Vendimi regjistrohet menjëherë në Regjistrin Themeltar të Vendimeve Përfundimtare dhe numërtohet.
454. Seanca përfundon me marrjen e vendimit të Gjykatës në dhomën e këshillimit. Vendimi shpallet i arsyetuar brenda 30 ditëve nga përfundimi i seancës ose nga marrja e vendimit në dhomë këshillimi, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.
455. Në çështje me interes publik, Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit në bashkëpunim me këshilltarin e çështjes, sipas udhëzimeve të gjyqtarit relator, merr masat për përgatitjen e njoftimit që publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës, i cili përmban të dhënat e çështjes dhe dispozitivin e vendimit. Në këto çështje, Gjykata mund të përfshijë në njoftim edhe argumentet kryesore të

448 Nenet 73, pika 4 të Ligjit Organik të Gjykatës dhe 39, pika 7 të Rregullores.

vendimmarrjes së saj. Kjo praktikë e fundit ndiqet zakonisht në rastet kur ankimi kushtetues individual ka pasur në objektin e tij ligj ose akt normativ.

456. Përgatitja e vendimit dhe struktura e tij parashikohen nga neni 40 i Rregullores. Konkretisht, vendimi përgatitet nga gjyqtari relator, duke mbajtur parasysh diskutimet e zhvilluara gjatë votimit për projektvendimin. Në rast se gjyqtari relator ka mendim pakice ose paralel, ai përpilon vendimin sipas linjave të arsyetimit që kanë rezultuar gjatë diskutimeve dhe votimit. Në vendimin përfundimtar duhet të gjejnë pasqyrim argumentet bazë të vendimmarrjes, të cilat kanë qenë objekt i diskutimit dhe votimit.
457. Vendimi përgatitet brenda një periudhe të arsyeshme duke mbajtur në konsideratë afatin 30 ditor të shpalljes së tij. Ai duhet të trajtojë ato çështje që kanë qenë objekt i diskutimit dhe i votimit nga gjyqtarët.
458. Teksti përfundimtar u shpërndahet gjyqtarëve të pranishëm në marrjen e vendimit, të cilët diskutojnë mbi tekstin dhe mund të paraqesin vërejtje e komente. Pas reflektimit të ndryshimeve të propozuara, gjyqtari relator u paraqet gjyqtarëve, sa herë të jetë e nevojshme, tekstin e vendimit mbi të cilin ata diskutojnë, deri kur bien dakord për version përfundimtar.
459. Vendimi përfundimtar i Gjykatës organizohet në 3 pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese-arsyetuese dhe pjesa urdhëruese.

Pjesa hyrëse përmban:

- a) numrin e çështjes dhe të vendimit;
- b) përbërjen e trupës gjyqësore dhe kryesuesin e saj;
- c) gjyqtarin relator;
- ç) datën e seancës/ave plenare dhe emrin e sekretares gjyqësore;
- d) të dhënat e palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- dh) objektin e kërkesës, bazën ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare.

Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban:

- a) rrethanat e çështjes;
- b) pretendimet dhe prapësimet e palëve në gjykim;
- c) vlerësimin e Gjykatës lidhur me pretendimet dhe prapësimet e palëve, duke treguar edhe dispozitat kushtetuese për të cilat pranohet ose rrëzohet kërkesa.

Pjesa urdhëruese, e njohur edhe si dispozitivi i vendimit, përmban:

- a) atë që ka vendosur Gjykata dhe nëse është rasti edhe mënyrën e ekzekutimit të tij;
- b) efektin e vendimit dhe pasojat e tij;
- c) kohën e hyrjes në fuqi të vendimit.

460. Vendimi tregon, bazën ligjore, mënyrën e votimit të gjyqtarëve, datën e marrjes dhe të shpalljes së tij. Gjyqtari që ka mendim paralel ose në pakicë, njofton relatorin e çështjes se do të përgatisë mendimin e tij veçmas vendimit përfundimtar. Ky mendim duhet të përgatitet brenda periudhës kohore që përgatitet vendimi përfundimtar dhe i dërgohet Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit jo më vonë se dita e shpalljes së vendimit përfundimtar. Në mendimin paralel ose në pakicë duhet të trajtohen ato çështje që kanë qenë objekt i diskutimit dhe votimit nga gjyqtarët. Në mendimin paralel gjyqtari parashtron argumentet se përse nuk pajtohet tërësisht ose pjesërisht me linjën e arsyetimit të shumicës. Mendimeve paralele dhe të pakicës mund t'u bashkohen edhe gjyqtarë

- të tjerë. Mendimi paralel dhe ai në pakicë janë pjesë e vendimit përfundimtar dhe publikohen së bashku, në të njëjtën kohë.
461. Vendimi përfundimtar nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët, fillimisht nga relatori dhe menjëherë pas tij nga gjyqtarët e tjerë, të cilët kanë marrë pjesë në seancën plenare dhe në të pasqyrohet vota kundër, tërësisht ose pjesërisht, nëse ka të tillë.
462. Vendimi përfundimtar i nënshtrohet redaktimit gjuhësor, si rregull, brenda 2 ditëve, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit relator dhe këshilltarit ligjor. Pas përgatitjes së variantit përfundimtar të redaktuar të vendimit të Gjykatës, këshilltari ligjor ia përcjell Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit, e cila merr masat për nënshkrimin e tij nga të gjithë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në gjykim dhe më pas njofton palët për ditën dhe orën e shpalljes së vendimit.
463. Ditën e shpalljes, një kopje e vendimit e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm u njoftohet palëve me shkresë ose me postë elektronike.
464. Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit mban një procesverbal ku shënohen numri i vendimit dhe data e shpalljes së tij, si dhe fakti nëse është shpallur i arsyetuar brenda afatit ligjor. Pas shpalljes së vendimit, kopje e tij, autenticiteti i së cilës vërtetohet nga Sekretari i Përgjithshëm, dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare. Vendimi pasqyrohet edhe në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës në formën e tij të plotë, përveç rasteve kur është vendosur anonimizimi i të dhënave.
465. Në fillim të çdo viti pasardhës, vendimet përfundimtare botohen në një përmbledhje të veçantë që përgatitet nga administrata e Gjykatës Kushtetuese. Botimi shoqërohet edhe me indeksin përkatës dhe pasqyrë statistikore të vendimmarrjes së Gjykatës për periudhën në fjalë. Së fundmi, Gjykata ka ndërmarrë edhe një nismë të re për rritjen e transparencës së veprimtarisë së saj, si dhe informimin e praktikantëve të së drejtës dhe të qytetarëve, duke publikuar buletin periodik, që është një përmbledhje e vendimmarrjes së saj për një periudhë dy-mujore. Vendimet paraqiten të sintetizuara dhe me gjuhë të thjeshtuar, për të lehtësuar kuptimin e tyre. Numri i parë i buletinit periodik përfshiu periudhën janar-shkurt 2024⁴⁴⁹, ndërsa numri i dytë periudhën mars - prill 2024⁴⁵⁰.
466. Vendimet nuk mund të ndryshohen pas votimit. Megjithatë Gjykata ka të drejtë të plotësojë vendimin ose të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të, kryesisht ose me kërkesë të palëve. Kërkesa e palëve duhet të paraqitet brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. Në rast se bëhet fjalë për vendim të marrë në seancë plenare publike, edhe shqyrtimi i kërkesës bëhet në seancë plenare publike, në praninë e palëve (*shih infra paragrafët 531-539*).
467. Gjykata mund të përcaktojë në vendim edhe mënyrën dhe afatin e zbatimit të tij. Për ilustrim, në një rast, individ i u ankua në Gjykatën Kushtetuese për cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor me pretendimin se organet shtetërore refuzonin të ekzekutonin vendimin gjyqësor përfundimtar, me të cilin ishte urdhëruar regjistrimi i titullit të pronësisë së tij në regjistrat publikë. Gjykata vendosi pranimin e ankimit kushtetues, duke konstatuar shkeljen e të drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshem dhe njëherazi, urdhëroi në dispozitiv Agjencinë Kombëtare të Kadastrës të përfundonte procedurën e regjistrimit të pronës së kërkuesit⁴⁵¹. Në rast se kërkohet nga Gjykata, subjekti për të cilin vendimi ka përcaktuar detyrimin duhet të japë informacion në lidhje me zbatimin e vendimit.

449 Buletini i parë mund të konsultohet në adresën https://www.gjk.gov.al/web/buletini_02_05_2024_botuar_2771.pdf, aksesuar për herë të fundit më 26.06.2024

450 https://www.gjk.gov.al/web/buletini_mars_prill_2024_2810.pdf, aksesuar për herë të fundit më 26.06.2024

451 Shih vendimin nr. 39, datë 14.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese

PJESA E KATËRT

LLOJET E VENDIMEVE TË
GJYKATËS KUSHTETUESE

Kreu I

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese

Seksioni 1

Kwadri normativ

468. Kushtetuta nuk shprehet mbi llojet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ajo kufizohet vetëm me parashikimin se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim⁴⁵², çka nënkupton se në fund të çdo shqyrtimi gjyqësor Gjykata Kushtetuese, në çdo rast, shprehet me vendim. Ky normim i fuqisë juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është përcaktues i pozitës së saj në kuadër të hierarkisë së akteve juridike brenda sistemit kushtetues. Fuqia juridike e vendimeve, zakonisht, për të mos thënë pa përjashtim, ka karakter absolut dhe shprehet me fjalët latine *erga omnes*⁴⁵³. Kjo do të thotë se gardiani i Kushtetutës flet i fundit dhe për kushtetushmërinë e vendimit nuk ka vend për dyshim.
469. Tipologjia e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese parashikohet në Ligjin Organik të Gjykatës, i cili ndryshimet e reformës së vitit 2016 i reflekton edhe në mënyrën e vendimmarjes së Gjykatës Kushtetuese⁴⁵⁴.
470. Gjithsesi, rol vendimtar në përcaktimin dhe klasifikimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese ka pasur dhe ka jurisprudenca kushtetuese, e cila duke u bazuar në përvojat më të mira të gjykatave homologe, si dhe nëpërmjet arsyetimit të ndjekur gjatë procedurave të veçanta objekt të shqyrtimit të saj, ka evidentuar lloje të reja vendimesh, që nuk gjejnë pasqyrim në Ligjin Organik të Gjykatës.

Seksioni 2

Klasifikimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

471. Nga pikëpamja procedurale vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ashtu sikurse edhe ato të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndahen në vendime të ndërmjetme, vendime jopërfundimtare dhe vendime themeli. Ndërsa nga pikëpamja e themelit vendimet e Gjykatës Kushtetuese klasifikohen në dy kategori: (i) vendime që nuk shqyrtojnë themelin e çështjes; dhe (ii) vendime të themelit.

452 Neni 132, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

453 E. Hasani, M. Brahim, *Gjyqësia Kushtetuese*, NTG "Blendi", Prishtinë 2021, fq. 709.

454 F. Papajorgji, *Types of decisions of the Albanian Constitutional Court and their legal effects*, Euro-Balkan Law and Economics Review, N. 1(2021); Fascicolo 1, shih <https://ojs.cimedoc.uniba.it/index.php/law/article/view/1239>.

Në dallim nga termat e ndryshëm të vendimmarrjes kushtetuese që njihen në jurisprudencën ndërkombëtare⁴⁵⁵, Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës njohin “vendimin” si të vetmin emërtim që identifikon aktin juridik të gjykimit kushtetues.

472. Në kategorinë e vendimeve të cilat nuk shqyrtojnë themelin e kërkesës hyjnë vendimet për plotësimin e kërkesës, vendimet për bashkimin e kërkesave, vendimet e pezullimit, vendimet për saktësimin dhe plotësimin e vendimit, vendimet e pushimit të çështjes dhe vendimet e moskalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare.
473. Kategoria e vendimeve të themelit, quhet ndryshe ajo e vendimeve përfundimtare⁴⁵⁶ dhe ky term lidhet me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat⁴⁵⁷. Kjo kategori, pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, përbëhet nga vendimet e rrëzimit të kërkesës ose të pranimit, tërësisht apo pjesërisht, të saj⁴⁵⁸. Këto lloje vendimesh kanë ndryshime thelbësore ndërmjet tyre dhe kjo merr rëndësi të veçantë kur objekt të shqyrtimit kushtetues janë aktet normative.
474. Vendimet e pranimit të kërkesës janë ato me anë të të cilave Gjykata Kushtetuese vlerëson si të bazuar çështjen e kushtetushmërisë së aktit objekt shqyrtimi dhe vendos shfuqizimin e tij. Ato kanë efekte “*erga omnes*”.
475. Përkundrazi, vendimet e rrëzimit të kërkesës janë ato me anë të të cilave Gjykata Kushtetuese vlerëson si të pabazuar çështjen e kushtetushmërisë së aktit objekt shqyrtimi. Këto vendime nuk u japin këtyre të fundit një “patentë” kushtetushmërie. Ato kanë efekte vetëm “*inter partes*” dhe kërkuesi mund t’i drejtohet përsëri Gjykatës Kushtetuese⁴⁵⁹ nëse parashton një shkak apo argument të ri për antikushtetushmërinë e aktit të kundërshtuar.⁴⁶⁰
476. Gjithsesi, nga analiza e jurisprudencës kushtetuese vërehet se kjo ndarje tradicionale në mënyrën e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, për arsye nga më të ndryshmet, nuk është ndjekur gjithmonë nga kjo e fundit. Ajo ka elaboruar teknika të vendimmarrjes gjithmonë e më të sofistikuar dhe komplekse, duke zhvilluar në këtë mënyrë orientimin se në lidhje me aktet normative, antikushtetutshmëria është pasojë e “dështimit” të interpretimit të tyre konform me Kushtetutën dhe se juridiksioni kushtetues ka funksionin e “rikompozimit interpretues” ose “integritimit normativ” të sistemit juridik⁴⁶¹.

455 Për formën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese italiane shih A. Ruggeri, A. Spadaro, *Lineamenti di Giustizia Costituzionale*, G. Giappichelli Editore, 2019, fq. 165 e vijues.

456 Sipas parashikimit të nenit 132 të Kushtetutës këto vendime quhen përfundimtare. Nga një krahasim me procedurat gjyqësore në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, termi “përfundimtar” për ato gjykime përdoret në kuptimin e vendimit që mbyll procesin gjyqësor. Ndërsa në kuptim të dispozitës kushtetuese dhe të jurisprudencës kushtetuese termi “përfundimtar” në lidhje me vendimet e Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë me fuqinë detyruese të përgjithshme të tyre.

457 Shih vendimet nr. 21, datë 29.04.2010; nr. 14, datë 03.06.2009 dhe nr. 5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese.

458 Përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të fundit (ligji nr.99/2016), neni 74 i Ligjit Organik të Gjykatës Kushtetuese parashikonte si një lloj tjetër vendimmarrjeje refuzimin e kërkesës.

459 Shih vendimet nr. 7, datë 23.02.2021; nr.21, datë 29.04.2010; nr.29, datë 21.12.2006 të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata është shprehur se ajo ka pranuar rishqyrtimin e kërkesës me të njëjtin objekt, kur përmes një kërkesë tjetër, brenda afatit të parashikuar nga Ligji Organik i Gjykatës, është argumentuar një shkak i ri për antikushtetutshmërinë e akteve normative. Ndërsa, në rastet kur Gjykata është shprehur më parë me vendim për themelin e pretendimeve të ngritura nga palët, në situatën e riparqitjes të kërkesës ajo ka vlerësuar se vendimi i mëparshëm përbën pengesë në aspektin kushtetues, për sa kohë që është mbajtur një qëndrim përfundimtar lidhur me të njëjtat shkaqe të ngritura sërish në kërkesë.

460 Përrjashtimisht, sipas dispozitës së re të nenit 71/c, pikat 3 dhe 4 të Ligjit Organik të Gjykatës, nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur më parë mbi një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i cënuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesit gjyqësor. Kërkesa për rihapje të procesit para Gjykatës Kushtetuese paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Ajo duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, si dhe kërkimet konkrete. Kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit dhe shfuqizimin e aktit.

461 G. Zagrebelsky, V. Marcano’, *Giustizia costituzionale*, Shtëpia Botuese “Il Mulino”, Bologna, 2012, fq. 338-339.

Kreu II

LLOJET E VENDIMEVE

Seksioni 1

Vendimet që nuk shqyrtojnë themelin e çështjes

477. Kategoria kryesore e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që nuk shqyrtojnë themelin e çështjes përbëhet nga vendimet e moskalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, sipas procedurës së trajtuar në pjesën e dytë (*shih paragrafët 362-365*). Bëhet fjalë për vendime të dhëna nga Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve. Megjithatë mund të ndodhë që një vendim i tillë të jepet edhe nga Gjykata në seancë plenare në varësi të rrethanave të çështjes dhe pretendimeve të subjekteve të interesuara mbi mungesën e juridiksionit të Gjykatës⁴⁶² ose legjitimitimin e ankuesit⁴⁶³. Në këto raste, Gjykata disponon formalisht me vendim rrëzimi, por nga arsyetimi kuptohet që nuk është zgjidhur themeli i mosmarrëveshjes kushtetuese.
478. Përveç sa më lart, neni 31, pika 2 i Ligjit Organik të Gjykatës përcakton se Kolegji kur kërkesa nuk është e plotë mund t'i kthejë atë subjektit që ka vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për plotësim duke dhënë shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit të saj. Edhe pse ligji nuk përcakton mënyrën sesi disponon Kolegji, në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese vërehet se edhe në këto raste Kolegji është shprehur me vendim për plotësimin e kërkesës⁴⁶⁴, i cili aktualisht është një vendim i ndërmjetëm dhe si i tillë, nuk numërohet dhe as publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës.
479. Edhe në rastet kur Gjykata Kushtetuese, kryesisht ose me kërkesë të palës, urdhëron pezullimin e ligjit ose të aktit⁴⁶⁵ sipas rastit, me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve ose në seancën plenare, shprehet me vendim. Në analogji me vendimet e pezullimit gjatë gjykimit të zakonshëm, edhe gjatë gjykimit kushtetues Gjykata Kushtetuese në çdo fazë të shqyrtimit të çështjes, apo me vendim në seancën plenare, mund të heqë masën e pezullimit, ndërsa duhet të shprehet në vendimin përfundimtar të saj për vazhdimësinë ose jo të masës së pezullimit.
480. Me ndryshimet e paketës së reformës në drejtësi të vitit 2016 në katalogun e vendimeve që nuk shqyrtojnë themelin e çështjes hyn edhe vendimi për pezullimin e gjykimit kur Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjes, vendos të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj ose të kërkojë *amicus curia* nga organizma të tjerë⁴⁶⁶.
481. Ligji Organik i Gjykatës, në nenin 80, pika 1 ka rregulluar gjithashtu kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të plotësuar dhe ndrequr vendimin e saj, e cila do të trajtohet në kreun III të kësaj pjese.
482. Në kategorinë e vendimeve që nuk shqyrtojnë themelin e çështjes hyjnë edhe vendimet e pushimit

462 Shih vendimin nr. 36, datë 04.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese, por duke vënë re se nuk i përket procedurës së ankimit kushtetues individual.

463 Shih vendimin nr. 21, datë 28.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese, por duke vënë re se nuk i përket procedurës së ankimit kushtetues individual.

464 Shih vendimet nr.22, datë 19.12.2019 dhe nr.16, datë 17.01.2020 për plotësimin e kërkesës të Kolegjeve të Gjykatës Kushtetuese.

465 Kjo ndodh kur Gjykata Kushtetuese vlerëson se zbatimi i ligjit ose i aktit mund të sjellë pasoja që prekin interesa shtetërorë, shoqërorë ose të individëve sipas parashikimit të nenit 45 të Ligjit Organik të Gjykatës.

466 Neni 44/b i Ligjit Organik të Gjykatës.

e gjykimit kushtetues. Këto vendime janë të parashikuara nga Ligji Organik i Gjykatës në dy raste. Së pari, kur kërkesi përpara fillimit të shqyrtimit të kërkesës nga Gjykata Kushtetuese (neni 31/b) apo në çdo fazë të procesit, deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese (neni 43/b, pika 2), heq dorë nga kërkesa⁴⁶⁷ dhe së dyti, kur një ligj apo akt normativ ose pjesë të tij, që janë objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese, shfuqizohen ose ndryshohen para se kjo e fundit të marrë vendim (neni 51, pika 2 e ligjit)⁴⁶⁸. Në të dyja këto raste, Gjykata Kushtetuese mund vendosë të vazhdojë shqyrtimin e çështjes kur vlerëson se ajo paraqet një interes publik apo shtetëror.

483. Sa i takon konceptit kushtetues të interesit publik, Gjykata, kryesisht gjatë kontrollit abstrakt të akteve normative, ka theksuar se nuk ka një listë shtetërore, pasi interesi publik duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen. Mbrojtja e sistemit normativ dhe parimet shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj., të shpalosura në Kushtetutë hyjnë në konceptin e interesit publik⁴⁶⁹. Në praktikën kushtetuese është pranuar gjithashtu se iniciativat e ligjvënësive, të cilat shërbejnë për një rregullim të tregut apo interesave të një shteti social, konsiderohen në respekt të interesit publik. Gjithashtu interes publik konsiderohet edhe parimi i shtetit social, i parashikuar që në preambulën e Kushtetutës, pra ndërhyrja e autoritetit publik për të mbrojtur interesat e përgjithshme, si p.sh. kontrollin publik të kostos së jetesës, luftën kundër inflacionit, shtytjen dhe nxitjen e aktiviteteve prodhuese, mbrojtjen e shtresave të varfra, promovimin e vlerave sociale.⁴⁷⁰

Seksioni 2

Vendimet përfundimtare

484. Në rast se nuk ka shkaqe procedurale që mund të përbëjnë pengesë për shqyrtimin e çështjes në themel, pra me përmbushjen e “filtrave” që përcaktojnë moskalimin e çështjes në seancë plenare apo rrethana të reja që ndalojnë vazhdimin e gjykimit, siç është tërheqja e kërkesës, Gjykata shqyrton themelin e kërkesës së paraqitur nga subjektet që mund ta vënë atë në lëvizje. Në këto raste kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese shqyrtohet në seancë plenare dhe vendimmarja e saj përcaktohet sipas procedurave të veçanta, objekt të kontrollit të saj⁴⁷¹.
485. Mënyra se si mund të përfundojë gjykimi përpara Gjykatës Kushtetuese është ose shfuqizimi si antikushtetues i akteve të pushtetit publik objekt shqyrtimi ose deklarimi i pabazueshmërisë së kërkesës. Në parim duket sikur nuk ka mundësi tjetër (*tertium non datur*). Nënkuptohej se kjo vlen për çdo lloj kërkesë që i drejtohet Gjykatës, pra jo vetëm për ankimin kushtetues individual. Prandaj edhe në lidhje me këtë të fundit, Gjykata mund ta pranojë ose rrëzojë atë.
486. Doktrina për kërkesat që kanë objekt dispozita ligjore është shprehur se Gjykata Kushtetuese vepron më shumë për të ruajtur ligjin sesa për ta anuluar; priret më shumë ta anulojë pjesërisht sesa ta rrëzojë të gjithë, dhe kjo jo për një *favor legitimatis*, por sepse të zhdukësh rrënjësisht një akt legjislativ që mund të qëndrojë tërësisht ose pjesërisht, do të ishte një lloj si të dalësh jashtë attributeve të tua për të zaptuar ato që i janë dhënë ligjvënësive⁴⁷².

467 Shih vendimin nr. 5, datë 16.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

468 Shih vendimin nr. 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese, duke vënë re se nuk i përket procedurës së ankimit kushtetues individual.

469 Shih vendimet nr. 35 datë 15.06.2023; nr. 18, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 18.01.2017; nr. 55, datë 27.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

470 Shih vendimet nr. 5, datë 27.01.2017; nr. 52, datë 05.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese.

471 Procedurat e veçanta janë të parashikuara në Kreun VII të *Ligjit Organik të Gjykatës*.

472 C. Leone, *Il principio di continuità dell'azione amministrativa*, Giuffrè Editore, 2007, fq. 329. Sipas autores, tezave të

487. Përpara reformës së vitit 2016 mënyra e përfundimit të gjykimit kushtetues bazohej edhe në përmbajtjen e nenit 132, pika 1, fjalia e dytë të Kushtetutës, sipas të cilit *“Gjykata Kushtetuese ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton”*. Megjithatë, Gjykata në jurisprudencën e saj, edhe para ndryshimeve të 2016, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, gjithmonë e më tepër kishte vënë në dukje se është e nevojshme të kapërcehet kjo skemë e ngurtë.
488. Përmbajtja aktuale e nenit 132 të Kushtetutës duke hequr fjalinë e lartpërmendur nga teksti i saj jo vetëm është uniformizuar me atë çfarë kishte përcaktuar jurisprudenca kushtetuese, por edhe i ka lënë *“rrugë të lirë”* mënyrave të tjera të përfundimit të gjykimit kushtetues. Prandaj, bazuar në teknikat e arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese vendimet e themelit janë të natyrave të ndryshme.

2.1. Vendime të interpretimit të Kushtetutës

489. Kompetenca e Gjykatës Kushtetuese për të bërë interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, rrjedh drejtpërdrejt nga neni 124, pika 1, i Kushtetutës⁴⁷³. Ky i fundit, në formulimin pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, këtë kompetencë e lidh me *“zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese”*, çka përbën dhe funksionin e saj⁴⁷⁴, ndërkohë që rastet konkrete të *“mosmarrëveshjeve kushtetuese”* detajohen në nenin 131 dhe në dispozita të tjera kushtetuese. Sa i takon ankimit kushtetues individual, kompetenca e Gjykatës për shqyrtimin e tij parashikohet shprehimisht në pikën 1, shkronja *“f”*, të nenit 131.
490. Vlen të theksohet fillimisht se në rastet e shqyrtimit të ankimeve kushtetuese individuale, vendime të interpretimit të Kushtetutës nuk janë dhënë ndonjëherë deri tani. Gjithsesi përderisa nuk përjashtohet mundësia që më së paku, kur objekt i ankimit kushtetues individual është dispozita ligjore, Gjykata të investohet edhe për këto lloj vendimesh, ato do të trajtohen më poshtë.
491. Gjykata është shprehur se nëpërmjet teknikës së interpretimit të Kushtetutës, bëhet e mundur që ajo të kthehet në një instrument *“të gjallë”*, që i përshtatet zhvillimit të vlerave në rendin juridik, duke garantuar që vlera të reja, të cilat ndoshta nuk ishin në vëmendje të hartuesve të Kushtetutës, të marrin njohje dhe, mbi të gjitha, mbrojtje kushtetuese⁴⁷⁵.
492. Një pjesë e doktrinës e ka vlerësuar këtë kompencë të Gjykatës Kushtetuese si të pavarur nga kompetencat e tjera të saj të parashikuara nga neni 131 i Kushtetutës, duke konsideruar se interpretimi është një metodë që ka për objekt të gjitha çështjet e mundshme që lindin nga Kushtetuta për verifikim kushtetues; ndërsa një pjesë tjetër e ka vlerësuar si metodë të kontrollit të çështjeve që parashikohen në nenin 131 të Kushtetutës⁴⁷⁶.

tilla mund t'u kundërvihesh se, meqë Parlamenti dhe Gjykata Kushtetuese nuk veprojnë në fusha të ndryshme dhe të kundërta, *horror vacui* nuk ka pse të jetë, nëse Gjykata pranon se norma e nxjerrë nga dispozita ligjore nuk është konform me Kushtetutën dhe, për pasojë, e heq nga rendi juridik, Parlamenti, duhet të plotësojë boshllëkun dhe të zëvendësojë dispozitën e shpallur si antikushtetuese me një dispozitë tjetër që është konform me Kushtetutën, në mënyrë që sistemi i normave të jetë i plotë dhe koherent.

473 Neni 124, pika 1 e Kushtetutës parashikon se *“Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”*.

474 Neni 2 i Ligjit Organik të Gjykatës ka të njëjtën përmbajtje me nenin 124 të Kushtetutës dhe titullohet *“Funksioni i Gjykatës Kushtetuese”*.

475 Shih vendimin nr. 20, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese. Zbatimi i kësaj teknike interpretimi nga ana e Gjykatës Kushtetuese ka ngjallur jo pak kundërshtime, sidomos nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, pasi mund të ndodhë që interpretimi pajtues i normës së kundërshtuar që ka bërë Gjykata Kushtetuese të mos përputhet me atë që ka bërë gjyqtari i zakonshëm, përkundrazi i kundërvihet.

476 K. Traja, parathënie e librit me autor S. Sadushi, *Drejtësia Kushtetuese në zhvillim*, vep. cit., fq. 23-24. Autori arsyeton se Gjykata Kushtetuese ka edhe kompetenca të tjera përveç atyre të parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës, i cili, sipas tij, nuk ka karakter shterues në lidhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

493. Vetë Gjykata në jurisprudencën e saj ka kryer interpretimin përfundimtar të nenit 77, pika 2 të Kushtetutës në lidhje me ngritjen e komisioneve hetimore të Kuvendit⁴⁷⁷, si edhe të nenit 125, pika 3 të Kushtetutës⁴⁷⁸, në lidhje me ripërtëritjen e një të tretës së gjyqtarëve kushtetues⁴⁷⁹, edhe pse këto çështje nuk janë shprehimisht të parashikuara nga neni 131 i Kushtetutës.
494. Nga ana tjetër, nisur nga përmbajtja fillestare e nenit 124 të Kushtetutës, sipas të cilit, Gjykata garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj, është shtruar pyetja nëse kjo kompetencë ushtrohet pavarësisht ekzistencës së një çështjeje konkrete për shqyrtim. Edhe pse *prima facie* duket sikur Gjykata nuk ka qenë konsekuente në vendimmarrjen e saj në lidhje me këtë situatë, ajo nuk e ka vënë në dyshim faktin se interpretimi është një metodë për gjitha çështjet e mundshme që kërkojnë verifikim apo kontroll kushtetues, dhe prej vitit 2011⁴⁸⁰ e ka trajtuar këtë kompetencë duke e lidhur në lidhje me ekzistencën e një "problemi/mosmarrëveshje kushtetues/e" zgjidhjen e të cilit synon të kryejë, sepse përndryshe ka vlerësuar se do të vihej në rolin e organit që jep opinione këshillimore për mënyrën se si duhet të veprojnë në të ardhmen institucionet kushtetuese⁴⁸¹. Kështu, në rastin kur objekt i shqyrtimit ka qenë interpretimi i neneve 70, 71 dhe 72 të Kushtetutës, Gjykata nuk e pranoi kërkesën, duke vlerësuar se nuk kishte një "çështje konkrete" që kërkonte interpretim⁴⁸².
495. Edhe përmbajtja aktuale e nenit 124 të Kushtetutës duke lidhur interpretimin e Kushtetutës me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese, reflekton qëndrimin e mbajtur nga jurisprudenca kushtetuese dhe mbetet për të parë në të ardhmen nëse kjo kompetencë e Gjykatës do të gjejë zbatim edhe në rastin e ankimit kushtetues individual.

2.2. Vendimet e pranimit të kërkesës

496. Gjykata në rastet kur vlerëson se akti i pushtetit publik, objekt shqyrtimi i saj, bie në kundërshtim me Kushtetutën, vendos pranimin e kërkesës. Në çdo rast Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit shprehet edhe për efektin e vendimit dhe pasojat e tij⁴⁸³.
497. Kështu kur objekt i ankimit kushtetues individual është një ose disa *dispozita ligjore* dhe Gjykata deklaron antikushtetueshmërinë e saj/të tyre, ajo/ato humbasin fuqinë e tyre që nga dita e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare. Dispozita ligjore shfuqizohet⁴⁸⁴ dhe vendimi ka efekte përgjithësisht për të ardhmen (*ex nunc*), me përjashtim të rasteve kur Ligji Organik i Gjykatës parashikon se ai

477 Shih vendimin nr. 18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese.

478 Rregulli i ripërtëritjes së një të tretës së gjyqtarëve kushtetues çdo tre vjet, para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 parashikohet nga neni 125, pika 3 i Kushtetutës. Aktualisht ky rregull sot parashikohet nga pika 6 i po të njëjtit nen.

479 Shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

480 Deri në vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit interpretimin përfundimtar të Kushtetutës nuk e lidhte me ekzistencën e një problemi kushtetues, por mjaftonte të ngrihej nga subjektet që justifikonin interesin e tyre në ngritjen e këtij kërkimi (shih edhe vendimet nr. 37, datë 23.06.2000, nr. 38, datë 23.06.2000, nr. 39, datë 23.06.2000, nr. 49, datë 31.07.2000 të Gjykatës Kushtetuese).

481 Shih vendimin nr. 24, datë 09.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese. Ajo u shpreh se "kompetenca interpretuese e saj, në kuptim të nenit 124 të Kushtetutës, nuk nënkupton formulimin e interpretimeve tërësisht abstrakte të normës kushtetuese, pasi kjo do ta vinte Gjykatën në rolin e organit që jep opinione këshillimore për mënyrën se si duhet të veprojnë në të ardhmen institucionet kushtetuese. Në rast se Gjykata do të jepte vendime interpretuese in abstracto, duke mos u shprehur përfundimisht për kushtetueshmërinë e aktit që ka ardhur si pasojë e ushtrimit të veprimtarisë përkatëse të subjektit, ky vendim do të merrte karakteristikat e kontrollit paraprak të kushtetueshmërisë".

482 Shih vendimin nr. 29, datë 30.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

483 Neni 51/a, pika 1, shkronja "ç" i Ligjit Organik të Gjykatës.

484 Në ndryshim nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese italiane të cilat anulojnë normat e vlerësuara si antikushtetuese (shih P. Caretti, U. De Siervo, *Istituzioni di diritto pubblico*, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli", Torino, 2010, fq. 407), efekti i vendimeve të pranimit të kërkesës të Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri është ai i shfuqizimit të normës.

ka fuqi prapavepruese⁴⁸⁵. Gjithashtu vendimi ka efekte *erga omnes*, që ka të bëjë me respektin që duhet ta tregojnë të gjithë ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, nga i cili derivohen edhe dy segmentet të tjera: përshtatja e sjelljeve konform me vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe zbatimi i tyre konkret nga ana e organeve që kanë kompetencë kushtetuese dhe ligjore për një gjë të tillë. Kjo e bën mjaft të qartë se efekti i përgjithshëm (*erga omnes*) nuk duhet të ngatërrohet me efektin *res judicata*, i cili përbën objektin e ekzekutimit, ndërkohë që efekti i përgjithshëm (*erga omnes*) nuk është i krijuar për ekzekutim sepse i tillë nuk është *per se* nisur nga fakti që konceptualisht nuk ka fund dhe as substancë të përcaktuar saktësisht⁴⁸⁶. Në këtë kuptim, vendimet e pranimit në këto raste i drejtohen edhe ligjvënësit, i cili me hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës duhet të bëjë ndërhyrjet e duhura për rregullimin e legjislacionit.

498. Gjykata Kushtetuese në këtë drejtim në jurisprudencën e saj ka pranuar se kur, si rrjedhojë e një vendimi shfuqizues, krijohet një boshllëk ligjor, i cili në vetvete përbën antikushtetutshmëri, ai duhet të pasqyrohet në vendim, duke dhënë arsyet përse dhe duke i dhënë kohën e mjaftueshme ligjvënësit që të plotësojë normën, apo një pjesë të saj, sipas arsytimit në vendimin e Gjykatës, duke vendosur nëse duhet edhe shtyrjen në kohë të hyrjes në fuqi të vendimit të saj për këtë qëllim⁴⁸⁷.
499. Gjithsesi Gjykata mund edhe të shfuqizojë vetëm një fjalë apo togfjalësh nga dispozita që ka në shqyrtim duke e konsideruar atë të panevojshme, sepse edhe pa të norma mund të jetë e kuptueshme dhe e zbatueshme, pra pa kërkuar ndërhyrje të mëtejshme të ligjvënësit.⁴⁸⁸
500. Në rastet kur objekt i ankimit kushtetues individual është *vendimi/vendimet gjyqësore* dhe Gjykata deklaron antikushtetutshmërinë e tij/të tyre, ajo shfuqizon vendimin/vendimet e dhëna në shkallët e ndryshme të gjykimit, duke nisur nga ai ku ka ndodhur cenimi.
501. Në praktikën e Gjykatës, edhe kur objekt i kërkesës kanë qenë vendimet e të gjitha shkallëve të gjykimit, nëse janë konstatuar shkelje gjatë procesit gjyqësor, përgjithësisht është shfuqizuar vendimi i Gjykatës së Lartë, e cila bazuar në parimin e subsidiaritetit dhe në rolin e saj, duhet t'i garantojë individit mbrojtjen e të drejtave kushtetuese. Gjithsesi për ekonomi gjyqësore, nëse cenimi është konstatuar se ka ndodhur në shkallët e tjera të gjykimit, Gjykata ka shfuqizuar edhe vendimet e asaj shkalle (normalisht të gjykatës së apelit, duke qenë se në apel ekziston mundësia e rihapjes së shqyrtimit gjyqësor dhe marrjes së provave).⁴⁸⁹ Në këto raste vendimi i Gjykatës ka efekte *inter partes*, pra vetëm ndaj palëve të gjykimit kushtetues.

2.3. Vendimet e rrëzimit të kërkesës

502. Në rast se Gjykata Kushtetuese vlerëson se akti i pushtetit publik objekt shqyrtimi nuk shfaq

485 Përrjashtimisht neni 76, pika 7 e Ligjit Organik të Gjykatës parashikon rastet kur vendimi ka fuqi prapavepruese. Konkretisht, vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm:

a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;

b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë;

c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar.

486 E. Hasani, M. Brahim, *vep. cit.*, fq. 711.

487 Shih vendimet nr. 04, datë 15.02.2021, nr. 20, datë 20.04.2021, nr. 38, datë 09.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

488 Kështu ka ndodhur në vendimin nr.15, datë 17.04.2003 të Gjykatës Kushtetuese me kërkuar Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe objekt shfuqizimit e nenit 410, pika 2 e KPP-së, pra përpara se ankimi kushtetues individual të kishte për objekt dispozitat ligjore, por shoqatat mund t'i drejtoheshin Gjykatës për shfuqizimin e ligjit.

489 Shih vendimin nr. 31, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese (ka kthyer çështjen për rishqyrtim në apel) dhe vendimin nr. 14, datë 03.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese (ka kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e rrethit).

probleme kushtetutshmërie në lidhje me pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues individual vendos rrëzimin e tij.

503. Gjykata Kushtetuese, kur përmbyll gjykimin kushtetues me një vendim rrëzimi dhe objekt i shqyrtimit është dispozita ligjore, nuk shprehet në mënyrë pohuese mbi kushtetutshmërinë e normës juridike të kundërshtuar. Gjithsesi, sikurse u theksua më sipër, përpara Gjykatës çështja e pajtueshmërisë me Kushtetutën e të njëjtit akt të pushtetit publik mund të paraqitet përsëri, por nëse kërkuesi ngre një shkak të ri antikushtetutshmërie.
504. Por kjo nuk është e vetmja mundësi që Gjykata Kushtetuese të rishqyrtojë kushtetutshmërinë e dispozitës normative. Evoluimi (*in meius*) i jurisprudencës kushtetuese (mbi të cilën bazohet vendimi i kundërshtuar), apo dhe i vlerave sociale që i përshtaten zhvillimit të shoqërisë demokratike të vendit, mund të jenë disa nga rastet e tjera që mund të kërkojnë ndërhyrjen *ex novo* të drejtësisë kushtetuese⁴⁹⁰.
505. Në kategorinë e vendimeve të rrëzimit të kërkesës, kur objekt i ankimit kushtetues individual është dispozita ligjore, hyjnë edhe vendimet e interpretimit pajtues. Edhe kjo metodë nuk është përdorur deri tani në rastet e ankimit kushtetues individual.
506. Gjykata në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve që kanë qenë objekt të shqyrtimit të saj, në jurisprudencë konstante, është nisur nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se, lidhur me antikushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrohen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse dispozitat ligjore të kundërshtuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese⁴⁹¹.
507. Nisur nga ky parim, në shumë raste Gjykata ka vlerësuar të zbatojë teknikën e interpretimit pajtues të normës së kundërshtuar kur ka evidentuar se ligji apo dispozita ligjore mund të interpretohet në më shumë se një mënyrë, njëra nga të cilat është në pajtim me Kushtetutën. Kjo metodë përzgjedh rezultatin që është në pajtim me vlerat kushtetuese, duke marrë parasysh këtu të drejtat dhe liritë themelore të individëve. Bazuar në këtë metodë interpretimi, Gjykata ka arritur në përfundimin se ligji apo norma e kundërshtuar është kushtetues/e, me kusht që ai/ajo të interpretohen në mënyrën e përzgjedhur nëpërmjet arsytimit të vendimit të saj. Asnjë interpretim tjetër i dispozitave nuk është i lejueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe se mbrojtja e të drejtave të fituara nuk mund të arrihet në rast se dispozitave të kundërshtuara u jepet një kuptim tjetër⁴⁹².
508. Është për t'u theksuar se me këtë tip vendimi Gjykata Kushtetuese edhe pse nuk e shfuqizon dispozitën konkrete, në të vërtetë ndërhyr në të, në mënyrë që të rivendosë vetë tekstin në shtratin e kushtetutshmërisë, pra që ta "shpëtojë" atë nga antikushtetutshmëria.
509. Edhe kur objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi gjyqësor, kur Gjykata nuk konstaton shkelje të të drejtave të pretenduara, ajo rrëzon kërkesën. Në këto raste procesi gjyqësor mund të kundërshtohet për shkaqe të tjera, por duke respektuar afatin ligjor 4 - mujor.

490 Shih vendimin nr. 30, datë 17.06.2010 të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata ndryshoi jurisprudencën e saj për ta harmonizuar atë me praktikën e Gjykatës Europiane. Ajo riinterpretoi praktikën e saj në lidhje me gjykimin në mungesë nëpërmjet teknikës së interpretimit pajtues të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

491 Shih vendimet nr.16, datë 25.07.2008, nr. 29, datë 31.05.2010, nr.5, datë 27.01.2017, nr.9, datë 01.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata gjithashtu ka theksuar se e drejta e ligjvënësit për të rregulluar një situatë ndryshe nga ajo ekzistuese duhet të mbetet në thelb e paprekur, si një nga kërkesat e një shoqërie në zhvillim të vazhdueshëm, e cila nuk mund të kuptohet pa një kuadër normativ dinamik që i përshtatet zhvillimit të saj. Gjykata ka vlerësuar se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, si dhe t'u përgjigjet prioritetëve ose problemeve të ndryshme të vendit. Megjithatë, duhet të ritheksohet se ligjet apo dispozita të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës.

492 Shih vendimet nr. 29, datë 31.05.2010, nr. 2, datë 18.01.2017, nr. 43, datë 10.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese.

2.4. Vendimet në lidhje me boshllëkun ligjor

510. Sipas nenit 76, pika 5 të Ligjit Organik të Gjykatës, kur Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të një çështjeje, konstaton se ka boshllëk ligjor, si rrjedhojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative për të drejtat dhe liritë themelore të individit, ajo, veç të tjerave, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar. Ky parashikim është një risi e ndryshimeve të vitit 2016 (*shih edhe supra paragrafët 71-77*).
511. Kështu, në vitin 2021, ajo pati rastin që gjatë shqyrtimit të Ligjit të Pronave, të shprehej edhe mbi boshllëkun e evidentuar në këtë ligj⁴⁹³, duke vlerësuar se mungesa e rregullimit ligjor “*përbën një boshllëk ligjor, nga i cili vijjnë pasoja negative për të drejtën e pronës private*”. Në fakt edhe përpara këtij parashikimi në Ligjin Organik të Gjykatës, ajo ka pasur mundësinë të ndalet mbi boshllëkun ligjor (*shih supra paragrafin 72*), por kur ky ka ardhur si pasojë e shfuqizimit të dispozitës nga ana e saj⁴⁹⁴. Prandaj mund të thuhet se ndryshimi i përmbajtjes së Ligjit Organik të Gjykatës nuk ka ndikuar në thelbin e vendimmarrjes së saj.
512. Vlen të theksohet se, nëpërmjet kësaj teknike vendimmarrjeje, Gjykata arrin të fusë rregulla të reja në sistemin ligjor të cilat nuk gjenden në tekstin e ligjit, në ato raste kur shfuqizimi i thjeshtë i ligjit si antikushtetues nuk arrin të zgjidhë problemin e shtruar gjatë kontrollit kushtetues dhe shtimi i rregullave që mungojnë është e vetmja mënyrë për të garantuar parimet kushtetuese të cenuara.
513. Ky lloj vendimi duket sikur bie në kundërshtim me metodën e Kelsenit të shqyrtimit kushtetues, sipas të cilës Gjykata Kushtetuese duhet të jetë një “legjislator negativ”⁴⁹⁵, pasi me anë të vendimeve të tilla Gjykata e transformon veten në një krijues të rregullave ligjore, duke luajtur një rol që në sistemin parlamentar i takon kryesisht Parlamentit. *De facto*, Gjykata përmes jurisprudencës së saj gjatë shqyrtimit të akteve normative edhe pse ka theksuar se “*detyra e saj nuk është të vihet në rolin e ligjvënësit pozitiv dhe të përcaktojë rregullime ligjore, por të kontrollojë nëse zgjidhja që jep ligjvënësi është në përputhje me dispozitat e Kushtetutës*”⁴⁹⁶, nëpërmjet orientimeve që ajo i ka bërë ligjvënësit për të plotësuar boshllëkun e krijuar nga shfuqizimi i dispozitës, apo të parimeve që ai duhet të zbatojë gjatë procesit legjislativ, ka arritur një fazë të tillë evoluimi që nuk mund të mohohet roli i saj i shtuar në ligjbërje.

2.5. Vendime konstatimi dhe për dëmshpërblim

514. Edhe pse vendimet e konstatimit nuk janë të parashikuara në kategorinë e vendimeve që mund të marrë Gjykata Kushtetuese në përfundim të kontrollit kushtetues, kjo e fundit në jurisprudencën e saj përpara ndryshimeve të viti 2016, ka marrë edhe vendime të këtij lloji, përgjithësisht kur është ndalur në analizën e parimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit⁴⁹⁷.
515. Gjykata, kur në shqyrtimin e çështjes kufizohej vetëm në konstatimin e shkeljes së të drejtës, ka dhënë vendime pa ndonjë efekt të dobishëm për kërkuesin, pasi ato sikurse u theksua më lart (*shih supra paragrafin 359*), nuk parashikonin ndonjë mënyrë për rivendosjen e së drejtës së shkelur dhe

493 Shih vendimin nr. 04, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

494 Shih vendimin nr. 12, datë 14.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

495 H. Kelsen “*La garantie juridictionnelle de la constitution (La Justice constitutionnelle)*”, *Revue du droit public et de la science politique en France et a l'étranger*, Librairie Général de Droit et the Jurisprudence, Paris 1928, fq. 197 e vijues; A. S. Sweet, *Constitutional Courts*, Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law, OUP, 2012, fq.4

496 Shih vendimin nr. 12, datë 14.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

497 E drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, nën dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së është analizuar si gjatë gjykimit ashtu edhe në fazën e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë, edhe pse jurisprudenca kushtetuese është ndalur kryesisht në fazën e ekzekutimit.

për të cilat GJEDNJ-ja ka vërejtur se vetë gjykimi kushtetues rezulton të mos jetë (ose të paktën jo gjithmonë) një mjet efektiv.

516. Sa i përket të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, parashikimi i mjeteve të reja ligjore (nenet 399/1 e vijues të KPC-së) nga ligjvënësi për konstatimin e shkeljes, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e drejtë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në rastet e tejkallimit të afatit të arsyeshëm në shqyrtimin e çështjes edhe pse përbën një hap përpara në krahasim me disiplinën e mëparshme, megjithatë, nuk është pa kufizime, duke qenë se Gjykata Kushtetuese, kur i merr në shqyrtim, nuk ka përsëri mundësinë për shpërblimin e dëmit.
517. Në gjendjen e fakteve, Gjykata nën dritën e GJEDNJ-së, i ka marrë përsëri në shqyrtim kërkesat për cenimin e afatit të arsyeshëm, me qëllimin që të vlerësojë efektivitetin e tyre në praktikë, nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret⁴⁹⁸.
518. Ndërsa në rast se kërkesa ka për objekt tejzgjatjen e procesit nga ana e vetë Gjykatës, neni 71/ç i Ligjit Organik të Gjykatës parashikon të vetmin rast kur Gjykata mund të japë dëmshpërblim. Konkretisht, nëse nga fillimi i shqyrtimit të çështjes ka kaluar më shumë se një vit dhe Gjykata nuk ka dhënë një vendim, kushdo që ka qenë palë në proces kushtetues, pra edhe individit ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim. Në këtë rast Gjykata vlerëson shkaqet dhe rrethanat dhe vendos për pranimin ose jo të kërkesës, si dhe për masën e shpërblimit duke iu referuar pasojave që kanë ardhur për kërkuessin. Ajo mund të japë deri në 100.000 lekë dëmshpërblim për çdo vit vonesë.
519. Duhet evidentuar se në praktikë kjo procedurë, e cila hyri në fuqi me ndryshimet legislative të reformës në drejtësi 2016⁴⁹⁹, nuk është zbatuar asnjëherë deri më tani. Jo vetëm që nuk ka pasur kërkesa të individëve që të ankoheshin për tejkallim të afatit të arsyeshëm të gjykimit kushtetues të çështjes, por të dhënat statistikore tregojnë se Gjykata, pas rifunksionalizimit të saj me plotësimin e kuorumit të nevojshëm në vitin 2020, çështjet i ka shqyrtuar në kohë relativisht të shpejtë.
520. Gjykata edhe aktualisht është e privuar për të dhënë dëmshpërblim për liritë dhe të drejtat themelore të cenuara. Megjithatë, në praktikën e saj të punës, nuk kanë munguar edhe raste të të drejtave dhe lirive të tjera themelore, përtej asaj për gjykimin brenda afatit të arsyeshëm, ku në përfundim të gjykimit, është dhënë vendim konstatimi, pa shfuqizuar vendimin gjyqësor apo ligjin e kundërshtuar në objekt të ankimit.
521. Kështu, në një rast, Gjykata me vendimin përfundimtar konstatoi cenimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të ankimit ndaj urdhrin të ministrit të Drejtësisë "Për vendosjen në regjimin e posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë për të kërkuessin e paraburgosur", si pasojë e mosrespektimit të parimit të kontradiktoritetit. Në atë rast, gjykatat e zakonshme nuk kishin vlerësuar nëse të dhënat e akteve, mbi të cilat ishte bazuar urdhri i ministrit të Drejtësisë, ishin marrë në përputhje me ligjin, nëse kërkuessi duhej të ishte njohur me to, si dhe nëse në nxjerrjen e tyre organet shtetërore kishin vepruar në përputhje me ligjin dhe jo në mënyrë abuzive ose arbitrare. Gjykata i vlerësoi pretendimet në kontekstin e statusit të kërkuessit, të cilit i ishte hequr liria sipas nenit 27, pika 2, shkronja "c", të Kushtetutës, dhe pa paragjykuar fajësinë e tij për veprat penale që akuzohej, theksoi se sipas nenit 15 të Kushtetutës, organet e pushtetit publik kanë detyrimin të respektojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor edhe ndaj personave, të cilëve sipas ligjit iu është kufizuar liria, pasi, ashtu si të drejtat e tjera, edhe kjo e drejtë është e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme. Në përfundim, Gjykata vlerësoi se dërgimi

498 Shih vendimet nr. 33, 34 dhe 35, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

499 Ligji nr. 99/2016 për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Organik të Gjykatës.

i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për të, pasi ishin shuar efektet e urdhrit të kundërshtuar për shkak të mbarimit të afatit të tij.⁵⁰⁰

522. Me të njëjtën linjë arsyetimi, Gjykata konstatoi cenimin e të drejtës së procesit të rregullt ligjor në aspektin e aksesit në gjykatë pasi gjykata e apelit kishte vendosur mospranimin e ankimit, për shkak se atij (ankimit) nuk i ishte bashkëlidhur prokura e lëshuar nga kërkuesi dhe në vijim, Gjykata e Lartë kishte vendosur mospranimin e rekursit. Gjykata vërejti se kërkuesi e kishte lëshuar prokurën gjatë gjykimit në shkallë të parë, pra përpara shqyrtimit të çështjes në shkallë të dytë dhe se ai vetë ishte në pamundësi të paraqitej personalisht në gjykim, për shkak se i ishte kufizuar liria e lëvizjes. Edhe në këtë rast, Gjykata vlerësoi se ndonëse pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë ishte i bazuar, dërgimi i çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk do të sillte ndonjë rezultat konkret për të, pasi ekzekutimi i masës parandaluese të kufizimit të lëvizjes kishte përfunduar. Për rrjedhojë, Gjykata çmoi të shprehej vetëm për konstatimin e cenimit të të drejtës për akses në gjykatë.⁵⁰¹
523. Në një rast tjetër, të paraqitur së fundmi përpara Gjykatës, një qytetare u ankua se autoritetet shtetërore prej pothuajse 20 vjetësh nuk kishin hetuar dhe vënë përpara përgjegjësisë penale autorët e vrasjes së vëllait të saj, të kryer në vitin 1995. Gjykata vuri re se prokuroria nuk kishte kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, në mënyrë që të siguronte zbatimin efektiv të ligjit për të siguruar mbrojtjen e së drejtës së jetës. Ajo theksoi se detyrimi pozitiv i shtetit në mbrojtje të jetës kërkon hetim efektiv dhe të shpejtë, i cili të jetë në gjendje të identifikojë personat përgjegjës, me qëllim ndëshkimin e tyre, pavarësisht pengesave që mund të vështirësojnë progresin e hetimit në një situatë të veçantë. Një përgjigje efektive nga organi i ndjekjes penale konsiderohet thelbësor në ruajtjen e besimit të publikut, respektimin e shtetit të së drejtës dhe parandalimin e akteve të paligjshme. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së jetës për shkak të mungesës së hetimeve të plota dhe efektive nga organi i ndjekjes penale është i bazuar. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se kalimi i kohës së gjatë kishte shkaktuar tashmë parashkrimin e ndjekjes penale, arriti në përfundimin se ajo mund të vendoste vetëm konstatimin e shkeljes së të drejtës për jetës së garantuar nga neni 21 i Kushtetutës dhe neni 2 i KEDNJ-së, në aspektin procedural, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për kryerjen e hetimeve të plota dhe efektive⁵⁰².

2.6. Vendimet e rrëzimit formal

524. Sipas Ligjit Organik të Gjykatës, përpara ndryshimeve të vitit 2016, kur gjatë votimit votat ndaheshin në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar, Gjykata Kushtetuese vendoste refuzimin e kërkesës. Refuzimi nuk përbënte pengesë që kërkuesi të riparaqiste kërkesën në rast se krijoheshin kushte për formimin e shumicës së kërkuar⁵⁰³, sikurse ka ndodhur në jurisprudencën e Gjykatës⁵⁰⁴.
525. Raste të refuzimit kërkesës nuk kanë munguar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁵⁰⁵. Ato

500 Shih vendimin nr. 5, datë 22.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese

501 Shih vendimin nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese.

502 Shih vendimin nr. 42, datë 29.05.2024 të Gjykatës Kushtetuese.

503 Neni 74 i Ligjit Organik të Gjykatës, tashmë i shfuqizuar nga ligji nr. 99/2016.

504 Shih vendimet nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 4, datë 15.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

505 Shih vendimet nr. 16, datë 01.03.2017, nr. 58, datë 04.08.2016 dhe nr. 54, datë 27.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

kanë qenë një prej mangësive të konstatuar nga GJEDNJ-ja për procesin në Gjykatën Kushtetuese, pasi cenon kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së personat që nisin procese gjyqësore duhet të gëzojnë ndaj gjykatave garancitë themelore që parashikon neni 6, garanci në të cilat përfshihet edhe drejta për një vendim përfundimtar për çështjet e paraqitura në gjykatë, përfshi edhe Gjykatën Kushtetuese. Pamundësia e Gjykatës Kushtetuese për të siguruar shumicën e kërkuar të votave për çështjet në shqyrtim, lë ankuesin pa një vendim përfundimtar dhe për rrjedhojë kufizon thelbin e së drejtës së tij për t'u dëgjuar nga gjykata. Në këtë kuptim, është diktesa normative kushtetuese dhe ligjore që imponon këtë lloj zgjidhjeje, prandaj për një vendimmarrje në pajtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së, me qëllim sigurimin e të drejtave dhe lirive themelore, përmirësimi i Ligjit Organik të Gjykatës nga organi ligjvënës mbetet prioritet në këtë drejtim⁵⁰⁶.

526. Në lidhje me parashikimet ligjore në vende të ndryshme për rastet kur trupi gjyqësor nuk ka arritur të formojë një shumicë për marrjen e vendimit "... diku vlen vota mbizotëruese e Kryetarit, diku tjetër, kjo do të thotë vlefshmëri e aktit që gjykohet, diku tjetër vendimi quhet i marrë derisa të arrihet shumica"⁵⁰⁷.
527. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të vitit 2016 në Ligjin Organik të Gjykatës, rasti i refuzimit të votave nuk parashikohet më dhe vendimi konsiderohet i marrë vetëm atëherë kur arrihet shumica e votave të kërkuara nga ligji. Nëse nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar⁵⁰⁸. Raste të tilla në jurisprudencën kushtetuese nuk kanë munguar, të paktën kur përbërja e Gjykatës nuk ishte e plotë me nëntë gjyqtarë.⁵⁰⁹ Duhet vënë re se në këto raste, arsyetimi i çështjes nuk është shterues në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të kërkuarit, ai kufizohet vetëm në paraqitjen e qëndrimeve të gjyqtarëve, duke konkluduar se ankimi rrëzohet *ipso jure* për shkak të mungesës së kuorumit.

Seksioni 3

Hyrja në fuqi e vendimeve

528. Në procesin e vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, rëndësi të veçantë merr edhe shpallja e vendimit, si dhe hyrja në fuqi e tij. Ndër këto faza të vendimmarrjes, vetëm hyrja në fuqi e vendimeve gjen rregullim kushtetues, pasi është e parashikuar në nenin 132, pika 2 të Kushtetutës, ndërsa aspektet e tjera janë të rregulluara nga Ligji Organik i Gjykatës.
529. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si rregull, hyjnë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Gjithsesi Gjykata Kushtetuese kur objekt i ankimit kushtetues individual ka qenë ligji ose akti tjetër normativ, i cili është shfuqizuar, ka vendosur që ai të hyjë në fuqi në një datë tjetër⁵¹⁰. Ky rregull i fundit në praktikë përdoret në bazë të parimit të sigurisë juridike, pra për t'i dhënë kohën e përshtatshme organeve publike dhe qytetarëve të njihen me përmbajtjen e vendimit dhe ta zbatojnë atë si duhet.
530. Hyrja në fuqi është një koncept i ndryshëm nga efektet juridike të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, pasi këto të fundit mund të jenë edhe me fuqi prapavepruese kur verifikohet ndonjë nga rastet e parashikuara në Ligjin Organik të Gjykatës (*shih supra paragrafin 497*).

506 Shih vendimin *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, 18.12.2007, § 124.

507 K. Traja, *Drejtësia Kushtetuese*, Luarasi, Tiranë, 2000, fq. 98.

508 Neni 73, pika 4 i *Ligjit Organik të Gjykatës*.

509 Shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021 dhe nr. 15, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese.

510 Shih nenin 76, pika 4 të *Ligjit Organik të Gjykatës*.

Kreu III

Gabimet në vendimmarrje

Seksioni 1

Plotësimi dhe ndreqja e gabimit në vendim

531. Vendimet e Gjykatës, qofshin këto të në lidhje me pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual (vendimet e Kolegjit apo Mbledhjes së Gjyqtarëve) apo me themelin (vendimet e Gjykatës), pasi janë marrë dhe shpallur apo publikuar, nuk mund të ndryshohen.
532. Gjithsesi në disa raste të përcaktuara Ligji Organik i Gjykatës lejon që ato të "rishikohen". Konkretisht sipas nenit 80 të këtij ligji: *"1. Gjykata Kushtetuese ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. 2. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Gjykata Kushtetuese merr vendim, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare."*
533. Nga përmbajtja literale e këtij neni qartazi rezulton se vendimi vetëm mund të ndreqet, pra pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, për gabimet materiale, që janë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi e dukshme në vendim. Ky rregull, kuptohet vlen për të gjitha vendimet e Gjykatës dhe jo vetëm për ato që kanë për objekt ankim kushtetues individual.
534. Duke qenë se neni 80 i lartpërmendur duket se parashikon rastet e ndreqjes së gabimeve të Gjykatës (vendimet e themelit), në Rregulloren e Gjykatës janë përcaktuar edhe rastet kur gabimet kanë të bëjnë me vendimet e moskalimit të çështjes në seancë plenare. Neni 43 i saj parashikon se: *"1. Vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose i Gjykatës Kushtetuese pas votimit nuk mund të ndryshohet. 2. Kryesisht ose me kërkesë të palëve, e cila duhet të paraqitet brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit, Gjykata ka të drejtë të plotësojë vendimin ose të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të. 3. Kompetent për shqyrtimin e kërkesës është i njëjti Kolegj që ka dhënë vendimin, Mbledhja e Gjyqtarëve ose Gjykata, sipas llojit të vendimit që kërkohet të saktësohet, plotësohet ose ndreqet. 4. Në rast se bëhet fjalë për vendim të marrë në seancë plenare publike, shqyrtimi i kërkesës bëhet po në seancë plenare publike, me pjesëmarrjen e palëve."*
535. Bëhet fjalë për dy hipoteza: (i) plotësim vendimi, që përfshin rastin kur vendimi ka mungesë të dukshme rrethane, e cila nuk ndikon në thelbin e vendimmarrjes, por mund të cenojë qartësinë e tij; dhe (ii) ndreqje e gabimit material në vendim, që përfshin pasaktësitë në shkrim, pasaktësi në llogari ose pasaktësi të dukshme.
536. Nga përmbajtja e dispozitave të lartpërmendura mund të thuhet se kjo lloj kërkesë:
- mund të bëhet nga subjekti që ka qenë palë në vendim dhe në këtë rast duhet të paraqitet brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit, përndryshe ai nuk mund të legjitimohet *ratione temporis*;
 - mund të bëhet kryesisht nga Gjykata dhe në këtë rast bëhet në çdo kohë;
 - shqyrtohet nga e njëjta trupë që ka dhënë vendimin;
 - për vendimet e dhëna në seancë publike, shqyrtimi i saj bëhet po në seancë publike.
537. Neni 80 i Ligjit Organik të Gjykatës ka qenë pjesë e ndryshimeve të vitit 2016. Në formulimin e tij fillestar ai parashikonte si mundësi edhe interpretimin e vendimeve. Ky nen parashikonte se: *"1.*

Gjykata Kushtetuese nuk mund të anullojë ose të ndryshojë vendimin e saj, por ajo ka të drejtë: a) të interpretojë vendimin në rast dyshimi ose mosmarrëveshje për kuptimin e tij, pa ndryshuar në asnjë rast përmbajtjen; b) të plotësojë vendimin ose të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në të, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. 2. Shqyrtimi i çështjeve të mësipërme bëhet në seancë plenare, me pjesëmarrje të palëve". Tashmë interpretimi i vendimit nuk parashikohet si mundësi e rishikimit të vendimit.

538. Në praktikë, kur Gjykata ka konstatuar se në vendimin e saj është bërë një gabim material, ajo ka pranuar kërkesat për ndreqje gabimi duke zëvendësuar fjalët, ku është evidentuar gabimi, me ato të duhurat.⁵¹¹ Në këto raste kopja e vendimit të ndreqjes së gabimit i bashkohet vendimit për të cilin është kërkuar interpretimi.
539. Ndërsa në rastet kur është vlerësuar se pretendimet e kërkuarit janë të natyrës teknike gjuhësore që nuk ndryshojnë thelbin e vendimit që kërkohet të plotësohet, kërkesa për ndreqje gabimi nuk është pranuar nga Gjykata.⁵¹²

Seksioni 2

Interpretimi i vendimeve

540. Kërkesat për interpretim të vendimeve janë marrë në disa raste në shqyrtim nga Gjykata.
541. Sa u takon kërkesave për interpretim të paraqitura përpara ndryshimeve të vitit 2016, në rastet kur pretendimet e kërkuarit kanë pasur të bëjnë me çështje të themelit të mosmarrëveshjes, ato janë vlerësuar haptazi të pabazuara.⁵¹³ Po kështu nëse kërkesa është paraqitur nga subjekte që nuk kanë qenë palë në vendimin që është kërkuar të interpretohet, ata nuk janë legjitimuar *ratione personae*.⁵¹⁴
542. Ndryshe ka vepruar Gjykata në rastet kur është kërkuar interpretimi i vendimit të saj, i cili në pjesën arsyetuese të tij shprehet për shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor vetëm për një prej të pandehurve (i cili përkon me kërkuarin në vendimin që kërkohet të interpretohet), ndërkohë që në dispozitiv duke shfuqizuar vendimin/vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, por nuk përcakton nëse vendimmarrja ka efekt vetëm për atë të pandehur apo edhe për të bashkë të pandehurit e tjerë (të cilët nuk kanë kundërshtuar vendimin gjyqësor). Në këto çështje Gjykata ka pranuar se dispozitivi i vendimit për të cilin kërkohet interpretimi, duhet të jetë në pajtim dhe harmoni me pjesën arsyetuese të vendimit, duke theksuar se shfuqizimi i vendimit duhet të kuptohet se shtrihet vetëm ndaj të pandehurit për të cilin është konstatuar shkelja. Për këto arsye ajo ka pranuar kërkesat për interpretim.⁵¹⁵
543. Lidhur me kërkesat për interpretim të paraqitura pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të vitit 2016, është vlerësuar se Gjykata nuk ka më kompetencë *ratione materiae* për shqyrtimin e këtij lloji kërkimi të ankimit kushtetues individual.⁵¹⁶

511 Shih vendimet nr. 26, datë 16.05.2023; nr. 27/1, datë 05.11.2021; nr. 33 datë 09.06.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

512 Shih vendimin nr. 113, datë 11.10.2013 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

513 Shih vendimin nr. 31, datë 02.03.2016 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

514 Shih vendimin nr. 50, datë 02.04.2015 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

515 Shih vendimet nr. 6, datë 05.03.2008; nr. 23, datë 23.04.2012; nr. 1, datë 19.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

516 Shih vendimin nr. 14, datë 02.02.2022 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

Seksioni 3

Rihapja e procedurave

544. Përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2016, jurisprudenca e GJEDNJ-së i kishte kushtuar rëndësi të vazhdueshme parimit të njohur të së drejtës ndërkombëtare *restitutio in integrum* duke vlerësuar se një vendim i saj, i cili konstaton shkelje, vendos për Shtetin Përgjegjës detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të riparuar pasojat në mënyrë të tillë që të vendoset sa më shumë të jetë e mundur situata ekzistuese përpara shkeljes.
545. Duke qenë se në legjislacionin shqiptar mungonin mjetet e duhura për rihapjen e procedurave, ky boshllëk u plotësua nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 20, datë 01.06.2011. Në këtë çështje, kërkuesi Xheraj⁵¹⁷ i ishte drejtuar GJEDNJ-së, e cila vlerësoi se argumentet e palëve të përdorura nga prokurori për të justifikuar kërkesën për rivendosje në afat ishin të pamjaftueshme për të justifikuar vënien në pikëpyetje të një vendimi përfundimtar dhe për të përdorur këtë mjet të jashtëzakonshëm. Lejimi i kërkesës së prokurorit nuk vendoste një baraspeshë ndërmjet interesit të aplikantit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale. Si përfundim, sipas GJEDNJ-së mënyra e duhur për rivënien në vend të të drejtës së shkelur të aplikantit do të ishte rikonfirmimi nga autoritetet përkatëse i vendimit të pafajësisë, ku ishte vendosur pranimi i kërkesës së kërkuetit dhe pushimi i çështjes, sepse ai nuk e kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohet.⁵¹⁸ Pas dhënies së vendimit nga GJEDNJ-ja, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për ekzekutimin e tij, duke kërkuar njohjen e pafajësisë për veprën penale. Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese vendosi mospranimin e kërkesës, duke përcaktuar se organi shtetëror kompetent për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi i sipërpërmendur i GJEDNJ-së ishte Gjykata e Lartë.
546. Mirëpo, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vendosi mospranimin e kërkesës për rishikim të kërkuetit, duke theksuar se fakti që GJEDNJ-ja kishte konstatuar një shkelje të të drejtës për një proces të rregullt ligjor ndaj shtetasit të sipërpërmendur, përbënte një indicie për nisjen e një gjykimi kushtetues dhe jo rishikues.
547. Gjykata Kushtetuese e rivënë në lëvizje nga kërkuesi theksoi, krahas domosdoshmërisë së plotësimi nga Kuvendi të boshllëkut ligjor në legjislacionin penal procedural, se Gjykata e Lartë duhet të bënte përpjekje për të gjetur zgjidhjen e duhur, për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuetit, pasi një vendim i mundshëm i Gjykatës, do të kishte si pasojë, gjithsesi, rishqyrtimin e çështjes nga Gjykata e Lartë.⁵¹⁹

517 Xheraj ishte dënuar në mungesë për kryerjen e një vepre penale. Pas marrjes dijeni të këtij fakti, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, aplikanti iu drejtua gjykatave të zakonshme. Me vendim të gjykatës së apelit ai u shpall i pafajshëm. Në vijim, prokurori i çështjes bëri kërkesë jashtë afatit në Gjykatën e Lartë për rivendosje në afat të së drejtës së rekursit, e cila u pranua nga Gjykata e Lartë. Aplikanti pretendoi se procesi për rishikimin e vendimit të pafajësisë së tij, i cili ishte përfundimtar, kishte qenë i padrejtë, pasi as ai dhe as avokati i tij nuk ishin informuar për seancat gjyqësore dhe si rezultat, atij i ishte cenuar e drejta e mbrojtjes.

518 Shih vendimin Xheraj kundër Shqipërisë, nr. 37959/02, datë 29.07.2008.

519 Ajo u bazua në një rast të ngjashëm të marrë në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese italiane, e cila kishte pohuar se: "Në lidhje me një të drejtë themelore, respektimi i detyrimeve ndërkombëtare nuk mundet asnjëherë të jetë shkak i një zvogëlimi të mbrojtjes së saj në krahasim me ato të parashikuara tashmë nga rendi i brendshëm, por mund dhe duhet, përkundrazi, të përbëjë instrument efikas të zgjerimit të vetë mbrojtjes. Nëse merret kjo si pikënisje në shqyrtimin e marrëdhënies së ndërmjetme normative midis niveleve të ndryshme të garancive, arrihet lehtësisht në përfundimin, se vlerësimi përfundimtar në lidhje me forcën efektive të mbrojtjes në raste të veçanta është frut i një kombinimi virtuoz ndërmjet detyrimit që bie mbi ligjvënësin kombëtar për t'u përshtatur me parimet e vendosura nga GJEDNJ-ja, në interpretimin e saj gjyqësor, detyrim që në të njëjtën mënyrë bie mbi gjyqtarin e zakonshëm që t'i japë normave të brendshme një interpretim në përputhje me parimet e Konventës, dhe detyrimin që në fund bie mbi Gjykatën Kushtetuese – në hipotezën e pamundësisë së një interpretimi pajtues – që të mos lejojë të vazhdojë të ketë vlerë ligjore në sistemin juridik italian një normë për të cilën është vërtetuar deficit (mungesa, pamjaftueshmëria) i mbrojtjes në lidhje me një të drejtë themelore. Për më tepër, neni 53 i vetë KEDNJ-së përcakton se interpretimi i dispozitave të KEDNJ-së nuk mund të përmbajë nivele mbrojtjeje inferiore nga ato të siguruar nga burimet kombëtare." (Shih vendimin nr.317, datë 30.11.2009).

548. Të njëjtin qëndrim mbajti Gjykata Kushtetuese edhe në vendimin nr. 45, datë 01.11.2013 të saj, në lidhje kërkuesin Shkalla. Edhe në këtë rast pas vendimit të GJEDNJ-së⁵²⁰ që ka arritur në përfundimin se në procesin e zhvilluar ndaj tij ka pasur cenim të nenit 6 të KEDNJ-së, kërkuesi iu drejtua me kërkesë për rishikim Gjykatës së Lartë, e cila nuk e pranoi atë, me arsyetimin se GJEDNJ-ja kishte gjetur shkelje në gjykimin kushtetues dhe jo në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë.
549. Gjykata u shpreh se garantimi i zbatimit korrekt të ligjit penal, procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ishte detyrë e Gjykatës së Lartë dhe për atë lindte detyrimi që të riparonte pasojat e shkeljeve të konstatuara nga GJEDNJ-ja, që në rastin konkret kishin ardhur si rezultat i mosnjohimit të kërkuesit për procesin penal që po zhvillohej ndaj tij dhe gjykimin e tij *in absentia*.
550. Pas këtyre vendimeve, rihapja e procesit penal si rezultat i shkeljeve të konstatuara nga vendimi i GJEDNJ-së është parashikuar nga neni 450 i KPP-së,⁵²¹ i cili në pikën 1, shkronjën "d" e konsideron shprehimisht këtë situatë si shkak për rishikimin e vendimit penal të formës së prerë. Vlen këtu të përmendet se mjeti i rishikimit për të njëjtin shkak, bazuar në nenin 494, shkronja "ë" të KPC-së, i lidhur edhe me nenin 1, pika 2 të Ligjit të Gjykatave Administrative, është tashmë në dispozicion të individit edhe në gjykimin civil dhe atë administrativ.
551. Ligji Organik i Gjykatës pas ndryshimeve të vitit 2016, në nenin 71/c të tij për herë të parë parashikoi rihapjen e procesit gjyqësor. Sipas pikës 3 të këtij neni "*nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur më parë mbi një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesit gjyqësor*".
552. Pikat vijuese të këtij neni parashikojnë se kërkesa për rihapje të procesit para Gjykatës Kushtetuese paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Ajo duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, si dhe kërkimet konkrete. Kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit dhe shfuqizimin e aktit.
553. Kërkesa për rihapje të procesit nuk pranohet nëse:
- pasojat e cenimit të të drejtave dhe lirive themelore nuk ekzistojnë më;
 - gjykata ndërkombëtare ka dhënë një dëmshtëpërbllim, pa e shoqëruar me rihapje të procesit (*just satisfaction*);
 - cenimi është mënjeluar nga një rregullim i ri ligjor ose forma të tjera.
554. Gjykata Kushtetuese, kur pranon kërkesën, vendos:
- shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe pranimin e kërkesës;
 - shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe njëkohësisht të aktit që ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesit dhe detyrimin e organit kompetent të nxjerrë një akt të ri ose detyrimin e organit të mos veprojë, sipas rastit.

520 Shih vendimin *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, datë 10.08.2011.

521 Pas ndryshimeve me ligjin nr. 35, datë 30.03.2017 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar*".

555. Jurisprudenca kushtetuese mbi këtë mjet të ri u përball me nevojën për të përcaktuar rastet se kur rihapja e procesit hyn në kompetencën e Gjykatës, duke qenë se normalisht, për shkak të natyrës subsidiare të gjykimit kushtetues, shkeljet e të drejtave dhe lirive themelore të individit duhet të riparohen gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm ose nga organe të tjera publike.
556. Pas vendimit të GJEDNJ-së në çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë*⁵²², e cila ka gjetur shkelje të nenit 6 § 1, të KEDNJ-së në lidhje me parimin e “gjykatës të krijuar me ligj”, Gjykata është vënë në lëvizje nga disa subjekte të rivlerësimit kalimtar me kërkesa për rishikimin e vendimeve të KPA-së. Duke qenë se ato kishin të bënin me procesin e rivlerësimit kalimtar, për të cilat Gjykata ka theksuar se juridiksioni i saj në shqyrtimin e këtyre çështjeve është i kufizuar nga vetë Kushtetuta dhe nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë, Kolegjet e Gjykatës, duke konstatuar se në vendimin e GJEDNJ-së të paraqitur nga kërkuesi si shkak rishikimi nuk ka asnjë gjetje ose konstatim që lidhet me juridiksionin kushtetues, kanë vlerësuar se edhe këto lloj çështjesh nuk hynin në juridiksionin kushtetues për sa kohë që objekt i kërimit ishte rishikimi i vendimit të një organi tjetër kushtetues, KPA-së.⁵²³
557. Në vijim, u evidentuan disa raste që lidheshin me shkeljet e konstatuara nga GJEDNJ-ja në lidhje me zbatimin e afatit 4 – mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, në momentin e hyrjes në fuqi të tij.⁵²⁴ Duke qenë se në këto raste shkelja lidhej vetëm me gjykimin kushtetues, duket se *restitutio in integrum* realizohet nëpërmjet rihapjes së gjykimit kushtetues, por gjithnjë nëse përmbushen kriteret e tjera të parashikuara nga neni 71/c i Ligjit Organik të Gjykatës.
558. Ndërsa në një rast tjetër, një qytetare kishte fituar çështjen në GJEDNJ, e cila kishte konstatuar shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, në aspektin e aksesit në gjykatë për shkak të nxjerrjes jashtë juridiksionit të padisë së saj që lidhej me marrëdhëniet e punësimit. Pas dhënies së vendimit të GJEDNJ-së, ajo paraqiti dy kërkesa njëkohësisht: kërkesë për rishikimin e vendimit gjyqësor drejtuar Gjykatës së Lartë dhe kërkesë për rihapjen e procesit kushtetues drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kushtet kur kjo e fundit kishte vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Mbledhja e Gjyqtarëve nuk e pranoi kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke vënë në dukje se, ndonëse GJEDNJ-ja kishte gjetur shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, në aspektin e cenimit të së drejtës së aksesit, ajo kishte evidentuar se cenimi ishte rezultat i vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, e cila, sipas GJEDNJ-së, kishte penguar realizimin e së drejtës së kërkueses për rregullimin e pasojave nga zgjidhja e padrejtë e kontratës së punës. Për pasojë, mënyra e duhur për rivënien në vend të së drejtës së shkelur të kërkueses do të ishte rihapja e çështjes nga ajo gjykatë⁵²⁵.
559. Sa më lart, jurisprudenca kushtetuese deri më tani⁵²⁶ ka përcaktuar disa standarde procedurale të rëndësishme për rihapjen e procedurave, që mund të përmblihen në vijim:
- o nëse kërkuesi, pas vendimit të GJEDNJ-së, i drejtohet sërish Gjykatës dhe kërkon sipas rastit, rihapjen e procedurës dhe shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës, atëherë kompetent për shqyrtimin e kërkesës është ajo trupë që ka dhënë vendimin e kundërshtuar;

522 Shih footnote nr. 139.

523 Shih vendimet nr. 42, datë 22.02.2023, nr. 48, datë 28.02.2023; nr. 54, datë 13.03.2023; nr. 69, datë 04.04.2023 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

524 Shih vendimin *Çela kundër Shqipërisë*, cituar më lart. I njëjti qëndrim u konfirmua edhe në vendimin *Supergrav kundër Shqipërisë*, cituar më lart.

525 Shih vendimin nr. 103, datë 14.05.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

526 Shih vendimet nr. 42, datë 22.02.2023 dhe nr. 205, datë 09.10.2023 të Kolegjit të Gjykatës, vendimin nr. 103, datë 14.05.2024 të Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe vendimin nr. 67, datë 06.12.2023 të Gjykatës Kushtetuese

- o afati 4 mujor i paraqitjes së kërkesës fillon nga hyrja në fuqi e vendimit të GJEDNJ-së, pra nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 71/c, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe nenit 6, shkronja "dh", të ligjit nr. 78/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare";
- o qëllimi i kërkesës, në kuptim të nenit 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës, është rivendosja e kërkuarit në situatën që ishte para shkeljes së konstatuar, d.m.th. kjo lloj kërkesë nuk i jep të drejtën atij të paraqesë një ankim të ri kushtetues, me shkaqe të reja apo të ndryshme nga ato që ka paraqitur në kërkesën me të cilën ka vënë në lëvizje procesin për të cilin kërkon rihapjen;
- o kur procesi i parë, i cili kërkohet të rihapet, në Gjykatë ka përfunduar për shkak të moslegjitimitit *ratione temporis*, duke mos vijuar më tej me shqyrtimin e kriterëve të tjera të legjitimitit, shqyrtimi kushtetues, pas rihapjes së procesit, do të vijojë pikërisht me verifikimin e kriterëve të tjera të legjitimitit të kërkuarit, çka do të thotë në të njëjtën fazë në të cilën ka qenë procesi i gjetur nga GJEDNJ-ja në kundërshtim me Konventën.⁵²⁷
- o shkaku që paraqitet në kërkesën për rihapjen e procesit kushtetues duhet të jetë gjetje ose konstatim i gjykatës ndërkombëtare, që lidhet me juridiksionin kushtetues (pra që nuk i përket juridiksionit të një organi tjetër kushtetues, siç është KPA);
- o Shkelja e të drejtës ose lirisë themelore, që është konstatuar nga gjykata ndërkombëtare, duhet të jetë rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që ka përfunduar procesin kushtetues, i cili kërkohet të rihapet.

560. Së fundmi, vlen të evidentohet se në praktikë nuk kanë munguar rastet kur Gjykata është vënë në lëvizje për rishikimin e vendimeve të saj, kryesisht ato të Kolegjit, kërkesa të cilat paraqisnin shkaqe të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 71/c të Ligjit Organik të Gjykatës. Në këto raste Gjykata ka vlerësuar se rishikimi i vendimeve të saj nuk parashikohet në Ligjin Organik të Gjykatës, dhe nuk i ka pranuar kërkesa të tilla.⁵²⁸ I njëjti qëndrim është mbajtur edhe kur objekt i ankimit kushtetues individual ka qenë shfuqizimi⁵²⁹ apo anulimi⁵³⁰ i vendimeve të Gjykatës/Kolegjit.

Kreu IV

Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

561. Nga momenti i hyrjes në fuqi vendimi i Gjykatës sjell efekte juridike. Përveç efekteve *erga omnes* apo *inter partes* të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, ai ka fuqi detyruese të përgjithshme dhe është përfundimtar⁵³¹.
562. Në lidhje me efektet e vendimeve Gjykata në jurisprudencë konstante ka theksuar se nenet 124, 132 dhe 145, pika 2 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues.

⁵²⁷ Është e qartë që ky standard vlen për të gjitha kriteret e legjitimitit të individit për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

⁵²⁸ Shih vendimet nr. 36, datë 30.03.2022, nr. 67, datë 12.04.2021 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

⁵²⁹ Shih vendimin nr. 5, datë 15.01.2021 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

⁵³⁰ Shih vendimin nr. 71, datë 05.04.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

⁵³¹ Neni 132, pika 1 i Kushtetutës si dhe neni 76, pika 1 e Ligjit Organik të Gjykatës.

563. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit⁵³². Asnjë organ tjetër me përjashtim të vetë Gjykatës (dhe kjo lidhet me ndryshimin e praktikës, apo rishikimin e Kushtetutës), nuk mund të mos pranojë t'i zbatojë ato. Lënia në vlerësimin e organeve të tjera të vendimeve kushtetuese krijon precedentin e rrezikshëm për t'i mohuar këtij organi funksionin e garantit të Kushtetutës. Roli i Gjykatës qëndron pikërisht në fuqinë detyruese të vendimeve të saj. Formulimi që i ka dhënë Kushtetuta fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përcakton autoritetin e këtij organi dhe është e vetmja mënyrë e pranueshme për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjeve me natyrë kushtetuese⁵³³.
564. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj buron nga autoriteti i saj për të thënë fjalën e fundit në çështjet, për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane⁵³⁴ ka theksuar se efekti detyrues shtrihet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që u imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj.

532 Shih vendimin nr. 5, datë 07.02.2001 të Gjykatës Kushtetuese. Për më tepër shih edhe K. Traja, parathënie e Sokol Sadushi, vep. cit., fq. 53. Autori shprehet se t'u përmbahesh urdhërimeve të vendimeve të Gjykatës është një detyrim. Në fund të fundit, karakteristikat e këtij urdhërimi janë po ato të normave juridike: ai ka natyrë normative, detyeshmëri të përgjithshme, sanksionim shtetëror, përcaktueshmëri formale dhe formë dokumentare.

533 Shih vendimet nr. 18, datë 30.03.2021, nr. 49, datë 03.07.2017, nr. 15, datë 01.03.2017, nr. 44, datë 29.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese.

534 Shih vendimet BVerfGE 1, § 14 dhe BVerfGE 20, § 56 të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane.

Bibliografia

Literatura

1. A. Anastasi *Shterimi i mjeteve juridike në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për zgjidhjen e pasojave të divorcit*, Jeta Juridike, nr. 3, viti 2019
2. A. S. Sweet, *Constitutional Courts*, Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law, OUP, 2012
3. A. Ruggeri, A. Spadaro, *Lineamenti di Giustizia Costituzionale*, G. Giappichelli Editore, 2019
4. A. Vorpsi, J. Bergmann, *Ankimi kushtetues individual. Përvoja gjermane dhe perspektiva shqiptare*, Maluka 2017
5. Buyse, *Lost and Regained? Restitution as a Remedy for Human Rights Violations in the Context of International Law*, ZaöRV 68 (2008)
6. C. Leone, *Il principio di continuità dell'azione amministrativa*, Giuffrè Editore, 2007
7. *Debati Kushtetues - Diskutimet në Komisionin Parlamentar për Hartimin e Projekt-Kushtetutës së vitit 1998*, Vëllimi i Dytë, P.S.H., Tiranë, 2006
8. E. Hasani, M. Brahimi, *Gjyqësia Kushtetuese*, NTG "Blendi", Prishtinë 2021
9. F. Papajorgji, *Types of decisions of the Albanian Constitutional Court and their legal effects*, Euro-Balkan Law and Economics Review, N. 1 (2021); Fascicolo
10. F. Papajorgji, V. Teotonico, *Reflections on individual constitutional complaint in Albania*, Evolution, Journal of life sciences and society, Vol I, Issue 1, July 2020
11. Fjalori i Gjuhës Shqipe të Akademisë së Shkencave, Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, viti 2006
12. G. F. Ferrari, *Judicial Cosmopolitanism*, Brill Nijhoff, Leiden, Boston, 2019
13. G. Zagrebelsky, V. Marceno', *Giustizia costituzionale*, Shtëpia Botuese "Il Mulino", Bologna, 2012
14. H. Kelsen *"La garantie juridictionnelle de la constitution (La Justice constitutionnelle)"*, Revue du droit public et de la science politique en France et a l'étranger, Librairie Général de Droit et the Jurisprudence, Paris 1928
15. K. Traja, *Drejtësia Kushtetuese*, Luarasi, Tiranë, 2000
16. K. Traja, *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe procesi i rregullt ligjor sipas Kushtetutës shqiptare, në 10 vjet Gjykatë Kushtetuese*, Buletin i Posaçëm, Botim i Gjykatës Kushtetuese, Klean, Tiranë, 2003
17. Loiodice, Nr. Shehu, *La Costituzione albanese*, in A. Loiodice (a cura di) *Profili di Innovazione*, Caccuci, Bari, 1999
18. M. P. Maduro, *Mutual trust, mutual recognition and the rule of law*, The XXX FIDE Congress in Sofia, 2023 Congress publications, Vol. 1
19. Ovey, C.A. White, *The European Convention on Human Rights*, Fourth edition, Oxford University Press, New York, 2006
20. Opinione të Komisionit të Venecias CDL-AD (2010)039 rev. dhe CDL-AL (2021)001
21. P. Caretti, U. De Siervo, *Istituzioni di diritto pubblico*, Shtëpia Botuese "G. Giappichelli", Torino, 2010
22. T. Bingham, *Sundimi i Ligjit*, Botimi në shqip, Shtëpia botuese Albas, 2022
23. S. Sadushi, *Kontrolli kushtetues*, Botimpex, Tiranë, 2004
24. Xh. Zaganjori, A. Anastasi, E. (Methasani) Cani, *Shteti i së drejtës në Kushtetutën e RSH*, Aldeprint, Tiranë, 2011

Legjislacioni

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr. 7561, datë 29.04.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese"
3. Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", i ndryshuar
4. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë
5. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë
6. Ligji nr. 49/12 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar
7. Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"
8. Ligji nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti",
9. Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 18, datë 5.8.2020, "Për miratimin e tarifave të përfaqësimit në kuadër të ndihmës juridike dytësore".
10. Ligji nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", i ndryshuar
11. Urdhri nr. 131, datë 02.07.2021 "Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve" i zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë.

Jurisprudenca mbikombëtare*Vendime të GJEDNJ-së*

1. *Adil Aktay kundër Turqisë*, nr. 56064/16, datë 09.01.2024
2. *Agrotexim e të tjerë kundër Greqisë*, nr. 14807/89, datë 24.10.1995
3. *Airey kundër Irlandës*, nr. 6289/73, datë 09.10.1979;
4. *Apicella kundër Italisë* [DhM], nr. 64890/01, datë 29.03.2006;
5. *APIS a.s. kundër Sllovakisë*, nr. 39754/98, datë 13.01.2002
6. *Baku dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 43928/14, datë 10.04.2018
7. *Benet Praha, Spol. S R.O kundër Republikës Çeke*, nr. 33908/04, 7937/05, 25249/05, 29402/05, 33571/06, datë 24/02/2011
8. *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, datë 12.10.2021
9. *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05, datë 27.05.2010
10. *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, datë 4.10.2022
11. *Beshiri kundër Shqipërisë*, nr. 29026/06, datë 17.03.2020
12. *"Blondje" kundër Hollandës*, nr. 7245/09, datë 15.09.2009
13. *Brudnicka e të tjerë kundër Polonisë*, nr. 54723/00, datë 3.03.2005
14. *Fabris dhe Parziale kundër Italisë*, nr. 41603/13, datë 19.03.2020
15. *Căpățînă kundër Rumanisë*, nr. 911/16, datë 28/02/2023
16. *Çela kundër Shqipërisë*, nr. 73274/17, datë 29.11.2022
17. *Çinar kundër Turqisë* (vendim), nr. 48155/99, datë 15.01.2004;
18. *Dalban kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28114/95, datë 28.09.1999
19. *Džinić kundër Kroacisë*, nr. 38359/13, datë 17/05/2016
20. *Gest Jónsson dhe Ragnar Halldór Hall kundër Islandës*, nr. 68273/14 dhe 68271/14, datë 22.12.2020
21. *Gjonbocari dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 10508/02, datë 23.10.2007
22. *Gorraiz Lizarraga e të tjerë kundër Spanjës*, nr. 62543/00, datë 27.04.2004

23. *Ilgar Mammadov kundër Azerbaxhanit* (procedime për shkeljen)[DHM], nr. 15172/13, 29.05.2019
24. *Karácsony dhe të tjerë kundër Hungarisë* [DhM], nr. 42461/13 dhe 44357/13, datë 17.05.2016
25. *Karakó kundër Hungarisë*, nr. 39311/05, datë 28.04.2009
26. *Klass e të tjerë kundër Gjermanisë*, nr. 5029/71, datë 6.09.1978
27. *Kozacioğlu kundër Turqisë*, nr. 2334/03, datë 19.02.2009
28. *Kurt kundër Turqisë*, nr. 15/1997/799/1002, datë 25.05.1998
29. *Libert kundër Belgjikës*, nr. 44734/98, datë 08.07.2004
30. *Łysak kundër Polonisë*, nr. 1631/16, datë 07/10/2021
31. *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, datë 18.12.2007
32. *McCann e të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 18984/91, datë 27.09.1995
33. *Micallef kundër Maltës*, nr. 17056/06, datë 15.10.2009
34. *N.D. dhe N.T. kundër Spanjës* [DHM], nr. 8675/15 dhe 8697/15, 13 shkurt 2020
35. *Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë* [DHM], nr. 41720/13, datë 25.06.2019
36. *Nölkenbockhoff kundër Gjermanisë*, nr. 10300/83, datë 25.08.1987
37. *O'Keefe kundër Irlandës* [DHM], nr. 35810/09, datë 28.01.2014;
38. *Qufaj Co Shpk kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, datë 18.11.2004
39. *Prystavska kundër Ukrainës* (vendim pranueshmërie), nr. 21287/02, datë 17.12.2002
40. *Ringeisen kundër Austrisë*, nr. 2614/65, datë 16.07.1971
41. *Rossi e të tjerë kundër Italisë*, nr. 55185/08, 55483/08, 55516/08, 55519/08, 56010/08, 56278/08, 58420/08 dhe 58424/08 datë 16.12.2008.
42. *Scordino kundër Italisë* (nr. 1)[DhM], nr. 36813/97, datë 26.03.2006.
43. *Sejdic dhe Finci kundër Bosnje dhe Herzegovinës*, nr. 27996/06 dhe nr. 34836/06, datë 22.12.2009
44. *Selahattin Demirtaş kundër Turqisë* (nr. 2)[DhM], nr. 14305/17, datë 22.12.2020
45. *Senator Lines GmbH kundër pesëmbëdhjetë shteteve anëtare të BE* [DHM], nr. 56672/00, datë 10.03.2004
46. *Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14038/88, datë 7.07.1989
47. *Stukus e të tjerë kundër Polonisë*, nr. 12534/03, datë 01.04.2008
48. *Supergrav kundër Shqipërisë*, nr. 20702/18, datë 09.05.2023
49. *Vijayanathan dhe Pusparajah kundër Francës*, nr. 17550/90 dhe 17825/91, datë 27.08.1992
50. *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* [DHM], datë 25.03.2014
51. *Wiot kundër Francës*, nr. 43722/98, datë 15.03.2003;
52. *Xheraj kundër Shqipërisë*, nr. 37959/02, datë 29.07.2008
53. *Yaşa kundër Turqisë*, nr. 63/1997/847/1054, datë 2.09.1998
54. *Ziętal kundër Polonisë*, nr. 64972/01, datë 12.05.2009
55. *Žugić kundër Kroacisë*, nr.3699/08, datë 31.0.5.2011

Vendime të Gjykatave Kushtetuese të tjera

1. Vendim nr.317, datë 30.11.2009 i Gjykatës Kushtetuese Italiane.
2. Vendim BVerfGE 1, § 14 dhe BVerfGE 20, i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane.

Website

1. https://www.echr.coe.int/Documents/Admissibility_guide_ENG.pdf
2. http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/dokumenti_shqip.pdf
3. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)001-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)001-e),
4. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)037-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)037-e)
5. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)023-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)023-e)

6. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036-e)
7. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2009\)044-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2009)044-e)
8. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2009\)007-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2009)007-e)
9. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2007\)029-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2007)029-e)
10. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2004\)034-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2004)034-e)
11. <https://ojs.cimodoc.uniba.it/index.php/law/article/view/1239>.
12. www.gjk.gov.al

Jurisprudenca kombëtare

Vendime të Gjykatës Kushtetuese

- | | |
|------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Vendim nr. 42, datë 29.05.2024 | 36. Vendim nr. 18, datë 04.04.2023 |
| 2. Vendim nr. 39, datë 14.05.2024 | 37. Vendim nr. 16, datë 23.03.2023 |
| 3. Vendim nr. 34, datë 24.04.2024 | 38. Vendim nr. 13, datë 21.03.2023 |
| 4. Vendim nr. 33, datë 23.04.2024 | 39. Vendim nr. 12, datë 15.03.2023 |
| 5. Vendim nr. 31, datë 18.04.2024 | 40. Vendim nr. 10, datë 07.03.2023 |
| 6. Vendim nr. 29, datë 16.04.2024 | 41. Vendim nr. 9, datë 23.02.2023 |
| 7. Vendim nr. 28, datë 11.04.2024 | 42. Vendim nr. 7, datë 21.02.2023 |
| 8. Vendim nr. 22, datë 04.04.2024 | 43. Vendim nr. 6, datë 16.02.2023 |
| 9. Vendim nr. 18, datë 19.03.2024 | 44. Vendim nr. 5, datë 09.02.2023 |
| 10. Vendim nr. 19, datë 21.03.2024 | 45. Vendim nr. 4, datë 08.02.2023 |
| 11. Vendim nr. 17, datë 13.03.2024 | 46. Vendim nr. 3, datë 07.02.2023 |
| 12. Vendim nr. 14, datë 07.03.2024 | 47. Vendim nr. 1, datë 23.01.2023 |
| 13. Vendim nr. 10, datë 28.02.2024 | 48. Vendim nr. 39, datë 15.12.2022 |
| 14. Vendim nr. 5, datë 13.02.2024 | 49. Vendim nr. 38, datë 09.12.2022 |
| 15. Vendim nr. 4, datë 31.01.2024 | 50. Vendim nr. 37, datë 01.12.2022 |
| 16. Vendim nr. 1, datë 25.01.2024 | 51. Vendimi nr. 36, datë 24.11.2022 |
| 17. Vendim nr. 70, datë 27.12.2023 | 52. Vendim nr. 34, datë 17.11.2022 |
| 18. Vendim nr. 69, datë 27.12.2023 | 53. Vendim nr. 33, datë 14.11.2022 |
| 19. Vendim nr. 67, datë 06.12.2023 | 54. Vendim nr. 31, datë 03.11.2022 |
| 20. Vendim nr. 64, datë 30.01.2023 | 55. Vendim nr. 29, datë 01.11.2022 |
| 21. Vendim nr. 63, datë 20.11.2023 | 56. Vendim nr. 26, datë 27.10.2022 |
| 22. Vendim nr. 59, datë 14.11.2023 | 57. Vendim nr. 25, datë 13.10.2022 |
| 23. Vendim nr. 46, datë 03.10.2023 | 58. Vendim nr. 23, datë 10.10.2022 |
| 24. Vendim nr. 44, datë 26.09.2023 | 59. Vendim nr. 22, datë 29.09.2022 |
| 25. Vendim nr. 42, datë 19.09.2023 | 60. Vendim nr. 21, datë 26.09.2022 |
| 26. Vendim nr. 39, datë 15.12.2023 | 61. Vendim nr. 19, datë 07.07.2022 |
| 27. Vendim nr. 35, datë 15.06.2023 | 62. Vendim nr. 18, datë 07.07.2022 |
| 28. Vendim nr. 34, datë 12.06.2023 | 63. Vendim nr. 14, datë 21.06.2022 |
| 29. Vendim nr. 26, datë 16.05.2023 | 64. Vendim nr. 13, datë 26.05.2022 |
| 30. Vendim nr. 24, datë 24.07.2023 | 65. Vendim nr. 12, datë 24.05.2022 |
| 31. Vendim nr. 23, datë 25.05.2023 | 66. Vendim nr. 8, datë 03.03.2022 |
| 32. Vendim nr. 22, datë 25.04.2023 | 67. Vendim nr. 5, datë 22.02.2022 |
| 33. Vendim nr. 21, datë 18.04.2023 | 68. Vendim nr. 4, datë 21.02.2022 |
| 34. Vendim nr. 20, datë 05.04.2023 | 69. Vendim nr. 2, datë 17.02.2022 |
| 35. Vendim nr. 19, datë 04.04.2023 | 70. Vendim nr. 3, datë 17.02.2022 |

71. Vendim nr. 40, datë 21.12.2021
72. Vendim nr. 38, datë 02.12.2021
73. Vendim nr. 37, datë 05.11.2021
74. Vendim nr. 36, datë 04.11.2021
75. Vendim nr. 35, datë 01.11.2021
76. Vendim nr. 34 datë 01.11. 2021
77. Vendim nr. 33 datë 01.11.2021
78. Vendim nr. 31, datë 04.10.2021
79. Vendim nr. 29, datë 02.07.2021
80. Vendim nr. 27/1, datë 05.11.2021
81. Vendim nr. 25, datë 10.05.2021
82. Vendim nr. 23, datë 29.04.2021
83. Vendim nr. 21, datë 28.04.2021
84. Vendim nr. 20, datë 20.04.2021
85. Vendim nr. 18, datë 30.03.2021
86. Vendim nr. 15, datë 11.03.2021
87. Vendim nr. 14, datë 11.03.2021
88. Vendim nr. 12, datë 09.03.2021
89. Vendim nr. 11, datë 09.03.2021
90. Vendim nr. 10, datë 04.03.2021
91. Vendim nr. 9, datë 01.03.2021
92. Vendim nr. 8, datë 23.02.2021
93. Vendim nr. 7, datë 23.02.2021
94. Vendim nr. 6, datë 16.02.2021
95. Vendim nr. 5, datë 16.02.2021
96. Vendim nr. 4, datë 15.02.2021
97. Vendim nr. 2, datë 11.02.2021
98. Vendim nr. 17, datë 19.12.2019
99. Vendim nr. 8, datë 19.03.2018
100. Vendim nr. 5, datë 01.03.2018
101. Vendim nr. 84, datë 26.12.2017
102. Vendim nr. 80, datë 18.12.2017
103. Vendim nr. 79, datë 14.12.2017
104. Vendim nr. 78, datë 12.12.2017
105. Vendim nr. 72, datë 17.11.2017
106. Vendim nr. 71, datë 13.11.2017
107. Vendim nr. 67, datë 10.11.2017
108. Vendim nr. 56, datë 25.07.2017
109. Vendim nr. 49, datë 03.07.2017
110. Vendim nr. 48, datë 03.07.2017
111. Vendim nr. 43, datë 10.04.2017
112. Vendim nr. 29, datë 30.03.2017
113. Vendim nr. 22, datë 20.03.2017
114. Vendim nr. 16, datë 01.03.2017
115. Vendim nr. 15, datë 01.03.2017
116. Vendim nr. 9, datë 07.02.2017
117. Vendim nr. 8, datë 07.02.2017
118. Vendim nr. 5, datë 27.01.2017
119. Vendim nr. 2, datë 18.01.2017
120. Vendim nr. 1, datë 16.01.2017
121. Vendim nr. 86, datë 30.12.2016
122. Vendim nr. 62, datë 04.11.2016
123. Vendim nr. 60, datë 16.09.2016
124. Vendim nr. 58, datë 04.08.2016
125. Vendim nr. 54, datë 27.07.2016
126. Vendim nr. 43, datë 12.07.2016
127. Vendim nr. 39, datë 06.07.2016
128. Vendim nr. 33, datë 08.06.2016
129. Vendim nr. 25, datë 10.05.2016
130. Vendim nr. 30, datë 19.05.2016
131. Vendim nr. 27, datë 19.05.2016
132. Vendim nr. 17, datë 15.03.2016
133. Vendim nr. 12, datë 10.03.2016
134. Vendim nr. 7, datë 24.02.2016
135. Vendim nr. 6, datë 23.02.2016
136. Vendim nr. 3, datë 23.02.2016
137. Vendim nr. 1, datë 21.01.2016
138. Vendim nr. 73, datë 14.12.2015
139. Vendim nr. 67, datë 17.11.2015
140. Vendim nr. 55, datë 27.07.2015
141. Vendim nr. 52, datë 20.07.2015
142. Vendim nr. 48, datë 06.07.2015
143. Vendim nr. 44, datë 29.06.2015
144. Vendim nr. 28, datë 22.05.2015
145. Vendim nr. 5, datë 05.02.2015
146. Vendim nr. 3, datë 26.01.2015
147. Vendim nr. 1, datë 19.01.2015
148. Vendim nr. 33 datë 09.06.2014
149. Vendim nr. 14, datë 21.03.2014
150. Vendim nr. 6, datë 10.02.2014
151. Vendim nr. 1, datë 20.01.2014
152. Vendim nr.18, datë 23.04.2013
153. Vendim nr. 9, datë 15.03.2013
154. Vendim nr. 7, datë 27.02.2013
155. Vendim nr. 3, datë 19.02.2013
156. Vendim nr. 52, datë 05.12.2012
157. Vendim nr. 40, datë 18.07.2012
158. Vendim nr. 38 datë 05.07.2012
159. Vendim nr. 23, datë 23.04.2012
160. Vendim nr. 27, datë 09.05.2012
161. Vendim nr. 19, datë 02.04.2012

162. Vendim nr. 12, datë 05.03.2012
 163. Vendim nr. 8, datë 28.02.2012
 164. Vendim nr. 2, datë 25.01.2012
 165. Vendim nr. 43, datë 06.10.2011
 166. Vendim nr. 33, datë 22.07.2011
 167. Vendim nr. 29, datë 30.06.2011
 168. Vendim nr. 28, datë 23.06.2011
 169. Vendim nr. 24, datë 09.06.2011
 170. Vendim nr. 20, datë 01.06.2011
 171. Vendim nr. 17, datë 16.05.2011
 172. Vendim nr. 14, datë 03.05.2011
 173. Vendim nr. 12, datë 15.04.2011
 174. Vendim nr. 4, datë 23.02.2011
 175. Vendim nr. 36, datë 10.11.2010
 176. Vendim nr. 30, datë 17.06.2010
 177. Vendim nr. 29, datë 31.05.2010
 178. Vendim nr. 21, datë 29.04.2010
 179. Vendim nr. 15, datë 15.04.2010
 180. Vendim nr. 14, datë 15.04.2010
 181. Vendim nr. 12, datë 14.04.2010
 182. Vendim nr. 9, datë 23.03.2010
 183. Vendim nr. 1, datë 25.01.2010
 184. Vendim nr. 32, datë 28.12.2009
 185. Vendim nr. 25, datë 24.07.2009
 186. Vendim nr. 24, datë 24.07.2009
 187. Vendim nr. 15, datë 08.06.2009
 188. Vendim nr. 14, datë 03.06.2009
 189. Vendim nr. 10, datë 02.04.2009
 190. Vendim nr. 12, datë 28.04.2009
 191. Vendim nr. 9, datë 01.04.2009
 192. Vendim nr. 1, datë 19.01.2009
 193. Vendim nr. 26, datë 15.12.2008
 194. Vendim nr. 24, datë 12.11.2008
 195. Vendim nr. 23, datë 04.11.2008
 196. Vendim nr. 22, datë 07.10.2008
 197. Vendim nr. 21, datë 01.10.2008
 198. Vendim nr. 17, datë 25.07.2008
 199. Vendim nr.16, datë 25.07.2008
 200. Vendim nr. 9, datë 19.03.2008
 201. Vendim nr. 8, datë 13.03.2008
 202. Vendim nr. 6, datë 05.03.2008
 203. Vendim nr. 35, datë 10.01.2007
 204. Vendim nr. 27, datë 20.06.2007
 205. Vendim nr. 15, datë 18.04.2007
 206. Vendim nr. 6, datë 16.02.2007
 207. Vendim nr. 5, datë 26.01.2007
 208. Vendim nr. 1, datë 12.01.2007
 209. Vendim nr.29, datë 21.12.2006
 210. Vendim nr. 14, datë 11.12.2006
 211. Vendim nr. 6, datë 31.03.2006
 212. Vendim nr. 41, datë 29.12.2005
 213. Vendim nr. 39, datë 29.12.2005
 214. Vendim nr. 29, datë 09.11.2005
 215. Vendim nr. 17, datë 18.07.2005
 216. Vendim nr. 2, datë 19.01.2005
 217. Vendim nr. 19, datë 23.12.2004
 218. Vendim nr. 14, datë 15.10.2004
 219. Vendim nr. 39, datë 23.12.2003
 220. Vendim nr. 38, datë 23.12.2003
 221. Vendim nr. 31, datë 19.11.2003
 222. Vendim nr. 18, datë 14.05.2003
 223. Vendim nr.15, datë 17.04.2003
 224. Vendim nr. 2, datë 31.01.2003
 225. Vendim nr. 76, datë 25.04.2002
 226. Vendim nr. 95, datë 27.07.2001
 227. Vendim nr. 90, datë 25.07.2001
 228. Vendim nr. 5, datë 07.02.2001
 229. Vendim nr. 69, datë 16.10.2000
 230. Vendim nr. 49, datë 31.07.2000
 231. Vendim nr. 39, datë 23.06.2000
 232. Vendim nr. 38, datë 23.06.2000
 233. Vendim nr. 37, datë 23.06.2000
 234. Vendim nr. 7, datë 28.02.2000
 235. Vendim nr. 30, datë 23.03.1999
 236. Vendim nr. 29, datë 23.03.1999
 237. Vendim nr. 4, datë 27.02.1997
 238. Vendim nr. 4, datë 02.06.1995
 239. Vendim nr. 8, datë 03.11.1994
 240. Vendim nr. 5, datë 15.04.1994

Vendime të Mbledhjes së Gjyqtarëve

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Vendim nr. 103, datë 14.05.2024 | 17. Vendim nr. 76, datë 05.07.2022 |
| 2. Vendim nr. 90, datë 30.04.2024 | 18. Vendim nr. 72, datë 29.06.2022 |
| 3. Vendim nr. 72, datë 08.04.2024 | 19. Vendim nr. 149, datë 13.12.2021 |
| 4. Vendim nr. 52, datë 08.04.2024 | 20. Vendim nr. 86, datë 22.06.2021 |
| 5. Vendim nr. 33, datë 22.02.2024 | 21. Vendim nr. 57, datë 31.03.2021 |
| 6. Vendim nr. 5 datë 12.01.2024 | 22. Vendim nr. 56, datë 31.03.2021 |
| 7. Vendim nr. 265, datë 12.12.2023 | 23. Vendim nr. 44, datë 18.03.2021 |
| 8. Vendim nr. 189, datë 18.09.2023 | 24. Vendim nr. 38, datë 04.03.2021 |
| 9. Vendim nr. 140, datë 26.06.2023 | 25. Vendim nr. 37, datë 04.03.2021 |
| 10. Vendim nr. 94, datë 02.05.2023 | 26. Vendim nr. 47, datë 18.03.2021 |
| 11. Vendim nr. 71, datë 05.04.2023 | 27. Vendim nr. 46, datë 18.03.2021 |
| 12. Vendim nr. 56, datë 17.03.2023 | 28. Vendim nr. 45, datë 18.03.2021 |
| 13. Vendim nr. 194, datë 22.12.2022 | 29. Vendim nr. 12, datë 02.02.2021 |
| 14. Vendim nr. 189, datë 20.12.2022 | 30. Vendim nr. 31, datë 02.03.2016 |
| 15. Vendim nr. 95, datë 14.07.2022 | 31. Vendim nr. 113, datë 11.10.2013 |

Vendime të Kolegjit

- | | |
|-------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Vendim nr. 84, datë 18.04.2024 | 26. Vendim nr. 53, datë 13.03.2023 |
| 2. Vendim nr. 83, datë 18.04.2024 | 27. Vendim nr. 50, datë 02.03.2023 |
| 3. Vendim nr. 71, datë 05.04.2024 | 28. Vendim nr. 48, datë 28.02.2023 |
| 4. Vendim nr. 23 datë 05.02.2024 | 29. Vendim nr. 45, datë 28.02.2023 |
| 5. Vendim nr. 20, datë 05.02.2024 | 30. Vendim nr. 43 datë 22.02.2023 |
| 6. Vendim nr. 19 datë 05.02.2024 | 31. Vendim nr. 42, datë 22.02.2023 |
| 7. Vendim nr. 2 datë 10.01.2024 | 32. Vendim nr. 41 datë 22.02.2023 |
| 8. Vendim nr. 267 datë 19.12.2023 | 33. Vendim nr. 35 datë 22.02.2023 |
| 9. Vendim nr. 254, datë 07.12.2023 | 34. Vendim nr. 34 datë 22.02.2023 |
| 10. Vendim nr. 222 datë 31.10.2023 | 35. Vendim nr. 33 datë 16.02.2023 |
| 11. Vendim nr. 205, datë 09.10.2023 | 36. Vendim nr. 29 datë 13.02.2023 |
| 12. Vendim nr. 194 datë 25.09.2023 | 37. Vendim nr. 23, datë 03.02.2023 |
| 13. Vendim nr. 188 datë 15.09.2023 | 38. Vendim nr. 19 datë 03.02.2023 |
| 14. Vendim nr. 178 datë 18.07.2023 | 39. Vendim nr. 10 datë 20.01.2023 |
| 15. Vendim nr. 162 datë 12.07.2023 | 40. Vendim nr. 9, datë 20.01.2023 |
| 16. Vendim nr. 161 datë 12.07.2023 | 41. Vendim nr. 8, datë 19.04.2023 |
| 17. Vendim nr. 147, datë 05.07.2023 | 42. Vendim nr. 6 datë 20.01.2023 |
| 18. Vendim nr. 128, datë 13.06.2023 | 43. Vendim nr. 2, datë 13.01.2023 |
| 19. Vendim nr. 100, datë 15.05.2023 | 44. Vendim nr. 187, datë 19.12.2022 |
| 20. Vendim nr. 81 datë 19.04.2023 | 45. Vendim nr. 172, datë 06.12.2022 |
| 21. Vendim nr. 76 datë 13.04.2023 | 46. Vendim nr. 162 datë 23.11.2022 |
| 22. Vendim nr. 69, datë 04.04.2023 | 47. Vendim nr. 159, datë 18.11.2022 |
| 23. Vendim nr. 68, datë 04.04.2023 | 48. Vendim nr. 148, datë 09.11.2022 |
| 24. Vendim nr. 59 datë 23.03.2023 | 49. Vendim nr. 124, datë 30.09.2022 |
| 25. Vendim nr. 54, datë 13.03.2023 | 50. Vendim nr. 122 datë 30.09.2022 |

51. Vendim nr. 110, datë 16.09.2022
52. Vendim nr. 111, datë 16.09.2022
53. Vendim nr. 102, datë 19.07.2022
54. Vendim nr. 97, datë 19.07.2022
55. Vendim nr. 96 datë 15.07.2022
56. Vendim nr. 93, datë 14.07.2022
57. Vendim nr. 82 datë 06.07.2022
58. Vendim nr. 80, datë 06.07.2022
59. Vendim nr. 81 datë 06.07.2022
60. Vendim nr. 74, datë 30.06.2022
61. Vendim nr. 54, datë 13.05.2022
62. Vendim nr. 48, datë 20.04.2022
63. Vendim nr. 38, datë 30.03.2022
64. Vendim nr. 36, datë 30.03.2022
65. Vendim nr. 33, datë 29.03.2022
66. Vendim nr. 31, datë 18.03.2022
67. Vendim nr. 14, datë 02.02.2022
68. Vendim nr. 2, datë 08.01.2022
69. Vendim nr. 129, datë 02.11.2021
70. Vendim nr. 119, datë 14.10.2021
71. Vendim nr. 98, datë 28.07.2021
72. Vendim nr. 83, datë 07.06.2021
73. Vendim nr. 79, datë 29.04.2021
74. Vendim nr. 67, datë 12.04.2021
75. Vendim nr.35, datë 26.02.2021
76. Vendim nr. 34, datë 26.02.2021
77. Vendim nr. 26, datë 12.02.2021
78. Vendim nr. 14, datë 05.02.2021
79. Vendim nr. 5, datë 15.01.2021
80. Vendim nr. 97, datë 16.11.2020
81. Vendim nr. 93, datë 20.10.2020
82. Vendim nr. 92, datë 20.10.2020
83. Vendim nr. 90, datë 19.10.2020
84. Vendim nr. 91, datë 19.10.2020
85. Vendim nr. 76, datë 03.07.2020
86. Vendim nr. 74, datë 03.07.2020
87. Vendim nr. 68, datë 20.05.2020
88. Vendim nr. 57, datë 23.04.2020
89. Vendim nr. 52, datë 18.02.2020
90. Vendim nr. 43, datë 06.02.2020
91. Vendim nr. 31, datë 28.01.2020
92. Vendim nr. 16, datë 17.01.2020
93. Vendim nr. 13, datë 17.01.2020
94. Vendim nr. 12, datë 17.01.2020
95. Vendim nr. 11, datë 14.01.2020
96. Vendim nr. 9, datë 14.01.2020
97. Vendim nr. 6, datë 10.01.2020
98. Vendim nr. 28, datë 20.12.2019
99. Vendim nr. 26, datë 20.12.2019
100. Vendim nr.22, datë 19.12.2019
101. Vendim nr. 5, datë 02.12.2019
102. Vendim nr. 227, dt. 12.10.2017
103. Vendim nr. 163, datë 29.06.2017
104. Vendim nr. 71, datë 31.03.2017
105. Vendim nr. 62, datë 29.03.2017
106. Vendim nr. 49, datë 13.03.2017
107. Vendim nr. 50, datë 02.04.2015
108. Vendim nr. 123, datë 22.09.2015
109. Vendim nr. 132, datë 27.06.2014
110. Vendim nr. 110, datë 29.05.2014
111. Vendim nr. 145, datë 10.12.2013

Aneks 1

Fjalorth juridik

<i>Ab origine</i>	- që prej fillimit.
<i>Actio popularis</i>	- e drejta e çdo qytetari për t'i drejtuar gjykatës për cenimin e interesit publik të përgjithshëm, pa pasur nevojën të provojë një interes të drejtpërdrejtë për çështjen.
<i>Amicus curiae</i>	- mik i gjykatës, përdoret në rastin e opinionëve këshillimore
<i>Conditio sine qua non</i>	- kusht pa të cilin.
<i>De quo</i>	- për të cilin flitet.
<i>De facto</i>	- një veprim i cili ndërmerret pavarësisht mungesës së autorizimit nga ligji.
<i>De minimis non curat praetor</i>	- parimi sipas të cilit gjykata që vlerëson pretendimet shkeljet nuk duhet të merret me çështje të vogla të papërfillshme.
<i>Dies a quo</i>	- dita nga e cila fillon të ecë afati.
<i>Dies ad quem</i>	- deri në ditën.
<i>Erga omnes</i>	- me efekt të përgjithshëm.
<i>Ex officio</i>	- për shkak të detyrës, me nismën e tij/saj, kryesisht
<i>Ex lege</i>	- për shkak të ligjit
<i>Ex novo</i>	- nga fillimi, procesi fillon edhe një herë nga e para.
<i>Ex nunc</i>	- vendimi ka efekt për të ardhmen.
<i>Ex plurimus</i>	- midis shumë rasteve
<i>Favor legitimatis</i>	- predispozita/preferenca për ta njohur një akt si të ligjshëm.
<i>Horror vacui</i>	- frika nga kufizimi (hapësirat e ngushta).
<i>In absentia</i>	- në mungesë.
<i>In meius</i>	- alternativa më e favorshme.
<i>In primis</i>	- së pari.
<i>Infra</i>	- në citim, tregon se informacioni shpjegohet më poshtë
<i>Inter partes</i>	- midis palëve.
<i>Inutiliter data</i>	- që nuk ka asnjë efekt.
<i>Ipso jure</i>	- për shkak të ligjit (të të drejtës)
<i>Iter</i>	- procedurë.
<i>Lacuna legis</i>	- boshllëk ligjor
<i>Lex specialis derogat generali</i>	- ligji i veçantë shmang të përgjithshmin
<i>Lex superior derogat inferiori</i>	- ligji më i lartë shmang më të ulët
<i>Locus standi</i>	- e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata në një çështje, e drejta për të paraqitur një ankesë në gjykatë.
<i>Mortis causa</i>	- për shkak të vdekjes.
<i>Nemo iudex in causa sua</i>	- askush nuk gjykon çështjen e tij.
<i>Per se</i>	- në vetvete

<i>Periculum in mora</i>	- rreziku që vjen nga vonesa.
<i>Prima facie</i>	- në pamje të pare.
<i>Quorum</i>	- minimumi i votave të kërkuara nga ligji për të marrë një vendim.
<i>Ratio decidendi</i>	- një element thelbësor për marrjen e vendimit.
<i>Ratione personae</i>	- vetëm pala e cila justifikon intersin e drejtpërdrejtë mund t'i drejtohet gjykatës.
<i>Ratione temporis</i>	- afati kohor i përcaktuar që lejon bërjen e një veprimi (ankimit në gjykatë).
<i>Ratione materiae</i>	- pretendimet janë të tilla që hyjnë në kompetencën e gjykatës.
<i>Res judicata</i>	- gjë e gjykuar
<i>Restitutio in integrum</i>	- rivendosja në vend e së drejtës.
<i>Revirement</i>	- ndryshimi i jurisprudencës.
<i>Salus rei publica suprema lex esto</i>	- interesi i përgjithshëm prevalon mbi interesin vetjak.
<i>Subiecta materia</i>	- në lëndën/ fushën në shqyrtim/analizë.
<i>Super partes</i>	- mbi palët.
<i>Supra</i>	- sipër
<i>Tertium non datur</i>	- pa pasur një alternativë të tretë.
<i>Tout court</i>	- thjesht, pa shpjegime të mëtejshme.
<i>Vulnus</i>	- cenimi i një të drejte.
<i>Ut supra</i>	- siç u përmend më lart.

Aneks 2

Vendime të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë

- **Qufaj Co. Sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr. 54268/00, datë 18.11.2004**

Ankuesja, një kompani ndërtimi, bleu një sipërfaqe toke nga bashkia e Tiranës, e cila i dha edhe lejen e planifikimit për ndërtim. Megjithatë, bashkia më pas refuzoi t'i jepte kompanisë lejen e nevojshme të ndërtimit. Padia e saj për kompensim u rrëzua nga Gjykata e Rrethit, por u la në fuqi nga Gjykata e Apelit, vendim i cili mori formë të prerë. Bashkia në mënyrë të përsëritur refuzoi ekzekutimin e këtij vendimi.

Gjykata vlerësoi se parimet e procesit të rregullt duhet të ishin interpretuar në një mënyrë që t'i garantonin ankueses një mjet juridik efektiv për zbatimin e vendimit në favor të saj. Në çdo rast, ai nuk duhet të ishte penguar të përfitonte nga gjykimi në favor të tij për shkak të vështirësive financiare të pretenduara të shtetit.

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

- **Xheraj kundër Shqipërisë, nr. 37959/02, datë 29.07.2008**

Ankuesi ishte dënuar në mungesë për kryerjen e një vepre penale. Pas marrjes dijeni të këtij fakti, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ankuesi iu drejtua gjykatave të zakonshme. Me vendim të gjykatës së apelit ai u shpall i pafajshëm. Në vijim, prokurori i çështjes bëri kërkesë jashtë afatit në Gjykatën e Lartë për rivendosje në afat të së drejtës së rekursit, e cila u pranua nga Gjykata e Lartë. Ankuesi pretendoi se procesi për rishikimin e vendimit të pafajësisë së tij, i cili ishte përfundimtar, kishte qenë i padrejtë, pasi as ai dhe as avokati i tij nuk ishin informuar për seancat gjyqësore dhe si rezultat, atij i ishte cenuar e drejta e mbrojtjes.

Gjykata vlerësoi se argumentet e palëve të përdorura nga prokurori për të justifikuar kërkesën për rivendosje në afat ishin të pamjaftueshme për të justifikuar vënien në pikëpyetje të një vendimi përfundimtar dhe për të përdorur këtë mjet të jashtëzakonshëm. Lejimi i kërkesës së prokurorit nuk vendos një baraspeshë ndërmjet interesit të aplikantit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale.

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6. Nuk ka pasur shkelje të nenit 4 të Protokollit 7 të Konventës.

- **Shkalla kundër Shqipërisë, nr. 26866/05, datë 10.05.2011**

Ankuesi ishte dënuar në mungesë me burgim të përjetshëm për kryerjen e një vepre penale. Pas marrjes dijeni të këtij vendimi, ai ka caktuar një përfaqësues për të paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, për të kundërshtuar procesin penal të zhvilluar në mungesë, kërkesë e cila u rrëzua me argumentin se ishte paraqitur jashtë afatit ligjor 2 vjeçar.

Gjykata vlerësoi se ankuesit i ishte cenuar e drejta e aksesit në Gjykatën Kushtetuese dhe proceset e zhvilluar për gjykimin e tij në mungesë kishin qenë të parregullta.

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

- **Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë, nr. 604/07, 34770/09, 43628/07, datë 31.07.2012 - vendim pilot**

Njëzet individë të cilët pavarësisht se kishin trashëguar tituj pronësie mbi sipërfaqe toketë njohura nga autoritetet me vendime administrative të formës së prerë që u jepnin kompensim në një nga format e njohura nga ligji në lidhje me kthimin e pronës u ankuan në Gjykatë me argumentin se këto vendime nuk ishin zbatuar. Nisur nga fakti se këto ankesa pasqyronin një problem të përhapur në Shqipëri që prekte një numër të madh individësh, Gjykata vendosi të zbatojë procedurën e vendimit pilot në këtë çështje. Ajo u shpreh se Shqipëria duhej të merrte masa të përgjithshme për të siguruar efektivisht të drejtën e kompensimit brenda 18 muajve nga data në të cilën vendimi mori formën e prerë.

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të Nenit 6 § 1, Nenit 1 Protokolli nr. 1 dhe Nenit 13 të Konventës.

- **Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr. 29026/06, datë 17.03.2020**

Ankuesit u drejtuan GJEDNJ-së me pretendimin për mosekzekutimin e vendimeve përfundimtare të cilat u kishin njohur atyre kompensimin e pasurive të shpronësuara gjatë regjimit komunist.

Gjykata vendosi se kërkesa ishte e papranueshme. Ajo analizoi skemën e re ligjore të miratuar pas vendimit pilot në çështjen Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë. Sipas saj, me qëllim që të parandalohet një barrë e tepërt për subjektet e shpronësuara, mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv nëse shuma totale e kompensimit, pavarësisht formës së kompensimit, arrin të paktën 10% të vlerës që do të ishte përfituar nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral aktual të pronës së shpronësuar. Pragu minimal 10% për vlerën e kompensimit mund të konsiderohet i arsyeshëm në kontekstin specifik të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri, për shkak të nivelit të përgjithshëm sakrifikes që skema e re e kompensimit imponon tek subjektet e shpronësuara, krahasuar me pritshmërinë e tyre për të marrë kompensim me vlerën e tanishme të tregut që buronte nga legjislacioni i mëparshëm.

- **Xhoxhaj kundër Shqipërisë, nr.15227/19, datë 09.02.2021**

Ankuesja, ish anëtare e Gjykatës Kushtetuese u ankua kundër procesit të rivlerësimit të zhvilluar ndaj saj, i njohur si procesi i vetingut, në përfundim të të cilit ajo u shkarkua nga detyra. Ajo ngriti një sërë pretendimesh në kuadër të procesit të rregullt ligjor, sipas Nenit 6 të KEDNJ-së, duke kundërshtuar legjitimitetin e trupave të rivlerësimit dhe procesin në tërësi. Veç kësaj, ajo pretendoi se si pasojë e shkarkimit nga detyra, ishte cenuar në të drejtën e saj për jetë private dhe familjare garantuar nga Neni 8 i KEDNJ.

Gjykata konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 § 1 pasi organet e vetingut kishin qenë të pavarura dhe të paanshme, procesi kishte qenë i drejtë dhe nuk ishte cenuar parimi i sigurisë juridike. Gjykata vlerësoi gjithashtu se shkarkimi nga detyra kishte qenë proporcional dhe se ndalimi ligjor i përjetshëm i vendosur ndaj ankuseses për t'u emëruar në sistemin e drejtësisë për shkak të

shkeljeve të rënda etike ishte në përputhje me sigurimin e integritetit të detyrës së gjyqtarit dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Gjykata vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1, nenit 8 të Konventës.

- **Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, nr. 43391/18 dhe 17766/19, datë 12.10.2021.**

Gjykata konstatoi se duke marrë parasysh reformat gjyqësore që po bëheshin në Shqipëri në atë kohë, gjykatat vendase nuk kishin arritur t'i trajtonin çështjet e aplikantëve me një shpejtësi të mjaftueshme, që nënkuptonte se procedurat nuk ishin zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm. Përveç kësaj, ajo konstatoi se mjeti i ri juridik sipas Kodit të Procedurës Civile, i miratuar në vitin 2017, nuk kishte ndihmuar në përshpejtimin e procedimeve, duke e lënë aplikantin e parë pa mjete juridike në dispozicion. Megjithatë, Gjykata deklaroi se mjeti i ri juridik në parim ishte në përputhje me nenin 13 dhe për këtë arsye duhet të shterohej përpara se të parashtrohen ankesa të ngjashme në Gjykatë.

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të 6 § 1 të Konventës.

- **Çela kundër Shqipërisë, nr. 73274/17, datë 29.11.2022**

Pas përfundimit të gjykimit të çështjes së tij civile në gjykatat e zakonshme, ankuesi iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin e kolegjit nr. 163, datë 29.06.2017 vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare me argumentin se kërkesa ishte paraqitur tej afatit 4-mujor të futur rishtaz me ligjin nr. 99/2016, i cili ndryshoi Ligjin Organik të Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata vlerësoi se megjithëse afati për paraqitjen e kërkesës i shkurtuar nga 2 vjet në 4 muaj synonte forcimin e sigurisë juridike, ndiqte një qëllim të ligjshëm dhe nuk ishte në vetvete në kundërshtim me nenin 6 § 1 të Konventës, ai vinte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Në rastin konkret, meqenëse ligji nr. 99/2016 kishte krijuar paqartësi se si do të llogaritej afati i ri për paraqitjen e ankimit kushtetues, Gjykata Kushtetuese duhej të sqaronte mënyrën e saktë që do të përdorej në përlogaritjen e këtij afati.

Gjykata vendosi se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

- **Hysa kundër Shqipërisë, nr. 52048/16, datë 21.02.2023**

Ankuesja ishte e dyshuar për kryerjen e një vepre penale. Ndaj saj u aplikua masa e sigurimit arrest me burg vendim i cili u la në fuqi nga gjykatat e zakonshme. Në një datë të mëvonshme, kjo masë u revokua duke u vendosur masa e sigurimit "arrest në shtëpi".

Gjykata konstatoi se vendimet e gjykatave të zakonshme u bazuan kryesisht në pasojat e rënda financiare të veprës në fjalë dhe në faktin që ankuesja dyshohej se e kishte kryer atë duke shpërdoruar detyrën e saj publike. Megjithatë, ashpërsia e veprës penale ose pasojat e saj nuk përbënin arsye të pavarura që justifikonin paraburgimin dhe nuk mund të justifikonin, në vetvete, heqjen e lirisë së një të dyshuari, përveç nëse ato merren parasysh gjatë vlerësimit të ekzistencës së arsyeve të lejueshme sipas të cilave mund të urdhërohet paraburgimi, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës. Gjithashtu refuzimi i Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar bazueshmërinë e ankimit kushtetues të ankueses nënkuptonte se mangësitë në arsyetimin e vendimeve të shkallës së parë

dhe të apelit nuk u korrigjuan dhe shkelja e të drejtës së saj për liri nuk u korrigjua, nga Gjykata e Lartë ose Gjykata Kushtetuese.

GJEDNJ konstatoi se ka pasur shkelje të nenit 5 § 3 të Konventës

- **Supergrav Albania shpk kundër Shqipërisë, nr. 20702/18, datë 09.05.2023**

Ankuesja shoqëria Supergrav Albania shpk iu drejtua Gjykatës Kushtetuese pas përfundimit të gjykimit të çështjes civile në gjykatat e zakonshme. Me vendimin nr. 241, datë 08.11.2017, Kolegji i kësaj gjykate vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin se aplikantja nuk legjitimohej *ratione temporis* për paraqitjen e kërkesës.

GJEDNJ-ja analizoi faktin se megjithëse shkurtimi i afatit kohor për paraqitjen e kërkesave në Gjykatën Kushtetuese kishte për qëllim forcimin e sigurisë juridike dhe i shërbeu shmangies së periudhave të gjata përpara arritjes së rezultatit përfundimtar të një çështjeje të caktuar, mënyra në të cilën ato zbatohen në një çështje të caktuar mund të shkaktojë shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për shembull nëse afati kohor për paraqitjen e ankimit fillon të ecë në momentin kur pala nuk e dinte dhe nuk mund ta dinte në mënyrë efektive përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar të gjykatës më të ulët.

Gjykata vlerësoi se palët duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga e drejta për të bërë ankim që nga momenti kur marrin vesh efektivisht për vendimet gjyqësore që u ngarkojnë atyre një barrë ose që mund të cenojnë të drejtat ose interesat e tyre të ligjshme. Si një mjet komunikimi ndërmjet organit gjyqësor dhe palëve, dhënia e vendimit ua bën të njohura palëve vendimin e gjykatës dhe arsyet e vendimmarrjes, duke u mundësuar atyre të ankohen nëse e shohin të arsyeshme. Pra, afati kohor për paraqitjen e ankimit kushtetues duhet të ishte llogaritur që nga data që ankuesja kishte marrë dijeni për vendimin që do të kundërshtojë.

Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

Aneks 3

Formular për ankim kushtetues individual.

ANKIM KUSHTETUES INDIVIDUAL⁵³⁵ DREJTUAR GJYKATËS KUSHTETUESE

KËRKUES:*

1. Emri, atësia, mbiemri; 2) Datëlindja; 3) Adresa e plotë (në të cilën preferoni të kontaktoheni nga Gjykata Kushtetuese), përfaqësuar nga av. _____, me prokurë nr. ____ , datë _____ .

(Nr. telefoni, adresa email-it të kërkuesit dhe/ose të avokatit).

2. (Nëse ka më shumë se një kërkues, të dhënat duhet të jepen si më lart për secilin nga kërkuesit).

SUBJEKT I INTERESUAR (ose SUBJEKTE TË INTERESUARA, sipas rastit): *

1. (1. Emri, mbiemri; 2) Adresa e plotë e subjektit/eve të interesuar/a)

2. (Nëse ka më shumë se një subjekt të interesuar, të dhënat duhet të jepen si më lart për secilin nga subjektet).

OBJEKTI I KËRKESËS:*

1) **Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. _____, datë ____ të Gjykatës _____; nr. _____, datë ____ të Gjykatës _____.**

(Objekti i kërkesës duhet të përmbajë qartësisht vendimin ose vendimet gjyqësore që kundërshtohen para Gjykatës Kushtetuese. Sipas rastit, mund të kundërshtoni një vendim ose disa vendime të gjykatave).

Ose:

2) **Shfuqizimi si antikushtetues i aktit të pushtetit publik nr. _____, datë _____.**⁵³⁶

BAZA LIGJORE:*

Neni/Nenet ____ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Neni / nenet _____ të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

neni/nenet _____ të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

(Duhet të përcaktoni qartësisht parashikimet kushtetuese dhe ligjore, që garantojnë të drejtat që pretendoni se ju janë shkelur! Në këtë pjesë mund të referoni dhe nene të ligjeve ose akteve të tjera që garantojnë të drejtat tuaja).

⁵³⁵ Ky formular gjendet edhe në faqen zyrtare të Gjykatës www.gjk.gov.al

Çdo fushë/rubrikë me shënimin * është e detyrueshme të plotësohet.

⁵³⁶ Plotësoni pikën 1 të "Objektit të kërkesës" nëse kundërshtoni vendime të gjykatave dhe pikën 2 nëse kundërshtoni akt të pushtetit publik, përjashtuar vendimet e gjykatave.

I. PARAQITJA E FAKTEVE*

(Në këtë pjesë jepni një përmbledhje të rrethanave të çështjes suaj, si dhe argumenteve të paraqitura nga ana juaj para gjykatave).

II. LEGJITIMIMI I KËRKUESIT (neni 71/a i ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar)

a) Argumentoni nëse keni qenë pjesë e procesit gjyqësor ose jeni bartës i të drejtave themelore kushtetuese të cenuara nga vendimi gjyqësor i kundërshtuar ose akti publik i kundërshtuar (*ratione personae*).

b) Argumentoni nëse keni respektuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit dhe dokumentet provuese për këtë qëllim.

c) Argumentoni nëse keni shteruar mjetet ligjore në dispozicion dhe se nuk ka mjete të tjera të pashteruara ose se legjislacioni nuk i parashikon ato.

ç) Argumentoni se cila e drejtë apo liri kushtetuese ju është cenuar, cilat janë pasojat negative, reale dhe konkrete që ju kanë ardhur, si edhe si mund të riparohen.

III. PRETENDIMET NË LIDHJE ME SHKELJET KUSHTETUESE*

(Në këtë pjesë paraqisni argumentet tuaja në lidhje me shkeljet e natyrës kushtetuese që pretendoni se u janë bërë. Pretendimet duhet të jenë të ndara për secilën nga shkeljet e natyrës kushtetuese që kundërshtoni para Gjykatës Kushtetuese).

A. Për ____ (argumente për këtë shkelje kushtetuese)
(Lutemi jepni shpjegimet dhe argumentet tuaja për pikën A!)

B. Për ____ (argumente për këtë shkelje kushtetuese)
(Lutemi jepni shpjegimet dhe argumentet tuaja për pikën B!)

(Vazhdoni në pikat C, D etj. për çdo pretendim që keni)

IV. KËRKESA PËRFUNDIMTARE*

Në përfundim, kërkoj/më nga Gjykata Kushtetuese shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit (ose vendimeve) nr. _____, datë ____ të Gjykatës ____; nr. ____ , datë ____ të Gjykatës ____ (ose aktit të pushtetit publik nr. ____ , datë ____ , nëse kundërshtoni një akt të tillë, sipas pikës 2 të "Objektit të kërkesës").

(Kjo pjesë është e njëjtë me objektin e kërkesës.)

V. LISTA E DOKUMENTEVE BASHKËLIDHUR

1.
2.
3.
4.
5.

(Lutemi rendisni në rend kronologjik sipas datës së aktit (kërkesë, vendim, ankim, vendim, rekurs, vendim, etj.), si dhe listoni të gjitha dokumentet që i bashkëlidhen kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese!)

Kërkues:

(Emër, mbiemër, firmë)*

(Nëse kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i kërkuesit, ajo duhet edhe të nënshkruhet prej tij).

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Xhaferllari, Marsida
Ankimi kushtetues individual :
manual praktik / Marsida Xhaferllari,
Dr. Fiona Papajorgji, Përparim Kalo.
- Tiranë : Gent Grafik, 2024.
152 f. ; 21 x 29.7 cm.
ISBN 9789928395405
I.Papajorgji, Fiona II.Kalo, Përparim

1.Të drejtat e njeriut 2.Gjykata
3.Vendime gjyqësore 4. Shqipëri

347.956 :342.72/73(496.5)

